



Ndikimi i sistemeve zgjedhore në sjelljen e deputetëve

Shqipe Mjekiqi, PhD

Ndikimi i sistemeve zgjedhore në sjelljen e deputetëve

Shqipe Mjekiqi, PhD

Titulli:

Ndikimi i sistemeve zgjedhore në sjelljen e deputetëve

Botues:

Fondacioni Konrad Adenauer në Republikën e Kosovës

Autore:

Shqipe Mjekiqi, PhD

Koordinimi:

Fondacioni Konrad Adenauer në Republikën e Kosovës

Dizajni:

Tedel

Publikimi mund të shkarkohet falas në: <http://www.kas.de/>
Kosovo

Vërejtje:

Qëndrimet e prezantuara në këtë libër janë pikëpamje personale të autorit dhe ato nuk paraqesin patjetër qëndrimet e Fondacionit Konrad Adenauer.

Ky botim nga Fondacioni Konrad Adenauer është vetëm për informacion. I njëjti nuk mundet të përdoret për qëllime fushate gjatë një fushate zgjedhore.

Katalogimi në botim – (CIP)

Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

324

Mjekiqi, Shqipe

Ndikimi i sistemeve zgjedhore në sjelljen e deputetëve / Shqipe Mjekiqi. - Prishtinë : Fondacioni Konrad Adenauer në Republikën e Kosovës, 2022. - 201 f. : ilustr. ; 28 cm.

Zgjedhjet -- Sistemi zgjedhor -- Kosovë

ISBN 978-9951-8664-4-6

Aleph [000100672]

Mirënjohje

Ky libër, i cili është rezultat i hulumtimit që kam kryer gjatë studimeve të doktoraturës në Shkenca Politike në Trinity College Dublin (TCD) gjatë viteve 2010-2014, nuk do të ishte realizuar pa ndihmën që kam marrë nga mentori im, familja, miqtë, kolegët dhe personat që takova gjatë kryerjes së punës në terren, ose gjatë pjesëmarrjes në konferenca ndërkombëtare. Ndjej detyrim ndaj personave të mëposhtëm për ndihmën dhe mbështetjen e tyre. Para të gjithëve, dëshiroj të vlerësoj udhëzimin dhe mbështetjen e palodhshme të mentorit tim, Prof. Michael Gallagher, i cili ishte po aq entuziast sa unë që në fillimet e projektit. Njohuritë dhe ekspertiza e pamasë e Michael në fushën e sistemeve zgjedhore janë reflektuar shumë në punën time. Ai gjithmonë më inkurajonte të përpiqesha më shumë dhe të eksploroja një fushë që ishte eksploruar pak në rajonin e Evropës Juglindore. Kontributi im në këtë temë është rezultat i besimit të Michael në atë që mund të arrija.

Grumbullimi dhe analizimi i votimeve të hapura ishte punë e gjatë dhe e lodhshme. Kryesisht, dëshiroj të falënderoj Raimondas Ibenskas dhe Lukas Kuld, ish studentë të doktoraturës në Trinity College Dublin, për ndihmën e tyre veçanërisht për analizat e votimeve. Përveç tyre, u jam mirënjohës Margit Tavits që më siguroi votat nga Parlamentet e vendeve të Evropës Qendrore dhe Lindore, Ulrich Sieberer për votat e shumë prej vendeve të Evropës Perëndimore, Sam Depauw dhe Shane Martin për disa nga votat e këtyre shteteve, Ismet Krasniqit, sekretar i Kuvendit të Kosovës, dhe Lulzim Latifit, punonjës i Kuvendit, që më siguruan të dhënat për Kosovën, Haki Abazit nga Fondi Rockefeller Brothers për vendosjen e kontakteve me përfaqësuesit e Orgaizatës Joqeveritare MANS (Mreza za Armaciju Nevladinog Sektora) nga Mali i Zi, të cilët mbledhën votat nga Mali i Zi në emrin tim, dhe përfaqësuesve të OJQ-së CRTA (Centar za Istraživanje, Transparentnost i Odgovornost) nga Serbia, përkatësisht Vukosava Crnjanski, Bojana Milloshević dhe Ivana Tošović, të cilat bënë të njëjtën gjë për sa i përket të dhënave nga Serbia, si dhe Hideo Oda, një ish student universitar në Trinity College, i cili kaloi muaj duke nxjerrë të dhëna nga web faqet e parlamenteve të Maqedonisë së Veriut dhe Sllovenisë.


Më duhet gjithashtu të shpreh mirënjohjen time për personat që bënë të mundur punën time në terren në një periudhë relativisht të shkurtër kohore, si në Kosovë ashtu edhe në Maqedoninë e Veriut. Në përgjithësi, dëshiroj të falënderoj të gjithë

deputetët e të dy parlamenteve që iu përgjigjën pyetësorit tim dhe madje më vunë në kontakt me kolegët e tyre. Po ashtu, u jam mirënjohës Arban Abrashit nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) që më ndihmoi të organizoj intervistat me anëtarët e partisë së tij, homologut të tij nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK) Abelard Tahirit, me kryetarin e athershëm të Grupit Parlamentar të Bashkimit Demokratik për Integrim (BDI) të Maqedonisë së Veriut, Nexhati Jakupit, dhe gjithë stafit të tij që më pritën, më ndihmuan për organizimin e intervistave, dhe më bënë shoqëri gjatë qëndrimit tim në Maqedoninë e Veriut. Gjithashtu i jam shumë mirënjohës Driton Nebiut, këshilltarit të z. Jakupi, i cili përktheu në shumë raste nga shqipja në maqedonisht dhe anasjelltas. Së fundi, vlerësoj ndihmën që mora nga Dane Taleski, i cili më ndihmoi të organizoja takime me deputetët e Maqedonisë së Veriut, madje përktheu në disa raste, edhe pse ishte duke përfunduar tezën e tij të doktoraturës. Pa ndihmën e Dritonit dhe Danes, mostra ime do të kishte qenë e njëanshme.

Më duhet gjithashtu të falënderoj një numër studiuesish për komentet dhe sygjerimet e tyre në raste të ndryshme. Para të gjithëve, i jam mirënjohës Fernando Casal Bertoa për komentet e tij në shumë nga punimet e mia dhe veçanërisht për drejtimin dhe ndihmën e tij për matjen e institucionalizimit të sistemit partiak. Po ashtu, falënderoj Matt Golder për komentet e vlefshme gjatë pjesëmarrjes në takimin vjetor të Shoqatës Amerikane të Shkencave Politike (APSA) në vitin 2013, dhe komentet e tij të mëvonshme në një nga kapitujt e librit, dhe Eric Magar për komentet e tij gjatë takimit të Shoqatës së Mësuesve të Shkencave Politike (MPSA) në vitin 2014. Gjithashtu dëshiroj të falënderoj ish kolegët e mi nga TCD për komentet, sugjerimet dhe mbështetjen e tyre në një mënyrë apo tjetër gjatë katër viteve, saktësisht Donata Katharina Brunelli, Adriana Bunea, Michael Courtney, Raj Chari, Michelle D'Arcy, Sander Ensink, Christian Houle, Lisa Keenan, Tom Louwerse, Caroline McEvoy, Nelson Mills, Jessie Smith, Marta Smolen, dhe Magda Staniek.

Gjithashtu jam mirënjohës për mbështetjen bujare nga Konrad Adenauer Stiftung (KAS) në Kosovë për botimin e këtij libri. Teksa u riaktivizova në politikë, rrugët tona u kryqëzuan sërish pas shumë vitesh. Ky libër është një kontribut për miqësinë tonë të rinovuar.

Së fundi, por jo për nga rëndësia, janë dashuria dhe mbështetja e pafundme që kam marrë nga familja ime, prindërit e mi Rasim dhe Naxhije, si dhe motrat e mia Mimoza dhe Venera. Ishin ata që më inkurajuan ta nis këtë rrugë, më ndoqën gjatë gjithë kohës, dhe më qëndruan pranë edhe në kohët e vështira. Teksa botoj këtë libër më kujtohet dashuria dhe mbështetja që marr nga bashkëshorti im Armendi dhe dy fëmijët tanë Eno dhe Irna, të cilëve u jam përjetësisht mirënjohës.



Dedikuar

Prindërve të mi
Rasim dhe Naxhije Mjekiqi.

Përmbledhje

Ky libër shqyrton ndikimin e sistemeve zgjedhore në mënyrën si sillen deputetët, e matur si në aspektin e unitetit të Grupit Parlamentar (GP) ashtu edhe të lidhjeve me elektoratin. Argumenti kryesor është se është e mundshme që sistemet zgjedhore të kenë ndikim më të madh në sjelljen e deputetëve në demokracitë e reja që kanë Institucionalizim të dobët të Sistemit Partiak (ISP) sesa në demokracitë e konsoliduara parlamentare që kanë nivele të larta të ISP-së. Argumenti im është se në vendet me ISP të dobët, sistemet zgjedhore që lejojnë konkurrencën brenda partisë ka të ngjarë të çojnë në unitet më të ulët të GP-së dhe lidhje më të forta me elektoratin, ndërsa sistemet zgjedhore që nuk kanë konkurrencë brenda partisë ka të ngjarë të çojnë në unitet më të lartë të GP-së dhe lidhje më të dobëta me votuesit. Teksa në vendet me ISP të lartë, sistemet zgjedhore kanë pak ndikim në sjelljen e deputetëve, pasi deputetët përgjithësisht priren të votojnë në linjë me partinë e tyre dhe të krijojnë lidhje të ngushta me zgjedhësit e tyre pavarësisht sistemeve zgjedhore, ka shumë pak njohuri për ndikimin real, nëse ka, të sistemeve zgjedhore në vendet ku ISP është i ulët.

Hulumtimi përdor një qasje sasiore duke analizuar rezultatet e votimeve (RV) nga 21 vende evropiane, duke përfshirë 6 vende të Evropës Juglindore (EJL) që nuk janë studiuar më parë, dhe veç kësaj përdor një qasje cilësore për të shqyrtuar shkallën në të cilën deputetët në dy vende të EJL-së, përkatësisht Kosovë dhe Maqedoni të Veriut, krijojnë lidhje të ngushta me zgjedhësit e tyre. Analiza e RV-ve tregon se uniteti i GP-së është përgjithësisht më i ulët në vendet e EJL-së në krahasim me vendet e Evropës Perëndimore (EP), megjithëse ndryshimi nuk është domethënës. Për më tepër, rezultatet e analizave të regresionit me shumë nivele tregojnë se institucionalizimi i sistemit partiak ka më shumë rëndësi sesa sistemet zgjedhore. Pra, kur niveli i ISP-së është i ulët, uniteti pritet të jetë përgjithësisht më i lartë në sistemet proporcionale (SP) me lista të mbyllura, midis sistemeve të tjera të orientuara kah partia,

dhe më i ulët në SP me lista të hapura, midis sistemeve të tjera të orientuara kah kandidati. Partitë që janë në qeveri shihen gjithashtu si më kohezive në krahasim me partitë opozitare. Dhe, në mënyrë të ngjashme, sa më i vogël të jetë marzhi i qeverisë ndaj opozitës brenda parlamentit, aq më i lartë është uniteti i GP-së.

Kur shqyrtohet ndikimi i sistemeve zgjedhore në kontaktet e deputetëve me zgjedhësit e tyre në zona zgjedhore, në rastin e Kosovës, ku sistemi zgjedhor ndryshoi nga SP me listë të mbyllur në SP me listë të hapur, shohim se me vendosjen e sistemit të hapur deputetët zhvillojnë më shumë lidhje me zgjedhësit e tyre sesa ish kolegët e tyre. Nën sistemin proporcional me lista të hapura deputetët kanë raportuar se shpenzojnë më shumë orë në aktivitete të ndryshme me votues, kalojnë më shumë kohë në zonën e tyre lokale, marrin një numër më të madh kërkesash në javë nga votuesit, dhe shpenzojnë më shumë kohë duke u marrë me ato kërkesa. Rasti i Maqedonisë së Veriut, me sistem proporcional me lista të mbyllura, tregon gjithashtu se deputetët prirën të zhvillojnë lidhje të ngushta me zgjedhësit e tyre, por intervistat me deputetët zbuluan se kjo është kryesisht për shkak të metodave të përzgjedhjes së kandidatëve, ku vendimi i partive se ku do të vendosen kandidatët në listë varet nga popullariteti i tyre në mesin e votuesve. Ky konstatim tregon se vetëm sistemi zgjedhor nuk mjafton për ta kuptuar dhe parashikuar sjelljen e deputetëve. Nëse përdoren sondazhet e opinionit publik për të përcaktuar renditjen në listë, siç ndodh në Maqedoninë e Veriut, atëherë në fakt kjo i afrohet transformimit të një sistemi nominalisht me listë të mbyllur në një sistem de fakto me lista të hapura.

Në përgjithësi, hulumtimi tregon se ndikimi i sistemeve zgjedhore është më i nuancuar sesa kanë sugjeruar disa hulumtime të mëparshme. Ndikimi varet nga faktorë të tjerë, veçanërisht nga niveli i institucionalizimit të sistemit partiak. Kur ISP është i ulët, sistemi zgjedhor, veçanërisht zgjedhja mes versioneve të SP me lista të hapura dhe të mbyllura, ka gjasa të ketë ndikim më të madh sesa kur ISP është i lartë. Për më tepër, edhe ndikimi unifikues i SP me lista të mbyllura mund të shuhet nga aspekte të tjera të procesit përmes të cilit individët bëhen deputetë, veçanërisht nga procesi i përzgjedhjes së kandidatëve, gjë që në Maqedoninë e Veriut ka efektin e nxitjes së deputetëve për të qenë më të afërt me votuesit siç parashikohet të sillen deputetët e zgjedhur më SP me listë të hapur. Prandaj, studimi sugjeron se niveli i institucionalizimit të sistemit partiak dhe metodat e përzgjedhjes së kandidatëve janë variabla të rëndësishme që nuk duhen neglizhuar në asnjë teori për unitetin e GP-së dhe lidhjet ndërmjet deputetëve dhe elektoratit.

Tabela e përmbajtjes

1. Hyrje	17
1.1 Hyrje	17
1.2 Institucionalizimi i Sistemit Partiak (ISP)	21
1.3 Skema e librit	34
2. Shqyrtimi i literaturës dhe hipotezat	37
2.1 Mekanizmat teorikë	39
2.2 Uniteti i Grupit Parlamentar (GP)	41
2.2.1 Formulatat zgjedhore	42
2.2.2 Përzgjedhja e kandidatëve	47
2.2.3 Faktorët partiakë	48
2.3 Lidhjet me votuesit	49
2.3.1 Formulatat zgjedhore	50
2.3.2 Përzgjedhja e kandidatëve	56
2.3.3 Rolet përfaqësuese	57
3. Metodologjia	63
3.1 Rezultatet e votimeve (RV)	64
3.1.1 Mbledhja e të dhënave	65
3.1.2 Matja	70
3.2 Intervistat	70
3.2.1 Mbledhja e të dhënave	72
3.2.2 Matja	77

4. Ndikimi i sistemeve zgjedhore në sjelljen e deputetëve	81
4.1 Hyrje	81
4.2 Analiza	84
4.2.1 Uniteti i GP sipas çështjeve	90
4.3 Gjetjet	96
4.3.1 Uniteti i GP sipas çështjeve	103
4.4. Diskutim	107
5. Shtrirja e lidhjeve me votuesit në mesin e deputetëve në Kosovë: krahasimi i sjelljes së deputetëve në sistemin proporcional me lista të mbyllura dhe me atë me lista të hapura	109
5.1 Hyrje	109
5.2 Institucionalizimi i Sistemit Partiak (ISP)	111
5.3 Sistemi zgjedhor dhe ai partiak	114
5.4 Gjetjet	117
5.5 Diskutim	136
6. Deri në çfarë mase zhvillojnë lidhje të ngushta me zgjedhësit e tyre deputetët në sistemet zgjedhore me lista të mbyllura? Dëshmi nga Maqedonia e Veriut	139
6.1 Hyrje	139
6.2 Institucionalizimi i Sistemit Partiak (ISP)	141
6.3 Sistemi zgjedhor dhe partiak	143
6.4 Gjetjet	145
6.5 Krahasimi i sjelljes së deputetëve të Maqedonisë së Veriut me atë të homologëve të tyre kosovarë	163
6.6 Diskutim	168
7. Konkluzion	171
7.1 Implikimet	175
Bibliografia	179

Lista e figurave

Figura 4-1 Grafik që tregon nivelin e unitetit të GP në 21 vende evropiane	90
Figura 4-2 Efekti marginal i ISP në unitetin e GP në varësi të sistemit zgjedhor	101
Figura 4-3 Efekti i ndryshimit të sistemit zgjedhor në unitetin e GP i kushtëzuar nga ISP	102

Lista e tabelave

Tabela 1-1: Ndërlidhjet e unitetit të GP-së dhe zonave zgjedhore në sisteme zgjedhore dhe nivele të ndryshme të ISP-së	26
Tabela 1-2: Niveli i ISP-së në 34 vende evropiane	29
Tabela 1-3: Niveli i ISP-së në 34 vende evropiane	32
Tabela 3-1: Përmbledhje e të dhënave të votimeve për 21 vende evropiane	66
Tabela 3-2: Përmbledhje e të dhënave të votimeve për vendet e EJL-së	68
Tabela 3-3: Numri i deputetëve të intervistuar në Kosovë, 2013	73
Tabela 3-4: Numri i deputetëve të intervistuar në Maqedoni të Veriut, 2013	75
Tabela 4-1: Uniteti mesatar i GP në 21 vende evropiane (shifra të papeshuara)	85
Tabela 4-2: Uniteti mesatar i GP në vendet e EJL (shifra të peshuara)	88
Tabela 4-3: Votimet sipas çështjeve në Kosovë	93
Tabela 4-4: Votimet e hapura sipas çështjeve në Maqedoni të Veriut	95
Tabela 4-5: Statistikat përshkruese për 21 vende evropiane	97
Tabela 4-6: Analizat e regresionit me shumë nivele në nivel partie	99
Tabela 4-7: Uniteti i GP sipas partisë dhe çështjeve në Kosovë (mandati 2)	105

Tabela 4-8: Uniteti i GP sipas partisë dhe çështjeve në Mal të Zi (mandati 2)	106
Tabela 5-1 Përfaqësimi në SP me lista të hapura	123
Tabela 5-2 Përfaqësimi në SP me lista të mbyllura	123
Tabela 5-3 Rolet parësore të deputetëve	126
Tabela 5-4 Zbërthimi i punës së deputetëve	127
Tabela 5-5 Numri dhe përqindja e deputetëve që pohuan se kryejnë të paktën një nga aktivitetet në intervale të caktuara	128
Tabela 5-6 Numri dhe përqindja e deputetëve që pohuan se takohen me të paktën një organizatë	130
Tabela 5-7 Kontaktet e deputetëve me organizata të ndryshme	130
Tabela 5-8 Numri i kërkesave për ndihmë që deputetët raportuan se marrin mesatarisht në javë	131
Tabela 5-9 Orët mesatare që deputetët raportuan se shpenzojnë në javë për kërkesat që kanë të bëjnë me autoritetet publike	132
Tabela 5-10 Përgjigjet e deputetëve se çfarë do të ndodhte nëse do të reduktonin përpjekjet e tyre për t'iu përgjigjur kërkesave të zonave zgjedhore	133
Tabela 5-11 Statistika përshkruese	134
Tabela 5-12 Regresioni binomial negativ për secilin ndryshor të varur: (1) Numri i orëve të shpenzuara duke bërë aktivitete me elektoratin në javë (2) Numri i kërkesave të pranuar në javë, (3) Orët e shpenzuara për ato kërkesa në javë, dhe (4) Numri i orëve të shpenzuara në zonën lokale në muaj.	135

Tabela 5-13 Korrelacioni i votave preferenciale dhe mbështetjes zgjedhore për deputetët me ndryshorët e varur. (1) Numri i orëve të shpenzuara duke bërë punë me elektoratin në javë, (2) Numri i kërkesave të pranuar në javë, (3) Orët e shpenzuara për ato kërkesa në javë, dhe (4) Numri i orëve të shpenzuara në zonën lokale në muaj.	136
Tabela 6-1 Rolet parësore të deputetëve	149
Tabela 6-2 Rolet dytësore të deputetëve	149
Tabela 6-3 Fokusi i përfaqësimit të deputetëve	150
Tabela 6-4 Zbërthimi i punës së deputetëve	152
Tabela 6-5 Numri dhe përqindja e deputetëve që pohuan se kryejnë të paktën një nga aktivitetet në intervale të caktuara	154
Tabela 6-6 Numri dhe përqindja e deputetëve që pohuan se takohen me të paktën një grup në intervale të caktuara	155
Tabela 6-7 Kontaktet e deputetëve me organizata të ndryshme	156
Tabela 6-8 Numri i kërkesave për ndihmë që marrin deputetët mesatarisht në javë	157
Tabela 6-9 Përgjigjet e deputetëve se çfarë do të ndodhte nëse do të reduktonin përpjekjet e tyre për t'iu përgjigjur kërkesave të zonave zgjedhore	159
Tabela 6-10 Statistikat përshkruese (Maqedonia e Veriut)	159
Tabela 6-1: Regresioni binomial negativ për: (1) Numrin e orëve të shpenzuara duke bërë punë të zonës zgjedhore në javë, (2) Numrin e kërkesave të pranuar në javë, (3) Orët e shpenzuara për ato kërkesa në javë (4) Numrin e orëve të shpenzuara në zonën lokale në muaj.	161
Tabela 6-12 Sjellja votuese e deputetëve	162
Tabela 6-13 Roli parësor i deputetëve të Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut	164

Tabela 6-14 Fokusi i përfaqësimit të deputetëve të Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut	165
Tabela 6-15 Zbërthimi i punës së deputetëve të Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut	166
Tabela 6-16 Deputetët e Kosovës kundrejt atyre të Maqedonisë së Veriut përgjatë katër ndryshoreve të varur	167
Tabela 7-1 Marrëdhëniet e pritshme dhe të vëzhguara të ndryshoreve të pavarur mbi unitetin e GP-së dhe lidhjet me zgjedhësit	174

1

Hyrje

1.1 Hyrje

Studimi i sjelljes legjislativë ka tërhequr vëmendjen e gjerë akademike mes studiuesve në demokracitë parlamentare të Evropës Perëndimore. Legjislaturat, me rolet e tyre dominuese mbi legjislacionin, krijimin dhe rrëzimin e qeverive, dhe përfaqësimin e interesave të zonave zgjedhore, shihen si institucione thelbësore për funksionimin demokratik të vendeve. Një numër studiuesish kanë eksploruar veçanërisht faktorët institucionalë nën të cilët veprojnë parlamentarët, siç janë sistemet zgjedhore dhe metodat e përzgjedhjes së kandidatëve, të cilat 'shërbejnë për të kufizuar hapësirën e rezultateve të mundshme dhe në këtë mënyrë për të formësuar sjelljen e ligjvënësve' (Alvarez dhe Sinclair 2011, fq. 545). Në veçanti, sistemet zgjedhore, përmes të cilave votat e qytetarëve shndërrohen në mandate parlamentare, ndikojnë në mënyrën se si deputetët i perceptojnë dhe përmbushin detyrat e tyre si parlamentarë (Deschouwer et al 2014, fq. 1), dhe ato janë 'instrumentet praktike nëpërmjet të cilave nocionet si pëlqimi dhe përfaqësimi përkthehen në realitet' (Bogdanor 1983, fq. 1).

Sistemet zgjedhore thuhet se ndikojnë në masën në të cilën ligjvënësit mund të përfitojnë nga zhvillimi i një reputacioni individual në vend të atij partiak (Carey dhe Shugart 1995, fq. 417-8). Në përgjithësi, sistemet si ato proporcionale me lista të mbyllura dhe shumica e sistemeve të përziera, të cilave u mungon konkurrenca e brendshme, janë më të orientuara kah partia, duke u ofruar deputetëve pak stimuj që të kërkojnë vota personale, ndërsa sistemet si SP-VVT (votë e vetme e transferueshme), SP me lista të hapura dhe SP me listë fleksibël, të cilët lejojnë konkurrencën zgjedhore brenda partisë, janë më të orientuara kah kandidatët dhe ofrojnë motivim më të madh që deputetët t'i kërkojnë votat

e tilla (Mitchell 2000, fq. 341-2). Këto marrëdhënie maten kryesisht nëpërmjet modeleve të votimit të Grupeve Parlamentare (GP) dhe/ose natyrës së lidhjeve që ligjvënësit zhvillojnë me zgjedhësit e tyre. Të dyja këto janë të rëndësishme kur shqyrtohet sjellja e deputetëve, sepse në sistemet zgjedhore në të cilat deputetët janë shumë të varur nga partitë e tyre, mund të duket sikur mund t'ia lejojnë vetes 't'i shpërfillin votuesit' dhe të votojnë sipas vijave partiake, ndërsa në sisteme të tjera deputetët me sa duket do të jenë më shumë të prirur të zhvillojnë reputacion individual (Gallagher 2008, fq. 557).

Stimujt që politikanët të zhvillojnë një vijë partiake dhe/ose lidhje të afërta me zgjedhësit e tyre, mbështeten në dëshirën e tyre për avancim dhe rizgjedhje (Carey dhe Shugart 1995, fq. 418). Ashtu si vendosja e lidhjeve të afërta me votuesit rritë mundësitë e deputetëve për rizgjedhje, respektimi i vijës partiake u siguron atyre qasje në pozita drejtuese ose pozita të rëndësishme në qeveri, si dhe privilegje të lidhura me ato pozita, duke përfshirë emërimet në komisione, financimin e fushatës dhe publicitet. Duke supozuar se 'ligjvënësit janë racionalë dhe kërkojnë karrierë', dhe si të tillë ata 'votojnë, paraqesin legjislacion dhe llobojnë për të kënaqur akterët që kontrollojnë burimet më të rëndësishme', ata do të përpunojnë të shpenzojnë më shumë burime në marrëdhëniet që janë më të dobishme për ta nga pikëpamja zgjedhore. Pra, deputetët do të bëjnë zgjedhjet e tyre strategjike nëse dhe ku do t'i angazhojnë burimet e tyre të pakta si koha, qasja në media ose çdo lloj tjetër asetesh organizative, për të arritur objektivat e tyre (Strøm 1997, fq. 158).

Andaj, nëse deputetët mund t'i arrijnë qëllimet e tyre vetëm përmes besnikërisë partiake, atëherë ata do t'i përmbahen vijës partiake (Desposato 2004, fq. 262-3). Nëse, në vend të kësaj, ka mënyra alternative, si nëpërmjet një marrëdhënieje të drejtpërdrejtë me votuesit, ata kanë më shumë gjasa të zhvillojnë reputacionin individual (Sieberer 2006, fq. 152). Kështu pra, në përgjithësi, korniza institucionale brenda së cilës veprojnë deputetët ndikon në sjelljen e deputetëve, pasi u jep atyre stimuj për të ndjekur një drejtim më shumë se tjetrin. Megjithatë, ndonjëherë, edhe nëse sistemi zgjedhor nuk ofron stimuj për deputetët për të zhvilluar një reputacion individual, mund të ketë një pritshmëri në mesin e publikut që deputetët do t'i kryejnë këto detyra (Gallagher et al 2011, fq. 70), ose ligjvënësit mund ta konsiderojnë angazhimin e tyre në raport me votuesit si psikologjikisht shpërblyese (DeWinter 1997a, fq. 142). Në fakt, në shumicën e partive në sisteme të konsoliduara demokratike deputetët ndiejnë një lloj detyre dhe përkushtimi si ndaj partisë ashtu edhe ndaj elektoratit (Norris 1997, Skjaeveland 1999).

Ne e dimë tashmë nga hulumtimet e mëparshme, se kur institucionalizimi i sistemit partiak (ISP, një term që do ta diskutojmë më në detaje më poshtë) është i lartë, variacionet në sistemin zgjedhor nuk ndikojnë shumë as në unitetin e GP-së e as në shkallën në të cilën deputetët zhvillojnë lidhjet me elektoratin. Duke ditur se niveli i institucionalizimit të sistemit partiak është i lartë në këto vende, nuk duket logjike që të gjeturat nga demokracitë e konsoliduara të mund të zbatohen lehtësisht diku tjetër. Për shembull, brenda vendeve me nivel të ulët të institucionalizimit të sistemit partiak, partitë kanë rrënjë më të dobëta në shoqëri pasi ato priren të shfaqen dhe të zhduken shpesh nga skena politike, dhe ato shpesh shihen si pengesë për kandidatët për t'i fituar zgjedhjet, sepse ato shpesh premtojnë gjëra të cilat nuk do t'i përmbushin domosdoshmërisht (Mainwaring dhe Torcal 2005, Roberts 2010). Në raste të tilla, deputetët do të kenë më shumë liri veprimi në ushtrimin e roleve të tyre dhe për rrjedhojë mund të ndikohen më shumë nga lloji i sistemit zgjedhor që përdoret. Prandaj, ky libër synon të testojë nëse konkluzionet që janë të vërteta për vendet me ISP të lartë vlejnë edhe për vendet me ISP të ulët.

Sigurisht, në radhë të parë, kjo ngre pyetjen se përse është i rëndësishëm eksplorimi i pasojave të sistemeve zgjedhore në vendet ku ISP është i ulët. Së pari, kjo ka përfitime praktike për demokratizimin e vendeve që mendojnë për zgjedhjen ose ndryshimin e sistemit zgjedhor. Siç e dimë, procesi i hartimit të kushtetutës pas shfaqjes së demokracive të reja në Evropën Qendrore dhe Lindore shkaktoi një debat të nxehtë në këto vende se cili sistem zgjedhor të adoptohej (Norris 1997, fq. 298). Për më tepër, shumë vende, por veçanërisht ato të Evropës Juglindore, vazhdojnë t'i ndryshojnë sistemet e tyre zgjedhore në mënyrë që t'i përforcojnë ose dobësojnë lidhjet e deputetëve me zgjedhësit. Kjo ka ndodhur veçanërisht në vendet ku deputetët mendohet se janë përqëndruar shumë në marrëdhëniet me zgjedhësit në dëm të trajtimit të çështjeve kombëtare, p.sh. si në Kolumbi (Crisp dhe Ingall 2002) por, është e paqartë se çfarë ndikimi kanë këto ndryshime dhe sa sukses kanë vendet kur i bëjnë ato. Siç argumenton Katz, 'është i gabuar ndryshimi i sistemeve zgjedhore me shpresën se kjo do të çojë në një përgjigje mekanike nga përfaqësuesit, sepse kultura politike luan një rol të rëndësishëm në përcaktimin e pasojave politike të sistemeve zgjedhore; të njejtat institucione mund të shoqërohen me rezultate krejt të ndryshme nëse akterët ndjekin një përzierje të ndryshme objektivash' (1999, fq. 16). Prandaj, gjetjet e këtij hulumtimi mund të kenë implikime si për demokracitë e Evropës Juglindore ashtu edhe për pjesë të tjera të botës që përpiqen për të zbuluar ndikimin e vërtetë të sistemeve zgjedhore.

Së dyti, ky libër do të hedhë dritë edhe mbi marrëdhëniet mes sistemeve zgjedhore dhe sjelljes së parlamentarëve në rajonin e EJL-së; një pjesë e botës jo e studiuar sa duhet. Ndoshta, një nga arsyet është mungesa e të dhënave. Siç do të tregohet më vonë, ky projekt hulumtimi ka kërkuar mbledhjen e të dhënave origjinale të cilat më parë nuk ishin të disponueshme. Për më tepër, mungesa e interesit për rajonin e EJL-së mund t'i atribuohet natyrës së dobët të demokracisë në këto vende, e cila shpesh shihet si pengesë për të analizuar efektin e vërtetë të sistemeve zgjedhore. Megjithatë, është pikërisht natyra e dobët e institucionalizimit të sistemit partiak atje që na ndihmon ta kuptojmë ndikimin e sistemeve zgjedhore në sjelljen e deputetëve në këto vende. Po kështu, fakti që sistemet zgjedhore ndryshojnë shpesh në këtë rajon, na lejon të krahasojmë sjelljen e deputetëve përgjatë kohës, një avantazh që nuk mund ta gjejmë në vendet e Evropës Perëndimore ku këto sisteme kanë mbetur relativisht të paprekura.

Në përgjithësi, objektivi im është të shqyrtoj nëse sistemet zgjedhore shpjegojnë sjelljen e deputetëve matur si në aspektin e unitetit të GP-së ashtu edhe të lidhjeve që deputetët krijojnë me votuesit. Në këtë mënyrë, ky libër ofron një analizë të gjerë të rezultatit të votimeve (RV) në 21 vende evropiane, duke përfshirë 6 vende të Evropës Juglindore (EJL) të pastudiuara më parë dhe, përveç kësaj, përmes intervistave me anëtarë të parlamenteve të Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut libri sjellë dritë mbi lidhjet e deputetëve me zgjedhësit. Vendet e përfshira në këtë analizë kanë sisteme të ndryshme zgjedhore, gjë që na lejon të testojmë nëse ka ndonjë lidhje sistematike mes sistemeve zgjedhore dhe sjelljes së ligjvënësve. Për më tepër, ndryshimi i sistemit zgjedhor nga SP me lista të mbyllura në SP me lista të hapura në Kosovë, na mundëson të krahasojmë sjelljen e deputetëve përgjatë kohës. Së fundi, marrja e Maqedonisë e Veriut me sistem proporcional me listë të mbyllur si rastin tjetër studimor, na lejon të krahasojmë sjelljen e deputetëve të Maqedonisë së Veriut me atë të homologëve të tyre në Kosovë, marrë parasysh ngjashmëritë mes dy vendeve.

Për ta kuptuar më mirë institucionalizimin e sistemit partiak mes demokracive të konsoliduara dhe atyre të reja, pjesa e mbetur e këtij kapitulli jep një pasqyrë të ISP-së për disa vende evropiane dhe më pas ofron një shpjegim më të detajuar të natyrës së institucionalizimit të sistemit partiak si në Kosovë ashtu edhe në Maqedoninë e Veriut, vende të shqyrtuara më në detaje në kapitujt 5 dhe 6. Në fund të këtij kapitulli, jepet edhe një përmbledhje e gjithë librit. Siç do të shpjegohet në gjerësi më vonë, jemi të kufizuar për sa i përket matjes së ISP-së që përdorim këtu, pasi të dhënat për këtë fenomen përgjithësisht mungojnë në vendet e EJL-së. Megjithatë, duke parë modelin e konkurrencës

qeveritare, e cila sipas Mair shënon 'thelbin e çdo sistemi partiak' (Mair 2006, fq. 65), ne tregojmë se vendet e Evropës Juglindore janë prapa vendeve të Evropës Perëndimore për sa i përket stabilitetit të sistemit partiak, dhe kjo ka disa implikime për mënyrën se si sillen deputetët.

1.2 Institucionalizimi i Sistemit Partiak (ISP)

Institucionalizimi i sistemit partiak (ISP) cilësohet si një 'proces nëpërmjet të cilit modelet e ndërveprimit ndërmjet partive politike bëhen rutinë, të parashikueshme dhe të qëndrueshme me kalimin e kohës' (Casal Bertoa 2012, fq. 453). Niveli i institucionalizimit është i rëndësishëm për t'i kuptuar sistemet partiake, megjithatë literatura i ka kushtuar pak vëmendje kësaj variable përtej demokracive të konsoliduara ku niveli i ISP-së është relativisht uniform. Më e rëndësishmja, niveli i institucionalizimit të sistemit partiak ka pasoja si për përfaqësimin ashtu edhe për llogaridhënien zgjedhore (Mainwaring dhe Torcal 2005, fq. 2). Sistemet partiake me institucionalizim të lartë sugjerojnë se ka stabilitet në konkurrencën ndërmjet partive politike dhe se partitë i përmbushin shumë nga funksionet e tyre demokratike, duke përfshirë përfaqësimin e interesave të votuesve (Lindberg 2007, fq. 215). Përkundrazi, në sistemet partiake me institucionalizim të dobët, ndërveprimi ndërmjet partive është fluid dhe natyra e përfaqësimit është individualiste, pasi elektorati priret të votojë më shumë bazuar në personalitetin dhe klientelizmin sesa partinë (Mainwaring 1999, fq. 38). Andaj, marrë parasysh se demokracitë e reja karakterizohen nga kontekste të ndryshme sociale dhe politike, është më se e qartë se ndikimi i sistemeve zgjedhore në demokracitë perëndimore nuk është domosdoshmërisht i njëjtë tek sistemet me institucionalizim të dobët të Evropës Lindore (Moser 1999a, fq. 365). Siç argumenton Moser, 'marrë parasysh mungesën e sistemeve partiake të mirë-institucionalizuara në shumicën e demokracive të reja, është thelbësore t'i kthehemi çështjes së sistemeve zgjedhore në demokracitë e reja' (1999b, fq. 3).

Sipas Mainwaring dhe Torcal, sistemet partiake me institucionalizim të dobët kanë katër veçori që i dallojnë ato nga sistemet partiake me institucionalizim të lartë. Së pari, mbështetja për partitë ndryshon shpesh, pasi partitë shfaqen dhe zhduken nga skena politike shpesh. Kur konkurrenca partiake është stabile, siç ndodh me shumicën e demokracive të Evropës Perëndimore, votuesit mund të identifikohen lehtësisht me një parti të caktuar në bazë të preferencave ideologjike ose programore, por kur konkurrenca partiake është fluide, votuesit e kanë të vështirë të identifikohen me ndonjë parti të caktuar.

Prandaj, ata kanë më shumë gjasa të votojnë në bazë të veçorive personale të kandidatëve ose përfitimeve klienteliste sesa ideologjisë apo programit partiak (2005, fq. 2,18). Për shembull, në 13 nga 30 vende afrikane, Kuenzi dhe Lambright vënë në pah se partitë e vjetra nuk arrijnë të fitojnë asnjë ulëse në parlament, duke sugjeruar që partitë kryesuese janë në fakt partitë e krijuara rishtaz, mbështetja e të cilave në shoqëri nuk është stabilizuar ende (2001, fq. 453). Aty ku ndodh kështu, pengohet llogaridhënia, sepse që ajo të funksionojë, votuesit duhet të jenë në gjendje të identifikojnë se cilat janë ato parti dhe çfarë përfaqësojnë ato (Mainwaring dhe Torcal 2005, fq. 25).

Së dyti, partitë kanë rrënjë të dobëta në shoqëri, pasi ato nuk mbajnë marrëdhënie të afërta me zgjedhësit. Përkundrazi, baza e marrëdhënieve në vendet me institucionalizim të dobët janë lidhjet personale mes elektoratit dhe përfaqësuesve të tyre. Siç tregojnë Mainwaring dhe Torcal, lidhjet mes votuesve dhe përfaqësuesve janë më të personalizuar në vendet që ata i quajnë regjime konkurruese të pas vitit 1978, krahasuar me vendet e konsoliduara demokratike (2006, fq. 204). Kur individët dhe jo partitë, si organizata, janë më të rëndësishme dëmtohet edhe llogaridhënia, andaj mund të presim që 'do të thuhet edhe premtimi që sjell demokracia përfaqësuese, që politikanët e zgjedhur do të shërbejnë si agjentë të votuesve për ta avancuar të mirën e përbashkët ose për të avancuar interesa të veçanta zonat zgjedhore' (Mainwaring dhe Torcal 2005, fq. 26).

Së treti, partive u mungon legjitimiteti, pasi qytetarët shpesh nuk i konsiderojnë ato si organizata të nevojshme për funksionimin demokratik. Sipas të njëjtëve autorë, 'qytetarët duhet të shohin partitë dhe zgjedhjet si mjete për të përcaktuar se kush qeveris, dhe se procesi zgjedhor dhe partitë duhet të kenë legjitimitet' (1995, fq. 14). Megjithatë, në mesin e sistemeve partiake me institucionalizim të dobët, deputetët janë të vetëdijshëm se ata nuk varen domosdoshmërisht nga partitë për të fituar përfaqësim. Në fakt, është e zakonshme mes këtyre vendeve, që deputetët të kandidojnë si të pavarur ose madje, siç tregon Mainwaring në rastin e Perusë (Mainwaring 1998, fq. 79), që deputetët të ndërrojnë parti duke e ditur se sërish mund të rizgjedhen dhe elektorati nuk do t'i ndëshkojë për këtë. Megjithatë, nëse elektorati tenton të votojë për të njëjtën parti nga një zgjedhje në tjetrën, mundësitë për të përfituar nga kalimet nga një parti në tjetrën janë të kufizuara (Mainwaring dhe Torcal 2006, fq. 206).

Së fundi, partitë shihen nga akterët politikë si organizata të dobëta. Për shembull, në vende si Bolivia, Brazili, Ekuadori dhe Peruja, Mainwaring argumenton se partitë vuajnë nga burimet dhe profesionalizimi i dobët (1998,

fq. 78). Kjo sjell dy implikime. Nga njëra anë, partitë janë të nënshtruara ndaj interesave të udhëheqësisë dhe si të tilla nuk arrijnë të fitojnë status të pavarur në shoqëri (2005, fq. 5,25). Në fakt, shpesh në këto lloj vendesh, etiketat partiake nuk janë gjë tjetër veçse 'mjete personale për figurat e tyre drejtuese' ku udhëheqësit ushtrojnë kontroll të fortë mbi nominimet dhe emërimet (Mainwaring 1998, fq. 78). Nga ana tjetër, organizimi i dobët i partisë gjithashtu ndikon në mënyrën si deputeti e percepton partinë dhe çfarë mund të bëjë partia për ta kontrolluar sjelljen e tij/saj. Siç argumenton Tavits, 'sa më e fortë të jetë partia si organizatë, aq më e vlefshme është partia për ligjvënësit dhe aq më i besueshëm dhe efektiv është kërcënimi për t'i ndërprerë përfitimet zgjedhore nëse një ligjvënës e minon unitetin e partisë' (2011, fq. 410).

Pra, si ndërvepron niveli i institucionalizimit të sistemit partiak me sistemet zgjedhore? Siç u shpjegua më herët, në sistemet zgjedhore me orientim kah partia, siç janë sistemet proporcionale me lista të mbyllura, për shembull, meqenëse votuesit votojnë për listën partiake dhe nuk mund të votojnë për kandidatë, deputetët kanë pak stimuj për të votuar në mënyrë të pavarur nga grupi i tyre parlamentar. Megjithatë, në sistemet e orientuara kah kandidati, si SP me lista të hapura, ku deputetët kanë më shumë stimuj për t'u dalluar nga bashkëpartiakët e tyre, për shkak të konkurrencës zgjedhore brenda partisë deputetët do të përpiqen të bëjnë disa gjëra, si p.sh. të votojnë në mënyrë të pavarur nga vija partiake për disa çështje, të zhvillojnë lidhje të ngushta me zgjedhësit e tyre, ose të angazhohen aktivisht në zhvillimin e punëve parlamentare. Sigurisht, ka më shumë kuptim që një deputet të përpiqet të bëjë dallim nga partia kur niveli i institucionalizimit të sistemit partiak është i ulët, marrë parasysh se votuesit priren të zgjedhin një kandidat mbi baza personale dhe se partitë mund t'i pengojnë shanset e kandidatëve për rizgjedhje. Ndërsa, kur niveli i institucionalizimit është i lartë, nuk do të ishte e mençur që deputeti të bënte dallim nga partia, sepse votuesit do të zgjedhin së pari një parti, dhe së dyti do të vendosin cilit kandidat do t'ia japin votat preferenciale.

Më konkretisht, kur sistemi zgjedhor është i orientuar kah kandidati, në rrethanat kur partitë kanë organizim të dobët dhe ku votuesit priren të identifikohen me individë dhe jo me parti, partia nuk do të jetë në gjendje ta kufizojë sjelljen e ligjvënësve individualë, sepse deputeti mund të rizgjedhet në bazë të raporteve të veta me elektoratin. Siç u përmend më lart, ligjvënësit e dinë se mund të rizgjedhen edhe nëse ndërrojnë parti, ose kandidojnë si të pavarur. Prandaj, kandidatët në vendet me ISP të ulët janë me sa duket më pak të kufizuar në sjelljen e tyre në krahasim me ata në vendet me ISP të lartë, ku

votuesit identifikohen ngushtë me partinë, prandaj kandidatët kanë më pak shanse të zgjedhen me forcat e veta. Megjithatë, kur sistemi zgjedhor është i orientuar kah partia, kjo e fundit mund të kërcënojë se do ta heqë kandidatin ose nuk do ta përfshijë atë në listë në zgjedhjet e ardhshme nëse kandidati nuk i përmbahet vijës partiake. Po kështu, duke ditur se sistemi zgjedhor nuk ua lejon votuesve votat preferenciale për kandidatin, deputetët do të kenë pak stimuj për të zhvilluar lidhje të afërta me zgjedhësit e tyre.

Efekte të ngjashme mund të priten nga sistemet e orientuara kah partia në sistemet partiake me institucionalizim të lartë, por atje stimujt për të zhvilluar lidhje të ngushta me zgjedhësit do të jenë më të mëdha duke pasur parasysh që deputetët e shohin punën me zgjedhësit si të dobishme psikologjikisht, ose ata besojnë se është një nga detyrat kryesore të tyre si ligjvënës (Norris 1997, fq. 47). Një nga shpjegimet e këtyre stimujve lidhet me kulturën politike, apo pritshmëritë që kanë zgjedhësit nga ligjvënësit e tyre. Për shembull, brenda kontekstit britanik, Searing tregon se pjesa më e madhe e shpërblimit psikologjik për deputetët, për ofrimin e një shërbimi të veçantë për zgjedhësit e tyre, është rezultat i mirënjohjes që votuesit shprehin më pas (1985, fq. 377):

“Dhe herë pas here arrin një sukses. Dhe sekretarja ime do të thotë: ‘Ditë e bukur sot, keni tre ose katër letra falënderimi’. Dhe, pra, të bën të ndihesh mirë. Ndiheh mirë sepse ke bërë detyrën duke marrë mundimin për të ofruar një shërbim. Dhe ajo më shkroi një letër kaq të ëmbël duke thënë: Faleminderit shumë për mundimin të kujdeseni për interesat e mia të vogla”.

Por, brenda vendeve me ISP të dobët kemi një realitet tjetër. Për shembull, në Turqi, Kim et al. raportojnë se jo vetëm që nuk ka mirënjohje të ngjashme kur një deputet u ofron një shërbim zgjedhësve të vet, por edhe se një numër i madh kërkesash nga zonat e tyre zgjedhore janë të natyrës personale dhe konsumojnë një sasi relativisht të konsiderueshme të kohës së deputetit. Një përgjigje e një deputeti turk e ilustron këtë (1984, fq. 145):

‘Ata [zgjedhësit me ankesa personale] vijnë gjatë gjithë kohës. Ata mund t’ju telefonojnë në çdo kohë të ditës ose të natës, nga stacioni i autobusëve ose trenit, t’ju tregojnë problemin e tyre, dhe presin që të merresh menjëherë me të. Ata shpesh nuk e njohin kryeqytetin, si të qarkullojnë, si të kryejnë punë. Ata duan që të shkosh dhe t’i takosh, t’i shëtisësh përreth dhe t’i ushqesh. Nëse puna e tyre nuk

mund të trajtohet brenda një dite, mund të duhet t'u gjesh vend ku të flenë. Kur gjithçka të ketë mbaruar, duhet t'i përcjellësh dhe në shumë raste t'u blesh biletën e kthimit'.

Kështu, bazuar në argumentet e mësipërme, sistemi zgjedhor pritet të ketë efektet e mëposhtme, siç tregohet në tabelën 1-1. Në sistemet zgjedhore me ISP të fortë që lejojnë konkurrencën brenda partisë (p.sh. sistemet me lista të hapura), si uniteti i GP-së ashtu edhe sasia e lidhjeve me elektoratin do të jenë të larta, siç ndodh për shembull në Irlandë. E njëjta gjë pritet në sistemet zgjedhore me ISP të fortë që nuk kanë konkurrencë brenda partisë (p.sh. sistemet me lista të mbyllura), si në Norvegji, ku deputetët vlerësojnë lartë lidhjet me elektoratin në zonat e tyre zgjedhore. Në sistemet zgjedhore me ISP të dobët dhe me konkurrencë ndërmjet kandidatëve brenda partisë, siç është Kosova, kohezioni pritet të jetë i ulët, por lidhjet me elektoratin pritet të jenë të larta. Së fundi, në sistemet zgjedhore me ISP të dobët dhe pa konkurrencë brenda partisë, siç është Maqedonia e Veriut, kohezioni do të jetë i lartë, por sasia e lidhjeve me elektoratin do të jetë e ulët.

Kjo teori bazohet në logjikën e Moser (1999a) dhe Thames (2005). Duke përdorur numrin efektiv të partive për të analizuar sjelljen partiake, Moser konstaton se efektet kufizuese të sistemeve zgjedhore, në kuptim të reduktimit të numrit të partive, varen nga niveli i institucionalizimit të sistemit partiak. Në vende si Polonia dhe Hungaria, me nivele më të larta të institucionalizimit të sistemit partiak, numri i partive ishte më i ulët se në vendet me ISP të dobët. Për më tepër, në këto vende sistemi zgjedhor shfaq tendenca më të mëdha për sjellje strategjike dhe adaptim me kalimin e kohës, në krahasim me Rusinë dhe Ukrainën me nivele më të ulëta të ISP-së. Megjithëse jo të gjitha sistemet zgjedhore kanë efektet e parashikuara, studimi tregon se efektet e sistemeve zgjedhore në sjelljen partiake në sistemet partiake me institucionalizim të lartë janë shumë të ndryshme nga ato që shfaqen në sistemet partiake me institucionalizim të dobët, duke sugjeruar se ISP është një ndryshor kyç që kushtëzon efektet e sistemeve zgjedhore.

Tabela 1-1: Uniteti I GP-së dhe lidhjet me elektoratin në sisteme zgjedhore dhe nivele të ndryshme të ISP-së

Institucionalizimi i Sistemit Partiak (ISP)			
		I fortë	I dobët
Sistemet zgjedhore	Garë zgjedhore brenda partisë	Kohezion i lartë Lidhje të forta me zonën zgjedhore	Kohezion i ulët Lidhje të forta me zonën zgjedhore
	Pa garë zgjedhore brenda partisë	Kohezion i lartë Lidhje të forta me zonën zgjedhore	Kohezion i lartë Lidhje të dobëta me zonën zgjedhore

Në mënyrë të ngjashme, në studimin për ndikimin e sistemeve zgjedhore të përziera në sjelljen e deputetëve në Hungari, Rusi dhe Ukrainë, vende me nivele të ndryshme të ISP-së, Thames zbuloi se niveli më i ulët i ISP-së shkaktonte një 'ndarje mes mandateve' në Rusi, ndërkohë që një ndarje e tillë nuk ishte e pranishme në Hungari dhe Ukrainë me nivele më të larta të ISP-së. 'Ndarja mes mandateve' sugjeron që deputetët e zgjedhur në zona me një anëtar (ulëse) të vetëm (ZAV) duhet të kënaqin votuesit lokalë për tu rizgjedhur, sepse ata zgjedhen përmes garës lokale. Kurse deputetët e zgjedhur në sistemin proporcional kanë stimul të fortë të ndjekin komandat e udhëheqësisë së partisë, sepse ata fitojnë vota bazuar në perceptimet e votuesve për partitë e tyre në tërësi dhe varen nga ai lidhshmëri për të siguruar përfshirje në një pozicion të mirë në listë në zgjedhjet e ardhshme. Thames shpjegon më tej se në Rusi, krahasuar me dy vendet e tjera, në mungesë të ISP-së të fortë, deputetët e zgjedhur me sistemin ZAV nuk mendonin se rizgjedhja e tyre varej nga mbështetja e partisë së tyre, ose se partia mund t'u mohonte burime të vlefshme zgjedhore (2005, fq. 284-7).

Në përgjithësi, sistemet partiake të demokracive të avancuara konsiderohen të jenë më të institucionalizuara në krahasim me ato të demokracive të reja (Mainwaring dhe Torcal 2005, fq. 1). Siç theksojnë Mainwaring dhe Torcal, sistemet partiake janë më të qëndrueshme në SHBA dhe Australi krahasuar me Letoninë, Rumaninë, Perunë, etj. (2005, fq. 9), megjithëse ka të dhëna që sugjerojnë se besnikëria ndaj partisë është ulur edhe në mesin e të parëve (Dalton dhe Weldon 2007, fq. 183). Për më tepër, për shkak të uniformitetit të niveleve të institucionalizimit në këto vende, kjo temë rrallë ka qenë objekt i vëmendjes së studiuesve (Mainwaring dhe Torcal 2005, fq. 2). Në Evropën Lindore dhe Qendrore, Owens pretendon se mbështetja zgjedhore për partitë

është e paqëndrueshme, partitë ofrojnë burime të kufizuara zgjedhore, atyre u mungon dallueshmëria ideologjike dhe ligjvënësit shpesh nuk i binden partisë, sepse e dinë se mund të rizgjedhen edhe nëse ndërrojnë parti (2003, fq. 19). Në mënyrë të ngjashme, Roberts vëren se në mesin e sistemeve partiake me institucionalizim të dobët, partitë e dinë se mund të mos ekzistojnë për shumë kohë, dhe për këtë arsye bëjnë premtime të mëdha të cilat edhe nuk i realizojnë. Në fakt, ata mbase as nuk do të jenë aktivë që të përballen me pasojat e premtimeve të parealizuara (Roberts 2010).

Dikush mund të argumentojë se niveli i institucionalizimit të sistemit partiak rritet me kalimin e kohës kur votuesit mësojnë të identifikohen me parti të caktuara, teksa partitë zhvillohen ideologjikisht, dhe teksa kjo veçori kthehet në themelin mbi të cilin partitë konkurrojnë në zgjedhje dhe mbajnë lidhje me votuesit. Sigurisht, disa vende si Polonia dhe Hungaria duket se i kanë stabilizuar sistemet e tyre partiake me kalimin e kohës, ndërsa të tjera si Rusia dhe Ukraina jo (Moser 1999a, fq. 360). Megjithatë, dëshmitë sugjerojnë se sistemet partiake në demokracitë e reja nuk bëhen domosdoshmërisht më të qëndrueshme me kalimin e kohës (Bielasak 2002, Mainwaring dhe Torcal 2005). Për shembull, Mainwaring dhe Torcal konstatojnë se paqëndrueshmëria e partive politike në 19 vende të botës mbeti pothuajse e njëjtë përgjatë zgjedhjeve të ndryshme, dhe se nuk kishte dallim statistikisht domethënës mes paqëndrueshmërisë në zgjedhjet e para dhe nivelit të saj në zgjedhjet pasuese (2005, fq. 10). Në mënyrë të ngjashme, Lindberg konstaton se në 21 vende afrikane sistemet partiake nuk janë bërë më të qëndrueshme me kalimin e kohës, por se ka mbetur një model stabiliteti në mesin e sistemeve partiake me institucionalizim të lartë (2007, fq. 216). Ky aspekt vlen të theksohet duke ditur se ndikimi i sistemeve zgjedhore testohet me kalimin e kohës në vende të ndryshme. Për më tepër, teksa mënyra jonë për matjen e ISP-së raporton nivelin e institucionalizimit në mandatin më të fundit të qeverisë, për të cilin kemi të dhëna (shih në fund të tabelës 1-3 për secilin vend), duke parë nivelet e ISP-së për vendet në çdo mandat qeveritar, nuk duket se niveli i institucionalizimit është rritur me kalimin e viteve.

Megjithatë, matja e institucionalizimit të sistemit partiak nuk është e lehtë. Në fakt, përdorimi i katër kritereve të ndryshme të përshkruara më lart, si identifikimi i partisë, rrënjët e partive me shoqërinë, legjitimiteti partiak dhe organizimi i partive, do të ishte një detyrë e pamundur për vendet e EJK-së të përfshira këtu. Shumë prej vendeve u mungojnë të dhëna për shumë nga këto aspekte të institucionalizimit të sistemit partiak, veçanërisht rrënjët e partive në shoqëri dhe organizimi i partive politike. Për më tepër, edhe në mesin e

sistemeve partiake me institucionalizim të lartë rrallëherë përdoren të katër komponentët. Për shembull, Mainwaring dhe Torcal pranojnë se ka vështirësi në marrjen e të dhënave mes këtyre vendeve (2005, fq. 8). Ajo që përdoret më shpesh është paqëndrueshmëria e partive politike sipas Indeksit të Pedersen-it, i cili mat nivelin e stabilitetit në sistemin partiak duke krahasuar mbështetjen për partitë në zgjedhjet nga një palë zgjedhje në tjetrën (Pedersen 1979, Roberts dhe Wibbels 1999, Mainwaring dhe Torcal 2005, Mainwaring dhe Zoco 2007, Tavits 2008). Të tjerë kanë përdorur një matje dikotomike të ISP-së, ku vendet klasifikohen me ISP të dobët ose të fortë, pa lejuar diferencimin mes niveleve të institucionalizimit (Moser dhe Scheiner 2004). Siç tregon Lindberg, edhe në mesin e vendeve afrikane, me nivele përgjithësisht të ulëta të ISP-së në krahasim me vendet e Evropës Perëndimore, ka një ndryshim që e shtyn t'i klasifikojë sistemet partiake në tre kategori: fluid, i destabilizuar dhe stabil (2007, fq. 216). Veç kësaj, të tjerë e kanë klasifikuar nivelin e ISP-së të ulët në mesin e vendeve me demokraci të re, pa dhënë realisht një matje të tij (Thames 2006).

Sidoqoftë, çka duket më e realizueshme në mesin e vendeve me institucionalizim të dobët është matja e ISP-së e ofruar nga Casal Bertoa dhe Mair (2010), e cila bazohet në konkurrencën e qeverisë, dhe është më e lehtë për t'u matur dhe funksionalizuar mes vendeve të EJK-së. Teksa përkufizimi dhe konceptualizimi i ISP-së siç përdoret nga Mainwaring dhe Torcal është sigurisht ai që përdoret më shpesh, ndoshta sepse fokusohet tek partitë dhe jo te qeveritë, cilësia e të dhënave që jemi në gjendje të mbledhim mes vendeve të EJK-së e kufizon përkufizimin tonë të ISP-së në atë nivel që është praktikisht i testueshëm. Prandaj, për këtë arsye ne përdorim konceptimin e Casal Bertoa dhe Mair të termit dhe përdorim konkurrencën qeveritare, në vend të konkurrencës partiake, për të matur nivelin e institucionalizimit të sistemit partiak mes vendeve. Autorët përdorin katër kriteret për të përcaktuar nivelin e ISP-së mes disa vendeve, duke përfshirë ato të Evropës Qendrore dhe Lindore, siç përshkruhet në Tabelën 1-2, përkatësisht frekuenca (shpeshësia) e ndryshimit (sa shpesh ndryshon përbërja partiake e qeverisë), ndryshimi në qeveri (nëse përbërja e qeverisë ndryshon tërësisht - ndryshim total, pjesërisht - ndryshim i pjesshëm, ose mbetet e pandryshuar - pa ndryshim), formula qeverisëse (nëse koalicionet përbëhen nga i njëjti rreshtim partish sa herë që formohet një qeveri e re), dhe qasja në qeveri (nëse qeveria është e hapur për të përfshirë parti të reja në përbërjen e saj, apo të njëjtat parti priren të jenë në qeveri shumicën e kohës).

Tabela 1-2: Niveli i ISP-së në 34 vende evropiane

	Institucionalizimi i Sistemit Partiak	
	I fortë	I dobët
Frekuenca e ndryshimit	e ulët	e lartë
Ndryshimi i qeverisë	tërësishtëm/asnjë	i pjesshtëm
Formula qeverisëse	të njohura	inovative
Qasja në qeveri	e mbyllur	e hapur

Niveli i ISP-së konsiderohet i lartë nëse frekuenca e ndryshimit të qeverisë është e ulët, nëse ka ndryshim total ose asnjë ndryshim në qeveri, nëse alternativat qeverisëse janë të qëndrueshme dhe të njohura, dhe qasja në qeveri është e kufizuar në një numër partish; në kuptimin që partitë e reja, që nuk kanë marrë pjesë më parë në qeveri, kanë pak shanse për t'u përfshirë në qeveri. Nga ana tjetër, ISP konsiderohet i ulët nëse frekuenca e ndryshimit në qeveri është e lartë, ndryshimi në qeveri është kryesisht i pjesshtëm, partive qeverisëse u mungon stabiliteti në përbërje, dhe partitë e reja, më parë joqeveritare, kanë qasje më të madhe në qeveri (2010, fq. 2-4).

Prandaj, për arsye praktike, është përdorur kjo matje dhe jo ajo e Mainwaring dhe Torcal (2005) për të llogaritur nivelet e ISP për 34 vende evropiane, siç jepet në Tabelën 1-3. Megjithatë, përpara se të shikohen vlerat, është e rëndësishme të shpjegohet si është koduar dhe matur secili nga komponentët. 'Frekuenca e ndryshimit' thjesht mat numrin e ndryshimeve në përbërjen e partive nga një qeveri në tjetrën, duke përfshirë qeverinë e parë. Kur të paktën një parti hyn ose largohet nga qeveria, është shënuar si rast i ndryshimit të qeverisë. Duhet theksuar se ndryshe nga Casal Bertoa dhe Mair (2010), këtu një qeveri e re konsiderohet ajo qeveri e cila rezulton nga zgjedhjet ose nga ndryshimet në përbërjen partiake (p.sh. del një parti dhe hyn një tjetër) pa pasur domosdoshmërisht zgjedhje, sepse matja përndryshe është e njëanshme kundrejt stabilitetit të konkurrencës. Për më tepër, për ta bërë këtë komponent të krahasueshëm me tre të tjerët, e kemi modifikuar dhe në vend të saj kemi matur ndryshimet mesatare në përbërjen partiake për secilën qeveri. Për çdo rast të ndryshimit në qeveri, në matjen tonë merret parasysh numri i partive që hyjnë ose dalin nga qeveria. Për shembull, nëse partitë A, B, C dhe D janë në qeveri në kohën t, ndërsa partia C largohet nga qeveria në kohën t+1, atëherë ndryshimi mesatar nga njëra qeveri në tjetrën është 1/4.

Në mënyrë të ngjashme, nëse partitë A, B, C dhe D janë në koalicion në kohën t, dhe në kohën t+1 partia C del jashtë, por futet partia E, atëherë ndryshimi është gjithashtu 1/4, pasi ndryshon vetëm një e katërta e qeverisë. Meqenëse sipas tabelës, sa më e lartë të jetë frekuenca e ndryshimeve, aq më i dobët është institucionalizimi i sistemit partiak, vlerat për ndryshimet mesatare në përbërjen partiake janë zbritur nga 1. Andaj, sa më e lartë të jetë vlera në këtë komponent, aq më i institucionalizuar është sistemi partiak. 'Ndryshimi' mat shkallën në të cilën ndryshimet në përbërjen e qeverisë janë të tërësishme; d.m.th. e gjithë qeveria zëvendësohet nga një grup i ri partish, ose nuk ka fare ndryshim, me ç'rast të njëjtat parti mbeten në pushtet në qeverinë pasuese. Vlerat e 'ndryshimit' variojnë nga 0-1, ku 0 do të thotë se nuk ka pasur asnjë rast të ndryshimit të tërësishëm/mosndryshimit dhe për rrjedhojë të gjitha rastet e ndryshimit të qeverisë kanë qenë të pjesshme, p.sh. siç është rasti me Rumaninë ku në çdo periudhë të krijimit të qeverisë së re vetëm disa parti zëvendësohen nga partitë e reja qeverisëse, ndërsa vlera 1 do të thotë që të gjitha rastet e ndryshimit të qeverisë ose kanë qenë të tërësishme ose nuk ka pasur ndryshim, siç është për shembull rasti me Danimarkën. Në mënyrë të ngjashme, një vend me vlerën 0.7 në komponentin e ndryshimit, si Irlanda, do të thotë se 70 për qind e ndryshimeve qeveritare ose kanë qenë të tërësishme ose nuk ka pasur ndryshim, dhe në 30 për qind të rasteve ndryshimet kanë qenë të pjesshme.

'Formula qeverisëse' mat shkallën në të cilën ndryshon rreshtimi i partive me çdo qeveri të re. Për shembull, nëse nga pesë qeveri (duke përjashtuar qeverinë e parë dhe rastin e parë të ndryshimit të qeverisë), tre kanë qenë të njohura (një grup i qëndrueshëm partish kanë qeverisur së bashku), por dy kanë qenë inovative (një kombinim i ri partish e ka formuar qeverinë), atëherë $2/6^1$ ose 33 për qind e qeverisë është inovative. Megjithatë, për të qenë në përputhje me komponentët e tjerë, ku sa më e lartë të jetë vlera aq më i institucionalizuar është sistemi partiak, ne i kemi zbritur vlerat nga 1. Prandaj, një vlerë prej 0.75 për këtë komponent, siç është rasti i Gjermanisë, do të thotë se në 80 për qind të ndryshimeve të qeverisë së saj, në qeveri ka qenë i njëjti rreshtim i partive. Po kështu, poentimi 0.22, siç është rasti me Shqipërinë, do të thotë se në 20 për qind të ndryshimeve qeveritare të njëjtat e kanë përbërë qeverinë, ndërsa në 80 për qind të rasteve, këtë e ka përbërë një rreshtim i ri partish.

1 Shënim: Rasti i parë i ndryshimit të qeverisë përfshihet në emërues.

Së fundi, 'qasja në qeveri' mat shkallën në të cilën partitë e reja, përkatësisht partitë që nuk kanë qenë kurrë më parë pjesë e qeverisë, marrin pjesë në qeverinë e re. Për shembull, duke u nisur nga logjika e mësipërme, nëse nga dy qeveritë inovative vetëm njëra prej tyre kishte një parti të re e cila më parë nuk qeveriste, atëherë 1/6 ose 17 për qind e qeverive kanë qenë të hapura (përfshirë të paktën një parti jo qeverisëse më parë) ndërsa qeveritë e mbetura janë të mbyllura (të gjitha partitë kishin marrë pjesë në qeveri në një periudhë në të kaluarën). Në mënyrë të ngjashme, që të përputhen me komponentët e tjerë, vlerat këtu janë zbritur nga 1. Prandaj, vlera 1 do të thotë se qeveritë përbëheshin gjithmonë nga parti që kanë qenë në qeveri më parë, ndërsa një vlerë prej 0.4 do të thotë se në 40 për qind të kohës qeveritë i kanë përjashtuar partitë e reja nga përbërja e tyre, ndërsa në 60 për qind të kohës ka pasur të paktën një parti të re e cila është përfshirë.

Sigurisht, matja e ISP-së na ka kërkuar që të marrim parasysh ndarjet dhe bashkimet partiake, të cilat ndoshta nuk janë aq problematike për vendet e Evropës Perëndimore, sa janë për vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore. Për t'i llogaritur këto ndryshime, janë zbatuar rregullat e mëposhtme: 1. nëse dy parti bashkohen në një, atëherë partia që rezulton është konsideruar si parti 'e vjetër' dhe, 2. nëse njëra parti ndahet nga tjetra, atëherë partia e ndarë konsiderohet e re, por jo edhe partia nga e cila është ndarë (Casal Bertoa dhe Mair 2010, fq. 12). Vlerat e përgjithshme të ISP-së të cilat janë raportuar në kolonën e fundit të tabelës 1-3, japin një rezultat të vetëm të ISP-së për secilin vend, i cili është llogaritur duke marrë mesataren e vlerave në të katër komponentët. Siç u përmend më herët, vlerat e raportuara përfaqësojnë nivelin e institucionalizimit në mandatin më të fundit të qeverisë për të cilin të dhënat janë të disponueshme dhe janë paraqitur në fund të tabelës. Sa më e lartë të jetë vlera, aq më i institucionalizuar është sistemi partiak, dhe sa më e ulët të jetë vlera aq më pak i institucionalizuar është sistemi partiak.

Tabela 1-3: Niveli i ISP-së në 34 vende evropiane

Shtetet	Frekuenca	Ndryshimi	Formula qeverisëse	Qasja në qeverisje	Mesatarja e ISP
Luksemburg	1	1	1	1	1
Zvicër	1	1	1	1	1
Danimarkë	0.80	1	1	1	0.95
Suedi	0.83	1	1	1	0.95
Greqi	0.71	1	1	1	0.93
Mbretëri e Bashkuar	0.67	1	1	1	0.93
Portugali	0.60	1	1	1	0.90
Spanjë	0.60	1	1	1	0.90
Austri	0.83	0.60	1	1	0.85
Gjermani	0.60	0.50	0.75	1	0.73
Irlandë	0.67	0.67	0.67	0.75	0.73
Hungari	0.42	0.80	0.60	0.80	0.65
Islandë	0.80	0.50	0.50	0.75	0.65
Norvegji	0.33	1	0.60	0.60	0.63
Finlandë	0.73	0.33	0.33	1	0.58
Holandë	0.67	0.16	0.33	0.83	0.50
Belgjikë	0.80	0.25	0.25	0.50	0.48
Mal i Zi*	0.81	0.33	0.33	0.50	0.48
Estoni	0.67	0	0.25	0.75	0.45
Poloni	0.48	0.57	0.29	0.43	0.45
Republika Çeke	0.48	0.38	0.25	0.38	0.43
Francë	0.63	0.67	0.33	0.33	0.43
Slovaki	0.42	0.60	0.40	0.33	0.43
Itali	0.48	0.57	0.14	0.43	0.40
Letoni	0.61	0	0.20	0.80	0.40
Sloveni*	0.59	0	0.20	0.71	0.40
Kroaci*	0.44	0.67	0.17	0.17	0.38
Maqedoni e Veriut*	0.51	0.50	0.10	0.40	0.38
Serbi*	0.58	0.44	0.22	0.33	0.38
Shqipëri*	0.60	0.22	0.10	0.55	0.35
Lituani	0.50	0.25	0.25	0.25	0.35
Rumani	0.64	0	0.20	0.60	0.35
Bosnjë*	0.56	0	0.14	0.57	0.33
Kosovë*	0.69	0	0.33	0.33	0.33
Mesorja e EJL-së:					0.36
Mesorja e EPL-së:					0.75
Mesorja e përgjithshme					0.59
N = 34					

*Vende të EJL-së. Danimarkë 1996-2009, Greqi 1993-2011, Luksemburg 1995-2013, Portugali 1995-2011, Spanjë 1993-2011, Suedi 1994-2010, Zvicër 1991-2019, Mbretëri e Bashkuar 1991-2019, Gjermani 1991-2014, Hungari 1994-2013, Irlandë 1994-2008, Norvegji 1993-2013, Finlandë 1995-2010, Islandë 1995-2009, Francë 1995-2007, Itali 1996-2011, 1996-2011, Slovaki 1996-2011, Mal i Zi 2011 1995-2011, Holandë 1994-2011, Shqipëri 1992-2009, Belgjikë 1991-2008, Republika Çeke 1992-2013, Kroaci 1992-2014, Estoni 2002-2011, Letoni 211021-20102, Maqedoni 20102-2013, Rumani 2004-2014, Serbi 1991-2012, Sloveni 1992-2012, Bosnjë 1997-2014, Kosovë 2002-2014. Burimi: Libri vjetor i të dhënave politike i Gazetës Evropiane të Hulumtimeve Politike dhe Berglund et al 2013 (për të dhënat e përbërjes së qeverive në EJL).

Ajo çfarë tregon tabela është se në përgjithësi vendet e EJL kanë vlera më të ulëta të ISP-së krahasuar me vendet e Evropës Perëndimore, megjithëse ka përjashtime. Shifrat e paraqitura në fund të tabelës tregojnë se mesatarja e ISP-së për vendet e Evropës Juglindore është 0.36, shumë më e ulët se mesatarja e Evropës Perëndimore prej 0.75 (p-vlera=0.00), dhe është gjithashtu më e ulët në krahasim me vendet jashtë EJL (p-vlera=0.00). Vlen të theksohet se për sa i përket komponentëve individualë, për shembull, ndryshimi në përbërjen partiake të qeverisë në vendet e EJL-së nuk është i rregullt dhe ndodh ndërmjet zgjedhjeve të rregullta si dhe menjëherë pas zgjedhjeve, gjë që është një tipar i sistemeve partiake me institucionalizim të dobët. Kjo ka ndodhur në katër prej vendeve, përkatësisht në Serbi ndërmjet zgjedhjeve të viteve 2003 dhe 2007, Kroaci ndërmjet zgjedhjeve 2000 dhe 2003, Slloveni mes zgjedhjeve 2000 dhe 2004, dhe në Maqedoninë e Veriut mes zgjedhjeve 2002 dhe 2006. Në mënyrë të ngjashme, për sa i përket frekuencës së ndryshimeve në përbërjen partiake të qeverisë, vendet e EJL-së si Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Serbia dhe Sllovenia duket të jenë rastet më ekstreme me përkatësisht 9, 8 dhe 7 ndryshime në përbërjen partiake të qeverisë, kurse rastet më pak ekstreme mes tyre janë Kroacia me 5 ndryshime dhe Kosova me 3 ndryshime. Dikush mund të argumentojë se problemet mund të lindin nga përdorimi i agregateve kohore të përfaqësuesit 20 viteve në vlerat e ISP-së. Megjithatë, siç u shpjegua më herët, niveli i ISP duket se ka mbetur pothuajse i njëjtë në vendet e ekzaminuara. Më konkretisht, në mesin e sistemeve partiake me institucionalizim të lartë, niveli i ISP-së është stabilizuar me kalimin e kohës, por kjo ka ndodhur edhe mes sistemeve partiake me institucionalizim të dobët, ndoshta me përjashtim të Polonisë dhe Republikës Çeke. Megjithatë, duke qenë se matja jonë e ISP-së fokusohet në katër komponentë të ndryshëm, nëse në një moment në kohë njëri prej këtyre komponentëve do të bëhej më i qëndrueshëm, kjo do të reflektohej në nivelin aktual të ISP. Kështu, pavarësisht se ISP e përgjithshme për çdo vend përfaqëson nivelin në mandatin më të fundit të qeverisë, vlera e ISP llogaritet duke marrë parasysh informacione nga të gjitha rastet e mëparshme të formimit të qeverisë.

Duhet të theksohet gjithashtu se përveç matjes së mësipërme, si paqëndrueshmëria zgjedhore (Pedersen 1979, Mainwaring dhe Zoco 2007, Tavits 2008) që mat ndryshimin e mbështetjes zgjedhore për partitë nga një zgjedhje në tjetrën, ashtu edhe paqëndrueshmëria e qeverisë, e cila mat ndryshimin e ministrave nga një qeveri në tjetrën, janë llogaritur për të gjitha vendet, megjithëse poentimet nuk janë paraqitur këtu. Me rëndësi është që, në përgjithësi, nga të tre matjet, niveli i ISP në vendet e EJL është nën mesataren për të gjitha vendet. Kjo është gjithashtu e vërtetë nëse mbështetemi në një

matje të re të vazhdueshme të zhvilluar nga Casal Bertoa dhe Zsolt (2014). Meqenëse duket se sistemet zgjedhore luajnë pak rol në sjelljen e deputetëve në sistemet partiake me institucionalizim të lartë, ka kuptim të fokusohemi në vendet me ISP të ulët me sisteme të ndryshme zgjedhore për të parë nëse ka ndonjë lidhje sistematike mes sistemeve zgjedhore dhe sjelljes së deputetëve.

1.3 Skema e librit

Pasi u ofrua një pasqyrë e institucionalizimit të sistemit partiak si teoria kryesore e këtij libri, pjesa tjetër e tij do të strukturohet si më poshtë. Kapitulli 2 shqyrton literaturën ekzistuese mbi sistemet zgjedhore dhe metodat e përzgjedhjes së kandidatëve si dhe pasojat e tyre në sjelljen e deputetëve. Ky kapitull ndahet në dy seksione, njëri që shqyrton literaturën mbi sistemet zgjedhore dhe unitetin e GP-së, dhe tjetri mbi sistemet zgjedhore dhe lidhjet me zonat zgjedhore. Më pas ofrohen shpjegime se përse do të prisnim që sistemet zgjedhore dhe metodat e përzgjedhjes së kandidatëve të kenë ndikim në sjelljen e deputetëve. Gjithashtu, janë marrë në konsideratë një sërë faktorësh të tjerë, përveç rregullave zgjedhore, të cilët potencialisht ndikojnë edhe në sjelljen e deputetëve. Nga kjo literaturë janë nxjerrë disa hipoteza që më pas testohen në kapitujt 3, 4 dhe 5.

Kapitulli 3 ofron një shpjegim të metodologjisë së përdorur në këtë hulumtim. Për të analizuar sjelljen e deputetëve janë përdorur një përzierje e metodave sasiore dhe cilësore. Komponenti sasior lidhet me mënyrën se si votojnë deputetët në parlament; d.m.th., duke përdorur votimet e hapura në 21 vende evropiane për të shqyrtuar prirjen e deputetëve për të votuar sipas vijës së grupit parlamentar të tyre. Siç do të shpjegohet më hollësisht në këtë kapitull, kontributi kryesor i analizës së rezultateve të votimeve të kryer këtu, është përfshirja e votimeve nga 6 vende të Evropës Juglindore, përkatësisht Bosnja, Kosova, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Serbia dhe Sllovenia, të cilat nuk janë ekzaminuar kurrë më parë. Për secilin prej këtyre vendeve jepet edhe një përkthim i plotë i mbledhjes së të dhënave. Komponenti cilësor lidhet me aspektin tjetër të variablës së varur - lidhjet me elektoratin. Në këtë kapitull jepet edhe një pasqyrë e intervistave të kryera me deputetë në Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut me sisteme të ndryshme zgjedhore, së bashku me një përkthim të procesit të mbledhjes së të dhënave. Në mënyrë të ngjashme, kapitulli shpjegon edhe se si janë matur uniteti i GP dhe lidhjet me votuesit.

Kapitulli 4 shqyrton ndikimin e sistemeve zgjedhore në sjelljen e deputetëve matur nëpërmjet unitetit të Grupit Parlamentar. Këtu jepet një analizë e

rezultateve të votimeve nga 21 vende evropiane. Siç do të tregohet, niveli i unitetit të GP neëvendet e EJT-së është më i ulët në krahasim me Evropën Perëndimore, megjithëse ky ndryshim nuk është statistikisht domethënës. Megjithatë, rezultatet sugjerojnë se institucionalizimi i sistemit partiak është i rëndësishëm për shpjegimin e sjelljes së deputetëve në këto vende. Kur ISP është i ulët, uniteti i GP-së priret të jetë më i ulët në SP me lista të hapura, mes sistemeve të tjera të orientuara kah kandidati, dhe më i lartë në SP me listë të mbyllur, mes sistemeve të tjera të orientuara kah partia. Rezultatet e votimeve nga Kosova dhe Mali i Zi më pas kategorizohen sipas çështjeve të ndryshme për të parë nëse niveli i kohezionit është më i lartë për çështjet që lidhen me mbijetesën e qeverisë dhe më i ulët për ato që nuk lidhen me të. Dëshmitë sugjerojnë se në të dy vendet kohezioni është përgjithësisht i njëtrajtshëm për të gjitha çështjet, pavarësisht nga rëndësia që kanë për mbijetesën e qeverisë.

Kapitulli 5 shqyrton sasinë e lidhjeve që deputetët në Kosovë zhvillojnë me elektoratin, duke krahasuar sjelljen e tyre sipas sistemit proporcional me lista të mbyllura, në përdorim në vitin 2004, dhe SP me lista të hapura, në përdorim si në zgjedhjet e vitit 2007 ashtu edhe në 2010. Gjithashtu jepet një pasqyrë e detajuar e natyrës së dobët të institucionalizimit të sistemit partiak, dhe sistemit zgjedhor. Dëshmitë e mbledhura nga intervistimi i 59 ligjvënësve tregojnë se nën SP me listë të hapur deputetët priren të zhvillojnë lidhje më të ngushta me zgjedhësit e tyre në krahasim me ata që zgjedhen në SP me listë të mbyllur. Në mesin e deputetëve të zgjedhur nën SP me lista të hapura, ata raportojnë se kalojnë më shumë kohë duke u marrë me aktivitete të ndryshme me votues, marrin një numër më të madh kërkesash, u kushtojnë më shumë kohë atyre kërkesave, dhe kalojnë më shumë kohë në zonën e tyre, krahasuar me deputetët e zgjedhur nën SP me lista të mbyllura. Për sa i përket përzgjedhjes së kandidatëve, këto metoda janë mjaft të centralizuara në të gjitha partitë, por sipas sistemit proporcional me lista të hapura, kandidatët kanë një shans më të mirë për t'u rizgjedhur nëse mbajnë lidhje të afërta me zgjedhësit e tyre, sepse ata do t'i rizgjedhin përmes votave preferenciale.

Përmes intervistave me 49 deputetë, Kapitulli 6 heton poashtu stimujt e deputetëve për të krijuar lidhje të ngushta me zgjedhësit e tyre, por brenda kontekstit të Maqedonisë së Veriut, ku përdoret SP me lista të mbyllura. Aty ofrohet edhe një pasqyrë e institucionalizimit të sistemit partiak dhe sistemit zgjedhor maqedonas. Ndryshe nga pritshmëritë se në SP me listë të mbyllur stimujt për deputetët për të zhvilluar lidhje të ngushta me zgjedhësit e tyre do të jenë më të ulëta, deputetët e Maqedonisë së Veriut janë shumë aktivë në këtë drejtim. Ajo që shpjegon këtë sjellje është fakti se me rastin e vendosjes

së kandidatëve në listë, udhëheqësia e partisë merr parasysh popullaritetin e kandidatit në mesin e votuesve të matur nëpërmjet sondazheve. Shumë nga partitë e Maqedonisë së Veriut prirën t'i renditin kandidatët më të popullarizuar në maje të listës. Më pas vijon krahasimi i sjelljes së deputetëve të Maqedonisë së Veriut me atë të homologëve të tyre kosovarë. Në përgjithësi, deputetët e Maqedonisë së Veriut ngjajnë më shumë me deputetët kosovarë të zgjedhur nën SP me listë të hapur sesa ata të zgjedhur nën SP me listë të mbyllur për arsye të cilat, unë argumentoj, lidhen kryesisht me metodat e përzgjedhjes së kandidatëve. Së fundi, Kapitulli 7 ofron një përmbledhje të gjetjeve kryesore të librit. Këtu diskutohen edhe implikimet e këtyre gjetjeve së bashku me udhëzimet për hulumtime në të ardhmen.

2

Shqyrtimi i literaturës dhe hipotezat

Studimi i unitetit partiak dhe lidhjet me elektoratin që zhvillojnë deputetët është i rëndësishëm për të kuptuar si funksionon demokracia. Legjislaturat, ku debatohen dhe miratohen vendimet kryesore reth politikave publike, ndikojnë në përfaqësim, pasi u ofrojnë qytetarëve informacione nëpërmjet të cilave qytetarët mund të tregojnë nëse partitë i realizojnë premtimet e tyre apo jo (Carey 2007, fq. 97). Për më tepër, në sistemet parlamentare, siç ndodh në të gjitha vendet e shqyrtuara këtu, mbijetesa e kabinetit qeveritar varet nga mbështetja e shumicës në parlament, pasi qeveria mund të shkarkohet përmes një vote mosbesimi (Lijphart 2004, fq. 103). Një mënyrë për të hetuar sjelljen e deputetëve është analizimi i modeleve të votimit duke përdorur votimet e regjistruara në parlament. Rezultatet e votimit ofrojnë një këndvështrim për sjelljen e deputetëve, pasi elektorati mund të monitorojë si votojnë deputetët për çështje që janë me interes për ta. Krahasuar me llojet tjera të sjelljes legislative, edhe votat e regjistruara monitorohen më lehtë si nga votuesit ashtu edhe nga grupet e interesit (Carruba et al 2008, fq. 543). Mënyra tjetër është të hulumtohet nëse ligjvënësit bëjnë ndonjë gjë 'për të rritur qasshmërinë e tyre përtej asaj që normalisht pritet prej tyre'. Shqyrtimi nëse deputetët mbajnë orar të rregullt të punës në zonat e tyre zgjedhore, në mënyrë që njerëzit të kenë mundësinë t'u flasin privatisht për problemet e tyre, është një metodë për ta bërë këtë (Mezey 1979, fq. 179).

Një nga teoritë kryesore që është përdorur për të shpjeguar sjelljen e deputetëve është zgjedhja racionale. Teoria supozon se rregullat zgjedhore formësojnë stimujt e akterëve politikë dhe se këta akterë duke qenë racionalë dhe që duan të maksimizojnë votën, veprojnë strategjikisht për të arritur (ri) zgjedhjen (Norris 2004b, fq. 7). Prandaj, duke pasur parasysh se ligjvënësit janë 'racionalë dhe në kërkim të karrierës', ne presim që ata 'të votojnë, të krijojnë

nisma legislative dhe të llojnë për çështje që kënaqin akterët që kontrollojnë burimet më të rëndësishme' (Desposato 2004, fq. 262-3). Nëse këto burime kontrollohen nga partia, gjë që ndodh më shpesh në sistemet zgjedhore të orientuara kah partia, të cilave u mungon konkurrenca zgjedhore brenda partisë, atëherë deputetët do të jenë më shumë të prirur për ta respektuar vijën partiake dhe do të jenë më pak të prirur për të zhvilluar lidhje të afërta me elektoratin (Depauw dhe Martin 2009, fq. 107-8). Përveç rizgjedhjes, ndjekja e vijës partiake do t'u sigurojë qasje në pozitat drejtuese ose pozita në kabinetin qeveritar, si dhe privilegje që lidhen me ato pozita, duke përfshirë emërimet nëpër komisione, financimin e fushatës dhe publicitetin (Desposato 2004, fq. 262-3). Megjithatë, në raste të tjera, kur ka konkurrencë zgjedhore brenda partisë dhe kështu akterët lokalë mund të kenë kontroll më të madh mbi rizgjedhjen e deputetëve, këta të fundit mund të përballen me kërkesa të zgjedhësve që janë të ndryshme nga ato të partisë (Carey 2007, fq. 94). Në raste të tilla, krijimi i lidhjeve të mira me votuesit është thelbësor për të përmirësuar perspektivën e dikujt për t'u rizgjedhur.

Të supozosh se politikanët kanë role monolitike është një thjeshtim i tepruar, marrë parasysh gamën komplekse të motivimeve që nxisin synimin për pushtet (Norris 2004b, fq. 9). Me fjalë të tjera, disa deputetë mund të udhëhiqen nga motive të tjera përveç kërkimit të karrierës. Ndoshta përmbledhja më e mirë e roleve të ndryshme që mund të kenë ligjvënësit dhe si këto mund të ndikojnë në mënyrën si sillen deputetët, paraqitet nga Searing. Ata që janë të fokusuar kryesisht në përfaqësimin e zgjedhësve quhen 'anëtarë të zonave zgjedhore', por ka edhe 'avokues të politikave' qëllimi kryesor i të cilëve është të përpiqen dhe të ndikojnë në politikën e qeverisë, 'aspirantë ministrorë' të cilët janë kryesisht të interesuar të rekrutohen për pozita qeveritare, dhe 'njerëz parlamenti' të cilët janë të fokusuar kryesisht në kryerjen e punëve parlamentare (1994, fq. 32). Për shembull, në mesin e deputetëve britanikë Norton vëren se ka pasur një ndryshim në orientimet e roleve të deputetëve nga 'aspirantë ministrorë' në 'avokues të politikave' (1997, fq. 26). Për më tepër, edhe kur sistemi zgjedhor nuk ofron stimuj për deputetët që të zhvillojnë një reputacion personal, këta të fundit mund ta konsiderojnë aktivitetet me zgjedhësit si shpërblyese psikologjikisht, siç është treguar në një numër vendesh të Evropës Perëndimore (Searing 1985, DeWinter 1997a, Norris 1997). Me fjalë të tjera, deputetët mund të angazhohen në shërbime për elektoratin për shkak të normave të heshtura sociale, rregullave informale brenda parlamenteve, ose sepse disa i shijojnë shpërblyesat e brendshme filantropike të ndihmës për publikun' (Norris 2004b, fq. 13). Prandaj, nuk e përjashtojmë që sjellja legislative edhe mund të mos shpjegohet me një 'logjikë të përshtatshmërisë' ku vlerësimi i kostos

dhe përfitimeve nga ana e deputetëve përcaktohet nga normat shoqërore që mbizotërojnë brenda komunitetit, siç do të parashikonte institucionalizmi sociologjik (Martin et al 2014, fq. 10). Megjithatë, siç argumenton Saalfeld, 'procesi i saktë përmes të cilit përvetësohen normat dhe orientimet e roleve është i vështirë për t'u gjurmuar në mënyrë empirike. Lidhja shkakësore ndërmjet orientimeve të roleve dhe normave nga njëra anë, dhe sjelljes nga ana tjetër, mbetet e paqartë' (1998, fq. 797).

Krahasimisht, 'motivimi zgjedhor përbën bazën e shpjegimeve më të famshme dhe më të fuqishme të sjelljes së politikanëve'. Shumica e studuesve janë mbështetur në institucionalizmin e zgjedhjes racionale jo vetëm për të shpjeguar ndikimin e sistemeve zgjedhore, por edhe të metodave të përzgjedhjes së kandidatëve, si dhe rregullave legjislative dhe organizimit mbi sjelljen legjislative. Siç argumenton Strøm, edhe pse sjellja e ligjvënësve mund të formësohet nga pritshmëritë kulturore dhe veçoritë personale, 'ato kanë më shumë gjasa që të rrjedhin nga synimet e arsyetuara dhe të qëllimshme në të cilat angazhohen parlamentarët'. Kështu, mbi të gjitha, ligjvënësit janë njerëz që kërkojnë të realizojnë qëllimet dhe që sillen në një mënyrë që i përshtatet destinacioneve që ata kanë në mendje (1997, fq. 158,165). Duke njohur stimujt e ndryshëm që mund të udhëheqin orientimet e deputetëve, Norris pohon se 'në të gjitha këto raste, teoria darviniane parashikon që politikanët që nuk janë maksimizues të votave, të paktën në një farë mase, gradualisht do të bëhen më pak të zakonshëm sepse, në përgjithësi, ata do të jenë më pak të suksesshëm në arritjen e zgjedhjes ose rizgjedhjes' (2004b, fq. 9). Përveç përdorimit të gjerë, teoria e zgjedhjes racionale na lejon të studiojmë sjelljen individuale të deputetëve në krahasim me socializimin e tyre në grup. Kjo është veçanërisht e rëndësishme kur shqyrtojmë aktivitetet e deputetëve me votuesit, pasi jemi të interesuar të kuptojmë si i shohin deputetët rolet e tyre dhe nga ana tjetër si i ndajnë burimet e tyre për t'i përmbushur ato role. Në seksionin vijues, shpjegojmë mekanizmat teorikë që shërbejnë brenda kontekstit tonë. Në veçanti, elaborojmë lidhjen ndërmjet sistemeve zgjedhore, institucionalizimit të sistemeve partiake dhe sjelljes legjislative.

2.1 Mekanizmat teorikë

Teoria e zgjedhjes racionale është e përshtatshme për të shpjeguar sjelljen legjislative, si në aspektin e unitetit të grupeve parlamentare ashtu edhe në kuptim të lidhjeve që deputetë zhvillojnë me elektoratin. Siç shpjegohet, në qendër të teorisë qëndron supozimi se ligjvënësit janë maksimizues të dobisë

që kërkojnë rizgjedhjen në parlament ose avancimin në pozita legislative dhe partiake, dhe për arritjen e këtyre qëllimeve ata u përgjigjen ndëshkimeve dhe shpërblimeve të dhëna nga partia. Për sa i përket unitetit të GP-së, nëse marrim sjelljen e parlamentarëve si rezultat të qasjes motivuese, teoria parashikon që uniteti arrihet dhe ruhet teksa deputetët zbulojnë arsyet e tyre personale për të votuar si bllok (Davidson-Schmich 2003, fq. 88). Rrallëherë ndodh që ata deputetë që largohen nga partia të kenë qasje në avancim në karrierë dhe përfitime tjera. Për më tepër, duke e lidhur miratimin e projektligjit me votëbesim, lidhshipi i partisë është në gjendje ta shtypë opozitën e mundshme të brendshme (Hazan 2003, fq. 6). Deputetët mund të jenë të prirur të votojnë ndryshe nga grupi i tyre parlamentar, por vetëm kur përballen me kërkesa kontradiktore ndërmjet udhëheqësisë së partisë dhe votuesve. Në raste të tilla, ligjvënësit do të bien në dilemë a duhet t'i binden udhëheqësisë, që normalisht kontrollon përzgjedhjen e kandidatëve në listën e kandidatëve, apo votuesve, që përcaktojnë rizgjedhjen e deputetëve nëpërmjet votave preferenciale. Megjithatë, shkalla në të cilën deputetët ndjekin njërin drejtim kundrejt tjetrit, varet nga perceptimet e tyre se kush i kontrollon burimet. Përndryshe, deputetët mund të votojnë kundër vijës së tyre partiake kur kjo nuk rrezikon pozitën e tyre brenda partisë; për shembull, kur çështja për të cilën deputeti voton kundër nuk është jetike për partinë, ose partia është e sigurt se do ta miratojë legjislacionin pa mbështetjen e deputetit përkatës.

Kjo nuk do të thotë se kohezioni mund të mos jetë rezultat i bindjeve të vetë deputetëve; domethënë, ligjvënësit mund të votojnë në të njëjtën mënyrë për arsye normative, duke përfshirë bindjet ideologjike, socializimin, solidaritetin me partinë e kështu me radhë, në vend të llogaritjeve racionale (Hazan 2003, fq. 3). Në fakt, Hazan argumenton se ajo që i mban deputetët të bashkuar është ndjenja e detyrimit ndaj partisë dhe kolegëve të tyre, ose korniza institucionale që stimulon ligjvënësit të veprojnë në mënyrë të unifikuar (Hazan 2003, fq. 4). Megjithatë, e kemi argumentuar më herët se interesi ynë është vetëm të shpjegojmë mënyrën e votimit të deputetëve në parlament dhe jo preferencat e tyre, me çka lidhet drejtpërdrejt disiplina partiake. Po aq e rëndësishme është se brenda sistemeve partiake me institucionalizim të dobët, ku deputetëve u mungon ndjenja e detyrimit dhe e përkushtimit ndaj partisë që e gjejmë në vendet me ISP të lartë, nuk mund të presim që uniteti i GP-së të jetë rezultat i ndjenjave të tilla nga ana e ligjvënësve. Andaj, ka më shumë hapësirë që normat institucionale – konkretisht sistemet zgjedhore - të ndikojnë në sjelljen e deputetëve.

Kur bëhet fjalë për lidhjet me elektoratin, sjelljen e deputetëve na ndihmon ta kuptojmë teoria e zgjedhjes racionale, pasi ajo fokusohet në preferencat dhe stimujt e tyre individualë dhe jo në normat e grupit. Kur studiojmë këto lidhje, jemi veçanërisht të interesuar të kuptojmë se çka mendojnë deputetët për rolet e tyre, si dhe për aktivitetet e tyre. Siç argumentohet, 'rekomandimi kryesor metodologjik i qasjes motivuese është rindërtimi i roleve politike siç kuptohen nga lojtarët e tyre' (Müller dhe Saalfeld 1997, fq. 10). Nga ana tjetër, mënyra si i perceptojnë deputetët rolet e tyre ndikon në sasinë e lidhjeve që ata zhvillojnë me zgjedhësit dhe në mënyrën si ata i llogarisin koston dhe përfitimet nga lidhjet me zgjedhësit në kuptim të mundësive politike dhe stimujve me të cilët përballen (Norris 1997, fq. 30). Ose, siç thotë Norris: 'Rolet formësojnë atë që bëjnë politikanët, si e bëjnë dhe pse mendojnë se është sjellje e duhur' (po aty, fq. 33).

Kur lloji i sistemit zgjedhor është i tillë që votuesit nuk mund të hedhin vota preferenciale, p.sh. SP me lista të mbyllura, deputetët mund ta shohin rolin e tyre kryesisht në terma partiakë dhe t'i kushtojnë pak vëmendje krijimit të lidhjeve të afërta me zgjedhësit e tyre, të cilët nuk kanë një ndikim të drejtpërdrejtë mbi rizgjedhjen e tyre. Në raste të tilla, deputetët nxjerrin më shumë përfitime zgjedhore duke e përqendruar vëmendjen dhe burimet e tyre në fitimin e betejave brenda partisë që do t'u jepnin një pozicion të favorshëm në listë, sesa duke zhvilluar lidhje me votuesit (Mitchell 2000, fq. 345). Megjithatë, kur sistemi zgjedhor ua lejon votuesve të bëjnë dallimin mes kandidatëve, deputetët do t'i shohin rolet e tyre në terma të lidhjes së tyre me elektoratin dhe do të fokusojnë shumë nga burimet e tyre në ruajtjen e dukshmërisë dhe lidhjeve me të. Duke vepruar kështu, deputetët shpresojnë të marrin mbështetjen që do t'u mundësonte të marrin edhe një mandat. Me fjalë të tjera, aktivitetet me votuesit kanë më shumë gjasa të zhvillohen kur ato vlerësohen dhe agjentët kanë stimuj praktikë zgjedhorë për të kryer aktivitete të tilla (Mitchell 2000, fq. 345). Në përgjithësi, zgjedhja racionale është e përkryer për të na ndihmuar të kuptojmë dhe shpjegojmë sjelljen e deputetëve, si për sa i përket unitetit parlamentar ashtu edhe lidhjeve të tyre me zgjedhësit. Në vijim do të shqyrtojmë secilin nga këto aspekte veç e veç.

2.2 Uniteti i Grupit Parlamentar (GP)

Uniteti ose kohezioni i Grupit Parlamentar (GP), i cilësuar si '...kusht objektiv i unitetit të veprimit ndërmjet anëtarëve të partisë, i cili mund të jetë ose jo funksion i represionit disiplinor' (Ozbudun 1970, fq. 305), ka tërhequr vëmendje të gjerë. Uniteti i partisë, i cili rrjedhimisht lidhet me mënyrën se si votojnë deputetët në parlament, ndryshon nga disiplina partiake.

Kjo e fundit përkufizohet si 'rezultat i një loje strategjike të luajtur brenda partive politike, në të cilën ligjvënësit që janë anëtarë partie përgjigjen ndaj shpërblimeve dhe ndëshkimeve të përcaktuara nga një regjim vendimmarrës i brendshëm partiak' (Giannetti dhe Laver 2005, fq. 2), dhe është kështu e lidhur drejtpërdrejt me preferencat e deputetëve, gjë që është jashtë fushëveprimit të këtij libri. Një nivel i lartë i unitetit partiak konsiderohet vendimtar për funksionimin e duhur të regjimeve moderne parlamentare (Epstein 1980) pasi partitë kohezive mund të lehtësojnë miratimin e programeve partiake, patronazhin dhe qeveritë stabile (Owens 2003, fq. 23). Megjithatë, pjesa më e madhe e hulumtimeve është përqendruar në studimin e sjelljes legislative brenda demokracive të konsoliduara parlamentare, duke përfshirë studimet e unitetit të grupeve partiake brenda Parlamentit Evropian, që ndoshta nuk është mjedisi ideal për studimin e sjelljes legislative, pasi mungesa e unitetit nuk do të rrezikonte ekzistencën e qeverisë (Giannetti dhe Laver 2005, fq. 2-3). Për më tepër, partitë e Evropës Perëndimore shihen si shumë kohezive, duke na lënë me shumë pak variacione për të shpjeguar.

Ka disa shpjegime teorike se përse uniteti i GP-së mund të jetë më i lartë në disa vende dhe më i ulët në të tjera, duke përjashtuar rastet e demokracive të konsoliduara ku uniteti priret të jetë përgjithësisht i lartë për arsye që do të shpjegohen më vonë. Një nga shpjegimet është struktura institucionale në të cilën funksionojnë deputetët, si sistemet zgjedhore që përcaktojnë rregullat e shndërrimit të votave në mandate. Në varësi të këtyre rregullave, deputetët në disa vende mund të kenë stimuj më të mëdhenj për të ndjekur vijën e partisë në krahasim me deputetët në vende të tjera. Shpjegimi tjetër kryesor është ai i metodave të përzgjedhjes së kandidatëve. Ngjashëm me sistemet zgjedhore, stimujt për deputetët që të ndjekin vijën partiake janë më të mëdha sipas disa rregullave të përzgjedhjes së kandidatëve sesa sipas të tjerave. Megjithatë, shpjegimet përfshijnë edhe faktorë të lidhur me partinë, si p.sh. nëse partia në fjalë është në qeveri apo opozitë. Seksioni vijues shpjegon këta faktorë në më shumë detaje dhe ofron disa hipoteza të cilat testohen në kapitujt e mëvonshëm.

2.2.1 Formulatat zgjedhore

Njohuritë konvencionale për sjelljen e deputetëve thonë se në sistemet zgjedhore si SP me lista të hapura dhe Vota e Vetme e Transferueshme (VVT), uniteti i Grupit Parlamentar do të jetë më i ulët se në sisteme proporcionale me lista të mbyllura, sisteme mazhoritare, dhe në shumicën e sistemeve të përziera (Carey 2009, fq. 92). Arsyeja kryesore është se në sistemet zgjedhore

të orientuara kah kandidati, ku votuesit mund të japin një votë preferenciale, kandidatët duhet të konkurrojnë si me anëtarët e partive të tjera ashtu edhe me ata të partisë së vet. Kurse në sistemet e orientuara kah partia kjo garë brenda partisë mungon, pasi kandidatët duhet të konkurrojnë vetëm me kandidatët e partive të tjera. Nga kjo duhet të presim që uniteti i GP-së do të jetë më i lartë në sistemet zgjedhore të orientuara kah partia, të cilave u mungon konkurrenca brenda partisë, sesa në sistemet zgjedhore të orientuara kah kandidati, të cilat lejojnë një konkurrencë të tillë zgjedhore brenda partisë (H.1). Për më tepër, për arsyet që shpjeguam në kapitullin 1, presim që efektet e mësipërme të sistemeve zgjedhore të vien në pah vetëm kur niveli i institucionalizimit të sistemit partiak është i ulët (H.1.a). Në momentet kur një çështje nuk është jetike për partinë, ose marzhi i qeverisë ndaj opozitës është i gjerë, partia mund t'ua lejojë disa deputetëve të votojnë kundër shumicës, pasi kjo nuk do ta rrezikonte miratimin e ligjit. Megjithatë, kur dezertimet rrezikojnë miratimin e aktit legjislativ, ligjvënësit do të përballen me presion më të madh për të ndjekur vijën e partisë për këtë çështje.

Megjithatë, në Evropën Perëndimore sistemi zgjedhor ka pak ose aspak ndikim në gatishmërinë e deputetëve për të mbështetur vijën partiake gjatë votimeve në parlament. Siç vëren Gallagher, edhe partitë që u ofrojnë votuesve zgjedhje brenda partisë në përgjithësi 'operojnë si akterë gati unitarë në votimet parlamentare' (Gallagher 2008, fq. 544-5). Për shembull, në studimin e 11 vendeve të Evropës Perëndimore, Sieberer gjen pak dëshmi se sistemet zgjedhore të orientuara kah kandidati janë kusht i mjaftueshëm që deputetët të largohen nga partia e tyre (2006, fq. 154,163). Në mënyrë të ngjashme, raste studimore në mesin e këtyre vendeve sugjerojnë të njëjtën gjë. Rasti i Irlandës, siç kanë thanë Bowler dhe Farrell, është mjaft 'çuditshëm', sepse sistemi zgjedhor në përdorim i orientuar kah kandidati, SP-VVT, jo vetëm që i shtyn deputetët irlandezë të mbajnë lidhje të ngushta me zgjedhësit e tyre, por gjithashtu prodhon unitet të lartë të votimit në Daíl (dhoma e ulët e parlamentit irlandez) (1991, fq. 316). Përveç kësaj, Gallagher dhe Komito theksojnë se 'është jashtëzakonisht e rrallë që deputetët të mos votojnë në linjë me partinë; norma është që çdo deputet të votojë në përputhje me vijën partiake për çdo çështje'. Sipas autorëve, një pjesë e arsyes pse ka unitet të lartë votimi në Irlandë, megjithëse sistemi proporcional VVT nuk përputhet me idenë standarde të një sistemi partiak të prodhuar nën një sistem të tillë votimi preferencial, është 'ndjenja e besnikërisë dhe e qëllimit të përbashkët' mes deputetëve (2010, fq. 201, 213).

Prandaj, një nga shpjegimet për këtë lloj sjelljeje nga ana e deputetëve është roli i rëndësishëm që luajnë dallimet kulturore, ose ekzistenca e një 'efekti

kulturor' (Farrell dhe Scully 2007, fq. 58), sesa prania e stimujve zgjedhorë (Gallagher 2008, fq. 559). Skjaeveland argumenton se në pjesën më të madhe të Evropës është kolektivizmi që nxit një model përfaqësimi të bazuar në grup dhe të lidhur me partinë. Në rastin e Danimarkës, ai konstaton se ekziston një ndjenjë e përkushtimit moral dhe një detyrim për të votuar me partinë (1999, fq. 124,130). Shpjegimi tjetër, i shtjelluar në hyrje, është se niveli i institucionalizimit të sistemit partiak në këto vende është i lartë. Në rrethana të tilla, krahasuar me sistemet partiake me institucionalizim të dobët, ka lidhje të forta ndërmjet votuesve dhe partive, dhe vetë partitë, duke qenë organizata të forta, janë në një pozicion më të mirë për t'i privuar ligjvënësit nga burimet zgjedhore në rast se ata nuk pajtohet me qëndrimin e partisë (Tavits 2011, fq. 410).

Megjithatë, jashtë vendeve të Evropës Perëndimore rezultatet janë të përziera. Për shembull, në vendet e Amerikës Latine, Carey konstaton se edhe nën rregullat e SP me listë të mbyllur, uniteti është i ulët, por kjo i atribuohet kryesisht formës presidenciale të qeverisjes, ku mbijetesa e qeverisë nuk varet nga mbështetja e shumicës në parlament (Carey 2009, fq. 161,168). Në fakt, ekzistenca e procedurës së votëbesimit në sistemet parlamentare është në vetvete një element i rëndësishëm që nxit kohezionin. Për shembull, Diermier dhe Feddersen ofrojnë dëshmi për të treguar se ndërlidhja e procedurës së votëbesimit me një projektligj është e mjaftueshme për të prodhuar kohezion (1998, fq. 616). Për më tepër, në sistemet presidenciale, negociatat legjislative zhvillohen në nivel komisioni, ndryshe nga sistemet parlamentare ku këto negociata zhvillohen ndërmjet anëtarëve të kabinetit qeveritar. Prandaj, kohezioni është i lartë në të dytin, pasi kabineti përbëhet vetëm nga anëtarë të koalicionit qeverisës, por kohezioni është i ulët në të parin sepse komisionet janë normalisht dy partiake dhe partitë minoritare gjithashtu kanë aftësinë të ushtrojnë ndikim (Diermier dhe Feddersen 1998, fq. 617).

Në studimin e tyre për Lituaninë, Clark dhe të tjerët tregojnë se nën sistemin e saj të përzier, ligjvënësit e zgjedhur në zonat me një anëtar të vetëm (ZNV) ishin më kohezivë se ata të zgjedhur me SP me listë të hapur 1 (2008, fq. 330-2)². Ndërkaq nën komponentin SP me listë të hapur, uniteti i GP-së ishte më e ulët sepse deputetët konkurronin edhe me anëtarët e partisë së tyre, dhe duke synuar të dalloheshin nga kolegët e tyre partiakë, ata kishin më shumë stimuj për t'u larguar

² Shënim: Shënim: Sistemi zgjedhor në Lituani u lejon partive të vendosin nëse duan të paraqesin një listë partiake apo t'i lejojnë votuesit të japin vota preferenciale. Në studim, të gjitha partitë paraqitën lista të hapura (Clark et al 2008, fq. 323).

nga vija partiake. Megjithatë, kjo konkurrencë mungonte nën komponentin ZNV, ku kandidatët duhej të konkurronin vetëm me kandidatët e partive të tjera. Prandaj, uniteti i GP-së ishte më i lartë (po aty, fq. 320). Në përgjithësi, niveli i kohezionit në Lituani, i cili është rreth 90 për qind në vlerën e Indeksit Rice (që do të shpjegohet më vonë), është shumë më i ulët në krahasim me vendet e Evropës Perëndimore, megjithëse ka ndryshime ndërmjet partive (Lukosaitis 2004 cituar në Clark et al 2008, fq. 322). Për më tepër, natyra e shpeshtë e ndërrimit të partive si dhe tendenca e shpeshtë e partive për t'u ndarë, konsiderohet se e pengon më tej unitetin e GP-së. Në mënyrë të ngjashme, nivele të ulëta uniteti janë raportuar gjithashtu në sistemin zgjedhor SP me lista të hapura në Republikën Çeke, ku votuesit mund të hidhnin deri në katër vota preferenciale. Për më tepër, megjithëse duket se ka ndryshime në nivelet e unitetit mes partive, partitë qeveritare konstatohet të jenë më të unifikuara në krahasim me partitë opozitare (Linek dhe Rakusanova 2005, fq. 433).

Në ekzaminimin e një numri vendesh afrikane, VonDoepp konstaton se sistemi proporcional me listë të mbyllur kishte lehtësuar arritjen e kohezionit të lartë në Namibi. Në një rast të tillë, sistemi zgjedhor u jepte udhëheqësve të partisë kontroll absolut mbi përzgjedhjen e kandidatëve dhe për këtë arsye deputetët respektonin vijën partiake nga frika se nuk do të përzgjedheshin në zgjedhjet e ardhshme. Por, si në Malawi ashtu edhe në Zambia që përdorin sistem mazhoritar, deputetët kishin më shumë mundësi për t'u distancuar nga vija e tyre partiake. Deputetët e zgjedhur sipas sistemit mazhoritar konsideronin se kishin mundësi për të kandiduar si të pavarur dhe të kishin sukses (2005, fq. 75). Në përgjithësi, studimi sugjeron se sfida kryesore ndaj unitetit të ulët partiak në vendet e Afrikës Jugore është vendimi i deputetit individual për t'u larguar nga vija e partisë për arsye të ndryshme personale (2005, fq. 67,75). Në Izrael, nën sistemin proporcional me listë të mbyllur, Rahat konstaton se kohezioni është mjaft i lartë, ngjashëm me modelin e kohezionit që gjendet mes partive në demokracitë e Evropës Perëndimore, por që është më i lartë në disa çështje dhe më i ulët në të tjera. Për shembull, kohezioni është përgjithësisht i lartë në çështjet që kanë të bëjnë me mbijetesën e qeverisë si buxheti, është mesatar për çështje të tilla si siguria, punët e jashtme dhe feja, të cilat definojnë identitetin e partive dhe potencialin e koalicionit, dhe është më i ulët për çështjet kushtetuese (Rahat 2007, fq. 279). Në mënyrë të ngjashme, uniteti pritet të jetë më i lartë në çështjet që lidhen drejtpërdrejt me ideologjinë partiake, pasi ato priren t'i bëjnë të dallueshme partitë politike, dhe më i ulët në çështjet që priren t'i ndajnë partitë nga brenda (2007, fq. 281-2). Në një studim tjetër, Hawkins dhe Morgenstern tregojnë se partitë e Amerikës Latine janë shumë të ndara kur bëhet fjalë për çështjet e ndjeshme dhe 'më përçarëse'. Shumica e partive

nëpër këto vende shfaqin nivele të ulëta kohezioni në këto çështje (2010, fq. 153). Megjithatë, është e vështirë të dihet se cilat çështje janë ideologjike në rastin e Kosovës dhe Malit të Zi, ku shqyrtohet ky efekt, duke ditur se partitë nuk kanë baza të forta ideologjike. Për më tepër, brenda këtyre konteksteve, në mungesë të një matje të pavarur, është e vështirë të konstatohet se cilat çështje i dallojnë partitë nga njëra-tjetra dhe cilat çështje i ndajnë partitë nga brenda. Sigurisht, nëse testi për të parë a është një çështje përçarëse nga brenda apo jo për një parti, është nëse deputetët e saj votojnë ndryshe në parlament për atë çështje, atëherë hipoteza kthehet në tautologji. Çka mund të bëjmë, megjithatë, është t'i kategorizojmë çështjet në kuptimin e rëndësisë që kanë për mbijetesën e qeverisë. Prandaj, duhet të presim që uniteti i GP-së do të jetë më i lartë për çështjet që janë të rëndësishme për mbijetesën e qeverisë, sesa për çështjet që nuk janë të rëndësishme (H.2).

Për më tepër, stimujt e deputetëve për të votuar në mënyrë të pavarur nga partia do të jenë më të mëdha me rritjen e madhësisë së zonës zgjedhore. Megjithatë, kjo vlen vetëm në kuadër të sistemeve zgjedhore të orientuara kah kandidati, ku ka konkurrencë zgjedhore brenda partisë. Arsyeja është se me rritjen e madhësisë së zonës zgjedhore rritet edhe numri i bashkëpartiakëve kundër të cilëve konkurron çdo anëtar, çka bën që deputetët të kërkojnë vota personale për tu dalluar nga të tjerët (Shugart et al 2005, fq. 439). Siç vihet re nga Gallagher dhe Holliday, 'deputetët në detyrë janë të cenueshëm nga humbja e ulëses së tyre ndaj një kandidati të një partie tjetër, por ata janë gjithashtu të cenueshëm - ndoshta, në të vërtetë ata janë veçanërisht të cenueshëm ndaj rrëzimit nga një kandidat tjetër i partisë së tyre. Kjo, sugjerohet, i bën ata veçanërisht të vëmendshëm ndaj dëshirave dhe kapriçove të zgjedhësve të tyre' (2003, fq. 109). Teksa deputetët kërkojnë vota personale, zhvillimi i një lidhjeje më të ngushtë zgjedhore me votuesit mund t'i tërheqë ata në drejtime të kundërta nga kërkesat e udhëheqësve të partisë (Carey 2007, fq. 94). Megjithatë, efekti nuk është i njëjtë në sistemet proporcionale me listë të mbyllur. Në fakt, me rritjen e madhësisë së zonës zgjedhore, rritet edhe uniteti i partisë (Depauw dhe Martin 2009, fq. 106).

Ekziston një mekanizëm tjetër shkakësor që shpjegon pse kandidatët në zona më të mëdha do të kishin më shumë prirje për të votuar në mënyrë të pavarur nga partia e tyre teksa kërkojnë vota personale. Sipas Hix, me rritjen e madhësisë së zonës zgjedhore, zvogëlohet kërcënimi i udhëheqësisë së partisë për ta hequr një kandidat nga lista, sepse në zonat më të mëdha, më shumë se në zonat e vogla, ka një shans më të madh që ligjvënësit popullorë që nuk pajtohen me udhëheqësit e partisë së tyre, të mundën potencialisht të

dalin si kandidatë të pavarur dhe të arrijnë të rizgjedhen. Prandaj, kandidatët në zonat më të vogla janë më të cenueshëm ndaj presionit nga partia e tyre në krahasim me kandidatët në zonat më të mëdha, që zgjedhin shumë anëtarë për Parlament (2004, fq. 198). Nga argumentet e mësipërme, rezulton se uniteti i GP-së do të jetë më i ulët sa më i madh të jetë numri i bashkëpartiakëve ndaj të cilëve duhet të konkurrojnë kandidatët (H.3).

2.2.2 Përzgjedhja e kandidatëve

Një pjesë e literaturës sugjeron se, përveç sistemit zgjedhor, në sjelljen e deputetëve ndikon edhe përzgjedhja e kandidatëve (Gallagher dhe Marsh 1988), megjithëse të dy faktorët janë të lidhur ngushtë. Pra, metoda të ndryshme të përzgjedhjes së kandidatëve kanë efekte të ndryshme në varësi të llojit të formulave zgjedhore (Gallagher 2008). Siç vë në dukje Gallagher, të dy janë të lidhur ngushtë me njëri-tjetrin; 'nëse të dy janë të mbyllur ose të dy janë të hapura, kemi një ide të përafërt se çfarë të presim, por nëse zgjedhja e kandidatëve është plotësisht e mbyllur dhe e kontrolluar nga lidhshipi, ndërsa sistemi zgjedhor është i hapur, ose anasjelltas, parashikimet tona mund të jenë më pak të sigurta'. Më konkretisht, nëse përzgjedhja e kandidatëve kontrollohet nga organet qendrore të partisë ose udhëheqja e partisë, deputetët kanë më shumë gjasa të votojnë njëloj, ndërsa nëse rizgjedhja e tyre varet nga anëtarët lokalë të partisë, atëherë ata mund të kenë më shumë gjasa të ndjekin preferencat e veta, ose preferencat e anëtarëve lokalë, të cilat mund të mos jenë të njëjta me ato të udhëheqësisë qendrore (2008, fq. 557-9).

Megjithatë, një kombinim i metodave të centralizuara të përzgjedhjes së kandidatëve mund të bashkë-ekzistojë me sistemet zgjedhore të orientuara kah kandidati, kurse metodat e decentralizuara të përzgjedhjes së kandidatëve mund të bashkë-ekzistojnë me sistemet zgjedhore me orientim kah partia. Të dy këta skenarë kanë implikime në sjelljen e deputetëve. Për shembull, në Izrael sistemi proporcional me listë të mbyllur nën një zonë zgjedhore mbarëkombëtare bashkë-ekziston me metodat e decentralizuara të përzgjedhjes së kandidatëve dhe, për shkak se anëtarët e partisë lokale i zgjedhin kandidatët për deputetë, këta të fundit duhet vetëm t'i kushtojnë vëmendje bazës së tyre. Për më tepër, në këto rrethana, pasi deputetët marrin mbështetjen e nevojshme nga anëtarët e partisë, ata nuk kanë nevojë të marrin mbështetjen e drejtpërdrejtë nga populli dhe, për rrjedhojë, ata nuk kanë nevojë të jenë përgjegjës ndaj interesave të zonës më të gjerë zgjedhore (Hazan 1999, fq. 796). Nga ana tjetër, siç tregon rasti i Belgjikës për përzgjedhjen

e kandidatëve për Parlamentin Evropian (PE), në sistemet zgjedhore të orientuara kah kandidati mund të përdoren edhe metoda të centralizuara të përzgjedhjes së kandidatëve. Por, nëse një kandidat kërcënohet me heqje nga lista e partisë, ai/ajo mund të zgjedhë të kandidojë si i pavarur. Në përgjithësi, ajo që është thelbësore në çdo rast në vlerësimin e metodave të përzgjedhjes së kandidatëve, është perceptimi i deputetëve se kush i zgjedh ata dhe kush ka të drejtë t'i heqë nga lista në zgjedhjet e ardhshme.

Megjithatë, literatura mbi metodat e përzgjedhjes së kandidatëve është shumë e kufizuar (Gallagher dhe Marsh 1988, Bille 2001, Lundell 2004, Hazan dhe Rahat 2006, 2007, 2010), dhe nuk ka të dhëna të mjaftueshme për vendet, përveç ndoshta për disa nga demokracitë e konsoliduara. Megjithatë, krahasuar me sistemet zgjedhore ka disi më shumë dëshmi se metodat e përzgjedhjes së kandidatëve ndikojnë në sjelljen e deputetëve madje edhe në demokracitë e konsoliduara. Sieberer, për shembull, konstaton se në 11 demokraci të cilat i studion ai uniteti i partisë është më i lartë kur ekziston një metodë e centralizuar e përzgjedhjes së kandidatëve (2006, fq. 154,163). Edhe Hix konstaton se në Parlamentin Evropian eurodeputetët kanë më pak gjasa të votojnë ndryshe nga partitë e tyre kombëtare nëse ekziston një metodë e centralizuar e përzgjedhjes së kandidatëve (Hix 2004, fq. 216). Mungesa e të dhënave për shumicën e vendeve të EJL-së të përfshira këtu, e bën të pamundur studimin e ndikimit të përzgjedhjes së kandidatëve në unitetin e GP-së. Megjithatë, janë mbledhur të dhëna nëpërmjet intervistave si për Kosovën ashtu edhe për Maqedoninë e Veriut, në mesin e vendeve të EJL-së, andaj ndikimi i përzgjedhjes së kandidatëve do të shqyrtohet në aspektin e stimujve të deputetëve për të krijuar lidhje me votuesit në këto dy vende.

2.2.3 Faktorët partiakë

Ka një sërë faktorësh të tjerë që mendohet se ndikojnë në unitetin e partisë. Një prej tyre është statusi qeveritar i partive. Partitë në qeveri pritet të shfaqin unitet më të lartë të GP-së sesa partitë opozitare. Kjo për disa arsye. Së pari, partitë qeveritare kanë më shumë për të humbur. Kjo do të thotë se mbijetesa e tyre varet nga mbështetja e shumicës për qeverinë. Së dyti, duke qenë kohezive, këto parti mund të qeverisin në mënyrë më efektive (Sieberer 2006, fq. 157). Për më tepër, në rastet e një qeverie koalicioni, nevoja për të arritur konsensus për çështje të ndryshme ndërmjet partive, mund t'i çojë partnerët e koalicionit drejt një rezultati më koheziv, megjithëse mund të jetë e vërtetë edhe e kundërta, që në varësi të numrit të partive qeveritare, ato

mund të kenë vështirësi për të arritur marrëveshje, duke e ulur kështu unitetin e votimit. Së fundi, në sistemet parlamentare, udhëheqësia e partisë shihet si akteri më me ndikim tek ligjvënësit, dhe duke qenë se në mesin e partive qeverisëse udhëheqësia e degës legjislative dhe asaj ekzekutive janë të njëjta, ato kanë më shumë burime për të imponuar unitetin nga ana e deputetëve (Carey 2007, fq. 95). Nga kjo ngremë hipotezën se uniteti i GP-së do të jetë më i lartë për partitë qeveritare sesa për partitë opozitare (H.4).

Edhe marzhi i qeverisë ndaj opozitës mund të ndikojë në unitetin e votimit. Siç u përmend më herët, nëse dallimi në mes të dyjave, në kuptim të ulëseve në parlament, është i konsiderueshëm, qeveria mund të përballojë një nivel përçarjeje, pasi kjo nuk e rrezikon legjislacionin në fjalë. Megjithatë, në rastet kur diferenca është e ngushtë, stimujt për partinë qeveritare për të nxitur unitetin mes ligjvënësve të saj do të jenë më të lartë, pasi çdo votë është vendimtare për miratimin e legjislacionit (Sieberer 2006, fq. 158). Megjithatë, shpesh herë, edhe kur deputetët mund të mos pajtohen me qëndrimin e partisë, ata mund të vendosin të abstenojnë në vend që të votojnë kundër (Carey 2007, fq. 98). Nga logjika e mësipërme konkludojmë se sa më i vogël të jetë marzhi i partive qeverisëse ndaj opozitës, aq më i lartë do të jetë uniteti i GP-së (H.5). Për shembull, Sieberer konstaton se në 11 vende evropiane me rritjen e marzhit, kohezioni bie ndjeshëm (2006, fq. 166). Disa studime kanë konstatuar edhe se partitë e vogla priren të jenë më kohezive se partitë e mëdha (H.6) sepse partitë e vogla janë më homogjene (Desposato 2005, fq. 732). Si Mainwaring ashtu edhe Linan, në rastin e partive braziliane, dhe Hertig në rastin e partive zvicerane, konsiderojnë se kjo është e vërtetë (po aty, Hertig 1978, fq. 69). Megjithatë, një kusht është se indeksi i kohezionit tenton t'i paraqesë partitë e vogla si më kohezive sesa janë në të vërtetë (Depauw dhe Martin 2009, fq. 104), prandaj, siç do të shpjegohet më vonë, mesataret për vendet e EJT-së peshohen në bazë të numrit të deputetëve të një partie që marrin pjesë në çdo votim. Së fundi, partitë më të vjetra do të jenë më kohezive se partitë e reja (H.7) sepse ato priren të jenë më të institucionalizuara.

2.3 Lidhjet me votuesit

Kur shqyrtohet masa në të cilën deputetët zhvillojnë lidhjet me votuesit, kjo është një mënyrë tjetër për të vlerësuar sjelljen e deputetëve. Disa studime janë përpjekur ta kuptojnë këtë sjellje duke eksploruar shtrirjen dhe natyrën e ndërveprimit të deputetëve me zgjedhësit e tyre (Ames 1995, Norris 1997, Saalfeld 2002, Gallagher dhe Holliday 2003, Farrell dhe Scully 2007). Ky aspekt i

sjelljes së deputetëve lidhet drejtpërdrejt me çështjen e përfaqësimit që është një tipar kyç i qeverisjes demokratike (Studlar dhe McAllister 1996, fq. 69). Ose, siç e thotë Dahl 'një karakteristikë kyçe e një demokracie është reagimi i vazhdueshëm i qeverisë ndaj preferencave të qytetarëve të saj, të konsideruar si të barabartë politikisht' (1971, fq. 1-2). Andaj, ligjvënësit shihen si një lidhje e rëndësishme mes votuesve dhe qeverisë, duke ndërmjetësuar në emër të njerëzve për të siguruar që të drejtat e tyre të respektohen (Norris 1997, fq. 29).

Siç u përshkrua më herët, deputetët do të duan të krijojnë lidhje të ngushta me zgjedhësit e tyre në mënyrë që t'i përmirësojnë perspektivat e tyre për t'u rizgjedhur. Domethënë, duke përfaqësuar interesa specifike, deputetët mund të shpresojnë për rritjen e mbështetjes zgjedhore në zgjedhjet e ardhshme (Mezey 1979, fq. 193). Studimet e lidhjeve me elektoratin në demokracitë e konsoliduara parlamentare janë gjithashtu shumë më të shumta se ato për demokracitë e reja. Për më tepër, gjetjet sugjerojnë se deputetët në sistemet partiake me institucionalizim të lartë përgjithësisht priren të zhvillojnë lidhje të forta me zgjedhësit e tyre pavarësisht sistemit zgjedhor (Norris 1997, Skjaeveland 1999, Skjaeveland 1999, Saalfeld 2002, Leston-Bandeira 2007), megjithëse ka variacion ndërmjet tyre. Megjithatë, nuk është aspak e qartë nëse gjetjet mbi sjelljen e deputetëve në sistemet e konsoliduara partiake aplikohen në sisteme partiake me institucionalizim të dobët. Bazuar në formulat zgjedhore, metodat e përzgjedhjes së kandidatëve dhe rolet përfaqësuese të deputetëve, seksioni i mëposhtëm jep një shpjegim të plotë se përse, në praktikë, disa ligjvënës mund të zhvillojnë lidhje më të mëdha me zgjedhësit e tyre sesa të tjerët.

2.3.1 Formulatat zgjedhore

Ngjashëm me logjikën e përshkruar më herët, sistemet zgjedhore të orientuara kah kandidati ofrojnë stimuj më të mëdhenj për deputetët që të zhvillojnë lidhje me zgjedhësit, në krahasim me sistemet e orientuara kah partia. Sigurisht, ka dallime brenda sistemeve të orientuara kah kandidati dhe këto dallime kanë pasoja në sjelljen e deputetëve. Për shembull, nën një sistem me lista fleksibël, si ai i Suedisë, një listë me renditje paraprake mund të ndikojë në rezultatin e zgjedhjeve në rastet kur votuesit nuk e përdorin votën e tyre preferenciale. Ndërsa, në sistem proporcional të pastër me lista të hapura, siç është Zvicra, lista e paraqitur e kandidatëve nuk e përcakton se kush zgjedhet. Përkundrazi, vetëm votuesit mund të vendosin se cilët nga kandidatët do të zgjedhen (Mitchell 2000, fq. 342). Por, në të dyja rastet, krahasuar me sistemet e orientuara kah partia,

votuesit kanë të drejtën për të përcaktuar se kush do të ulet në parlament. Nga ana tjetër, në sistemet e orientuara kah partia shihet se 'i jepet përparësi besnikërisë ndaj partisë dhe jo aktiviteteve me votuesit' (Gallagher 2008, fq. 561-2, Carey dhe Shugart 1995, fq. 418). Së pari, në sisteme të tilla, rizgjedhja e një ligjvënësi konsiderohet se varet kryesisht nga konkurrenca ndërpartiake, prandaj reputacioni personal është më pak i rëndësishëm (Carey dhe Shugart 1995, fq. 424). Për më tepër, meqenëse partia e përcakton listën e kandidatëve, gjithçka që ka rëndësi për deputetët që kërkojnë rizgjedhje është të sigurohen që ata të sigurojnë një pozicion të lartë në listë dhe të zgjedhen sërish në zgjedhjet e ardhshme. Së fundi, në sistemet e orientuara kah partia, për shkak se votuesit votojnë thjesht për partinë dhe nuk mund t'i dallojnë kandidatët, ata nuk janë në gjendje t'i shpërblejnë apo ndëshkojnë ata që zgjedhen. Prandaj, stimujt për të kultivuar vota personale janë të pakta (Golden 2003, fq. 195), me përjashtim të masës që vendimi i atyre që bëjnë radhitjen e kandidatëve në listë ndikohet nga reputacioni i dukshëm i kandidatit në mesin e votuesve. Nga kjo mund të presim që deputetët e zgjedhur sipas sistemit proporcional me lista të hapura do të krijojnë lidhje më të mëdha me zgjedhësit e tyre sesa ata të zgjedhur nën SP me lista të mbyllura (H.8).

Sipas shumicës së hulumtimeve të mëparshme, sistemet zgjedhore kanë pak ndikim edhe në masën e lidhjeve që deputetët zhvillojnë me votuesit në sistemet partiake me institucionalizim të lartë. Për shembull, në studimin e sjelljes së deputetëve britanikë nën sistemin mazhoritar me shumicë të thjeshtë (first-past-the-post), Norris konstaton se sasia e aktiviteteve me elektoratin në të cilat angazhohen parlamentarët është relativisht e madhe, por kjo është më shumë rezultat i perceptimit të deputetëve se puna me elektoratin është shpërbluese sesa ndonjë gjë tjetër. Sipas saj, 'duke e njohur këtë situatë, stimujt zgjedhorë dhe përzgjedhës duken më pak të rëndësishëm për politikanët britanikë sesa ngjitja nëpër shkallët e thepisura të politikës së Westminster-it, kombinuar me një ndjenjë të përgjithshme se shqyrtimi i çështjeve që kanë të bëjnë me votuesit është një detyrë e rëndësishme publike e përfaqësuesve' (1997, fq. 47). Për më tepër, studimet tregojnë se sasia e lidhjeve me zgjedhësit që zhvillojnë deputetët britanikë është rritur me kalimin e kohës (Gaines 1998, fq. 167). Për shembull, në vitin 1971 shumica e deputetëve shpenzonin rreth 11 orë në javë duke punuar për zgjedhësit, një dekadë më vonë ata shpenzonin 16 orë, ndërsa në 1992 ata shpenzonin 25 orë ose 1/3 e punës së tyre (1997, fq. 30).

Në mënyrë të ngjashme, nën sistemin proporcional me listë të mbyllur në Portugali, ku 'natyra e mandatit përfaqësues është ende e dominuar nga

mandati i partisë' (Leston-Bandeira dhe Tiburcio 2012, fq. 384), Leston-Bandeira vëren se deputetët ndjenin kënaqësi në zhvillimin lidhjeve të ngushta me qytetarët (2007, fq. 412), megjithëse kjo i mvishet kryesisht rritjes së mjeteve të reja të komunikimit (Leston-Bandeira dhe Tiburcio 2012, fq. 384). Megjithatë, autorët pranojnë se një mandat përfaqësues filloi të zhvillohej vetëm pas periudhës së demokratizimit pas viteve 1970. Para kësaj, historia e paqëndrueshmërisë politike dhe institucionale kishte krijuar stimuj për marrëdhënie klienteliste mes përfaqësuesve dhe votuesve, pasi përfaqësuesit u premtorin favore votuesve të tyre në këmbim të mbështetjes nga ata. Prandaj, natyra e përfaqësimit ishte më personaliste dhe deputetët ndiqnin agjendat e tyre individuale dhe jo kolektive të partisë (po aty, fq. 385-6).

Në Gjermani, Saalfeld argumenton se pavarësisht natyrës së mbyllur të komponentit SP të sistemit të përzier zgjedhor, deputetët 'krijojnë rrjete të dendura komunikimi me elektoratin në zonat e tyre zgjedhore', nëpërmjet mediave elektronike, kontakteve personale, gazetave lokale, web faqeve, si dhe zyrave individuale në zonat e tyre zgjedhore. Megjithatë, shkalla në të cilën parlamentarët përfshihen në aktivitete të tilla ndryshon mes parlamentarëve shtetërorë dhe federalë. Për shembull, 37 për qind e parlamentarëve shtetërorë shpenzojnë më shumë se 50 për qind të kohës së tyre të punës në aktivitete me elektoratin në zonat e tyre zgjedhore, në krahasim me 18 për qind të deputetëve bavarez të Bundestagut. Për sa i përket kërkesave të elektoratit, deputetët e Bundestagut marrin rreth 50 letra në javë nga elektorati në zonat e tyre zgjedhore dhe 50 të tjera nga qytetarët jashtë zonave të tyre zgjedhore. Për më tepër, studimi vëren se ka pasur një rritje të numrit të kërkesave të zgjedhësve me kalimin e kohës si rezultat i rritjes së arsimit dhe besimit në sistemin politik (po aty, fq. 56-62).

Në mënyrë të ngjashme, Farrell dhe Scully (2007, fq. 199) konstatuan se anëtarët e Parlamentit Evropian (PE) të zgjedhur sipas sistemit proporcional me lista të hapura prireshin të zhvillonin lidhje të afërta me zgjedhësit e tyre, por po ashtu bënë edhe deputetët britanikë të zgjedhur sipas sistemit me listë të mbyllur. Po kështu, siç u përmend më herët, ky është kryesisht rezultat i një 'efekti kulturor' të pranishëm në mesin e parlamentarëve britanikë që shkakton një ndjenjë kënaqësie nga ana e deputetëve, dhe jo nga sistemi zgjedhor (Katz 1997, fq. 218). Një studim i mëparshëm mbi marrëdhëniet e deputetëve të PE-së me zonat zgjedhore tregon se sigurisht që ka ndryshime brenda vetë PE-së; deputetët britanikë për shembull janë më aktivë në zonat e tyre zgjedhore sesa eurodeputetët francezë (Scholl 1986, fq. 323). Por, natyra e lidhjeve që krijojnë eurodeputetët në krahasim me deputetët në

parlamentet kombëtare, janë gjithashtu të ndryshme për shkak të mjediseve të ndryshme në të cilat funksionojnë secili. Për shembull, eurodeputetët kanë pak për t'u ofruar votuesve individualë dhe për këtë arsye ata priren t'u shërbejnë bizneseve ose autoriteteve lokale duke i ndihmuar të kenë qasje në grante dhe kredi (po aty), dhe ata gjithashtu kanë kompetenca të kufizuara mbi legjislacion të caktuar në BE.

Megjithatë, jashtë sistemeve partiake të institucionalizuara mirë, gjetjet janë të përziera dhe është e vështirë të krahasohen, pasi prekin aspekte të ndryshme të marrëdhënieve deputetë-votues. Për shembull, në Honduras, Taylor-Robinson konstaton se sistemi proporcional me lista ta mbyllura nuk është i mjaftueshëm për të shpjeguar sjelljen e deputetëve për sa i përket numrit të projektligjeve rreth çështjeve lokale që iniciojnë deputetët. Përkundrazi, faktorët kryesorë shkakësorë janë institucionet informale, si klientelizmi që plotëson 'hendekun e përfaqësimit të lënë nga përfaqësimi joefektiv i ofruar nga institucionet formale'. Partitë, duke e ditur se ruajtja e mbështetjes nga zonat e tyre lokale është thelbësore për të fituar presidencën, i shtyjnë deputetët e tyre të mbajnë lidhje të ngushta me votuesit, dhe madje e monitorojnë shkallën në të cilën deputetët kryejnë shërbime të tilla (2006, fq. 106-7). Për më tepër, studimi tregon se pavarësisht nëse një deputet zgjedhet lehtë apo fitorja e tij/saj është marginale, dhe pavarësisht nëse perspektivat e tij/saj për rizgjedhje janë të larta apo të ulëta në atë zonë, deputetët që vijnë nga zona më të varfra kanë tendencë të iniciojnë legjislacion më të orientuar lokalisht në krahasim me ata nga zonat më të pasura, ku popullsia është gjithashtu më e arsimuar. Në përgjithësi, numri i projektligjeve të natyrës lokale që iniciojnë deputetët, në krahasim me projektligjet e tjera, shihet si një reflektim i kërkesave të zgjedhësve. Siç thotë Taylor-Robinson 'votuesit në Honduras nuk e kuptojnë se detyra e një deputeti është të nxjerrë ligje, dhe ata nuk e vlerësojnë legjislacionin sepse nuk mund të hash një ligj' (po aty, fq. 111,117-8).

Një studim krahasues i vendeve baltike nuk konstaton se sistemet zgjedhore 'kanë një ndikim të menjëhershëm ose të qartë në sjelljen e deputetëve'. Me fjalë të tjera, studimi tregon se deputetët e zgjedhur në sisteme të centralizuara zgjedhore nuk duket të jenë më të orientuar nga partia në sjelljen e tyre krahasuar me ata të zgjedhur në sistemet zgjedhore me orientim kah kandidati. Në fakt, deputetët letonezë ishin më të shqetësuarit për adresimin e çështjeve të votuesve dhe të gatshëm për të bashkëndjerë me shqetësimet e grupeve të interesit, megjithëse Letonia me sistem proporcional me lista të mbyllura konsiderohet të ketë sistemin zgjedhor më pak të përqendruar tek

kandidatët (Pettai 2005, fq. 462). Megjithatë, për shkak se sistemi zgjedhor në Letoni ua lejon votuesve të japin votë preferenciale brenda listës së partisë, dhe nga ana tjetër, listat e partive riorganizohen bazuar në numrin e votave të marra nga kandidatët (IPU Parline), ekziston një nivel i pasigurisë për ndikimin real të sistemit zgjedhor. Siç vënë në dukje autorët, kandidatët kanë një mundësi për fushatë individuale në mënyrë që t'i inkurajojnë votuesit që të votojnë në mënyrë specifike për ta dhe jo për kolegët e tyre partiakë (po aty 2005, fq. 465), kështu që kjo mund të jetë pjesë e shpjegimit për sjelljen e deputetëve të orientuar kah elektorati.

Për më tepër, nivele të ulëta të lidhjeve ndërmjet deputetëve dhe zgjedhësve janë vënë re në rastin e Malawi që përdorur sistemin zgjedhor mazhoritar, duke sugjeruar se ekziston një 'hendek përfaqësimi' mes zgjedhësve dhe përfaqësuesve të tyre atje (Afrobarometer 2006, fq. 1-2). Duke iu përgjigjur pyetjes 'Sa kohë kalon deputeti juaj në zonën tuaj zgjedhore?', në një sondazh mbarëkombëtar të kryer nga IfESOR, 56 për qind e Malawianëve pohonin se përfaqësuesit e tyre nuk i kishin vizituar kurrë në zonën e tyre zgjedhore, 12 për qind thanë se shkonin vetëm një herë në vit, dhe mbi 18 për qind thanë se deputetët i vizitonin vetëm një herë në muaj. Për më tepër, në pyetjen 'Sa herë i dëgjojnë deputetët qytetarët e zakonshëm?', 55 për qind e Malawianëve pohuan përfaqësuesit e tyre nuk i dëgjojnë 'kurrë', 17 për qind thanë se 'vetëm ndonjëherë' e bëjnë këtë, 13 për qind thanë 'shpesh', dhe vetëm 11 për qind thanë 'gjithmonë'. I njëjti raport vë në dukje se ajo që pengon përfaqësimin e zgjedhësve është mungesa e llogaridhënies, pasi votuesve nuk u jepen mekanizma të tjerë, përveç zgjedhjeve të rregullta, përmes të cilëve ata mund të kërkojnë llogari nga përfaqësuesit e tyre (po aty, fq. 4-6). Si përmbledhje, studimet e mësipërme tregojnë se është e vështirë të gjesh një marrëdhënie sistematike mes formulave zgjedhore dhe përfaqësimit të votuesve në këto vende, por ato vënë në dukje mjediset e ndryshme që i rrethojnë ligjvënësit.

Madhësia e zonës zgjedhore, së bashku me fletëvotimin, kanë poashtu ndikim në stimujt e deputetëve për të kultivuar vota personale, edhe pse më shumë brenda sistemeve zgjedhore të orientuara kah kandidati sesa kah partia. Në SP me listë të mbyllur, ku votuesit votojnë për një listë partie, me rritjen e përmasave të zonës zgjedhore ulen stimujt e deputetëve për të kultivuar vota personale. Në mungesë të konkurrencës brenda partisë, të cilën e gjejmë në sistemet me orientim kah kandidati, dhe duke pasur parasysh pozicionin e tyre në listën e partisë, ligjvënësit mund ta rrisin perspektivën e tyre për rizgjedhje vetëm duke 'i dhënë një fytyrë njerëzore partisë' dhe duke fituar një ulëse shtesë për partinë (Andre et al 2012, fq. 4). Ndërsa, siç u përmend më

herët, në sistemet proporcionale të hapura dhe me listë fleksibël, me rritjen e madhësisë së zonës zgjedhore po kështu rritet edhe numri i bashkëpartiakëve kundër të cilëve konkurren çdo anëtar (Shugart et al 2005, fq. 439). Në këto sisteme, ku secili kandidat varet nga popullariteti i tij/saj dhe jo nga partia për t'u rizgjedhur, ligjvënësit do të kenë më shumë stimuj për t'u dalluar nga bashkëpartiakët e tyre, gjë që do ta bëjnë, ndër të tjera, duke zhvilluar një reputacion personal (Crisp et al 2004, fq. 825). Për më tepër, duke qenë se kandidatët janë anëtarë të së njëjtës parti dhe konsiderohen si mbështetës të së njëjtës platformë, ata nuk janë në gjendje të konkurrojnë në bazë të politikës apo ideologjisë. Në vend të kësaj, ata duhet të konkurrojnë në bazë të kompetencës personale (Bowler dhe Farrell 1991, fq. 305).

Duke përdorur iniciimin e projektligjeve, në vend të aktiviteteve me elektoratin, nën sistemin me lista fleksibël në Belgjikë, një studim konstaton se deputetët paraqesin më shumë projektligje me një autor të vetëm si inicues kur rritet konkurrenca brenda partisë (Brauninger et al 2012, fq. 626). Në mënyrë të ngjashme, një studim tjetër në disa vende të Amerikës Latine konstaton se për ligjvënësit që përballen me stimuj personalizues, me rritjen e madhësisë së zonës zgjedhore rriten edhe prirjet e deputetëve për të ofruar të mira publike lokale ose private (Crisp et al 2004, fq. 843-4). Megjithatë, kërkimi i një marrëdhënieje ndërmjet madhësisë së zonës zgjedhore dhe stimujve të deputetëve për të zhvilluar lidhje të ngushta me zgjedhësit e tyre, nuk ka gjasa të jetë produktiv si në rastin e Kosovës, pasi i gjithë territori përbën një zonë zgjedhore, ashtu edhe atë të Maqedonisë së Veriut ku vendi është i ndarë në gjashtë zona zgjedhore me numër të barabartë të ulëseve (anëtarëve).

Numri i votave preferenciale që mbledhin deputetët shihet gjithashtu se ndikon në sjelljen e tyre brenda sistemeve preferenciale të votimit, megjithëse siç vëren Norris, efekti i votave preferenciale varet nga përdorimi aktual i votave të tilla (1997, fq. 2). Kjo do të thotë se në disa raste votuesit mund të hedhin një votë vetëm për partinë edhe pse ata mund të kenë mundësinë të japin një votë edhe për kandidatin. Deputetët që marrin më shumë vota preferenciale mund të pritët të krijojnë lidhje më të ngushta me zgjedhësit e tyre. Gjetjet sugjerojnë se deputetët belgë reagojnë ndaj mënyrës se si zgjedhësit e tyre i përdorin votat preferenciale. Pra, ata deputetë që marrin më shumë vota preferenciale shihet gjithashtu se iniciojnë një numër më të madh projektligjesh (Brauninger et al 2012, fq. 610). Por, mund të pritët edhe e kundërta, që deputetët që krijojnë lidhje më të ngushta me zgjedhësit e tyre mund të fitojnë më shumë vota preferenciale në zgjedhjet e ardhshme. Hedhja e votave preferenciale në rastin e Kosovës për shembull, të cilën do

ta shqyrtojmë më në detaje më vonë, është fakultative, pasi votuesit mund të vendosin të votojnë vetëm për partinë. Prandaj, efekti i votave preferenciale në sasinë e lidhjeve të deputetëve me zonat zgjedhore do të testohet në këtë rast, por për arsye që do të shpjegohen në detaje në kapitullin 5, kjo është mjaft problematike.

2.3.2 Përzgjedhja e kandidatëve

Metodat e përzgjedhjes së kandidatëve ndikojnë gjithashtu në prirjen e deputetëve për të krijuar lidhje të ngushta me zgjedhësit e tyre (Gallagher dhe Marsh 1988, Gallagher 2008). Siç vëren Norris, 'përzgjedhësit janë zgjedhësit kryesorë të përfaqësuesve' (1997, fq. 32). Kur përzgjedhja e kandidatëve është e centralizuar, deputetët përgjithësisht konsiderohen si të varur nga përzgjedhësit e partisë së tyre, prandaj, ata mund të fokusohen në zhvillimin e reputacionit të partisë dhe të jenë indiferentë ndaj votuesve (Gallagher 2008, fq. 557). Për më tepër, duke zhvilluar një reputacion partiak, partia mund t'u ofrojë atyre një pozicion më të lartë në listë në zgjedhjet e ardhshme. Nga ana tjetër, sipas metodave të decentralizuara të përzgjedhjes së kandidatëve, ku përzgjedhja bëhet nga njësitë lokale të partisë, deputetët kanë më shumë stimuj për të zhvilluar lidhjet me elektoratin, sepse mendojnë se kjo do të përmirësojë perspektivat e tyre për rizgjedhje, ose sepse njëzia lokale e partisë mund ta konsiderojë këtë si të rëndësishme. Nga kjo rrjedh se sa më e centralizuar të jetë përzgjedhja e kandidatëve, aq më e vogël është shkalla në të cilën deputetët do të krijojnë lidhje të ngushta me zgjedhësit e tyre, dhe sa më e decentralizuar të jetë përzgjedhja e kandidatëve, aq më e madhe është shkalla në të cilën deputetët do të krijojnë lidhje të afërta me zgjedhësit e tyre (H.9).

Sigurisht, mund të ketë raste kur edhe me metoda të centralizuara të përzgjedhjes së kandidatëve partitë do të duan që deputetët të krijojnë lidhje të afërta me zgjedhësit e tyre për të rritur mbështetjen e përgjithshme të partisë në zonën zgjedhore. Në mënyrë të ngjashme, sipas metodave të decentralizuara të përzgjedhjes së kandidatëve, përzgjedhësit lokalë të partive mund të presin që deputetët të fokusohen kryesisht në çështjet kombëtare. Megjithatë, në përgjithësi, kur kandidatët zgjedhen nga qendra, supozohet se për shkak se organet qendrore të partisë vlerësojnë më shumë aktivitetet e deputetëve në nivel kombëtar, parlamentarët do ta përqendrojnë pjesën më të madhe të energjive të tyre në kryerjen e detyrave parlamentare. Sidoqoftë, kur kandidatët përzgjedhen në nivel lokal, dhe duke supozuar se anëtarët e zakonshëm janë më të shqetësuar se sa të dukshëm janë përfaqësuesit

parlamentarë në zonën e tyre lokale, deputetët do të shpenzojnë më shumë kohë në zhvillimin e lidhjeve me zgjedhësit ose aktivitete të ngjashme që i mbajnë ata në kontakt me anëtarësinë lokale (Gallagher 1988, fq. 15).

Ka disa studime që sugjerojnë efekte të forta në sjelljen e deputetëve të metodave të decentralizuara të përzgjedhjes së kandidatëve në kombinim me sistemet zgjedhore me orientim kah kandidati. Në Irlandë, Arter vë në dukje se kombinimi i sistemit zgjedhor VVT me metodat e përzgjedhjes së decentralizuar të kandidatëve i shtyn deputetët të zhvillojnë lidhje personale me zgjedhësit, ndër të tjera, duke mbajtur 'zyra të deputetit' nëpër zonat zgjedhore (Arter 2011, fq. 131-4). Një studim tjetër raporton se 85 për qind e deputetëve të intervistuar mbajnë rregullisht zyra të deputetit ose qendra këshillimi në zonat e tyre zgjedhore (O'Leary 2011, fq. 335). Në fakt, deputetët irlandezë shpesh kritikohen se janë tepër të përqendruar në zhvillimin e lidhjeve me votuesit kundrejt fokusimit në çështjet e politikave kombëtare (Gallagher dhe Holliday 2003). Në mënyrë të ngjashme, në Finlandë, kombinimi i metodave të decentralizuara të përzgjedhjes së kandidatëve me sistem proporcional me lista të hapura tregon se deputetët janë shumë më pak të orientuar nga partia në krahasim me homologët e tyre në vendet e tjera të Evropës Perëndimore, megjithëse, nga ana tjetër, pjesa më e madhe e aktiviteteve zgjedhore që ndërmarrin këta deputetë ka të bëjë me iniciimin e projektligjeve në vend të aktiviteteve me zonat zgjedhore, siç janë zyrat e deputetit, të cilat i gjejmë në Irlandë dhe gjetkë (po aty, fq. 149).

Pra, në përgjithësi, përzgjedhja e kandidatëve duket se është kyçi për suksesin zgjedhor të kandidatëve, por matja e saj mund të jetë mjaft komplekse. Kjo ndodh sepse proceset e përzgjedhjes së kandidatëve 'përfshijnë disa grupe akterësh në faza të ndryshme të procesit, nga nominimi në përzgjedhje' (Kittilson dhe Scarrow 2003, fq. 68), dhe fuqia e organizatave qendrore kundrejt atyre lokale ndryshon nga një parti në tjetrën brenda vendeve (Gallagher 1998, fq. 489). Për më tepër, teksa të dhënat përgjithësisht mungojnë edhe për vendet e zhvilluara, siç argumenton Gallagher, për vendet më pak të zhvilluara, problemi është shpesh mungesa e informacionit të thjeshtë (Gallagher 1988, fq. 17).

2.3.3 Rolet përfaqësuese

Siç u la të kuptohet më herët, përfaqësimi i interesave të veçanta nga deputetët mbështetet në stimujt e tyre për të rritur mbështetjen zgjedhore në zgjedhjet e ardhshme (Mezey 1979, fq. 193). Megjithatë, këto role, të cilat përgjithësisht klasifikohen në role zgjedhore, partiake dhe grup interesi (Wahlke et al 1962,

cituar në Müller dhe Saalfeld 1997, fq. 5), janë vetëm një pjesë e vogël e asaj që bëjnë deputetët si ligjvënës. Siç argumenton Katz, 'të shërbesh si zëdhënës ose rrip transmetimi për pikëpamjet e qytetarëve të zakonshëm është një koncept i mundshëm i roleve, por ka shumë të tjerë' (1997, fq. 211). Rolet përfaqësuese ndryshojnë në varësi të 'fokusit'; përkatësisht kë deputetët mendojnë se përfaqësojnë, si dhe 'stilit' që lidhet me mënyrën se si deputetët i marrin vendimet e tyre. Për sa i përket këtij të fundit, sipas 'modelit të të besuarit', duke iu besuar përfaqësimi nga votuesit, ligjvënësit priren të ndjekin gjykimin e tyre për mënyrën e duhur të veprimit, ndërsa të tjerët priren të ndjekin 'modelin e të deleguarit' të përfaqësimit, të cilët pasi zgjedhen fokusohen kryesisht në përfaqësimin e preferencave të zgjedhësve të tyre (Pitkin 1967). Në pyetjen nëse përfaqësuesit, në rast konflikti, do t'i shmangeshin opinionit të partisë së tyre e do të vepronin sipas gjykimit të tyre personal nga njëra anë dhe opinionit të votuesve të tyre nga ana tjetër, rreth 60 për qind e të anketuarve në 15 vende të Evropës Perëndimore treguan se do të ndiqnin vijën e partisë edhe nëse kjo do të thotë të linin mënjane opinionin e tyre personal. Dhe, në mënyrë të ngjashme, 65 për qind treguan se do të ndiqnin vijën e tyre partiake përpara asaj të votuesve të tyre (Andre et al 2014a, fq. 103).

Për sa i përket të parës, natyra e përfaqësimit mund të ndryshojë nga interesat e përcaktuara territorialisht; me ç'rast deputeti shihet se përfaqëson një njësi të caktuar gjeografike, në zona të tjera hapësinore si 'kombi', në funksionale; me ç'rast deputetët konsiderohen të përfaqësojnë interesa ekonomike, fetare ose çfarëdo interesi tjetër të veçantë, si dhe në interesa partiake; me ç'rast fokusi kryesor është partia dhe jo zona zgjedhore (Brack et al 2012, fq. 387, Judge 1999, fq. 148). Për shembull, De Winter vëren se pothuajse gjysma e deputetëve belgë, kur u pyetën se kë mendonin se përfaqësonin në radhë të parë, pohuan votuesit nga zona e tyre zgjedhore si një nga tre rolet më të rëndësishme, me kategoritë socio-ekonomike dhe elektoratin e partisë brenda zonës zgjedhore të deputetit që ishin respektivisht i dyti dhe i treti (1997a, fq. 134). Nga ana tjetër, Arter konstaton se shumica e deputetëve finlandezë përfaqësonin kryesisht të gjithë qytetarët finlandezë, pastaj të gjithë qytetarët në zonën zgjedhore, votuesit e vet në njësi zgjedhore, votuesit e partisë në zonën zgjedhore dhe në fund të gjithë votuesit e partisë në vend (2011, fq. 133-4). Në Spanjë, një studim konstaton se fokusi kryesor i deputetëve ishte të përfaqësonin të gjithë spanjollët, ndërsa fokusi i tyre dytësor ishte të përfaqësonin të gjithë votuesit në zonën e tyre zgjedhore (Mendez-Lago dhe Martinez 2002, fq. 70). Në Hungari, Judge dhe Ilonzski tregojnë se nën një sistem hibrid zgjedhor, deputetët e zgjedhur sipas listave partiake identifikuan zonat më të gjera gjeografike të vendit si fokusin e tyre kryesor, ndërsa ata të

zgjedhur në një zonë zgjedhore raportuan theks të barabartë ndërmjet kombit dhe zonës zgjedhore (1995, fq. 169).

Në përgjithësi, kur shqyrtohet natyra e përfaqësimit të deputetëve, është e rëndësishme të zbulohet se ke konsiderojnë se përfaqësojnë deputetët brenda një zone të caktuar zgjedhore dhe, nga ana tjetër, se si këta mund t'u 'sigurojnë sinjale votimi vetë përfaqësuesve' (Judge 1999, fq. 148). Duke ditur se kë deputetët mendojnë se përfaqësojnë, mund të na tregojë se kë dëgjojnë dhe kujt i përgjigjen. Shpjegimi se si deputetët i perceptojnë rolet e tyre është gjithashtu i rëndësishëm në mesin e sistemeve partiake me institucionalizim të dobët. Mezey vëren se në shumë prej atyre që ai i quan 'legjislatura marginale', ato të karakterizuara nga mungesa e kongruencës mes sjelljes së ligjvënësve dhe pritshmërive publike, si Kenia dhe Tajlanda, ligjvënësit nuk i trajtojnë çështjen e zgjedhësve të tyre në mënyrë efektive për shkak se ata nuk e perceptojnë rolin e tyre në ato terma. Për më tepër, në legjislaturat ku përzgjedhja e kandidatëve kontrollohet nga qendra, partia mund të dëshirojë që ligjvënësit e saj të bëhen agjentë të saj dhe jo agjentë të zgjedhësve të tyre (1979, fq. 188,280). Në raste të tilla, ligjvënësit do të fokusohen në përfaqësimin e interesave të partisë dhe jo të interesave të elektoratit.

Ke mendojnë se përfaqësojnë deputetët, lidhet ngushtë me llojin e sistemit zgjedhor. Në SP me lista të mbyllura, meqenëse deputetët zgjedhen përmes një liste partie, ata, në parim, nuk do t'u përgjigjen votuesve, por partisë që ruan të drejtën për t'i rikandiduar ose jo në zgjedhjet e ardhshme. Prandaj, përfaqësuesit do të priren të mendojnë për zonat e tyre zgjedhore kryesisht në terma partiakë (Mezey 2008, fq. 51). Për shembull, Leston-Bandeira vëren se për shkak të sistemit proporcional me listë të mbyllur dhe metodave të centralizuara të përzgjedhjes së kandidatëve, ligjvënësit portugezë zhvillojnë një model të përfaqësimit partiak. Si rezultat, 'përfaqësimi parlamentar është i centralizuar rreth partive dhe mundësitë për kontakte të drejtpërdrejta mes parlamentit dhe qytetarëve janë të pakta dhe të rralla' (2012, fq. 425-6). Në sistemet proporcionale me lista të hapura, megjithatë, për shkak se votuesit kanë zgjedhjen për të hedhur vota preferenciale brenda listës së një partie, deputetët duhet t'i kushtojnë vëmendje edhe elektoratit. Nga kjo mund të presim që deputetët e zgjedhur nën SP me lista të hapura do të kenë më shumë gjasa ta shohin veten si përfaqësues të elektoratit sesa ata deputetë të zgjedhur nën SP me lista të mbyllura (H.10). Veç kësaj, në rastet kur deputetët përballen me një dilemë nëse duhet të ndjekin vijën e partisë apo atë të elektoratit, do të presim që deputetët e zgjedhur nën SP me lista të mbyllura do të ndjekin kryesisht vijën e partisë dhe jo atë të votuesve të tyre (H.11).

Për sa i përket përfaqësimit, ka një çështje tjetër që meriton diskutim. Teksa argumentuam më herët se deputetët në sistemet me lista të hapura do të krijojnë lidhje më të mëdha me zgjedhësit e tyre në krahasim me deputetët nën SP me lista të mbyllura, është e vështirë të përkufizohet se me kë nga elektorati duhet të zhvillohen lidhje të ngushta në mungesë të zonës së përcaktuar territorialisht, p.sh. në zona mbarëkombëtare. Për më tepër, kur zonat janë të vogla, ligjvënësit mund t'i gjejnë lehtësisht dhe konsultohen me zgjedhësit e tyre, por, me rritjen e madhësisë së zonave, ky proces bëhet më problematik (Mezey 2008, fq. 56). Në raste të tilla, deputetët mund ta identifikojnë veten me të gjithë kombin, me vendin e tyre të lindjes, ose me grupe jo territoriale të përcaktuara si gratë, pakicat etnike, e kështu me radhë. Këto grupe do të jenë më pas fokusi kryesor për krijimin e lidhjeve të ngushta. Pra, rezulton se kandidatët e zgjedhur në zona me shumë anëtarë do të priren t'i përqendrojnë aktivitetet e tyre kryesisht në ato zona, por në SP me listë mbarëkombëtare, në mungesë të një zone zgjedhore të përcaktuar gjeografikisht, deputetët do të priren t'i përqendrojnë aktivitetet e tyre në zonën e tyre lokale, si vendlindja e tyre, ose në grupe të përcaktuara në formë jo gjeografike (H.12).

Edhe pse këtu kemi parë vetëm një aspekt të krijimit të lidhjeve me zgjedhësit, konkretisht angazhimin e drejtpërdrejtë të deputetëve me zgjedhësit e tyre, ka mënyra të tjera përmes të cilave deputetët mund të krijojnë lidhje të ngushta me zgjedhësit e tyre, ose ndoshta, t'u sinjalizojnë aktivitetet. Për shembull, disa studime analizojnë aktivitetet brenda-parlamentare si iniciimi i projektligjeve (Brauninger et al 2012, Arter 2011, Gamm dhe Kousser 2010, Taylor-Robinson 2006 Crisp et al 2004), ndërsa të tjerë analizojnë sasinë dhe natyrën e pyetjeve parlamentare që ngrenë deputetët (Martin 2011, Soroka et al 2009). Për më tepër, disa kanë ekzaminuar aktivitetet qeveritare për interesa lokale, si ofrimi i të mirave private dhe publike për zgjedhësit lokalë (Ames 1995, Crisp et al 2010). Së fundi, literatura i ka kushtuar vëmendje edhe përdorimit të TIK-ve (Teknologjitë e Informacionit dhe Komunikimit) nga deputetët për të ruajtur lidhjet me votuesit (Leston-Bandeira 2007, Ward dhe Lusoli 2007, Norton 2008). Arsyeja pse ky libër fokusohet në të parën është sepse format e tjera të aktiviteteve sinjalizuese duken të parëndësishme si në rastin e Kosovës e Maqedonisë së Veriut, ashtu edhe në vendet e tjera të rajonit, dhe kështu duket e pamundur që ato mund të kapin masën në të cilën deputetët i zhvillojnë lidhjet me zonat zgjedhore. Së pari, në intervistat që kam realizuar, shumica e deputetëve kanë përmendur takimet e drejtpërdrejta me zgjedhësit si formë e aktivitetit. Nga ana tjetër, iniciimi i projektligjeve apo ndonjë formë tjetër përmendej rrallë. Për më tepër, mes sistemeve partiake me institucionalizim të dobët, siç është rasti i Brazilit, Ames pretendon se

'deputetët prezantojnë legjislacion pa qëllim që t'i shtyjnë projektligjet e tyre deri në kalimin përfundimtar' (2001, fq. 142).

Kështu, ka të ngjarë që deputetët në këto lloj vendesh mund të prezantojnë legjislacion thjesht për t'u sinjalizuar zgjedhësve të tyre se ata janë aktivë, por nuk e çojnë punën deri në fund. Së dyti, mungojnë të dhënat që përmbledhin numrin e pyetjeve parlamentare që deputetët bëjnë rregullisht. Marrja e këtij informacioni do të kërkonte që ne të shikonim procesverbalet e mbledhjeve parlamentare, çka do të merrte shumë kohë. Megjithatë, ka arsye për të besuar se rrjetet sociale përdoren gjerësisht për të nxitur lidhjet e deputetëve me zgjedhësit në dy rastet tona studimore, për shkak të një popullsie të re në të dy vendet dhe penetrimit të lartë të internetit, dhe megjithëse nuk janë shqyrtuar këtu, mund të rezultojnë produktive në hulumtime të mëtejshme në vendet e EJT-së. Në përgjithësi, duke pasur parasysh se literatura që shpjegon efektin e sistemeve zgjedhore në sjelljen e deputetëve është e kufizuar kryesisht në vendet me demokraci të konsoliduar që kanë nivele të larta të ISP, ky hulumtim kontribuon në literaturën aktuale duke e shqyrtuar këtë ndikim brenda vendeve me demokraci të re ku niveli i ISP është i ulët. Ka pritshmëri teorike që sugjerojnë se ndikimi i sistemeve zgjedhore në sjelljen e deputetëve mes këtyre vendeve të fundit do të jetë më i madh, dhe e vetmja mënyrë për ta zbuluar është testimi në kontekstin e vendeve me institucionalizim të dobët. Implikimi kryesor, siç do të shihet më vonë, është se konkluzionet e arritura mes demokracive të konsoliduara nuk mund të aplikohen për demokracitë e reja për arsye që kanë të bëjnë me sistemet e tyre partiake. Prandaj, institucionalizimi i sistemit partiak është një ndryshor që nuk duhet neglizhuar në studime të tjera të sjelljes legjislative, pasi mund të ketë implikime të mëdha për demokratizimin e vendeve gjatë.

3

Metodologjia

Ky hulumtim përdor një kombinim të metodave hulumtuese sasiore dhe cilësore për shqyrtimin e ndikimit të sistemeve zgjedhore në sjelljen e deputetëve. Komponenti sasior ka të bëjë me aspektin e parë të ndryshorit të varur; gjegjësisht unitetin e Grupit Parlamentar (GP). Për të matur unitetin e GP-së, është kryer një analizë e rezultateve të votimeve nga parlamentet e 21 vendeve të Evropës Perëndimore, Qendrore, Lindore dhe Juglindore, ku përfshihen mbi 100 parti dhe disa mijëra vota, marre nga disa mandate legjislative. Qëllimi i analizës së rezultateve të votimeve është të eksploroohen modelet e votimit të deputetëve për sa më shumë akte të legjislacionit që të jetë e mundur. Analiza është e përshtatshme për të zbuluar nëse deputetët votojnë së bashku me grupin e tyre partiak në parlament, me ç'rast uniteti i votimit do të jetë i lartë, apo dalin nga vija e tyre partiake, me ç'rast do të jetë i ulët. Për më tepër, analiza do të japë një pamje se ku qëndron uniteti partiak në demokracitë e reja të EJT-së, për të cilat ne dijmë pak, në krahasim me unitetin përgjithësisht të lartë partiak në vendet me demokraci të konsoliduar.

Komponenti cilësor i hulumtimit ka të bëjë me aspektin e dytë të ndryshorit të varur, përkatësisht lidhjet me zonën zgjedhore. Arsyeja për përfshirjen e komponentit cilësor është marrja e informacionit mbi sjelljen e deputetëve, gjë që nuk është e dukshme vetëm nga analizimi i votave të regjistruara. Nëpërmjet një analize të rezultateve të votimeve, siç shpjegohet, mund të shihet nëse uniteti është i ulët apo i lartë ndërmjet partive/vendeve, megjithatë dihet pak për prirjen e deputetëve për të krijuar lidhje të afërta me zgjedhësit e tyre. Prandaj, intervistat gjysmë të strukturuar me ligjvënësit në Kosovë dhe Maqedoni të Veriut synojnë pikërisht të kuptojnë përpjekjet e tyre për zhvillimin e lidhjeve të tilla me zgjedhësit. Më konkretisht, synimi i realizimit të intervistave ka qenë vlerësimi i perceptimeve të deputetëve për rolin e

tyre si deputetë, fokusi i tyre i përfaqësimit, lloji i lidhjeve që ata krijojnë me zgjedhësit, sasia e kohës që ata shpenzojnë në ato aktivitete etj. Seksioni në vijim i shpjegon në detaje këto dy metoda si dhe procesin e mbledhjes së të dhënave.

3.1 Rezultatet e votimeve (RV)

Për të analizuar sjelljen e deputetëve në aspektin e unitetit të GP-së, janë përdorur rezultatet e votimeve në parlament nga 21 vende evropiane. Rezultatet e votimeve janë mjeti kryesor i analizës për sjelljen legjislative (Carrubba et al 2006, fq. 691), dhe siç e përcaktojnë Ferejohn dhe Fiorina ato janë 'aspektet më të spikatura të sjelljes legjislative' (1975, fq. 411). Teksa literatura që shqyrton sjelljen legjislative duke përdorur rezultatet e votimeve është rritur me kalimin e viteve, është argumentuar se mbështetja në këto votime ka risqet e veta. Owens (2003) jep tre arsye pse është kështu. Së pari, duke analizuar sjelljen e deputetëve përmes rezultateve të votimit, nuk shihen dallimet brenda partisë dhe ato ndërpartiake që mund të ekzistojnë përpara se një projektligji të silllet në parlament, dhe çfarë bëjnë partitë për t'i pajtuar këto dallime, të cilës ne i referohemi si disiplinë. Në fakt, në krahasimin e kohezionit partiak me disiplinën partiake në parlamentin zviceran, Hertig vë në dukje se shkalla e konsistencës mes mënyrës se si ndiheshin deputetët dhe si sillleshin ata ndryshonte nga partia në parti, sepse deputetët vështirë se votonin në të njëjtën mënyrë siç ndiheshin në diskutimet para votimit aktual (1978, fq. 77-9). Së dyti, dhe lidhur me argumentin e parë, rezultatet e votimeve pasqyrojnë vetëm veprimet e dukshme të ligjvënësve dhe jo preferencat e tyre të fshehura. Së treti, partitë politike janë në gjendje t'i manipulojnë rregullat dhe procedurat duke i mbajtur larg agjendës legjislative çështjet që do të cenonin unitetin partiak (Owens 2003, fq. 16).

Në fakt, pika e fundit nxjerr në pah një aspekt të rëndësishëm të përdorimit të rezultateve të votimit për të analizuar sjelljen e deputetëve; domethënë, fakti që në shumicën e legjislaturave të Evropës Perëndimore RV-të janë vetëm një nëngrup i të gjitha votave. Në raste të tilla, nëse përdoret ose jo një votim i cili regjistrohet është rezultat i një zgjedhjeje strategjike nga njëra prej partive (Carey 2009). Siç argumenton Saalfeld, 'votimet e regjistruara zakonisht bëhen kur një çështje është shumë e diskutueshme, kur të paktën njëra parti dëshiron të sinjalizojë pozicionin e saj për publikun, apo edhe shefat e grupeve parlamentare duhet të sigurojnë pjesëmarrjen e anëtarëve' dhe si të tillë ato votime priren ta mbivlerësojnë kohezionin në parti (1997, fq. 50). Për sa i

përket grupit të parë të kritikave, ato kanë të bëjnë më shumë për mënyrat 'si ndihen deputetët' sesa 'si sillen ata'; që është në fakt fokusi i librit. Për sa i përket kritikës së fundit, megjithatë, përdorimi i votimeve të regjistruara duket të jetë një normë në parlamentet e vendeve të EJL. Për shembull, 95 për qind e votave në parlamentin e Kosovës janë vota të regjistruara. Numri i madh i rezultateve të votimeve në Maqedoni të Veriut dhe Slloveni tregon gjithashtu përdorimin e shpeshtë të votave të regjistruara. Megjithatë, shpresoj se mangësitë janë kapërcyer deri diku duke intervistuar ligjvënës në vendet e EJL. Në përgjithësi, të dy masat duhet të na japin një kuptim të mjaftueshëm të sjelljes së deputetëve në këto vende.

3.1.1 Mbledhja e të dhënave

Për të mbledhur të dhënat e votimeve të hapura për 21 vendet evropiane, kam qenë në kontakt me një numër akademikësh, zyrtarësh parlamenti, përfaqësues të OJQ-ve, kolegë dhe të njohur nga Kosova dhe vendet e tjera të rajonit të EJL. Numri i vendeve për të cilat janë mbledhur rezultatet e votimeve është më shumë rezultat i disponueshmërisë së të dhënave sesa i ndonjë gjëje tjetër. Krahasuar me ato vende për të cilat kemi llogaritur nivelin e institucionalizimit të sistemit partiak në Tabelën 1.3, numri këtu është dukshëm më i ulët, sepse mbledhja e rezultateve të votimeve është shumë më e vështirë. Për shumicën e vendeve të Evropës Perëndimore, të cilat përfshihen në analizën tonë, të dhënat janë kryesisht të disponueshme në internet, ose me kërkesë të studiuesve. Megjithatë, siç vë në dukje Owens, edhe mes vendeve demokratike 'një hetim i përciptë zbulon se të dhënat e votimeve nuk janë të disponueshme... të paktën për periudha të gjata kohore'. Mes demokracive të Evropës Perëndimore, në fakt, vetëm për Shtetet e Bashkuara të gjitha votat e regjistruara janë të disponueshme publikisht dhe në një format lehtësisht të lexueshëm (Carey 2007, fq. 98). Për më tepër, disa vende duket se kalojnë rreth 1,000 akte të legjislacionit përmes një votimi të regjistruar, siç është për shembull rasti i Italisë, por të tjerat deri në 50 (2003, fq. 7-8).

Edhe mes legjislatrave për të cilat janë mbledhur të dhënat, ka një ndryshim të madh për sa i përket numrit të RV-ve të marra dhe të përdorura për analizë. Megjithëse ky numër nuk tregohet për vendet e Evropës Perëndimore, Qendrore dhe Lindore, ato variojnë nga disa qindra në disa mijëra. Po kështu, edhe informacioni i dhënë për një votim të caktuar është i ndryshëm në vende të ndryshme, me disa që ofrojnë informacion shumë të detajuar në lidhje me çështjen që votojnë deputetët, llojin e votës (p.sh. legjislacioni, vendimi, etj.) dhe

rezultatet nga votimet e ndryshme. Megjithatë, lloji i informacionit që gjejmë në të gjitha legjislaturat është nëse deputetët votuan pro, kundër ose abstenuan për një votim të caktuar, çka në fakt është e vetmja gjë që na intereson dhe është e mjaftueshme për të llogaritur unitetin e votimit. Edhe nëse një numër më i madh vendesh dhe votimesh do të përfshiheshin në analizë, ka pak dëshmi që rezultatet do të ndryshonin. Siç sugjeron literatura dhe tregon analiza e mëvonshme, ka relativisht një nivel më të madh uniteti mes vendeve të EP, dhe më shumë ndryshim në nivelin e unitetit mes vendeve të EQ dhe EJL.

Më konkretisht, të dhënat për Austrinë, Danimarkën, Finlandën, Gjermaninë, Islandën, Norvegjinë, Suedinë dhe Britaninë e Madhe, janë marrë nga Ulrich Sieberer (Sieberer 2006). Të dhënat për Belgjikën, Francën dhe Irlandëneerdhën nga Sam Depauw dhe Shane Martin (Depauw dhe Martin 2009), ndërsa të dhënat për Republikën Çeke, Estoninë, Hungarinë dhe Poloninë u mbledhën nga Margit Tavits (Tavits 2013). Përveç kësaj, kam mbledhur të dhëna për gjashtë vende të EJL-së, përkatësisht Bosnjën, Kosovën, Maqedoninë e Veriut, Malin e Zi, Serbinë dhe Slloveninë, duke lënë jashtë Shqipërinë dhe Kroacinë për të cilat përpjekjet për mbledhjen e të dhënave ishin të pasuksesshme. Tabela 3-1 jep një pasqyrë të të dhënave sipas vendit, periudhës kohore dhe burimit. Të dhënat për Bosnjën, Maqedoninë e Veriut dhe Slloveninë janë marrë nga web faqet e tyre parlamentare. Në rastin e Bosnjës, të dhënat e mbledhura nuk ishin në format elektronik dhe duke qenë kështu është e mundur të jenë përvjedhur disa gabime shumë të vogla gjatë transformimit të të dhënave në formatin elektronik, pavarësisht nga kontrolli i dyfishtë i votave. Megjithatë, në rastin e Maqedonisë së Veriut, meqenëse numri i RV-ve ishte më i madh, ato u mbledhën nga web faqja.

Tabela 3-1: Përmbledhje e të dhënave të votimeve për 21 vendet evropiane

Vendi	Vitet	Burimi
Austri	1994-1997	Sieberer 2006
Belgjikë	1991-1995	Depauw dhe Martin 2009
Bosnjë	2010-2012	Autorja
Republika Çeke	1996-2009	Tavits 2013
Danimarkë	1990-1996	Sieberer 2006
Estoni	1999-2007	Tavits 2013
Finlandë	1995-1996	Sieberer 2006
Francë	1993-1997	Depauw dhe Martin 2009

Vendi	Vitet	Burimi
Gjermani	1980-1990	Sieberer 2006
Hungari	1994-2006	Tavits 2013
Islandë	1995-1996	Sieberer 2006
Irlandë	1994-1996	Depauw dhe Martin 2009
Kosovë	2005-2010	Autorja
Maqedoni e Veriut	2002-2006	Autorja
Mal i Zi	2009-2011	Autorja
Norvegji	1990-1994	Sieberer 2006
Poloni	1997-2007	Tavits 2013
Serbi	2011	Autorja
Slloveni	2008-2012	Autorja
Suedi	1994-1995	Sieberer 2006
Mbretëri e Bashkuar	1992-2001	Sieberer 2006

E njëjta gjë vlen edhe për rezultatet e votimeve nga Sllovenia, por në krahasim me ato të Maqedonisë së Veriut, për to u desh shumë më shumë kohë për shkak të natyrës së veçantë të web faqes. Për më tepër, shkronjat e ndryshme në emrat e deputetëve, të cilët nuk njiheshin nga R (programi për llogaritje statistikore), dhe mospërputhja mes emrave nga njeëmandat në tjetrin krijoi vështirësi të mëtejshme në punën me të dhënat. Po kështu, në disa raste mungonin emërtimet e partive të cilave u përkisnin deputetet, kështu që u desh t'i merrja ato manualisht dhe t'i shtoja vetë në grupin e të dhënave. Të dhënat për Kosovën janë marrë nga një anëtar i stafit të Kuvendit, i cili ishte përgjegjës për trajtimin e votimit elektronik në parlament, me lejen e Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit. Të dhënat për Malin e Zi dhe Serbinë u mblodhën përmes Organizatave Joqeveritare (OJQ) nga të dy vendet. Kishte një OJQ në çdo vend, që merrej kryesisht me mbikëqyrjen parlamentare, që mblodhi të dhënat e papërpunuara në emrin tim. Gjithsej, mbledhja e këtyre votave ka marrë tre vjet duke llogaritur dhe kohën për shndërrimin e tyre në format lehtë të përdorshëm, veçanërisht pasi të dhënat boshnjake, malazeze dhe serbe erdhën në kopje të shtypura, dhe për më tepër, ato të Serbisë ishin në alfabetin cirilik dhe kërkonin të ndryshoja emrat në latinisht në mënyrë që lexuesi t'i njihnte. Tabela 3-2 jep një përmbledhje të numrit të votave të mbledhura për çdo vend të EJK-së, të zbërthyer sipas shteteve dhe termave.

Tabela 3-2: Përmbledhje e të dhënave të votimeve për vendet e EJL-së

Vendi	Vitet	Numri i votave
Bosnjë	2010-2011	371
	2011-2012	727
Kosovë	2005-2007	1771
	2007-2010	3863
Maqedoni	2002-2006	4869
Mal i Zi	2009-2011	662
Serbia	2011	558
Slloveni	2000-2004	2133
	2004-2008	2946
	2008-2011	1854
	2011-2012	190

Siç u la të kuptohet më herët, të gjitha të dhënat nga EJL kërkonin të pastroheshin. Në rastin e Bosnjës, janë përdorur të gjitha votat që janë marrë, përveç njëres në mandatin e dytë që ishte e duplikuar. Në rastin e Kosovës janë përjashtuar 183 vota, sepse nuk kanë pasur datë dhe në vend të datës ishte shkruar abstenim. Në rastin e Maqedonisë së Veriut, janë marrë vetëm votat për mandatin 2002-2006, megjithëse votat për periudhat e mëparshme ishin të disponueshme në web. Çështja me llojin e dytë të votave ishte se jo të gjitha votat ishin të lexueshme dhe disa vota nuk hapeshin, dhe si të tilla mbetën jashtë analizës. Në rastin e Malit të Zi, nga 667 vota, pesë vota janë hequr për shkak të problemeve të ngjashme. Edhe në rastin e Malin e Zi rezultatet e votimeve ekzistonin edhe para vitit 2009, megjithatë përpjekjet për t'i marrë ato të dhëna ishin të pafrytshme pasi, nga informatat që mblodha, ato ishin menaxhuar nga një kompani e pavarur dhe nuk ishin ruajtur nga parlamenti. Sa i përket Serbisë, ka pasur shumë vota në të cilat vetëm një pjesë e deputetëve kanë votuar dhe pjesa tjetër nuk kanë votuar, por megjithatë ishin listuar. Aty ku ishte kështu dhe kishin votuar më pak se 1/3 e deputetëve, unë i përjashtova votat. Gjithashtu, sa i përket Maqedonisë së Veriut dhe Serbisë, rezultatet e votimit janë dhënë vetëm në alfabetin cirilik dhe si të tilla janë koduar në 1 (Po), 2 (Jo) dhe 3 (Abstenim). Në disa vende, votimet kanë regjistruar edhe rastet kur deputeti nuk ka votuar (p.sh. nuk votoi), me ç'rast deputeti ose ishte i pranishëm por nuk votoi, ose nuk ishte i pranishëm por emri i tij/saj përmendej në rezultat. Megjithatë, as këto vota nuk u morën parasysh, pasi Indeksi Rice për matjen e kohezionit merr parasysh vetëm votat pro dhe kundër.

Analiza e të dhënave për votimet e regjistruara kërkonte të dhëna për kalimin e mundshëm të ndonjë deputeti në një parti ose grup parlamentar tjetër nga një mandat në tjetrin. Megjithatë, kjo nuk ishte aq problematike, sepse kjo sjellje mund të vëzhgohej qartë brenda grupeve të të dhënave në dispozicion. Megjithatë, më problematike ishte të dihej se cilët deputetë ndërruan parti gjatë një mandati të vetëm parlamentar. Për t'i marrë këto të dhëna, kontrollova raportet për aktivitetet parlamentare në çdo vend. Këto raporte ishin sigurisht më të detajuara për disa vende se të tjerat, por në shumicën e rasteve listoheshin deputetët dhe jepeshin edhe shënime për ndryshimet e tyre të përkatësisë partiake. Herë pas here, deputetët ndërronin përkatësitë partiake deri në 3-4 herë brenda një mandati, ku, për shembull, një deputet kaloi nga partia A në të qenit i pavarur, për t'iu bashkuar partisë B brenda pak muajsh. Ky ishte, për shembull, rasti me disa deputetë slovenë që shërbyen gjatë mandatit 2004-2008, megjithëse ishin shumë pak që ndryshuan grupet e tyre partiake në mandatin e fundit. Prandaj, u përpoqa të merrja në konsideratë të gjitha këto ndryshime.

Shkalla e ndryshme në numrin e rezultateve të votimeve për vendet e EJL ngre pyetjen se pse për shembull Kosova, Maqedonia e Veriut dhe Sllovenia kanë disa mijëra vota, ndërsa Bosnja, Mali i Zi dhe Serbia kanë vetëm një pjesë të atyre votave, një çështje e cila meriton diskutim. E thënë në përgjithësi, pse disa vende nxjerrin ligje më shumë se të tjerat, edhe pse nuk mund të përjashtohet mundësia që një pjesë e atyre votave të jenë vendime, pasi nuk mund ta dimë gjithmonë.³ Dikush do të supozonte se ngarkesa legjislative për të gjitha vendet do të ishte e njëjtë, sepse të gjitha ato janë në rrugë të anëtarësimit në Bashkimin Evropian (BE). Andaj, BE-ja kërkon që vendet të harmonizojnë legjislacionin e tyre me kornizën e vet legjislative, përkatësisht 'acquis communautaire'. Miratimi i një numri aktesh legjislacioni kërkohet gjithashtu si pjesë e Marrëveshjeve të Stabilizim Asociimit të BE-së (MSA), të cilat i kanë nënshkruar të gjitha vendet e rajonit. Dikush do të sugjeronte gjithashtu që parlamentet më të vogla miratojnë një sasi më të vogël legjislacioni në krahasim me parlamentet më të mëdha, por kjo nuk shpjegon pse Bosnja me një parlament me 42 ulëse miratoi 727 akte në një vit, krahasuar me 558 në Serbi me një parlament me 250 ulëse. Për më tepër, nëse shikojmë rastin e Kosovës, i cili do të shpjegohet më në thellësi më vonë, vendi shpalli pavarësinë në vitin 2008, kështu që sasia e madhe e legjislacionit mund të jetë rezultat i përpjekjeve të saj për shtetndërtim e jo i madhësisë së parlamentit.

3 Shënim: Edhe në studime të tjera, votat e regjistruara të përdorura për analizë nuk dallojnë domosdoshmërisht mes llojeve të votave, shih për shembull Saalfeld 1997.

Shikimi i pjesëve të legjislacionit të miratuar me kalimin e kohës nuk ofron as një shpjegim të besueshëm. Në rastin e Malit të Zi, parlamenti miratoi 276 ligje (116 amendamente) në vitin 2009, 420 ligje (1562 amendamente) në vitin 2010, 525 ligje (1940 amendamente) në vitin 2011, dhe 225 ligje (812 amendamente) në vitin 2012. Andaj, është e vështirë të pajtohesh me një shpjegim të vetëm që mund të vlejë për të gjitha vendet. Megjithatë, edhe nëse niveli i unitetit do të llogaritej në bazë të një mostre më të vogël të votave në secilin vend, vlerat e përgjithshme të unitetit vështirë se do të ndryshonin.

3.1.2 Matja

Në matjen e unitetit të GP-së, unë përdor Indeksin e Kohezionit të Stuart Rice (Carey 2009) i cili përben një matje standarde të unitetit të GP-së në sjelljen legjislative. Indeksi Rice shënohet me formulën e mëposhtme:

$$RICE_{ij} = \frac{|\%AYE - \%NAY|}{\%AYE + \%NAY}$$

për partinë i në votimin j. Prandaj, përqindja e atyre që votojnë pro (PO) dhe atyre që votojnë kundër (JO) llogariten si proporcione të atyre që votojnë po ose jo, dhe shuma e tyre është 100 për qind. Vlerat RICE mund të variojnë nga 0, kur një numër i barabartë deputetësh votojnë pro dhe kundër, deri në 100 në rastet kur të gjithë deputetët që kanë votuar votojnë njësoj. Një indeks alternativ është Agreement Index (AI) (Indeksi i Marrëveshjes), i cili ndryshe nga Indeksi RICE merr parasysh edhe abstenimet, të cilat siç argumenton Mezey mund të jenë të rëndësishme sepse 'disidenca brenda partive mund të manifestohet me abstenime nga votimi dhe, shumë më rrallë, duke votuar kundër partisë' (Mezey 1979, fq. 102). Megjithatë, ka dy arsye kryesore pse zgjedha të përdor të parin. Arsyeja e parë është se ka korrelacion të lartë mes dy indekseve (Hix et al 2005). E dyta është se vlerat e kohezionit në vendet e Evropës Perëndimore që kam marrë nga Sieberer janë llogaritur nga autori duke përdorur Indeksin Rice. Kështu, megjithëse të dy indekset lidhen mirë, përdorimi i AI për vendet e EJT-së do të sillte krahasimin e vendeve në baza paksa të pabarabarta.

3.2 Intervistat

Për të mbledhur të dhëna për lidhjet me elektoratin, kam bërë një numër intervistash me deputetë në Kosovë, si me ata të zgjedhur nën SP me lista

të mbyllura ashtu edhe ata me lista të hapura, si dhe në Maqedoni të Veriut me SP me lista të mbyllura. Dikush mund ta vërë në dyshim besueshmërinë e intervistave si një mjet për të vlerësuar fuqinë e lidhjeve të deputetëve me votuesit; domethënë, deputetët mund të kenë një nxitje për t'i mbivlerësuar aktivitetet e tyre zgjedhore për t'u dukur aktivë në rolin e tyre. Për më tepër, mund të ndodhë që edhe ata deputetë që nuk dëshirojnë të jenë në kontakt të afërt me votuesit, mund të mos e pranojnë këtë hapur. Prandaj, kjo me siguri e minon saktësinë e përgjigjeve të tyre. Megjithatë, përveç faktit që nuk ka asnjë mënyrë tjetër të mundshme për të marrë të dhëna për aktivitetet e deputetëve në Evropën Juglindore, nuk është vërejtur ndonjë arsye pse deputetët nuk do të jepnin përgjigjet e tyre të sakta. Gjithashtu, nuk kishte arsye pse ata do ta ekzagjeronin kohën që kalojnë në zonën zgjedhore; në fund të fundit, të dhënat për individët veç e veç nuk do të zbuloheshin publikisht, kështu që ata, në parim, nuk kishin asnjë arsye për të qenë të pandershëm në përgjigjet e tyre. Në fakt, edhe pse secilit deputet i është premtuar konfidencialitet dhe intervistat janë incizuar, pothuajse të gjithë kanë thënë se nuk do të kenë problem nëse zbulohet identiteti i tyre, përveç dy deputetëve në Maqedoni të Veriut që nuk kanë dashur që intervistat të incizohen fare.

Megjithatë, në përpjekje për ta kapërcyer këtë problem të mundshëm, unë përdor disa matje të lidhjeve me zgjedhësit. Njëra është numri i orëve në javë që deputetët shpenzojnë duke bërë aktivitete të ndryshme me elektoratin, jashtë orarit të tyre të punës si ligjvënës. E dyta është numri i kërkesave që kanë të bëjnë me autoritetet publike që deputetët marrin nga zgjedhësit në javë. E treta është numri i orëve që deputetët shpenzojnë për t'u marrë me këto kërkesa. Së fundi, për të matur lidhjet me zonat zgjedhore përdoret edhe numri i orëve që deputetët shpenzojnë në zonën e tyre lokale në muaj. Për më tepër, në rastin e aktiviteteve të deputetëve në SP me lista të mbyllura në Kosovë, të dhënat janë mbledhur nga kujtimet e deputetëve për sjelljen e tyre disa vite më parë. Kjo mund të jetë problematike edhe për sa i përket saktësisë së kujtimeve të deputetëve. Megjithatë, kjo qasje, me të gjitha problemet e saj të mundshme, justifikohet nga mundësia për të shqyrtuar efektet e ndryshimit të sistemit zgjedhor duke i mbajtur të gjitha të tjerat konstante.

Në kohën kur intervistat kryheshin në Kosovë, vendi ishte në prag të zgjedhjeve lokale. Në Maqedoni të Veriut, në të njëjtën kohë me intervistimin e deputetëve, u shpallën zgjedhje të parakohshme parlamentare. Kështu, mund të vihet në dyshim edhe shkalla në të cilën deputetët, të ndikuar nga fushata jozyrtare zgjedhore, mund ta kenë ekzagjeruar kohën që kalojnë me zgjedhësit e tyre, dhe se kjo mund të mos jetë përfaqësuese e kohës së tyre

jashtë periudhës zgjedhore. Megjithatë, vetëm disa deputetë ishin të përfshirë në garën zgjedhore për kryetar komune në Kosovë, ndërsa në Maqedoni të Veriut fakti që deputetët duhej të ishin në parlament për të miratuar sasinë e madhe të legjislacionit që solli qeveria në javët e fundit të mandatit të tyre, nënkuptonte që deputetët duhej të mendonin jashtë periudhës zgjedhore pasi përndryshe, siç përcillet gjerësisht, koha që ata kalonin me zonat zgjedhore në atë muaj të caktuar ishte minimale.

3.2.1 Mbledhja e të dhënave

Kosovë

Në mbledhjen e të dhënave për Kosovën, fillimisht bëra një studim pilot duke realizuar, brenda një periudhe njëjavore, gjatë prillit 2013, 14 intervista me deputetë: 7 me anëtarë të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), 4 me anëtarë të Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) dhe 3 me anëtarë të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK). Prej tyre, 5 nga 7 nga LDK-ja dhe të gjithë nga PDK-ja kanë shërbyer edhe nën SP me lista të mbyllura edhe nën atë me lista të hapura. Ka qenë edhe një deputete e AAK-së e cila ka shërbyer edhe në vitin 2004 edhe në vitin 2007, por deputetja nuk jetonte më në Kosovë, kështu që nuk munda ta intervistoj. Pyetjet ishin kryesisht të hapura, ku fillimisht deputetëve iu bënë pyetje për metodat e përzgjedhjes së kandidatëve brenda partive të tyre, e më pas pyetje për mënyrat e tyre për të mbajtur kontakte me elektoratin. Si rezultat i shqyrtimit të përgjigjeve të deputetëve ndaj pyetjeve të bëra në studimin pilot, pyetësi u ripërcaktua bazuar kryesisht në sondazhin e PartiRep, në mënyrë që të dhënat e gjeneruara nga intervistat të ishin më të përshtatshme për analizë dhe në verën e vitit 2013 u ktheva me një pyetësor të ridizajnuar.

Anëtarët e parlamentit nuk ndiheshin gjithmonë të gatshëm për t'iu përgjigjur 'pyetjeve me numra', si p.sh. sa orë pune kanë shpenzuar duke bërë aktivitete me votues, por u dhashë atyre mjaft kohë për të menduar para se të përgjigjeshin. Intervista e parë u zhvillua më 20 qershor 2013 dhe e fundit më 16 gusht 2013. Gjithsej kam bërë 59 intervista me 49 deputetë, por 10 deputetë janë intervistuar dy herë, prandaj numërohen si shtesë. Numri i deputetëve të intervistuar nga tre partitë kryesore sipas sistemit zgjedhor dhe gjinisë është paraqitur në Tabelën 3-3. Partitë e tjera janë përjashtuar qëllimisht, pasi ato ishin ose shumë të vogla, ose nuk ishin të përfaqësuara në disa mandate, andaj nuk mund të krahasohej sjellja e tyre me kalimin e kohës. Duhet të theksohet se këtu paraqitet edhe një anëtar nga një komunitet pakicë, sepse ai ishte pjesë e një prej koalicioneve më të mëdha parazgjedhore dhe po ashtu pjesë e GP të

tyre. Në atë rast edhe pyetjet që kanë të bëjnë me përzgjedhjen e kandidatëve janë parashtruar në mënyrë të tillë që të mblidhen njohuri mbi rregullat që rregullojnë përzgjedhjen në listën zgjedhore dhe jo listën e partisë së tij.

Tabela 3-3: Numri i deputetëve të intervistuar në Kosovë, 2013

	GP			Gjinia		Sistemi Zgjedhor		N
	LDK	PDK	AAK	Meshkuj	Femra	SP me listë të mbyllur	SP me listë të hapur	
Deputetë të intervistuar	27	21	11	43	16	19	40	59
Numri i deputetëve të GP	25*/29**	37/34	13/13	85/80	35/40			120***
Në Qeveri	Po/Jo	Po/Po	Jo/Jo					

*Mandati i parë. **Mandati i dytë. *** Deputetët nga 20 ulëset e rezervuara nuk janë intervistuar.

Në kohën kur u kryen intervistat, deputetët ishin shumë të ngarkuar me punë, pasi parlamenti mblidhej çdo ditë pune përveç të martës. Në një farë mënyre, kjo ishte një gjë e mirë, sepse shumica e tyre gjendeshin në Kuvend. Ndihmesë ishte edhe fakti se kam punuar më parë në të njëjtën ndërtesë dhe e njoh terrenin, por duhej vetëm një takim i konfirmuar për ditën që të mund të futeshe brenda ndërtesës. Për pjesën tjetër, do të qëndroja në parlament, shpesh për disa orë, derisa të realizoja sa më shumë intervista. Përgjithësisht, deputetët ishin shumë të qashtëm në një afat të shkurtër dhe një numër i madh i tyre dolën edhe nga seanca parlamentare për të kryer intervistën dhe për t'u rikthyer për periudhën e votimit. Intervistat zgjatën mesatarisht rreth 40 minuta, ku më e gjata ishte rreth 1.5 orë dhe më e shkurtra rreth 15 minuta. Numri më i madh i intervistave janë bërë në kohën kur parlamenti ishte ende në sesion, pra deri në fillim të gushtit. Sigurisht, kjo nuk vlente aq shumë për deputetët që në momentin e intervistimit nuk kishin mandat. Pas kësaj ishte e vështirë të kontaktoja me deputetët për shkak të periudhës së pushimeve. Intervistat u bënë në zyrat e deputetëve në parlament, në korridoret e parlamentit, në kafene jashtë, dhe dy u kryen përmes emailit,

sepse njëri deputet ishte aktualisht jashtë vendit, por u ofrua t'u përgjigjej pyetjeve, dhe tjetri mendonte se ishte më praktike. Në rastet kur deputetët intervistoheshin në kafene apo korridore, sigurohesha që ato të bëheshin privatisht dhe ligjvënësit të mos dëgjoreshin nga të tjerët.

Grupi i parë i të intervistuarve u përzgjedh në mënyrë të qëllimshme, sepse qëllimi ishte të intervistoheshin ata deputetë që kishin shërbyer si nën SP me lista të mbyllura ashtu edhe nën SP me lista të hapura, në mënyrë që të pyeteshin për lidhjet e tyre me elektoratin në të dy sistemet. Më pas, punët rrodhën vetvetiu. Megjithatë, në përgjithësi është e vështirë të jepet një përqindje e përgjigjeve për intervistat, sepse jo të gjithë deputetët u shënjestruan, për arsye të cilat u shpjeguan më herët, dhe ata që ishin shënjestruar gjerësisht iu përgjigjën pyetjeve.

Duke ditur se ndërrimi i partisë është i zakonshëm në Kosovë, më duhej të sigurohesha që ato ndërrime të merreshin parasysh kur klasifikoheshin deputetët në grupe partiake. Megjithatë nuk u konsultuan të dhëna të veçanta për shkak të njohurive të mia për zhvillimet politike. Vlen të theksohet se nuk ka pasur asnjë rast nga të intervistuarit që deputetët të ndërrojnë parti gjatë mandatit për të cilin po intervistoheshin. Megjithatë, tre raste ia vlen të përmenden. Njëri është një deputet që i përkiste një partie në mandatin e parë dhe një partie tjetër në mandatin e dytë. Kam intervistuar deputetin vetëm për mandatin e dytë, kryesisht sepse partia e deputetit u shpërbë dhe nuk përfaqësohet më në parlament. Rasti i dytë ishte një deputet i cili më herët kishte qenë pjesë e një partie tjetër, por në atë kohë ishte ministër dhe jo deputet, kështu që kjo ishte e parëndësishme, pasi nuk mund të krahasohej sjellja e tij me kalimin e kohës. Rasti i tretë është një deputet i komunitetit pakicë, i cili ka qenë në parlament për disa mandate, por ngjashëm me rastin e parë unë e intervistova deputetin vetëm për mandatin aktual në të cilin ai ishte pjesë e një grupi më të madh partiak që në fakt ka qenë në qeveri për disa mandate.

Maqedonia e Veriut

Në studimin e stimujve të deputetëve të Maqedonisë së Veriut për të mbajtur lidhje të ngushta me zgjedhësit e tyre, janë zhvilluar poashtu intervista me ligjvënës, ngjashëm si me rastin e Kosovës. Gjithsej 49 intervista janë realizuar gjatë shkurtit 2014, ku intervista e parë është realizuar më 4 shkurt dhe e fundit më 28 shkurt. Pasi në janar kuptova se mund të ketë zgjedhje të parakohshme së bashku me zgjedhjet e rregullta presidenciale në prill, u organizova të qëndroj në Maqedoni të Veriut gjatë gjithë muajit pak para përfundimit të mandatit parlamentar më 5 mars. Intervistimi i deputetëve pas kësaj kohe ishte

i vështirë, pasi ata të gjithë u shpërndanë në mbarë vendin për të bërë fushatë, edhe pse fushata zyrtare nuk kishte filluar ende; një praktikë e zakonshme në shumicën e vendeve të rajonit. Tabela 3-4 tregon numrin e deputetëve të intervistuar sipas grupit parlamentar, gjinisë dhe përkatësisë etnike.

Tabela 3-4: Numri i deputetëve të intervistuar në Maqedoni të Veriut, 2013

	GP						Përkatësia etnike					Gjinia		N
	VMRO	SDSM*	BDI	DPA	PEI	NDR**	Maqedonas	Shqiptarë	Vllahë	Boshnjakë	Romë	Meshkuj	Femra	
Deputetë të intervistuar	18	14	9	5	2	1	30	15	2	1	1	26	23	49
Numri i deputetëve të GP	56	37	15	8	5	2	84	25	2	2	2	81	42	123***
Në Qeveri	Po	Jo	Po	Jo	Jo	Jo								

*Numri i vendeve që fitoi koalicioni i LSDM-së është 42, por PEI së bashku me dy deputetë të pavarur (gjithashtu pjesë e koalicionit të LSDM-së) formuan një grup të veçantë parlamentar më vonë. **NDR nuk ka grup parlamentar. ***Asnjë nga tre deputetët e diasporës nuk u intervistua.

Pyetjet e përdorura ishin të njëjta me ato në Kosovë, të përdorura për intervistimin e deputetëve të zgjedhur sipas sistemit proporcional me lista të mbyllura, të cilat kryesisht janë marrë nga sondazhi i PartiRep. Herë pas here, deputetët u ankuan për gjatësinë e pyetësorit, por mbi 90 për qind e deputetëve të intervistuar iu përgjigjën të gjitha pyetjeve. Megjithatë, dhënia e një shkalle të përgjithshme të përgjigjeve për Maqedoninë e Veriut, ngjashëm si në rastin e Kosovës, është e vështirë, edhe pse do të kishte qenë e dobishme për t'i krahasuar këto me shkallët e përgjigjeve të studimeve të tjera. Arsyeja kryesore për këtë është se kam synuar dhe kam arritur të siguroj vetëm 50-60 intervista si në Kosovë ashtu edhe në Maqedoninë e Veriut; sa për të më dhënë një mostër përfaqësuese të të gjithë trupit të deputetëve. Suksesi i realizimit të kaq shumë intervistave në një periudhë kaq të shkurtër kohore qëndron kryesisht në ndihmën që kam marrë nga kryetari i GP-së të Bashkimit Demokratik për Integrim (BDI). Stafi i BDI-së më ka ndihmuar në caktimin e intervistave, dhe meqenëse partia ishte pjesë e koalicionit arrita të intervistoj një numër të madh të deputetëve maqedonas por, edhe nga partneri i tyre i koalicionit. Për më tepër, përkthimi i ofruar nga stafi i BDI-së si dhe nga një akademik i Maqedonisë

së Veriut ishte jashtëzakonisht i dobishëm për kryerjen e intervistave me ligjvënës që flisnin maqedonisht.

Grupi i parë i të intervistuarve u përzgjedh në mënyre të qëllimshme, përkatësisht ata që flisnin anglisht dhe shqip; gjuhën time amtare. Megjithatë, pas kësaj, hyri në veprim qasja ortek, pasi shumë nga deputetët e intervistuar më referonin, apo edhe më caktonin intervista me kolegët e tyre partiakë. Në përgjithësi, 17 intervista janë realizuar në gjuhën angleze, 15 në shqip, 14 në maqedonisht me përkthim, dhe unë vetë kam bërë 3 intervista në serbishten time mesatare. Kjo bëri të mundur përfshirjen në listën e të intervistuarve të deputetë të etnive dhe grupmoshave të ndryshme, por sigurisht që i zgjati disa intervista. Intervista më e shkurtër zgjati rreth 15 minuta dhe intervista më e gjatë rreth 1.5 orë. Intervistat u organizuan me shpejtësi. Fillimisht dërgova email në të gjitha llogaritë zyrtare të emailave të deputetëve të Maqedonisë së Veriut, por shkalla e përgjigjeve ishte shumë e ulët, veçanërisht pasi shumica e inbox-eve të tyre ishin plot. Rrjedhimisht, mora numrat e telefonit të deputetëve dhe, sapo arrita në Shkup, u telefonova ose u dërgova mesazhe deputetëve drejtpërdrejt për të caktuar intervistat. Në fakt, kontaktimi i deputetëve përmes telefonit ishte ndoshta mënyra e vetme për të organizuar intervista si në Maqedoni të Veriut ashtu edhe në Kosovë. Vështirësia tjetër ishte se, siç u përmend më herët, ishte shumë e qartë se zgjedhjet parlamentare do të mbaheshin menjëherë pas zgjedhjeve presidenciale të cilat ishin caktuar për në prill. Andaj, parlamenti mbledhjet çdo ditë duke përfshirë edhe të premtën, të cilat sipas Ligjit për Kuvendin (Neni 36), janë ditë kur përfaqësuesit duhet të takohen me zgjedhësit e tyre jashtë parlamentit, dhe mbledhjet e komisioneve mbaheshin edhe më shpesh. Vetëm në ditët e fundit të mandatit të saj, mbi 150 ligje u sollën për miratim nga qeveria.

Prandaj, në përgjithësi, deputetët kishin pak kohë për të bërë diçka tjetër, por megjithatë ishin të qasshëm dhe shumica e tyre gjetën kohë të mjaftueshme për t'iu përgjigjur të gjitha pyetjeve. Për të kuptuar nëse ndonjë nga deputetët e intervistuar ka ndërruar parti gjatë mandatit, më është dashur të konsultoj të dhënat për ndërrimin e partive të cilat kanë ardhur nga web faqja e parlamentit të Maqedonisë së Veriut.⁴ I ashtuquajtur 'Izveštaj' (Raport) që përshkruante të gjitha aktivitetet parlamentare për një periudhë të caktuar kohore, ishte në dispozicion vetëm në alfabetin cirilik. Herë pas here, Izveštaj jepte listën e deputetëve për mandatin parlamentar në fjalë, por nuk specifikonte se kush i ndërroi grupet partiake nga periudhat e mëparshme.

4 Shënim: E njëjta gjë u bë për të marrë informacionin e ndërrimit të partive për llogaritjen e unitetit të GP-së.

Në ato raste kam krahasuar listën e deputetëve dhe grupet e tyre partiake nga njëra periudhë në tjetrën. Asnjë nga deputetët e intervistuar nuk kanë ndërruar parti gjatë mandatit për të cilin janë intervistuar. Megjithatë, duhet theksuar se ka pasur një rast me një nga deputetët e intervistuar, i cili pretendonte se ishte i pavarur, por megjithatë deputeti ishte pjesë e një prej GP-ve më të mëdha. Andaj intervista u përfshi në analizë, megjithëse disa nga pyetjet e lidhura me partinë u anashkaluan.

3.2.2 Matja

Numri i përgjithshëm i pyetjeve të bëra në intervista ishte tridhjetë e një. Ndër të tjera, deputetët u pyetën se kush e përcaktonte përzgjedhjen e kandidatëve, cili ishte roli i tyre si deputet, cili mendonin se ishte fokusi kryesor i përfaqësimit të tyre, sasia e lidhjeve me zgjedhësit, mënyrat e tyre për të mbajtur lidhje të tilla, nëse votuesit kishin kërkesa për deputetët dhe si bëheshin këto kërkesa, e kështu me radhë. Lidhjet me elektoratin, siç u përmend më lart, më pas u matën duke përdorur katër pyetje të ngjashme për të përmirësuar saktësinë e matjes. Siç poashtu u përmend, pyetjet janë marrë kryesisht nga sondazhi i PartiRep dhe për këtë arsye janë të dobishme për krahasimin e gjetjeve për Kosovën dhe Maqedoninë e Veriut me ato në vendet e Evropës Perëndimore, ku janë përdorur dhe testuar pyetjet.

Sa i përket variablave të pavarura, në rastin e Kosovës, ato janë sistemi zgjedhor dhe rregullat e përzgjedhjes së kandidatëve. Rregullat që definojnë zgjedhjet janë shqyrtuar nga disa legjislacione që janë miratuar mes viteve 2001 dhe 2010. Të gjitha ligjet janë të publikuara në gazetën zyrtare të Kuvendit të Kosovës dhe mund të qasen lehtësisht në web faqen e Kuvendit. Përzgjedhja e kandidatëve në listë është matur duke përdorur intervista me deputetë. Sigurisht që mund të shqyrtohen rregulloret e punës së partive të ndryshme dhe të konstatohet se si funksionon përzgjedhja e kandidatëve, por ajo që është thelbësore është të kuptojmë se kë e perceptojnë deputetët si kontrollues të listës së kandidatëve, sepse atij do t'i përgjigjen. Megjithatë, matja e përzgjedhjes së kandidatëve në listë nuk është një detyrë e lehtë nga pikëpamja empirike. Siç vërejnë Rahat dhe Hazan, 'përzgjedhja bëhet nga përzgjedhës të ndryshëm, këta përzgjedhës përdorin sisteme të ndryshme nominimi dhe disa kandidatë përzgjedhen në lloje të ndryshme vendndodhjesh, të përcaktuara territorialisht dhe/ose funksionalisht' (2001, fq. 299). Ky studim përdor një matje të thjeshtë të përzgjedhjes së kandidatëve,

ku përgjigjet e kandidatëve vendosen në një vazhdimësi ndërmjet metodave të decentralizuara dhe të centralizuara të përzgjedhjes së kandidatëve (Gallagher 1998, fq. 4). Në rastin e Maqedonisë së Veriut, variablat e pavarura janë përzgjedhja e kandidatëve, gjinia, mosha dhe mandati i deputetëve. Të dhënat për këto variable u mblodhën nga web faqja e parlamentit, dhe në mënyrë të ngjashme metodat e përzgjedhjes së kandidatëve u matën nga përgjigjet e deputetëve.

Është përmendur më herët, në kapitullin 2, se mungon një metodë e bazuar mirë për të studiuar përzgjedhjen e kandidatëve. Për shembull, Rahat dhe Hazan kanë katër tregues për të bërë këtë e që përfshijnë kandidaturën (çështja se kush ka të drejtë të paraqesë kandidatët), përzgjedhësin (organi që i përzgjedh kandidatët), decentralizimin si dhe sistemet e votimit kundrejt emërimeve (2001). Megjithatë, të njëjtët autorë argumentojnë se mjafton të përqendrohemi vetëm tek përzgjedhësi për të shqyrtuar metodat e përzgjedhjes së kandidatëve, siç kemi bërë edhe ne. Siç argumentojnë ata, 'është përzgjedhësi që shfaq pasojat më të rëndësishme dhe më të gjera në përgjithësi, dhe është centralizimi kundrejt ekskluzivitetit të përzgjedhësit ai që e bën këtë në veçanti' (2007, fq. 369). Më e rëndësishmja, duke pasur parasysh se 'literatura ekzistuese sugjeron që thelbi i kontrollit zakonisht shtrihet diku mes dy ekstremeve' (përfshirës/përrjashtues ose i decentralizuar/centralizuar) (Gallagher 1988, fq. 4), këtu ne duam kryesisht të shohim nëse përzgjedhja e kandidatit është në një ekstrem; në kuptimin që përzgjedhja e kandidatëve varet nga agjencia qendrore e partisë (pavarësisht se çfarë lloj agjencie dhe sa e madhe është kjo agjenci), ose është në ekstremin tjetër; me ç'rast kandidatët i përzgjedhin njësia lokale e partisë.

Për ta përmbledhur këtë kapitull, mbledhja dhe analizimi i të dhënave kanë qenë proces i gjatë dhe që ka kërkuar shumë kohë. Kushdo që angazhohet në lloj të ngjashëm hulumtimesh mes demokracive të reja duhet të parashikojë sasinë e punës që kjo do të kërkojë. Unë isha me fat që kisha një rrjet njerëzish që më ndihmuan shumë në mbledhjen e këtyre të dhënave, dhe njohuritë e mia për rajonin gjithashtu ndihmuan në një masë të madhe. Në mënyrë të ngjashme, ata që angazhohen në hulumtime të ngjashme duhet të dinë se mënyrat formale të organizimit të intervistave nuk funksionojnë brenda kontekstit të EJJ, pasi shumica e intervistave planifikohen me telefon, kryesisht me mesazhe, dhe në baza ad-hoc në kundërshtim me sugjerimet që hasim në literaturën e Evropës Perëndimore për realizimin e intervistave. Për aq sa kjo mund të konsiderohet si një avantazh, ka edhe një disavantazh të madh pasi ka shumë pasiguri. Siç u përmend më herët, kalova shumë kohë në

parlamentet e të dyja vendeve duke pritur që deputetët të përgjigjen që të mund të bëja intervistat. Nuk ka gjasa që një numër i ngjashëm deputetësh të ishte siguruar pa shkuar realisht atje. Së fundi, lloji i masave që përdoren përcaktohen shumë nga lloji i të dhënave që mblidhen, dhe brenda EJK nuk ka shumë ndryshueshmëri të të dhënave. Megjithatë, të gjitha të dhënat e mbledhura për këtë projekt do të vihen në dispozicion për studiues të tjerë dhe shpresojmë se kjo do të ngrejë interesin akademik për studimin e rajonit. Kapitulli vijues shqyrton ndikimin e sistemeve zgjedhore në aspektin e parë të ndryshorit tonë të varur; uniteti i Grupit Parlamentar.

4

Ndikimi i sistemeve zgjedhore në sjelljen e deputetëve

4.1 Hyrje

Në këtë kapitull, do të shqyrtojmë ndikimin e sistemeve zgjedhore në sjelljen e deputetëve, fillimisht duke analizuar modelet e votimit të deputetëve në 21 vende evropiane dhe më pas duke u fokusuar veçanërisht në 6 vende të Evropës Juglindore (EJL). Siç u përmend në kapitujt e mëparshëm, teksa studimet mbi sjelljen e ligjvënësve duke përdorur rezultatet e votimeve janë kryer në disa vende të Evropës Perëndimore, kontributi kryesor i këtij kapitulli është se, përveç shqyrtimit të të dhënave për një numër vendesh të Evropës Perëndimore, janë shtuar të dhëna nga 6 vende të EJL-së, të cilat nuk janë ekzaminuar më parë. Duke vepruar kështu, ky studim bën një analizë më të gjerë e cila na lejon të krahasojmë nivelin e unitetit mes partive në vendet e Evropës Perëndimore, ku institucionalizimi i sistemit partiak është i lartë, me atë të homologëve të tyre në rajonin e EJL-së, ku, siç tregohet në Kapitullin 1 (shih në veçanti Tabelën 1-2), institucionalizimi është shumë më i ulët. Edhe pse është sugjeruar se 'marrëdhëniet sistematike mes karakteristikave institucionale dhe unitetit të partisë mund të vlerësohen vetëm nëse sistemi partiak i një vendi është mirë i zhvilluar dhe stabil' (Sieberer 2006, fq. 159), siç tregohet këtu, janë variacionet në nivel të unitetit ndërmjet sistemeve partiake me institucionalizim të dobët që na ofrojnë motive për ta shpjeguar këtë variacion. Përndryshe, në mesin e sistemeve partiake me institucionalizim të lartë, me përjashtim të Finlandës, modeli i kohezionit është uniform në të gjithë vendet, duke na lënë me shumë pak variacione për të shpjeguar.

Vendet e përfshira në analizë përdorin sisteme të ndryshme zgjedhore dhe kanë nivele të ndryshme të institucionalizimit të sistemit partiak, gjë që na

lejon të kërkojmë çdo marrëdhënie sistematike mes këtyre ndryshorëve të pavarur dhe ndryshorit tonë të varur - unitetit të GP. Siç përshkruhet në Kapitullin 2, stimujt e deputetëve për të votuar në mënyrë të pavarur nga partia do të jenë më të ulët në sistemet zgjedhore me orientim kah partia, të cilave u mungon konkurrenca zgjedhore brenda partisë dhe kështu partia kontrollon perspektivat e deputetëve për t'u rizgjedhur, dhe do të jetë më të lartë në sistemet zgjedhore me orientim kah kandidati, të cilat lejojnë konkurrencën zgjedhore brenda partisë, dhe për rrjedhojë rizgjedhja e deputetëve varet si nga partia ashtu edhe nga votuesit. Prandaj, hipoteza e parë që testohet këtu është: Uniteti i GP-së do të jetë më i lartë në sistemet zgjedhore të orientuara kah partia, të cilave u mungon konkurrenca zgjedhore brenda partisë, sesa në sistemet zgjedhore të orientuara kah kandidati, të cilat lejojnë një konkurrencë të tillë zgjedhore brenda partisë (H.1). Për më tepër, presim që këto efekte të shihen vetëm kur niveli i institucionalizimit të sistemit partiak është i ulët për arsye të cilat janë përshkruar në detaje më herët (H.1.a).

Gjithashtu u përmend në kapitullin 2 se kohezioni pritet të jetë më i lartë në disa çështje sesa në të tjerat. Më konkretisht, kohezioni do të jetë më i lartë për çështjet që janë thelbësore për mbijetesën e qeverisë, siç është buxheti për shembull, në krahasim me çështjet më pak vendimtare për mbijetesën e qeverisë, siç janë çështjet mjedisore. Andaj, konkluduar se uniteti i GP-së do të jetë më i lartë për çështjet që janë të rëndësishme për mbijetesën e qeverisë dhe do të jetë më i ulët për çështjet që nuk janë të rëndësishme për mbijetesën e qeverisë (H.2). Megjithatë, testimi i kësaj hipoteze në 21 vendet evropiane është i ndërlikuar, pasi do të na kërkonte të kodonim çështjet për secilin vend. Për më tepër, për ta bërë këtë, do të na duhej të kishim njohuri relativisht të mira për çështjet brenda vendeve në mënyrë që të mund t'i kategorizojmë ato siç duhet, sepse ajo që mund të konsiderohet një çështje e rëndësishme në një vend mund të mos shihet aq e rëndësishme në një tjetër. Siç do të shihet më vonë, në kontekstin e Kosovës në të cilën testohet kjo hipotezë, çështjet të cilat janë të rëndësishme për mbijetesën e qeverisë janë ato që kanë të bëjnë me pavarësinë e vendit, të cilat janë krejt të ndryshme nga lloji i çështjeve që mund të lidhen me mbijetesën e qeverisë në vende të tjera.

Hipoteza 3 sugjeroi që uniteti i GP-së do të jetë më i ulët sa më i lartë të jetë numri i bashkëpartiakëve kundër të cilëve kandidatët duhet të konkurrojnë. Kjo do të thotë, sa më e lartë të jetë madhësia e zonës zgjedhore, aq më i ulët do të jetë niveli i unitetit. Arsyeja pas kësaj është se me rritjen e madhësisë

së zonës zgjedhore, rritet edhe numri i bashkëpartiakëve kundër të cilëve kandidatët duhet të konkurrojnë. Megjithatë, ky efekt pritet vetëm në sistemet zgjedhore të orientuara kah kandidati, ku ka një konkurrencë të tillë zgjedhore brenda partisë. Siç shpjegon Carey, ajo që përcakton nëse rritja e madhësisë së zonës zgjedhore çon në më shumë ose më pak stimuj për personalizëm, është nëse votuesve u jepet mundësia të zgjedhin kandidatët përmes votave preferenciale (2007, fq. 94). Në mungesë të një konkurrence të tillë, në sistemet zgjedhore të orientuara kah partia, me rritjen e madhësisë së zonave, zvogëlohen stimujt për kandidatët për t'u diferencuar (Carey dhe Shugart 1995, fq. 418). Mes sistemeve zgjedhore të orientuara kah kandidati dhe atyre të orientuara kah partia, zonat ndryshojnë në madhësi në mostrën tonë, duke filluar nga zonat me një anëtar, siç është rasti me Francën, deri në 250 në rastin e Serbisë, ku i gjithë kombi është një zonë zgjedhore. Vendet e tjera bien diku në mes. Kjo ofron variacion të mjaftueshëm për të testuar efektin e madhësisë së zonës zgjedhore në unitetin e grupeve parlamentare.

Ne gjithashtu argumentuam se uniteti i GP-së do të jetë më i lartë për partitë qeveritare sesa për partitë opozitare (H.4). Së pari, kjo ndodh sepse në sistemet parlamentare mbijetesa e kabinetit varet nga mbështetja e shumicës në parlament. Andaj, procedura e votës së mosbesimit konsiderohet e mjaftueshme për të nxitur kohezionin partiak. Së dyti, duke vepruar në mënyrë kohezive, partnerët e koalicionit mund të qeverisin në mënyrë më efektive. Në fakt, nevoja për të arritur konsensus mes partive të koalicionit në vetvete do të çojë në një rezultat më koheziv në ato parti, megjithëse e pranuar se në varësi të numrit të partive në koalicion mund të bëhet gjithashtu e vështirë për partitë që të bien dakord për një rezultat votimi. Lidhur me këtë, sugjeruam edhe se marzhi i qeverisë ndaj opozitës do të ndikojë gjithashtu në unitetin e GP-së. Më konkretisht, sa më i vogël të jetë marzhi i partive qeverisëse ndaj opozitës, aq më i lartë do të jetë uniteti i GP-së (H.5). Kur dallimi mes të dyjave është i gjerë, partitë qeveritare munden, në një farë mase, të lejojnë që deputetët të votojnë ndryshe nga shumica e GP-së së tyre. Por, kur kjo diferencë është e ngushtë, lejimi i deputetëve të dalin kundër mund të rrezikojë miratimin e projektligjit. Në grupin tonë të të dhënave, kjo diferencë varion nga vlera negative, si në rastin me qeveritë minoritare në vendet skandinave, deri në marzhe relativisht të mëdha siç është rasti, për shembull, me partitë qeverisëse gjatë qeverisë 1994-1998 në Hungari. Së fundi, duke u mbështetur në gjetjet brenda literaturës ekzistuese, supozuam se një numër i variablave të kontrollit do të ndikojnë gjithashtu në nivelin e unitetit, përkatësisht madhësia e grupit parlamentar dhe vjetërsia e partisë. Së pari, partitë e vogla do të jenë më kohezive se

partitë e mëdha (H.6) sepse ato janë më homogjene dhe, po kështu, partitë e vjetra do të jenë më kohezive se partitë e reja (H.7) sepse priren të jenë më të institucionalizuara. Seksioni vijues paraqet një përmbledhje të nivelit të kohezionit në të 21 vendet përpara se të diskutohen gjetjet nga testimi i të gjitha hipotezave të mësipërme në seksionin e mëvonshëm.

4.1 Analiza

Siç u përmend më lart, ky seksion jep një përmbledhje të nivelit të kohezionit (vlerat Rice) në 21 vendet evropiane, të cilat janë paraqitur në Tabelën 4-1. Vlen të theksohet se duke përdorur indeksin Rice vlerat e kohezionit llogariten për secilën parti në një legjislaturë të caktuar (që është njësia jonë e analizës), dhe më pas mesatarizohen për të dhënë një vlerë të vetme për atë legjislaturë në vendet përkatëse, që është dhënë në kolonën e fundit të tabelës. Mesataret e vlerave të kohezionit të legjislatrave për secilin vend, që nuk janë paraqitur këtu, na japin vlerën e përgjithshme të kohezionit për atë vend. Por, kur të dhënat ishin të disponueshme vetëm për një vit, ajo vlerë e nxjerre nga votimet brenda një njëvjeçari përfaqëson vlerën e përgjithshme të kohezionit në atë vend. Ky është rasti specifik i Finlandës dhe Islandës mes vendeve të Evropës Perëndimore, dhe i Serbinë mes vendeve të Evropës Juglindore. Dikush mund të argumentojë se për shkak se shifra për disa vende bazohet në mesataren e vlerës së kohezionit për një numër vitesh, ndërsa për vende të tjera bazohet në vlerën për vetëm një ose dy vjet, shifrat për këto të fundit mund të jenë më pak të besueshme. Megjithatë, në shumicën e vendeve ka pak ndryshime në nivelet e kohezionit gjatë rrjedhës së një mandati parlamentar, duke sugjeruar se nuk është veçanërisht problematike që matja të bazohet në sjelljen gjatë një ose dy viteve. Për më tepër, fakti se kohezioni është më i ulët në Finlandë në krahasim me vendet e tjera të Evropës Perëndimore është dokumentuar mirë në literaturë (Sieberer 2006, Depauw dhe Martin 2009).

Siç mund të shihet nga tabela, uniteti mesatar i grupeve parlamentare është më i lartë për vendet e Evropës Perëndimore, ku, siç u përmend më herët, në prani të institucionalizimit të fortë të sistemit partiak ose ndonjë arsyeje tjetër, sistemi zgjedhor ka pak ose aspak rol në shpjegimin e sjelljes së deputetëve. Në përgjithësi, niveli mesatar i kohezionit për vendet e EJT është 95.91 që është më i ulët se 97.53; niveli mesatar i kohezionit për vendet e Evropës Perëndimore, por është pak më i lartë se mesatarja e EQL prej 94.68. Edhe pse shifrat nuk janë paraqitur këtu, niveli më i ulët i kohezionit vërehet në Partinë Demokratike të Serbisë (DSS) me një vlerë mesatare në Indeksin Rice

prej 80 për qind, dhe në Partinë Demokratike të Kosovës gjatë mandatit 2004-2007, me një mesatare prej 85. Shifër e ngjashme e ulët konstatohet edhe për socialdemokratët në Finlandë; ku niveli i ISP është më i ulëti në mesin e vendeve të Evropës Perëndimore, por përveç këtij shembulli dhe shifrave përgjithësisht të ulëta partiake në Finlandë, shifrat janë uniformisht të larta në këtë pjesë të botës.

Në Evropën Perëndimore, uniteti më i lartë i GP-së vërehet në Danimarkë, me sistemin proporcional me listë të hapur. Shifrat janë po aq të larta për Mbretërinë e Bashkuar me një sistem zgjedhor PM (i pastër mazhoritar) dhe Irlandën me sistemin VVT. Mes vendeve të EJT-së, vlerat më të larta të unitetit janë vërejtur për Serbinë dhe Bosnjën që përdorin sisteme proporcionale me listë të mbyllur, ndërsa niveli mesatar më i ulët i kohezionit, nga ana tjetër, vërehet në rastin e Maqedonisë së Veriut ku përdoret i njëjti sistem. Fakti që uniteti është i ulët në Maqedoni të Veriut është sigurisht befasues, pasi supozuam se niveli i kohezionit do të ishte i lartë në sisteme të tilla. Megjithatë, siç do të shpjegohet në Kapitullin 6, kjo mund të jetë pjesërisht rezultat i metodave të përzgjedhjes së kandidatëve atje, ku popullariteti i një kandidati në mesin e elektoratit konsiderohet se ndikon në vendimin e partisë se ku do ta vendosë kandidatin në listë. Përndryshe, një vlerë e ulët e unitetit të GP-së vërehet edhe në rastin e Malit të Zi që përdor një sistem proporcional me listë të mbyllur. Dy vendet e tjera të EJT-së, Kosova dhe Sllovenia, me sisteme proporcionale me lista të hapura, bien diku në mes.

Tabela 4-1: Uniteti mesatar i GP në 21 vende evropiane (shifra të papeshuara)

Vendi	Periudha e mbuluar	Partia	Kohezioni mesatar i GP për periudhën legislative
<i>Evropa Perëndimore</i>			97.53
Austri	1994-1997	SPO, OVP, FPO, Grunen, LiF	98.33
Belgjikë	1991-1995	AGALEV, VB, VLD, PRL, CVP, PSC, BSP, PSB, VU	99.06
Danimarkë	1990-1994	A, C, V, B, F, Z, K, CD	99.81
	1994-1996	A, C, V, B, F, Z, CD	99.89
Finlandë	1995-1996	V, SD, SFP, KoK, Kesk, Vihr, KD	88.63
Francë	1993-1997	PCF, PS, UDF, RPR	99.34
Gjermani	1980-1983	CDU, SPD, FDP	98.12
	1983-1987	CDU, SPD, FDP, GR	96.49
	1987-1990	CDU, SPD, FDP, GR	96.81

Vendi	Periudha e mbuluar	Partia	Kohezioni mesatar i GP për periudhën legjislative
Islandë	1995-1996	Aleanca e Grave, Aleanca Popullore, Lëvizja Popullore, Social Demokratët, Partia e Pavarësisë, Partia Progressive	96.93
Irlandë	1994-1996	FF, FG, Lab	100
Norvegji	1990-1994	SV, A/Ap, Sp, H, FrP, KrF	98.55
Suedi	1994-1995	V, SAP, FP, M, C, Miljoparteit, KD	96.57
Mbretëri e Bashkuar	1992-1997	L, Con	99.46
<i>Evropa Qendrore dhe Lindore</i>			94.68
Republika Çeke	1996-1998	CSSD, KDU, KSCM, ODA, ODS, SPR-RSC	93.66
	1998-2002	CSSD, KDU, KSCM, ODS, US, CSSD	90.53
	2002-2006	CSSD, KDU, KSCM, ODS, US	93.01
	2006-2009	CSSD, KDU, KSCM, ODS, SZ	93.66
Hungari	1994-1998	Fidesz, MDF, MSZP	92.39
	1998-2002	Fidesz, FKGP, KDNP, MDF, MSZP, SZDSZ	96.09
	2002-2006	Fidesz, MDF, MSZP, SZDSZ	97.21
Poloni	1997-2001	AWS, PSL, ROP, SLD, UW	93.14
	2001-2005	LPR, PiS, PO, PSL, SLD, SO	95.44
<i>Evropa Juglindore</i>			95.91
Bosnjë	2010	SDA, SBiH, SDP BiH, SNSD	97.48
	2011-2012	HDZ BiH, SBB BiH, SDA, SDP BiH, SDS, SNSD	98.79
Kosovë	2005-2007	AAK, LDK, PDK, ORA, KDTP, VAKAT	93.60
	2007-2010	AAK, AKR, KDTP, LDD-PSHDK, LDK, PDAK, PDK, SLS, VAKAT	96.00
Maqedoni e Veriut	2002-2006	Së bashku për Maqedoninë, VMRO-DPMNE, BDI, PDSH	93.52
Mal i Zi	2009-211	ECG, NOVA, PzP, SNP	94.53
Serbi	2011	G17 PLUS, PGM, PUPS, SPS-JS, ZES, DSS, SRS, SNS, LDP	97.67
Slloveni	2000-2004	DeSUS, LDS, NSi, SDS, SLS, SNS, ZLSD	94.91
	2004-2008	DeSUS, LDS, Lipa, NSi, SD, SDS, SLS, SNS, Zares	97.01
	2008-2011	DESUS, LDS, ZARES, SD, SDS, SLS, SNS	96.93
	2011-2012	DL, NSi, PS, SD, SDS, SLS	98.22

Dikush mund të argumentojë se niveli i përgjithshëm i kohezionit në mesin e vendeve të EJL-së ndikohet nga shifrat e partive të vogla që kanë për shembull 3 deri në 4 deputetë, si SLS në Kosovë ose PzP në Mal të Zi, duke marrë parasysh se ato me më pak se 3 deputetë janë përjashtuar nga analiza. Për të shmangur që partitë e vogla të kenë një ndikim joproporcional në vlerën e përgjithshme të kohezionit për vendin, janë llogaritur edhe mesataret e peshuara për të gjitha vendet e EJL-së, dhe rezultatet jepen në Tabelën 4-2. Mungesa e të dhënave të zberthyerë për vendet e tjera nuk na lejon të bëjmë të njëjtën gjë për të gjitha vendet. Mesatarja është peshuar me numrin e deputetëve të partisë që marrin pjesë në çdo votë. Kjo është një shifër më e saktë sesa peshimi i vlerave sipas madhësisë së GP, sepse shpesh ndodh që jo të gjithë deputetët e partisë marrin pjesë në një votim të caktuar, por, për shembull, 10 deputetë votojnë për një çështje dhe për një çështje tjetër 20 prej tyre. Kjo prek edhe partitë e mëdha ku numri i deputetëve që votojnë ndryshon shumë nga votimi në votim. Për shembull, në rastin e Serbisë, madhësia e grupit të partisë DSS në parlament gjatë vitit 2011 ishte 30, por numri më i madh i deputetëve që marrin pjesë në çdo votim të caktuar gjatë kësaj periudhe është 20. Për më tepër, siç shpjegohet më poshtë DSS merr pjesë vetëm në një numër të kufizuar votimesh.

Duhet theksuar se njësia e analizës këtu është uniteti mesatar i partisë për një çështje të caktuar dhe, siç u përmend më lart, mënyra e llogaritjes së tij ishte peshimi i mesatareve me numrin e deputetëve të partisë për votim. Kolona gjashtë e tabelës raporton numrin e votave për parti. Siç shihet, numri më i madh i vëzhgimeve (212530) tregohet për koalicionin 'Së bashku për Maqedoninë', i cili i votoi 4869 ligje, ndërsa numri më i vogël i vëzhgimeve është shënuar në rastin e PLD në Serbi (44), ku deputetë votuan vetëm 8 akte legjislacioni. Vlen të theksohet se dallimi i madh mes numrit të vëzhgimeve në Serbi është rezultat i mosvotimit të partive opozitare për një numër të madh të legjislacionit, që duket të jetë praktikë e zakonshme në politikën serbe, dhe nuk është e kufizuar vetëm në vitin 2011, periudha për të cilën kemi të dhëna. Në përgjithësi, ajo që tregon tabela është se vlerat e peshuara të kohezionit ndryshojnë vetëm pak. Megjithatë, edhe me mesataret e peshuara, shifrat e përgjithshme janë ende pak më të ulëta për vendet e EJL-së krahasuar me vendet e Evropës Perëndimore.


Tabela 4-2: Uniteti mesatar i GP në vendet e EJL (shifra të peshuara)

Vendi	Periudha e mbuluar	Partia	Madhësia e GP	Numri i vëzhgimeve	Numri i votimeve	Uniteti i GP	Uniteti gjatë periudhës legislative	
Bosnjë	2010-2011	SBiH	8	2565	384	96.73	97.63	
		SDA	9	2929	371	98.57		
		SDP BiH	5	968	251	98.35		
		SNSD	7	2169	355	97.14		
	2011-2012	SDA	7	4147	727	98.21	98.49	
		SDP BiH	8	4393	674	98.41		
		SNSD	8	4635	697	98.27		
		SDS	4	1946	539	98.87		
		SBB BiH	4	2002	550	99.10		
		HDZ BiH	3	414	138	99.03		
	Kosovë	2005-2007	PDK	30	23451	1705	94.13	92.82
			LDK	47	58885	1771	96.15	
AKK			9	8779	1726	90.93		
ORA			7	3645	940	97.37		
KDTP			3	1062	354	97.74		
VAKAT			3	1887	629	93.96		
2007-2010		PDK	37	77931	3863	96.91	95.68	
		LDK	25	59726	3858	97.11		
		AKK	10	16986	3218	89.77		
		AKR	13	23012	3712	91.10		
		LDD-PSHDK	11	18782	3242	95.15		
		KDTP	3	3102	1034	99.41		
		PDAK	3	1938	646	98.14		
		SLS	3	1941	580	99.59		
		VAKAT	3	3387	1129	98.64		
		Maqedoni e Veriut	2002-2006	Së bashku për Maqedoninë	60	212530		4869
VMRO	16			38828	4749	96.48		
BDI	7			847	218	93.86		
DPA								
Mal i Zi	2009-2011	ECG	49	26194	662	93.32	94.15	
		NOVA	8	2685	523	92.85		
		PZP	5	1340	344	96.27		
		SNP	16	6750	591	97.48		
Serbi	2011	SPS-JS	15	7266	555	99.86	99.71	
		DSS	30	83	3	96.63		
		G17 PLUS	24	12000	556	99.93		
		LDP	13	44	8	100		
		PGM	4	2697	516	99.56		
		PUPS	5	2420	529	100		
		SRS	58	209	6	100		
		ZES	78	40836	558	99.69		

Vendi	Periudha e mbuluar	Partia	Madhësia e GP	Numri i vëzhgimeve	Numri i votimeve	Uniteti i GP	Uniteti gjatë periudhës legislative
Slloveni	2000-2004	DeSUS	4	2415	805	97.85	94.51
		LDS	34	58692	2133	95.40	
		NSi	8	5994	1215	97.10	
		SDS	15	5439	1005	94.12	
		SLS	10	8538	1657	89.18	
		SNS	4	1359	409	100	
		ZLSD	11	20440	2126	92.76	
	2004-2008	DeSUS	4	6026	1769	92.89	97.84
		LDS	11	16118	2329	95.63	
		Lipa	3	588	196	100	
		NSi	8	20785	2927	98.60	
		SD	14	16309	2316	98.15	
		SDS	29	78778	2946	99.20	
		SLS	7	15186	2871	93.63	
		SNS	3	2868	812	99.09	
		Zares	7	2550	645	98.51	
	2008-2011	DeSUS	5	6757	1638	94.41	97.16
		LDS	5	7617	1796	98.45	
		SD	27	46303	1854	98.25	
		SDS	27	33342	1585	96.67	
		SLS	6	6654	1505	98.26	
		SNS	5	3516	928	98.23	
		Zares	7	12078	1829	95.63	
	2011-2012	DeSUS	6	1024	190	97.07	98.50
		DL	8	1330	190	98.50	
		NSi	4	686	186	99.42	
		PS	28	4287	182	98.04	
		SD	10	1580	189	96.20	
SDS		26	4426	185	99.77		
SLS		6	963	190	99.38		

Për të vizualizuar vlerat e kohezionit për të gjitha vendet, Figura 4-1 tregon një grafik të unitetit të GP-së në këto vende. Në përgjithësi, mediania është më e lartë për vendet e Evropës Perëndimore si Irlanda, Danimarka, Franca dhe Austria, dhe është më e ulët për vendet e EJT-së si Mali i Zi dhe Maqedonia e Veriut. Sigurisht, Finlanda përbën një përjashtim pasi është një nga sistemet partiake më të institucionalizuara, por me nivel të kohezionit që është shumë më i ulët se ai i vendeve të tjera të Evropës Perëndimore. Depauw dhe Martin (2009) argumentojnë se kjo mund të lidhet me metodat e decentralizuara të përzgjedhjes së kandidatëve, ku kandidatët përzgjedhen në nivel nën-kombëtar, së bashku me sistemin proporcional me listë të hapur që është në përdorim atje. Për më tepër, fakti që shpesh ministrat rekrutohen nga jashtë do të thotë se udhëheqja e GP-së nuk ka monopol mbi avancimin e deputetëve në poste ekzekutive dhe për rrjedhojë nuk mund ta kontrollojë sjelljen e tyre (Sieberer 2006, fq. 169-70).

Figura 4-1 Grafik që tregon nivelin e unitetit të GP në 21 vende evropiane



4.2.1 Uniteti i GP sipas çështjeve

Meqenëse analiza jonë e mëparshme nuk na tregon shumë për llojin e çështjeve për të cilat votojnë ligjvënësit, dhe duke pasur parasysh se dallimi mes çështjeve është i rëndësishëm sepse deputetët mund të kenë më shumë stimuj për të bashkëpunuar për një çështje dhe pak stimuj për të bashkëpunuar për një çështje tjetër (Hipoteza 2), tani i drejtohem llojit të çështjeve për të cilat votojnë deputetët si në Kosovë ashtu edhe në Mal të Zi. Arsyeja e kufizimit të analizës sonë në këto dy vende nuk është e veçantë, megjithëse qëllimi i përgjithshëm ishte testimi i këtij efekti brenda vendeve

të EJK-së, si dhe mundësisht si nën SP me lista të hapura ashtu edhe me lista të mbyllura. Për këtë qëllim, rezultatet e votimeve janë grupuar në çështje të ndryshme në varësi të rëndësisë së tyre për mbijetesën e qeverisë. Përndryshe, mund t'i kishim ndarë çështjet në ato që ne presim të dallojnë partitë njëra nga tjetrën dhe ato që priren t'i ndajnë partitë nga brenda. Duke marrë parasysh se votimi më i shpeshtë në parlamentet e Kosovës dhe Malit të Zi është përmes votimeve të regjistruara, atëherë do të kishim qenë mjaft të sigurt se të gjitha llojet e çështjeve janë hedhur në votim, pavarësisht se sa përçarëse mund të kenë qenë ato; një dallim i cili në raste të tjera mund të ketë qenë problematik. Megjithatë, është e vështirë të dihet se cilat çështje janë ideologjike në rastin e Kosovës dhe Malit të Zi, ku partitë nuk kanë baza të forta ideologjike. Për më tepër, në mungesë të një matjeje të pavarur, e vetmja mënyrë për të ditur nëse çështjet i ndajnë partitë brenda vendit është që fillimisht të llogariten vlerat e kohezionit.

Megjithatë, ndarja e çështjeve në bazë të faktit nëse ato janë të rëndësishme për mbijetesën e qeverisë apo jo, nuk është një detyrë e lehtë as mes vendeve të Evropës Juglindore, pasi, ndryshe nga Izraeli (Rahat 2007), nuk ka një dallim të thjeshtë mes çështjeve që janë thelbësore dhe çështjeve të cilat nuk janë. Në Izrael, për shembull, lloji i çështjeve që kategorizohen si të rëndësishme për mbijetesën e qeverisë janë votimet për krijim e qeverive, votimet e mosbesimit dhe projektligjet që propozojnë zgjedhje të parakohshme (po aty 2007), por nuk ka votime të tilla në grupin tonë të të dhënave as nga Kosova dhe as nga Maqedonia e Veriut. Për më tepër, bazuar në zhvillimet e mëparshme politike në të dy vendet, ka shumë pak gjasa që nëse qeveritë do të mposhten, ato do të japin dorëheqjen. Mundësia jonë më e mirë është të mbështetemi në gjykimin tonë për rëndësinë e çështjeve të ndryshme si në rastin e Kosovës ashtu edhe në atë të Malit të Zi. Nënseksionet e mëposhtme shpjegojnë madhësitë e mostrës dhe mënyrën si janë koduar çështjet në të dy vendet, ndërsa rezultatet e hipotezës 2, si dhe të gjitha të tjerat që lidhen me unitetin e GP, janë paraqitur në pjesën e gjetjeve të këtij kapitulli.

Kosovë

Në rastin e Kosovës, kohezioni ndërmjet çështjeve është llogaritur vetëm për mandatin e dytë (2007-2010), p.sh. në SP me lista të hapura, pasi të dhënat për sa i përket çështjeve që votoheshin mungonin për mandatin e parë. Është e rëndësishme të thellohem në mënyrat si i kategorizuar çështjet e ndryshme dhe si janë grumbulluar më pas votat për ato çështje. Së pari, në vend që të kodojmë çështjet për të gjitha 3863 votat që kemi marrë, gjë që do të na kishte marrë shumë kohë, me metodë rastësore janë përzgjedhur pesëqind

vota nga mandati i dytë. Këto vota janë përzgjedhur dhe grupuar sipas çështjeve të ndryshme përpara llogaritjes së vlerave të kohezionit për grupet parlamentare. Përndryshe, dikush mund të sugjerojë që ne kemi zgjedhur çështje më të rëndësishme për mbijetesën e qeverisë sipas vlerave më të larta të të kohezionit të GP-së dhe anasjelltas. Për rreth gjysmën e këtyre votave, mund të shihej qartë çështja për të cilën deputetët votuan brenda grupit të të dhënave origjinale, dhe për këtë arsye kodimi i këtyre çështjeve ishte i lehtë. Megjithatë, për pjesën tjetër, raporti i votimit ka deklaruar vetëm 'Mbledhja e Komisionit Funkcional' dhe ka specifikuar numrin e amendamenteve për të cilat kanë votuar deputetët, por nuk ka dhënë asnjë informacion për çështjen aktuale që kanë votuar deputetët. Sipas rregullores së punës, përveç komisioneve të përhershme, parlamenti mund të ngrejë komisione funksionale për fusha të ndryshme politikash, të cilat mund të përfshijnë tema të ndryshme si bujqësia, arsimi, kultura etj. Aty ku ishte kështu, unë shqyrtova procesverbalin e seancës nga faqja e parlamentit dhe votat i përputha me çështjet.

Herë pas here, çështja ndërlikohej më tej, pasi edhe duke parë procesverbalin nuk ishte e qartë në disa akte legjislacioni me të njëjtin numër ndryshimesh, se cili amendament i përkiste asaj çështjeje që votuan deputetët. Në ato raste, më duhej të krahasoja të dhënat e votimit nga grupi i të dhënave me përmbledhjen e rezultateve të votimit brenda procesverbalit dhe t'i përputhja me çështjen në fjalë. Gabimet u eliminuan nga fakti se nuk kishte asnjë rast votimi në të cilin rezultati ishte i njëjtë për disa amendamente; d.m.th. nuk ka pasur asnjë rast që i njëjti numër deputetësh kanë votuar pro, kundër dhe abstenim për më shumë se një akt legjislacioni. Dhjetë vota u hoqën nga mostra për shkak se nuk kishte procesverbal për to, dhe as seanca plenare e asaj dite nuk ishte përfshirë në rendin e ditës të parlamentit.

Përveç kësaj, pasi që në shkurt të vitit 2008 Kosova shpalli pavarësinë dhe duhej të miratonte disa ligje që dilnin nga pakoja e Ahtisaarit⁵ (për zgjidhjen e statusit përfundimtar), dhe meqenëse pjesa më e madhe e këtij legjislacioni fillimisht ishte lënë jashtë, unë i shtova të gjitha votat për ligjet e Ahtisaarit⁶ nga i gjithë grupi i të dhënave në mostër. Arsyeja për përfshirjen e tyre nën një kategorizim të veçantë është sepse ligjet trajtonin një sërë çështjesh të cilat konsideroheshin të ndjeshme, p.sh. të drejtat e pakicave, prania e bashkësisë

⁵ Emëruar sipas ish presidentit finlandez Maarti Ahtisaari i cili ndërmjetësoi në bisedimet ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

ndërkombëtare në Kosovë dhe decentralizimi i pushtetit, dhe për këtë arsye ishin shumë të rëndësishme jo vetëm për shpalljen e pavarësisë së vendit, por edhe për funksionimin e shtetit të ri. Për më tepër, mund të argumentohet se për shkak se kjo pako krijoi planin e një Kosove të pavarur, të cilën e synonin shumica e partive, atëherë partitë do të kishin stimul për të qenë kohezive për ta miratuar atë. Tabela 4-3 jep një pasqyrë të numrit të votave për çështje dhe përqindjet e tyre në raport me 590 votat e përdorura në këtë analizë.

Pesëmbëdhjetë rezultatet e votimeve të përfshira në 'Emërimet dhe shkarkimet' përfshijnë për shembull emërimin e gjyqtarëve në Gjykatën Kushtetuese, emërimin e Avokatit të Popullit, dhe atë të anëtarëve të bordeve të institucioneve të pavarura. Arsyeja e dallimit të këtyre votave nga votat e tjera është sepse emërimet, të cilat shpesh janë politike, janë të rëndësishme për partitë. Duke e ditur se emërimet në borde të ndryshme institucionale janë politike, partitë synojnë të emërojnë anëtarët e tyre përmes të cilëve mund të ushtrojnë më pas ndikim mbi institucionin. Për shembull, parlamentit iu deshën disa vite për të miratuar Avokatin e Popullit në vitin 2010 për shkak të politizimit të çështjes nga partitë. E njëjta çështje u rishfaq përsëri më vonë, në një debat parlamentar po aq të ndarë. Nëntëdhjetë votimet në kuadër të çështjeve 'kushtetuese' përfshijnë çështje që kanë të bëjnë me Kushtetutën, si të drejtat e pakicave, zgjedhjet, ligji për Presidentin, liria e asociimit, ligji për nëpunësit civilë etj. Duhet theksuar se numri i madh i votave, në raport me disa çështje të tjera, është kryesisht rezultat i miratimit të një kushtetute të re dhe rrjedhimisht krijimit të institucioneve të reja. Në anën tjetër, 162 votat në kuadër të 'Çështjeve ekonomike' kanë të bëjnë me të gjitha aspektet e ekonomisë, si tatimet, buxheti, të hyrat personale, punësimi, pensionet, sigurimet shoqërore, si dhe tregtia dhe energjia; çështje të rëndësishme për funksionimin e përditshëm të qeverisë.

Tabela 4-3: Votimet sipas çështjeve në Kosovë

Emërimet dhe shkarkimet	Çështjet kushtetuese	Çështjet ekonomike	Çështjet evropiane dhe ndërkombëtare	Drejtësia dhe siguria	Ligjet e Ahtisaarit	Tjetër	Gjithsej
15	96	162	17	63	112	125	590
2.5%	16.3%	27.5%	2.9%	10.7%	19.0%	21.1%	100.0%

Shtatëmbëdhjete votat në kuadër të 'Çështjeve Evropiane dhe Ndërkombëtare' kanë të bëjnë gjerësisht me çështjet që lidhen me politikën e jashtme, si anëtarësimi i Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar, Bankën Botërore, marrëveshjet dypalëshe ndërmjet Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut për demarkacionin e kufirit, si dhe një numër aktesh legjislativ të lidhura me BE-në, si ai i kthimit dhe ripranimit të migrantëve të parregullt. Gjashtëdhjetë e tre votimet në kuadër të 'Drejtësisë dhe Sigurisë' përfshijnë legjislativin që ka të bëjë me çështjet e sigurisë, si legjislativ për Forcën e Sigurisë së Kosovës, përdorimi i eksplozivëve, inteligjenca, korrupsioni, etj. Siç u shpjegua më herët, 112 votat për 'ligjet e Ahtisaarit' përfshijnë legjislativin që ka të bëjë me zgjidhjen e statusit përfundimtar por, duhet përmendur që ato janë të natyrave të ndryshme. Disa nga këto çështje përfshijnë misionet dhe personelin konsullor, shtetësinë, Inspektoratin Policor, kufijtë komunalë, aviacionin civil dhe fusha të tjera të ndryshme si këto. Së fundi, 125 votimet e hapura të mbetura përfshihen në 'Tjetër', sepse ato janë shumë të ndryshme dhe si të tilla nuk mund të grumbullohen në asnjë nga seksionet e tjera. Çështjet e përfshira këtu janë ligjet për mjedisin, bujqësinë, regjistrimin e popullatës si dhe legjislativin shëndetësor, të cilët ishin shumë të paktë në numër dhe për rrjedhojë nuk mund të përfshiheshin në një kategori të veçantë. Në përgjithësi, duhet të vëmë në pah nivelin më të lartë të kohezionit për ligjet kushtetuese dhe ligjet e Ahtisaarit, të cilat konsideroheshin si çështjet më të rëndësishme në atë kohë.

Mal i Zi

Për sa i përket Malit të Zi, uniteti i partisë në çështje është llogaritur për të gjithë grupin e të dhënave, thjesht sepse kishte vetëm 662 votime dhe ishte e lehtë të kodoheshin ato votime, krahasuar me 3863 në rastin e Kosovës. Njëlloj, këto vota janë ndarë në shtatë kategori sikurse në rastin e Kosovës: 'Emërimet dhe shkarkimet', 'Kushtetuese', 'Ekonomike', 'Çështjet evropiane dhe ndërkombëtare', 'Drejtësia dhe siguria', 'Shëndeti dhe siguria publike' dhe 'Tjetër'. Pra, dallimi i vetëm janë çështjet e 'Shëndetit dhe Sigurisë Publike' të cilat në rastin e Kosovës ishin shumë të pakta dhe prandaj i kemi përfshirë në kategorinë 'Tjetër'. Po ashtu, Maqedonia e Veriut nuk kishte çështje statusi të ngjashme me Kosovën, për të cilat kemi përfshirë ligjet e Ahtisaarit. Tabela 4-4 tregon numrin e votave për çështje, dhe përqindjen e tyre nga të gjitha rezultatet e votimeve.

Tabela 4-4: Rezultatet e votimeve sipas çështjeve në Maqedoni të Veriut

Emërimet dhe shkarkimet	Çështjet kushtetuese	Çështjet ekonomike	Çështjet evropiane dhe ndërkombëtare	Drejtësia dhe siguria	Shëndeti publik	Tjetër	Gjithsej
25	83	243	35	77	58	141	662
3.8%	12.5%	36.7%	5.3%	11.6%	8.8%	21.3%	100.0%

Njëzet e pesë votimet në kuadër të 'Emërimet dhe Shkarkimet' përfshijnë për shembull emërimet dhe shkarkimet e anëtarëve të institucioneve të pavarura, si p.sh. zgjedhja e një anëtar të Këshillit të Radio Televizionit të Malit të Zi. Për një numër të madh të votimeve nuk është specifikuar se për cilin institucion është bërë emërimi. Në këtë kategori përjashtohen emërimet e anëtarëve të komisioneve parlamentare. Tetëdhjetë e tre votimet e hapura në kuadër të çështjeve 'Kushtetuese' përfshijnë çështje që kanë të bëjnë me Kushtetutën, si projektligji në përgjigje të vendimit të Gjykatës Kushtetuese për kushtetutshmërinë e disa prej neneve të kushtetutës, si dhe çështje që kanë të bëjnë me vetëqeverisjen lokale, nëpunësit civilë, menaxhimi i kufirit, të drejtat e njeriut dhe minoritetet, dhe miratimi i qeverisë. Dyqind e katëdhjetë e tre votat në kuadër të çështjeve 'Ekonomike' kanë të bëjnë me të gjitha aspektet e ekonomisë, si tatimet, buxheti, të hyrat personale, punësimi, pensionet, sigurimet shoqërore si dhe legjislacioni për energjinë dhe zhvillimin rajonal.

Trigjjetë e pesë votat në kuadër të 'Çështjeve Evropiane dhe Ndërkombëtare' përfshijnë të gjithë legjislacionin në lidhje me Bashkimin Evropian dhe organizatat ndërkombëtare, si ratifikimi i konventave, krijimi i Zyrës Evropiane të Komunikimit etj. Shtatëdhjetë e shtatë votime në kuadër të 'Drejtësisë dhe Sigurisë' përfshijnë legjislacionin që ka të bëjë me çështjet e sigurisë, si legjislacioni për ushtrinë, gjykatat, prokurorinë, kodin penal dhe marrëveshjet e ekstradimit mes Malit të Zi dhe vendeve të tjera. Pesëdhjetë e tetë votimet e hapura në kuadër të çështjeve 'Publiku dhe Shëndeti' përfshijnë çështje të tilla si shitja e pijeve alkoolike, inspektimi sanitar, kontrolli i barnave si dhe rregulloret për përdorimin e automjeteve. Së fundi, 141 votimet e mbetura që përfshihen në 'Tjetër', përfshijnë ligjet për mostrat biologjike, komunikimet dhe shërbimet postare, regjistrimin e popullsisë, transportin, teatrin dhe arsimin. Megjithatë, ndryshe nga rasti i Kosovës presim që uniteti të jetë më i lartë në çështjet që kanë të bëjnë me ekonominë, p.sh. buxheti, emërimet, si dhe punët e jashtme, kryesisht për shkak të aspiratës së vendit për anëtarësim në BE, sesa për çështje të tjera.

4.3 Gjetjet

Pasi kemi dhënë një pasqyrë të nivelit të unitetit ndërmjet vendeve, ku kemi treguar se niveli i unitetit është më i lartë në mesin e vendeve të Evropës Perëndimore, dhe pasi kemi shpjeguar si janë grumbulluar votat sipas çështjeve në rastin e Kosovës dhe Malit të Zi, ky seksion paraqet gjetjet nga të dyja analizat. Qëllimi këtu ka qenë testimi i ndikimit të sistemeve zgjedhore në unitetin e GP-së duke përfshirë disa ndryshorë të pavarur të cilët janë përshkruar në Kapitullin 2 dhe janë shpjeguar më tej më poshtë. Po kështu, donim të testonim nëse kohezioni priret të jetë më i lartë në disa çështje dhe më i ulët për të tjera, siç u shpjegua edhe më sipër. Tabela 4-5 në vijim ofron statistika përshkruese për 21 vende evropiane dhe ndryshorët e përdorur në analizat tona.

Ndryshori ynë i parë i pavarur është madhësia mesatare e zonës zgjedhore (MZGJ). Ne vendosëm të përfshijmë vlerat e papërpunuara të madhësisë së zonës zgjedhore në analizën tonë, megjithëse një test për efektin e MZGJ duke përdorur log-vlerat nuk i ndryshon rezultatet. Mes sistemeve zgjedhore me të orientuara kah kandidati dhe ato të orientuara kah partia që kemi shqyrtuar, zonat ndryshojnë në madhësi duke filluar nga zonat me një anëtar/ulëse, siç është rasti me Francën, deri në 250 në rastin e Serbisë, ku i gjithë kombi është një zonë zgjedhore. Ndryshori ynë tjetër i pavarur është niveli i institucionalizimit të sistemit partiak që, siç u përmend më herët, raporton nivelin e institucionalizimit për secilin vend në mandatin më të fundit të qeverisë për të cilin të dhënat janë të disponueshme (shih në fund të Tabelës 1.3, fq. 17). Pastaj është madhësia e Grupit Parlamentar, e cila ne argumentuam se është e rëndësishme të merret parasysh pasi sugjerohet që grupet më të vogla do të japin unitet më të madh sepse janë më homogjenë. Shifrat e paraqitura në tabelë lidhen me numrin e deputetëve që ka çdo grup parlamentar. Edhe vjetërsia e partisë jepet në tabelë dhe thjesht raporton moshën e partive nga viti i themelimit deri në vitin 2014, ose deri në vitin e shpërbërjes së tyre në rastet kur ato u shpërbënë.

Efekti i numrit të ulëseve në parlament në unitetin e GP-së, që gjithashtu raportohet, nuk përdoret për të testuar unitetin e GP-së, por të dhënat jepen sepse ato përdoren për të matur marzhin e qeverisë ndaj opozitës. Marzhi i qeverisë ndaj opozitës llogaritet duke përdorur formulën e mëposhtme: $\text{Marzhi} = (\text{Shuma e partive qeveritare}) / \text{Totali i ulëseve parlamentare} * 2 * 100 - 100$. Së fundi, përqindja e ulëseve llogaritet si raport i madhësisë së GP-së dhe numrit

të përgjithshëm të ulëseve parlamentare. Të dhënat për këta ndryshore janë mbledhur nga burime të ndryshme: të dhënat e Matt Golder 'Democratic Electoral Systems around the World', për sistemet zgjedhore dhe madhësitë mesatare të zonave zgjedhore janë përdorur web faqet parlamentare, për madhësinë e GP-ve dhe atë të parlamenteve, Vjetari Politik i Studimeve Zgjedhore (Electoral Studies Political Yearbook) për të dhënat e statusit/ përbërjes së qeverisë, si dhe 'Political Parties of the World' (2005) për vjetërsinë e partive.

Tabela 4-5: Statistikat përshkruese për 21 vende evropiane

	Min	Mediane	Mesore	Max	Devijimi standard
Vlera Rice	80.00	96.95	96.26	100.00	3.57
Madhësia mesatare e zonës zgjedhore	1.00	11.20	31.65	250	54.67
Institucionalizimi i Sistemit Partiak	0.20	0.30	0.48	1.00	0.26
Madhësia e GP	3.00	22.00	41.61	419.00	60.56
Vjetërsia e partisë	3.00	25.00	45.63	184.00	39.19
Përmasa e parlamentit	42.00	181.00	231.70	650.00	153.21
Marzhi i qeverisë ndaj opozitës (%)	-34.08	8.30	7.46	63.60	19.67
Raporti i ulëseve	0.01	0.11	0.17	0.64	0.14

Duke qenë se vendet ndryshojnë sipas dimensioneve të ndryshme, p.sh. kanë sisteme të ndryshme zgjedhore dhe nivele të ndryshme të ISP, unë përdor analizat e regresionit me shumë nivele, rezultatet e të cilave janë raportuar në Tabelën 4-6. Siç argumentojnë Brambor et al, analizat e regresionit me shumë nivele përdoren shpesh kur marrëdhënia mes dy ndryshoreve varet nga konteksti institucional (2006, fq. 63). Në mjedisin tonë, ndikimi i sistemeve zgjedhore në sjelljen e deputetëve supozohet të jetë i kushtëzuar nga niveli i ISP. Më konkretisht, ne argumentojmë se vetëm në nivele të ulëta të ISP efekti i sistemeve zgjedhore mbi sjelljen e deputetëve do të jetë më i fortë. Për më tepër, analizat e regresionit me shumë nivele përdoren shpesh kur të dhënat janë të ndërlishura me më shumë se një kategori. Në rastin tonë njësia e analizës është partia në një mandat legjislativ (në total janë 215 vëzhgime), të ngulitura brenda sistemeve zgjedhore, brenda vendeve.

Regresioni i parë, i raportuar në kolonën I të Tabelës 4-6, shprehet nga:

$$Uniteti = \beta_0 + \beta_1 \text{ sistemi zgjedhor} + \beta_2 \text{ ISP} + \beta_3 \text{ MZGJ} + \beta_4 \text{ statusi qeveritar} \\ + \beta_5 \text{ moshë e partisë} + \beta_6 \text{ marzhi} + \beta_7 \text{ madhësia e GP} + \epsilon$$

Formula për regresionin e dytë të raportuar në kolonën II është e njëjtë, përveç faktit që shtohet një ndryshor shtesë, 1 për vendet që i përkasin rajonit të EJL-së, dhe 0 për ato që nuk i përkasin rajonit për të kontrolluar efektin rajonal:

$$Uniteti = \beta_0 + \beta_1 \text{ sistemi zgjedhor} + \beta_2 \text{ ISP} + \beta_3 \text{ MZGJ} + \beta_4 \text{ statusi qeveritar} \\ + \beta_5 \text{ moshë e partisë} + \beta_6 \text{ marzhi} + \beta_7 \text{ madhësia e GP} + \beta_8 \text{ EJL} + \epsilon$$

Së fundi, për shkak se ne argumentojmë se efekti i sistemeve zgjedhore në kohezion është i kushtëzuar nga niveli i ISP, efektet e ndërveprimit ndërmjet sistemeve zgjedhore dhe nivelit të ISP, shtohen në kolonën III duke përdorur formulën e mëposhtme:

$$Uniteti = \beta_0 + \beta_1 \text{ sistemi zgjedhor} * \text{ISP} + \beta_2 \text{ MZGJ} + \beta_3 \text{ statusi qeveritar} + \beta_4 \text{ moshë e partisë} \\ + \beta_5 \text{ marzhi} + \beta_6 \text{ madhësia e GP} + \beta_7 \text{ EJL} + \epsilon$$

Në pamje të parë, duke parë analizën e parë të regresionit, mund të shohim se disa ndryshorë janë domethënës. Mesatarisht, uniteti i GP-së (bazuar në vlerat Rice) është rreth 6 pikë më i lartë mes sistemeve mazhoritare krahasuar me sistemet e proporcionale me lista të mbyllura. Kohezioni ka drejtimin e parashikuar nën SP fleksibël dhe me lista të hapura, por ndryshorët nuk janë domethënës statistikiisht. Megjithatë, ndryshori i ISP është paksa domethënës. Kur të gjitha janë të barabarta, për një ndryshim në nivelin e ISP nga 1 devijim standard nën mesoren në një devijim standard mbi mesoren, niveli i unitetit rritet për 1.43 pikë. Po kështu, mesatarisht, uniteti i GP-së është më i lartë për 1.19 pikë mes partive qeveritare krahasuar me partitë opozitare. Së fundi, ndryshori tjetër që ka një efekt të rëndësishëm në kohezion, është marzhi i qeverisë ndaj opozitës. Teksa marzhi ndryshon nga 1 devijim standard nën mesoren në një devijim standard mbi mesoren, uniteti i GP zbritet për 2.26 pikë.

Duke parë rezultatin e dytë të regresionit, ku ndryshimi i vetëm është shtimi i një modeli rajonal, i cili gjithsesi nuk është domethënës, ashtu si më parë uniteti i GP tenton të jetë më i lartë me rreth 6 pikë në sistemet mazhoritare krahasuar me sistemet proporcionale me lista të mbyllura. Gjithashtu, për një ndryshim në nivelin e ISP nga 1 devijim standard nën mesoren në një devijim standard mbi mesoren, niveli i unitetit rritet për 1.91 pikë. Së fundi, ndryshori

i marzhit të qeverisë ndaj opozitës ruan efektin domethënës nga regresioni i mëparshëm. Kur të gjitha të tjerat janë të barabarta, teksta diferenca ndryshon nga 1 devijim standard nën mesoren në një devijim standard mbi mesoren, uniteti i GP zbritet për 1.97 pikë.

Tabela 4-6: Analizat e regresionit me shumë nivele në nivel partie

	Modeli I	Modeli II	Modeli III
(konstantja)	96.00*** (1.17)	94.96*** (1.44)	87.41*** (2.82)
SP me listë fleksibël	-0.70 (0.98)	-0.17 (1.07)	8.14** (2.93)
SP me lista të hapura	-0.57 (0.84)	-0.57 (0.84)	16.73*** (4.23)
Mazhoritar	5.95** (2.06)	6.01** (2.01)	1.42 4.74
I përzier	-0.72 (1.21)	-0.50 (1.22)	-2.68 (13.83)
VVT	2.27 (2.16)	2.55 (2.16)	2.49 (2.15)
Madhësia mesatare e zonës zgjedhore (MZGJ)	-0.00 (0.01)	-0.00 (0.01)	14.50*** (3.87)
Institucionalizimi i Sistemit Partiak (ISP)	2.71 (1.48)	3.63* (1.65)	0.63 0.47
Statusi Qeveritar (Po)	1.19** (0.45)	1.17** (0.44)	1.03* (0.44)
Mosha e partisë	-0.01 (0.01)	-0.01 (0.01)	-0.01 (0.01)
Marzhi i qeverisë ndaj opozitës	-0.06*** (0.01)	-0.05*** (0.01)	-0.05*** (0.01)
Madhësia e GP	-0.01 (0.01)	-0.01 (0.01)	-0.00 (0.01)
EJL (Po/Jo)		1.21 (0.96)	3.19* (1.25)
ISP*SP me listë fleksibël			-12.66** (4.20)
ISP*SP me lista të hapura			-7.66* (3.29)
ISP*sistem mazhoritar			-17.95** (6.65)
ISP*sistem i përzier			1.56 (18.75)
R-në katror	0.50	0.50	0.55
Total	215	215	215

I pa variablen dikotome EJL, II me variablën dikotome EJL, III me efekte ndërveprimi. Gabimet standarde në kllapa: *p-vlera 0.1, **p-vlera 0.05, ***p-vlera 0.01, ****p-vlera 0.001.


Megjithatë, dy regresionet nuk na tregojnë shumë për efektin që sistemi zgjedhor ka në unitetin e GP-së, i kushtëzuar nga niveli i ISP-së, prandaj kemi shtuar efektet e ndërveprimit mes të dyjave në regresionin e tretë. Ajo që tregon rezultati është se tani është i rëndësishëm efekti i disa ndryshorëve të tjerë. Sidoqoftë, jemi më së shumti të interesuar të interpretojmë efektet e ndërveprimit. Megjithatë, në mënyrë që ne të kemi një ide më të mirë si ndikojnë këto ndërveprime në kohezionin, fillimisht paraqesim efektin marginal të ISP në unitetin e GP, të kushtëzuar nga lloji i sistemit zgjedhor (Figura 2), dhe më pas paraqesim efektin e ndryshimit të sistemit zgjedhor mbi kohezionin në varësi të nivelit të ISP (Figurat 3 dhe 4), si dhe shpjegojmë madhësinë e efekteve. Ne llogarisim efektin marginal të ISP në nivelin e kohezionit dhe gabimet standarde, duke përdorur formulat e mëposhtme (shih Brambor et al 2006):

$$\frac{\partial PPG \text{ uniteti}}{\partial ISP} = \beta_1 + \beta_3 Z$$

$$\hat{\sigma} \frac{\partial PPG \text{ uniteti}}{\partial ISP} = \sqrt{\text{var}(\beta_1) + Z^2 \text{var}(\beta_3) + 2Z \text{cov}(\beta_1 \beta_3)}$$

Ajo që shohim në Figurën 4-2 është se vetëm sistemet proporcionale me lista të mbyllura dhe SP me lista të hapura janë të rëndësishme mes llojeve të sistemeve zgjedhore. Për shembull, nëse në sistemet proporcionale me lista të mbyllura niveli i ISP rritet për 0.5 pikë, kohezioni gjithashtu rritet për 7.3 pikë (0.5 x efekti marginal). E njëjta gjë është e vërtetë për sistemet e proporcionale me lista të hapura, megjithëse efekti është më i vogël pasi kohezioni rritet vetëm për 3.4 pikë. Për llojet e tjera të sistemeve zgjedhore, me rritjen e nivelit të ISP-së për 0.5 pikë, kohezioni rritet për 0.9 pikë në SP me listë fleksibël, rritet për 8 pikë në sistemet e përziera dhe zbret për 1.7 pikë në sistemet mazhoritare. Pra, ajo që tregon analiza është se siç parashikohet, kur rritet niveli i ISP, rritet edhe niveli i unitetit pavarësisht sistemit zgjedhor.


Figura 4-2 Efekti marginal i ISP në unitetin e GP në varësi të sistemit zgjedhor



Megjithatë, efekti mund të funksionojë edhe në drejtimin tjetër; domethënë, ndikimi i sistemit zgjedhor në kohezion mund të varet nga niveli i ISP. Andaj, në Figurën 4-3 ne tregojmë efektin e ndryshimit të sistemit zgjedhor nga SP me lista të mbyllura në SP me lista të hapura dhe nga SP me lista të mbyllura në SP listë fleksibël, kushtëzuar nga niveli i ISP. Boshti x tregon nivelin e ISP, ndërsa boshti y raporton efektin e ndryshimit të sistemit zgjedhor në unitetin e GP. Megjithatë, ne i lamë jashtë llojet e tjera të sistemeve zgjedhore, sepse efekti i tyre nuk ishte i rëndësishëm. Të dy grafikët në figurë tregojnë vetëm efektin domethënës të ndryshimit nga lista e mbyllur në të hapur dhe nga e mbyllur në SP me listë fleksibël kur niveli i ISP është në maksimum; pra është i barabartë me 1. Në mënyrë të veçantë, në nivelin 5 për qind të rëndësisë, 20 për qind e vendeve tona (SP me listë fleksibël) dhe përkatësisht 10 për qind (SP me lista të hapura) shtrihen brenda intervalit të domethënës të ISP. Megjithatë, asnjë efekt tjetër domethënës nuk vërehet pasi intervalet e besimit prej 95 për qind shënojnë 0 për pjesën më të madhe të gamës së ISP.⁷

⁷ Fakti që për disa vende, veçanërisht Gjermaninë dhe Finlandën, uniteti i partisë (shih Tabelën 3-1) matet për një fazë më të hershme, ndërsa Institucionalizimi i Sistemit Partiak matet për një fazë të mëvonshme (shih Tabelën 1-3, fq. 18) mund të duket problematik për sa i përket efektit të kësaj të fundit në të parën në analizën tonë të regresionit, andaj kërkon një test të qëndrueshmërisë. Prandaj, ne e ribëmë analizën duke hequr Gjermaninë

Figura 4-3 Efekti i ndryshimit të sistemit zgjedhor në unitetin e GP i kushtëzuar nga ISP



Në përgjithësi, dhe duke iu referuar pritshmërive tona teorike në Tabelën 1-1, ne nuk gjejmë se niveli i kohezionit bie kur ISP është i ulët pasi sistemi ndryshon nga ai i orientuar kah partia, p.sh. SP me lista të mbyllura, në sistem të orientuar kah kandidati, p.sh. SP me lista të hapura. Në fakt, pretendimi ynë kryesor ishin se efektet e sistemit zgjedhor në sjelljen e deputetëve do të qëndronin vetëm në nivele të ulëta të ISP. Përkundrazi, gjetja jonë këtu tregon se ndikimi i sistemeve zgjedhore është i rëndësishëm në nivele shumë të larta të ISP dhe se ai zvogëlohet në vend që të rritet, gjë që do të kishte më shumë kuptim duke marrë parasysh nivelet përgjithësisht të larta të kohezionit mes vendeve që kanë nivele të larta të ISP. Prandaj, pritjet tona nuk janë përmbushur plotësisht. Megjithatë, analiza tregon se niveli i institucionalizimit të sistemit partiak është më i rëndësishëm se lloji i sistemit zgjedhor në shpjegimin e sjelljes së deputetëve. Kur niveli i ISP është i ulët, uniteti i GP priret të jetë përgjithësisht më i lartë në SP me lista të mbyllura,

dhe Finlandën. Rezultatet tregojnë efektin e ndryshimit të sistemit zgjedhor, si nga lista e mbyllur në SP me listë të hapur, ashtu edhe nga lista e mbyllur në SP me listë fleksibël, në unitetin e GP, i kushtëzuar që niveli i ISP të jetë i parëndësishëm këtë herë. Efekti marginal i ISP në unitetin e GP mbetet pak a shumë i njëjtë, vetëm SP me lista të mbyllura dhe SP me lista të hapura janë domethënëse, megjithëse sistemet e përziera këtë herë dalin nga analiza. Më konkretisht, nëse në SP me listë të mbyllur niveli ISP rritet për 0.5 pikë, kohezioni rritet për 4.8 pikë. Nëse në sistemin me listë të hapur niveli i ISP rritet me të njëjtën sasi, uniteti i GP rritet për 3.3 pikë. Në përgjithësi, megjithëse efekti i ndryshimit të sistemit zgjedhor në unitetin e GP e humbet rëndësinë, rezultatet ishin mjaft të dobëta edhe para se t'i hiqim të dy vendet. Në thelb, efektet janë në kundërshtim me pritjet tona dhe janë pak domethënëse. Prandaj, testi i qëndrueshmërisë nuk na tregon asgjë përtej.

mes sistemeve të tjera të orientuara kah partia, dhe më i ulët në SP me lista të hapura, mes sistemeve të tjera të orientuara kah kandidati.

4.3.1 Uniteti i GP sipas çështjeve

Siç u përmend më herët, në rastin e Kosovës, ne presim që kohezioni të jetë më i lartë në çështjet që janë të rëndësishme për mbijetesën e qeverisë, p.sh. 'Çështjet kushtetuese' dhe 'Ligjet e Ahtisaarit', dhe do të jetë më i ulët për çështjet që nuk janë të rëndësishme për mbijetesën e qeverisë, p.sh. 'Drejtësia dhe Siguria' ose 'Çështje të tjera', të cilat përfshijnë çështje që kanë të bëjnë me arsimin dhe mjedisin ndër të tjera. Megjithatë, në rastin e Malit të Zi, presim që uniteti i GP të jetë më i lartë për 'Çështjet ekonomike', 'Emërimet dhe shkarkimet' si dhe 'Çështjet evropiane dhe ndërkombëtare', dhe më i ulët për çështje të tilla si 'Shëndeti dhe Siguria Publike'. Pas shpjegimit në seksionin e analizës se si janë koduar çështjet, Tabela 4-7 tregon nivelin e unitetit të GP-së në Kosovë në shtatë çështjet e ndryshme. Siç u shpjegua edhe më herët, jo të gjithë deputetët e grupeve parlamentare marrin pjesë gjatë gjithë kohës në të gjitha votimet. Andaj, kolona e parë për secilën parti përfaqëson numrin e votimeve në të cilat kanë marrë pjesë deputetët e një partie. Për shembull, partia KDTP merr pjesë vetëm në 4 nga 17 votimet për 'Çështje Evropiane dhe Ndërkombëtare'. Po kështu, SLS merr pjesë vetëm një herë në 'Çështjet e Emërimeve dhe Shkarkimeve'. Për të llogaritur këtë, ne i peshojmë vlerat mesatare të kohezionit me numrin e deputetëve të partisë në çdo votim, ngjashëm me atë që bëjmë për të gjitha vendet e EJK-së më parë. Në përgjithësi, partitë qeverisëse priren të marrin pjesë në numrin më të madh të votimeve, por ato të opozitës votojnë vetëm për një numër të kufizuar ligjesh. Sigurisht, një shpjegim mund të jetë se partitë opozitare nuk marrin pjesë në votim nëse e dinë se refuzimi i tyre nuk do t'i pengojë partnerët e koalicionit ta miratojnë ligjin.

Duke parë tabelën, mund të shohim se niveli i kohezionit është mjaft i lartë në të gjitha çështjet. Vlera më e ulët e kohezionit, 94 për qind, vërehet te 'Çështjet Ekonomike' dhe vlera më e lartë e kohezionit, 97, vërehet tek 'Çështjet Evropiane dhe Ndërkombëtare'. Ajo që tregon analiza është se, në kundërshtim me pritjet tona, edhe në çështjet kyçe për mbijetesën e qeverisë, si 'Ligjet e Ahtisaarit' dhe 'Çështjet kushtetuese', niveli i kohezionit nuk është dukshëm më i lartë në krahasim me nivelin e kohezionit në fusha të tjera. Për më tepër, nuk duket se ka ndonjë model uniform kohezioni ndërmjet partive; p.sh., niveli më i lartë i kohezionit për PDK-në dhe LDK-në është në çështjet

'evropiane dhe ndërkombëtare', por për AAK-në është për 'ligjet e Ahtsaarit', kurse për AKR-në është për çështjet e 'Tjera'. Megjithatë, ne gjejmë dy modele të qëndrueshme. Së pari, partitë më të vogla, si KDTP, PDAK, SLS dhe VAKAT janë përgjithësisht më kohezive se partitë më të mëdha, gjë që ne supozuam se do të ishte rasti në të 21 vendet, megjithëse dëshmitë e përgjithshme i mohuan pritshmëritë tona. Dhe, së dyti, niveli i kohezionit është më i lartë për partitë qeveritare, përkatësisht PDK, LDK, KDTP dhe SLS, sesa për partitë opozitare.

E njëjta analizë është bërë edhe për votimet malazeze, me përjashtim të faktit se i gjithë grupi i të dhënave prej 662 votash është përdorur këtu pasi që numri i votimeve ishte relativisht i vogël në krahasim me votimet në Kosovë. Tabela 4-8 tregon rezultatet e kësaj analize. Siç mund të shihet këtu, shumica e çështjeve janë të njëjta me ato të Kosovës, përveç se ligjet e Ahtsaarit nuk figurojnë këtu, por janë përfshirë çështjet e 'Shëndetit Publik dhe Sigurisë' sepse ato ishin të shumta. Ngjashëm me Kosovën, ka shumë pak dallim nga çështje në çështje. Megjithatë, krahasuar me Kosovën, këtu, niveli më i ulët i kohezionit, 92, vërehet te 'Çështjet Kushtetuese', që sugjeron se ndoshta në rastin e Malit të Zi ato nuk janë aq të rëndësishme për mbijetesën e qeverisë sa në Kosovë. Nga ana tjetër, niveli më i lartë i kohezionit, 99, vihet re në 'çështjet evropiane dhe ndërkombëtare'. Megjithatë, ndryshimi mes të dyve dhe të gjithë niveleve të tjera mesatare të kohezionit nuk është statistikisht domethënës (p -vlera=0.07).

	PDK*		LDK*		AAK		AKR		LDD- PSHDK		KDTP*		PDAK		SLS*		VAKAT		Mesatarja	Gjithësej vota
	Vota	Uniteti	Vota	Uniteti	Vota	Uniteti	Vota	Uniteti	Vota	Uniteti	Vota	Uniteti	Vota	Uniteti	Vota	Uniteti	Vota	Uniteti		
Emërimet dhe shkarkimet	15	97.12	15	97.60	14	87.80	14	86.36	14	95.17	4	100	5	100	1	100	4	100	94.89	15
Çështjet kushtetuese	96	96.27	96	96.69	89	85.75	93	93.70	85	94.94	34	100	16	100	14	100	39	98.29	95.31	96
Çështjet ekonomike	162	97.13	162	96.67	128	84.98	149	81.72	120	91.78	41	100	25	100	29	100	34	96.08	94.02	162
Çështjet evropiane dhe ndërkombëtare	17	98.21	17	98.48	11	96.92	17	95.12	14	91.30	4	100	5	100	3	100	10	93.33	97.18	17
Drejtesia dhe siguria	63	95.86	63	96.88	49	91.94	63	88.97	52	97.82	20	100	8	100	12	94.59	16	91.67	95.20	63
Ligjet e Ahtisaarit	112	96.16	112	96.31	112	97.97	112	91.72	110	95.17	52	98.72	32	100	4	100	49	100	95.93	112
Tjetër	125	95.95	125	96.49	103	91.61	119	96.06	121	98.64	32	100	18	100	16	100	43	100	96.25	125
Gjithësej	590	96.43	590	96.65	506	90.99	567	90.05	516	95.29	187	99.64	109	100	79	99.24	195	97.95	95.35	590

* Partitë qeveritare

Tabela 4 -7: Uniteti i GP sipas partisë dhe çështjeve në Kosovë (mandati 2)

Tabela 4-8: Uniteti i GP sipas partisë dhe çështjeve në Mal të Zi (mandati 2)

	ECG*		SNP		NOVA		PzP		Mesatarja	Gjithësej vota
	Vota	Uniteti	Vota	Uniteti	Vota	Uniteti	Vota	Uniteti		
Emërimet dhe shkarkimet	25	98.98	19	93.33	23	89.66	13	87.76	96.98	25
Çështjet kushtetuese	83	90.41	66	99.47	61	84.89	47	86.83	91.77	83
Çështjet ekonomike	243	92.86	208	95.93	181	95.91	120	98.29	93.83	243
Çështjet evropiane dhe ndërkombëtare	35	99.86	35	98.92	20	92.11	6	100	99.35	35
Drejtësia dhe siguria	77	95.54	70	98.80	72	95.63	66	95.20	96.12	77
Shëndeti dhe siguria publike	58	94.18	57	96.15	52	89.11	26	95.96	94.31	58
Tjetër	141	91.65	126	98.96	114	92.10	66	94.72	93.20	141
Gjithsej	662	93.32	581	97.48	523	92.85	344	96.29	94.15	662

* koalicioni qeverisës

Duke parë këto shifra, mund të shihet gjithashtu se niveli i kohezionit për ECG si koalicion qeverisës nuk është shumë më i lartë në krahasim me partitë opozitare; konstatim që ishte konsistent në rastin e Kosovës. Për më tepër, ngjashëm me rastin e Kosovës, shifrat nuk janë konsistente ndërmjet partive. Për shembull, niveli më i lartë i kohezionit për ECG vërehet në çështjet ‘Evropiane dhe Ndërkombëtare’, për SNP në çështjet ‘Kushtetuese’ dhe si për NOVA ashtu edhe për PzP nivelet më të larta vërehen në ‘Çështjet ekonomike’. Për ta përmbledhur, gjetjet nga analizat tona mbi nivelin e kohezionit ndërmjet çështjeve në Kosovë dhe Mal të Zi tregojnë se niveli i kohezionit është përgjithësisht i lartë ndërmjet çështjeve dhe nuk ka dallim të rëndësishëm ndërmjet kohezionit për çështjet që janë të rëndësishme për mbijetesën e qeverisë dhe ato që nuk janë të rëndësishme.

4.4 Diskutim

Qëllimi i këtij kapitulli ka qenë të testojë nëse sistemet zgjedhore ndikojnë në mënyrën se si sillen deputetët në demokracitë e reja të Evropës Juglindore në krahasim me demokracitë e konsoliduara parlamentare, duke përdorur votimet e regjistruara. Arsyeja kryesore për kryerjen e këtij studimi ishte se në vendet demokratike ku niveli i institucionalizimit të sistemit partiak është i lartë, pak lidhje janë gjetur mes sistemit zgjedhor dhe sjelljes së ligjvënësve. Megjithatë, në rastet kur ISP është i ulët, ku politika partiake është e paqëndrueshme dhe në përgjithësi nuk ka marrëdhënie të forta mes partive dhe votuesve, pritja ishte që sistemet zgjedhore do të luanin një rol më të madh në përcaktimin e sjelljes së deputetëve. Në vendet me ISP të dobët, me sisteme zgjedhore që nuk kanë konkurrencë brenda partisë, supozimi ishte se kohezioni do të ishte i lartë, ndërsa në të njëjtin grup vendesh me sisteme zgjedhore që lejojnë konkurrencën brenda partisë, kohezioni pritej të ishte i ulët.

Një analizë e disa mijëra rezultateve të votimeve në 21 vende evropiane që përdorin sisteme të ndryshme zgjedhore dhe me nivele të ndryshme të institucionalizimit të sistemit partiak, tregoi se niveli i kohezionit është përgjithësisht më i ulët, por vetëm pak, mes vendeve të EJL-së në krahasim me vendet e Evropës Perëndimore, dhe se është pak më i lartë se niveli mesatar i kohezionit që gjendet në vendet e Evropës Qendrore. Sidoqoftë, nuk u mbështet Hipoteza jonë e parë, e cila supozonte se niveli i unitetit të GP do të ishte më i lartë në sistemet zgjedhore të orientuara kah partia krahasuar me sistemet zgjedhore të orientuara kah kandidati. Për shembull, niveli më i lartë i unitetit mes vendeve të EJL u gjet në Serbi që përdor një sistem proporcional me lista të mbyllura, por vlerat më të ulëta mes këtyre vendeve u gjetën në dy sisteme të tjera proporcionale me lista të mbyllura, konkretisht Mali i Zi dhe Maqedonia e Veriut. Megjithatë, Hipoteza jonë 1.a, e cila sugjeronte se efekti i sistemit zgjedhor do të kushtëzohej nga niveli i ISP, u konfirmua pjesërisht. Kjo do të thotë se kur niveli i ISP ishte i ulët, kohezioni ishte përgjithësisht më i ulët në SP me listë të hapur, krahasuar me SP me listë të mbyllur. Me rritjen e nivelit të ISP, u rrit edhe niveli i kohezionit në të dy sistemet. Megjithatë, kjo nuk u pa për të gjitha llojet e sistemeve zgjedhore dhe për rrjedhojë, ne nuk mund të përgjithësojmë ndikimin e unitetit të GP-së në të gjitha sistemet zgjedhore të orientuara kah kandidati dhe sistemet zgjedhore të orientuara kah partia.

Ndër hipotezat e tjera që ngritëm, vetëm disa prej tyre shfaqën efekte domethënëse. Për shembull, ne zbuluam se kohezioni ishte përgjithësisht më i lartë në partitë qeveritare në krahasim me partitë opozitare (H.4). Për më tepër,

sa më i gjerë ishte marzhi i qeverisë ndaj opozitës, aq më i lartë ishte uniteti i GP-së (H.5). Nga ana tjetër, ne nuk gjetëm se kohezioni ishte më i ulët me rritjen e madhësisë së zonës zgjedhore. Prandaj, nuk u vërtetua Hipoteza 3, e cila sugjeronte se sa më i madh të jetë numri i bashkëpartiakëve me të cilët kandidatët duhet të konkurrojnë, aq më i ulët do të ishte uniteti i GP-së. Nuk gjetëm as ndonjë dëshmi se kohezioni ishte më i lartë për partitë më të vogla sesa për partitë më të mëdha (H.6), ose se kohezioni ishte më i lartë për partitë më të vjetra në krahasim me partitë më të reja (H.7). Ne prezantuam gjithashtu analiza të votimeve sipas çështjeve për Kosovën (një mostër) dhe Malin e Zi (të gjithë grupin e të dhënave). Analizat treguan modele të ngjashme në të dy vendet; domethënë, uniteti i GP-së ishte përgjithësisht i lartë në të gjitha çështjet, pavarësisht se sa të rëndësishme ishin ato për mbijetesën e qeverisë. Ky konstatim është në kundërshtim me atë që Rahat (2007) gjen në rastin e Izraelit, ku kohezioni ishte më i ulët për çështjet kushtetuese, të cilat ishin më pak të rëndësishme për mbijetesën e qeverisë, dhe ishte më i lartë për çështjet që kishin të bënin me mbijetesën e qeverisë, siç është buxheti. Për më tepër, modeli i kohezionit nuk ishte i qëndrueshëm ndërmjet partive. Disa parti treguan nivele më të larta të kohezionit për disa çështje, ndërsa të tjerat ishin më kohezive për çështje të tjera.

Teksa ndikimi i sistemeve zgjedhore i kushtëzuar nga niveli i institucionalizimit të sistemit partiak u konfirmua vetëm në disa lloje sistemesh zgjedhore, ky kapitull ofron një analizë të sjelljes së deputetëve në vende të cilat nuk janë studiuar më parë dhe për të cilat, pra, ne dijmë pak. Për më tepër, edhe pse ndikimi i sistemeve zgjedhore në sjelljen e deputetëve në sistemet partiake me institucionalizim të dobët nuk është aq i fortë sa ishte parashikuar, analizat treguan se sistemet zgjedhore nuk kanë të njëjtin efekt në sistemet partiake me institucionalizim të dobët dhe të lartë. Për më tepër, ne zbuluam se niveli i institucionalizimit të sistemit partiak është më i rëndësishëm se sistemi zgjedhor. Andaj, ky studim nënvizon rëndësinë e eksplorimit të sjelljes institucionale mes vendeve me demokraci të re ku gjetjet e vendeve të Evropës Perëndimore nuk janë përgjithësisht të zbatueshme. Ndoshta ka faktorë të tjerë, të ndryshëm nga ata që janë marrë parasysh këtu, të cilët do të na ndihmonin të shpjegojmë pse kohezioni është më i ulët mes këtyre vendeve. Në përgjithësi, ky studim ka hapur rrugën për hulumtime të mëtejshme mbi sjelljen e deputetëve. Pasi kemi eksploruar efektin e sistemit zgjedhor në unitetin e GP-së, një nga dy ndryshorët e varur, në dy kapitujt tanë të ardhshëm ne shqyrtojmë ndikimin e sistemit zgjedhor në ndryshorin tjetër të varur, përkatësisht lidhjet me elektoratin, si në rastin e Kosovës ashtu edhe në Maqedoni të Veriut, në mesin e vendeve të Rajonit të Evropës Juglindore.

5

Shtrirja e lidhjeve me votuesit në mesin e deputetëve në Kosovë: krahasimi i sjelljes së deputetëve në sistemin proporcional me lista të mbyllura dhe me atë me lista të hapura

5.1 Hyrje

Siç u përmend në Kapitullin 2, studimi i lidhjeve me zgjedhësit është i rëndësishëm për të kuptuar se si funksionon përfaqësimi. Megjithatë, u vu re gjithashtu se dihet shumë pak për stimujt e deputetëve për të zhvilluar lidhje të tilla jashtë demokracive të konsoliduara. Duke parë rastin e Kosovës, ku niveli i institucionalizimit të sistemit partiak është i ulët, ky kapitull shqyrton shkallën në të cilën deputetët e saj zhvillojnë lidhje të ngushta me zgjedhësit e tyre. Duke vepruar kështu, kapitulli do të krahasojë sjelljen e deputetëve në sistemin proporcional me listë të mbyllur që u përdor në zgjedhjet e vitit 2004 dhe sistemit proporcional me listë të hapur që u përdor si në zgjedhjet e vitit 2007 ashtu edhe në 2010. Argumenti kryesor është se për shkak të natyrës së dobët të institucionalizimit të sistemit partiak në Kosovë, deputetët e zgjedhur nën SP me lista të hapura, ku ka konkurrencë zgjedhore brenda partisë, do të zhvillojnë lidhje më të ngushta me zgjedhësit e tyre sesa ata të zgjedhur nën SP me lista të mbyllura, ku mungon një garë e tillë zgjedhore brenda partisë.

Duke ditur se deputetët në shumë demokraci të konsoliduara zhvillojnë lidhje të ngushta me zgjedhësit e tyre, si dhe shprehin kënaqësinë për to (Brouard et al 2012, fq. 157), pavarësisht nga sistemi zgjedhor, Kosova si një vend i sapodemokratizuar ofron një vend të mirë për të testuar nëse sistemi zgjedhor ka ndonjë ndikim në prirjen e deputetëve për ta bërë këtë. Për të shqyrtuar sjelljen e deputetëve, ky kapitull përdor një qasje cilësore duke intervistuar deputetë nga të tre mandatet legislative, përkatësisht 2004-2007, 2007-2010 dhe 2010-2014. Arsyeja kryesore e zgjedhjes së Kosovës, ndër vendet e tjera të rajonit, për të vlerësuar ndikimin e sistemeve zgjedhore në sjelljen e deputetëve, është se Kosova është i vetmi vend në rajonin e EJT që ka përjetuar një ndryshim në sistemin e vet zgjedhor nga SP me lista të mbyllura në SP me lista të hapura. Andaj, Kosova ofron një eksperiment të mirë natyror përmes të cilit mund të testojmë efektin e sistemeve zgjedhore në sjelljen e deputetëve me kalimin e kohës, duke i mbajtur të gjitha të barabarta.

Një nga hipotezat kryesore që testohet këtu është se deputetët e zgjedhur sipas sistemit proporcional me lista të hapura do të krijojnë lidhje më të mëdha me zgjedhësit e tyre sesa ata të zgjedhur me SP me listë të mbyllur (H.8). Ne argumentuam më herët në kapitullin 2 se një mënyrë që deputetët të dallohen nga bashkëpartiakët e tyre në sistemet proporcionale me lista të hapura, ku ka konkurrencë zgjedhore brenda partisë, është të zhvillojnë lidhje më të mëdha me zgjedhësit e tyre. Nga ana tjetër, në sistemet proporcionale me listë të mbyllur, ku kandidatët varen kryesisht nga konkurrenca ndërpartiake, stimujt për të ndërtuar një reputacion personal janë më pak të rëndësishme. Hipoteza tjetër ishte se sa më e centralizuar të jetë përzgjedhja e kandidatëve, aq më e vogël është shkalla në të cilën deputetët do të krijojnë lidhje të ngushta me zgjedhësit e tyre, dhe sa më e decentralizuar të jetë përzgjedhja e kandidatëve, aq më e madhe është shkalla në të cilën deputetët do të krijojnë lidhje të ngushta me zgjedhësit (H.9). Sipas metodave të centralizuara të përzgjedhjes së kandidatëve, ku përzgjedhësi është lidhësi i partisë, kandidatët duhet vetëm t'i kushtojnë vëmendje atij nëse synojnë të rizgjedhen përsëri. Për më tepër, duke supozuar se udhëheqja e partisë do të vlerësojë më shumë aktivitetet e deputetëve në nivel kombëtar, ligjvënësit do ta përqendrojnë shumicën e energjive të tyre në atë nivel. Sipas metodave të decentralizuara të përzgjedhjes së kandidatëve, megjithatë, duke supozuar se anëtarët e partisë të nivelit lokal do të jenë më të preokupuar me dukshmërinë e përfaqësuesve në zonën lokale, deputetët do të kenë më shumë stimuj për të zhvilluar lidhje të ngushta me zgjedhësit e tyre (Gallagher 1988, fq. 15).

Janë dy hipoteza të tjera të cilat janë testuar këtu që lidhen kryesisht me rolet përfaqësuese të deputetëve. Siç u përmend më herët, është e rëndësishme të zbulohet se kë përfaqësojnë deputetët, sepse këtu supozojmë se ata do t'i fokusojnë aty aktivitetet e tyre zgjedhore. Së pari, deputetët e zgjedhur nën SP me listë të hapur do të kenë më shumë gjasa ta shohin veten si përfaqësues të elektoratit sesa ata deputetë të zgjedhur nën SP me listë të mbyllur (H.10), sepse aty ku votuesve u jepet mundësia për votë preferenciale, deputetët kanë nevojë të jenë të vëmendshëm ndaj atyre interesave. Megjithatë, kur votuesit nuk mund të bëjnë dallimin mes kandidatëve në listë, ligjvënësit do të priren t'i shohin zonat e tyre zgjedhore kryesisht në terma partiakë (Mezey 2008, fq. 51). Dhe, së dyti, në SP me listë mbarëkombëtare, në mungesë të një zone zgjedhore të përcaktuar gjeografikisht, deputetët do të priren t'i përqendrojnë aktivitetet e tyre në zonën e tyre lokale, si vendlindja e tyre, ose në grupe të përcaktuara në formë jo gjeografike (H.12). Edhe pse deputetët në Kosovë zgjedhen nga votuesit në një zonë zgjedhore si në SP me lista të hapura ashtu dhe të mbyllura, fokusimi i këtyre aktiviteteve në të gjithë territorin është i vështirë për arsye praktike. Prandaj, ne presim që deputetët t'i përqendrojnë aktivitetet e tyre në vendin e tyre të lindjes ose në grupe jo-territoriale të përcaktuara siç sugjeron hipoteza. Rezultatet nga testimi i këtyre hipotezave janë paraqitur në seksionin 5.4 të këtij kapitulli. Në vijim jepet një pasqyrë e institucionalizimit të sistemit partiak si dhe atij zgjedhor.

5.2 Institucionalizimi i Sistemit Partiak (ISP)

Argumenti kryesor i këtij libri ishte se sistemet zgjedhore në vendet me sisteme partiake të institucionalizuara dobët (ISP) do të kenë një ndikim më të madh në sjelljen e deputetëve në krahasim me ndikimin e tyre në sistemet partiake me institucionalizim të lartë. Gjithashtu u theksua se ka disa arsye pse ne do të prisnim një efekt më të madh të sistemeve zgjedhore në sjelljen e deputetëve në vendet me ISP të dobët, dy prej të cilave janë të rëndësishme në këtë kontekst. Së pari, ekziston një lidhje e dobët mes partive dhe elektoratit. Kjo për shkak se partitë shfaqen dhe zhduken shpesh dhe si të tilla votuesit e kanë të vështirë të identifikohen me një parti të caktuar. Kjo ka dy implikime. Nga njëra anë, partitë e dijnë se nuk do të jenë në qarkullim për shumë kohë dhe për këtë arsye nuk kanë asnjë arsye për të mos bërë premtime të mëdha. Në fakt, ata mbase as nuk do të jenë aktive sa të përballojnë pasojat e premtimeve të tepruara (Roberts 2010). Nga ana tjetër, për shkak se partitë politike në raste të tilla nuk arrijnë të ofrojnë atë që qytetarët kërkojnë prej tyre, njerëzit zhgënjehen dhe nga ana tjetër kërkojnë përfaqësues të

pavarur. Rrjedhimisht, kjo lë hapësirë për lidhje personale mes votuesve dhe kandidatëve (Mainwaring dhe Torcal 2005, fq. 218).

Së dyti, kur niveli i institucionalizimit të sistemit partiak është i ulët, partitë shihen si organizata të dobëta pa efekte të besueshme për t'i privuar ligjvënësit nga përfitimet e tyre zgjedhore nëse këto pengojnë përgjegjësinë partiake (Tavits 2011, fq. 410), dhe ligjvënësit e dinë se mund të rizgjidhen edhe nëse ndërrojnë parti (Owens 2003, fq. 19). Kjo e fundit ndodh për disa arsye. Duke u bazuar në shqyrtimin e tij të rastit të Brazilit, Mainwaring argumenton se politikanët ndërrojnë parti jo aq për shkak të prirjes së tyre ideologjike, por më tepër për shkak të ambicieve të tyre politike dhe lidhjeve të tyre me politikanë të fuqishëm. Sipas autorit, 'kostoja e ndërrimit është shpesh e ulët duke pasur parasysh mungesën e sanksioneve ligjore dhe tolerancën e elektoratit ndaj politikanëve që ndryshojnë përkatësinë' (1999, fq. 145). Përveç kësaj, motivimi i deputetëve për të ndërruar parti mund të bazohet në stimujt e tyre për të fituar qasje në pozita më të mira institucionale të ofruara nga pala tjetër (Owens 2003, fq. 20). Paraqitja dhe zhdukja e partive në Kosovë është relativisht më e lehtë për t'u dokumentuar në krahasim me identifikimin partiak, për të cilin përgjithësisht mungojnë të dhënat e opinionit publik.

Një vështrim i thjeshtë në zgjedhjet parlamentare tregon se në vitin 2001 kishte 26 subjekte politike; parti si dhe nisma qytetare, të regjistruara në zgjedhje (Grupi Ndërkombëtar i Krizave 2001). Në vitin 2004, ky numër u rrit në 33 (Walecki 2006, fq. 82) me partinë ORA që hyri në zgjedhje për herë të parë për t'u shuar më pas pasi nuk arriti të kalojë pragun në zgjedhjet e radhës. Në vitin 2007 kishte 26 subjekte (Delegacioni i Vëzhgimit të Zgjedhjeve i PE 2007). Në mesin e atyre që hynë në garë për herë të parë ishte edhe partia AKR. Në vitin 2010 në zgjedhje garuan 29 subjekte politike, dy prej të cilave parti të reja, përkatësisht Vetëvendosje! (VV) dhe FER (BBC 2013). Aktualisht vetëm Vetëvendosje! vazhdon të ekzistojë pasi FER nuk arriti të kalonte pragun zgjedhor prej 5 për qind në zgjedhjet e të njëjtit vit dhe u shpërbë⁸ edhe pse një numër i konsiderueshëm i anëtarëve të saj më vonë iu bashkuan VV-së. Mes viteve 2012 dhe 2013 u regjistruan pesë parti të reja politike (KSHZ 2013).

Gjithsej, në zgjedhjet e vitit 2010 kanë marrë pjesë 31 subjekte politike, prej të cilave 19 parti politike (Telegrafi 2013). Në aspektin tjetër, është e vështirë të gjenden të dhëna që vlerësojnë nivelin e institucionalizimit të sistemit partiak

⁸ Shënim: Një pjesë e madhe e saj më vonë iu bashkua LDK-së.

në Kosovë. Unë kam llogaritur nivelin e ISP për disa vende duke përdorur indeksin e Casal Bertoa dhe Mair (2010) të konkurrencës qeveritare, i cili u diskutua në detaje në Kapitullin 1, dhe që tregon se niveli i ISP në Kosovë është më i ulët se mesatarja e përgjithshme për 34 vende evropiane të përfshira në analizë. Përveç kësaj, është e njohur se një nga elementët që zvogëlon nivelin e ISP në Kosovë është kalimi i shpeshtë i deputetëve nga një parti në tjetrën (KIPRED 2012, fq. 5). Ndërmjet viteve 2007 dhe 2010, njëmbëdhjetë nga 100 deputetë ndërruan parti dhe katër u bënë të pavarur (KDI 2010, fq. 15). Një raport i Institutit Kosovar për Hulumtim dhe Zhvillim të Politikave (KIPRED) thotë se 'pothuajse nuk ka asnjë parti të vetme në Kosovë që nuk ka humbur anëtarë dhe madje edhe zyrtarë të lartë që kanë kaluar në një parti tjetër, pasi nuk ka pothuajse asnjë parti që nuk ka pranuar anëtarë dhe zyrtarë nga një parti tjetër'. I njëjti raport thekson se arsyet e ndryshimit të partisë përfshijnë përfitimet zgjedhore dhe financiare, aftësinë për të ushtruar ndikim mbi sistemin gjyqësor duke mbajtur një pozicion të fuqishëm, si dhe gëzimi i statusit më të lartë shoqëror. Ndër këto, përfitimet financiare duket se janë arsyeja kryesore e cila, nga ana tjetër, shihet gjithashtu se forcon më tej rolin e udhëheqësisë, pasi ata gëzojnë të drejtën për t'i 'shpërblyer' të ardhurit me pozita politike (2012, fq. 5).

Prandaj, arsyet e ndërrimit të partive janë mjaft personale dhe ndihmohen nga mungesa e pozicionimit të qartë ideologjik të partive. Andaj, është shumë e vështirë të ofrohet një kuptim i përgjithshëm i modelit të ndërrimit të partive në Kosovë. Dikush do të sugjeronte se ndërrimi i partive ndodh më shpesh nga partitë opozitare në partitë në qeveri, pasi që ato kontrollojnë qasjen në shumicën e burimeve shtetërore, gjë që ndodh shpesh në Kosovë. Megjithatë, edhe deputetët e partive në pushtet kanë kaluar në parti opozitare, ndërsa ata të opozitës i janë bashkuar edhe partive të tjera në opozitë. Për shembull, pesë deputetë të PDK-së, e cila ka qenë në qeveri gjatë mandatit 2010-2014, u larguan nga partia për t'iu bashkuar partive të tjera që nuk ishin në koalicion me PDK-në (Zëri 2014). Në fakt, shumica e deputetëve që kanë ndërruar parti gjatë këtij mandati legjislativ i janë bashkuar LDK-së; partia kryesore opozitare. Ndoshta deputetët kishin nxitje të mendonin se mes akuzave për korrupsion dhe keqmenaxhim të ekonomisë së vendit nga PDK-ja, kjo e fundit do të humbiste nga LDK-ja në zgjedhjet e ardhshme, por arsyetimi i saktë është i vështirë.

Në përgjithësi, partitë politike në Kosovë ndjekin një qasje nga lart-poshtë të organizimit të partisë, ku udhëheqja e partisë ushtron rolet më të spikatura mbi punën e partisë, siç është zgjedhja e organeve qendrore të partisë, përzgjedhja e kandidatëve për zgjedhje dhe kontrolli i punës parlamentare të partisë.

Vendimet kryesore brenda partisë, si formimi i një koalicioni ose tërheqja nga një koalicion, janë gjithashtu vendime të cilat merren nga një pjesë e vogël e zyrtarëve të partisë. Një raport i Konrad Adenauer Stiftung (KAS) thekson se ndikimi i fortë i udhëheqësisë së partisë në mënyrën se si funksionojnë partitë, lë pak hapësirë për angazhimin e drejtpërdrejtë të anëtarëve të partisë në procesin e vendimmarrjes, 'ndikim të dobët të grupeve funksionale (të rinjtë, gratë, personat në pension, etj.) brenda partive, rend hierarkik të brendshëm, modele të thjeshta organizative të kopjuara në të gjitha nivelet, zgjedhje indirekte të organeve qendrore të partisë, mbivendosje të konsiderueshme të partisë në zyrën qendrore dhe të partisë në zyrën publike, autonomi të kufizuar të grupit parlamentar' (2012, fq. 9,21). Roli demokratik i partive minohet më tej pasi statutet e partive priren të ndryshojnë shpesh, madje edhe udhëheqësia tenton t'i anashkalojë rregullat formale të përshkruara në statute. Në përgjithësi, kështu, veçoritë e theksuara këtu plotësojnë vlerat e ulëta të ISP për Kosovën të dhëna në Kapitullin 1.

5.3 Sistemi zgjedhor dhe ai partiak

Sistemi zgjedhor që përdoret për zgjedhjen e anëtarëve të Kuvendit të Kosovës është SP me lista të hapura që mbahet me një zonë mbarëkombëtare, nga e cila zgjidhen 100 deputetë. Ky sistem u prezantua për herë të parë në zgjedhjet e vitit 2007, kryesisht për shkak të thirrjeve të shoqërisë civile për të forcuar marrëdhëniet deputetë-votues, pasi zgjedhjet e mëparshme u mbajtën nën një sistem SP mbarëkombëtar me listë të mbyllur, duke filluar me zgjedhjet e para parlamentare të vitit 2001. Sistemi proporcional u prezantua për të akomoduar interesat e të gjitha komuniteteve në Kosovë pas përfundimit të luftës në vitin 1999. Ajo që rezultoi nga kjo inxhinieri zgjedhore janë edhe 20 vende të rezervuara (përtej 100) për komunitetet pakicë në Kuvend; 10 për komunitetin serb dhe 10 për komunitetet e tjera pakicë, përkatësisht rom, turq, ashkali etj. Partive politike u kërkohet të respektojnë një kuotë prej 30 për qind gra (e quajtur gjinia më pak e përfaqësuar) kur paraqesin listën e tyre të kandidatëve dhe ka një kuotë 30 për qind për përfaqësimin e grave në parlament gjithashtu. Po kështu, partitë politike duhet të kalojnë një prag prej 5 për qind për të fituar përfaqësim në parlament.

Me kalimin e viteve, sistemi proporcional me listë të hapur ka pësuar ndryshime të vogla. Në vitin 2007, votuesit mund të hidhnin deri në 10 vota preferenciale. Në vitin 2010, ky numër u reduktua në 5. Aktualisht, pra, votuesit duhet të votojnë për një parti dhe, nëse dëshirojnë, të shprehin deri në 5 vota

preferenciale për kandidatët brenda së njëjtës parti. Një votues mund të japë vetëm një votë ose pesë, por nëse votohen për më shumë se pesë kandidatë, atëherë do të llogaritet vetëm vota për partinë politike. Rendi në të cilin partitë paraqesin kandidatët e tyre nuk ka rëndësi, në parim, pasi lista rirënditet në mënyrë zbritëse bazuar në numrin e votave të marra nga secili kandidat. Megjithatë, kjo nuk do të thotë se praktikisht nuk ndikon në sjelljen e votimit, pasi votuesit pa ndonjë preferencë të caktuar më së shpeshti do të shënojnë pesë kandidatët e parë në listë. Për më tepër, 'rendi i listës së partisë mund të tregojë një preferencë organizative të cilën mund ta ndjekin disa votues' (Katz dhe Bardi 1980, fq. 108-9). E vetmja gjë që cenon një rirënditje të vërtetë të listës bazuar në votat preferenciale është kuota prej 30 për qind për gratë, pasi zgjedhen femra me më pak vota preferenciale se meshkujt. Pra, nëse pas ndarjes së mandateve për një parti politike, kandidatëve femra nuk u janë ndarë mandatet sipas kërkesës për 30 për qind, atëherë kandidati i fundit mashkull zëvendësohet nga kandidatja tjetër femër nga lista e rirënditur dhe kështu me radhë deri kur arrihet 30 për qind.

Përpara se sistemi me lista të hapura të futej në përdorim në vitin 2007, sistemi zgjedhor ishte proporcional me lista të mbyllura me një zonë mbarëkombëtare, që u vendos kryesisht për të nxitur përfaqësimin e grave. Fakti që deputetët janë zgjedhur në një zonë mbarëkombëtare nuk ka ndryshuar, kështu që nuk është e mundur të eksplorohet efekti i ndryshimit të madhësisë së zonës zgjedhore në sjelljen e deputetëve me kalimin e kohës. Po kështu, gjithsej ishin 120 deputetë me 20 ulëse të rezervuara për komunitetet pakicë. Sistemi zgjedhor ndërmjet viteve 2001 dhe 2010 ka pësuar disa ndryshime, me përjashtim të fletëvotimit. Për shembull, kuota prej 30 për qind për gratë u fut në zgjedhjet e 2004-ës, mandati parlamentar u zgjat nga tre në katër vjet në të njëjtin vit, pragu prej 5 për qind u vendos në 2007, siç u përmend numri i votave preferenciale që votuesit mund të japin ndryshoi nga 10 në 5 në 2010, dhe parimi që lejonte udhëheqësin e partisë të fitonte automatikisht një votë preferenciale sa herë që hidhej një votë për partinë u hoq në vitin 2010.

Të dyja këto forma të sistemeve të përfaqësimit proporcional kanë prodhuar gjithmonë një qeveri koalicioni të disa partive qeverisëse dhe disa partive të përfaqësuara në parlament. Nga viti 2001 deri në vitin 2007, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) ishte partia kryesore politike, me Partinë Demokratike të Kosovës (PDK) në vendin e dytë dhe Aleancën e Ardhmërisë për Kosovën (AAK) në vendin e tretë. Megjithatë, zgjedhjet pasuese kanë parë shfaqjen e partive të reja dhe më të vogla politike, përkatësisht ORA, dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AKR). Skena politike ndryshoi në zgjedhjet e vitit 2007 pasi LDK-ja

dhe PDK-ja ndërruan vende; me PDK-në që u bë kështu partia më e madhe parlamentare. Lidhja Demokratike e Kosovës megjithatë arriti të qëndrojë në qeveri, si partner i koalicionit me PDK-në, deri në vitin 2010 kur u tërhoq nga koalicioni, dhe për pasojë u mbajtën zgjedhje të reja. Edhe atëherë PDK arriti të fitojë numrin më të madh të ulëseve, por kësaj radhe hyri në koalicion me AKR-në, duke e lënë LDK-në në opozitë. Kanë dalë në sipërfaqe edhe parti të tjera politike, përfshirë Vetëvendosjen! që fitoi përfaqësim në zgjedhjet e po atij viti, që mbesin të rëndësishme edhe sot. Përfaqësimi proporcional, së bashku me vendet e rezervuara për komunitetet pakicë, ka rezultuar gjithashtu në përfaqësimin e një numri të madh partish në parlament pavarësisht pragut prej 5 për qind. Në zgjedhjet e vitit 2010 u përfaqësuan 17 parti politike, me të njëjtin numër partish që kishin fituar përfaqësim në mandatin 2007-2010 (KQZ), ndërsa në mandatin 2004-2007 ishin 19 sosh (OSBE 2004).

Është e rëndësishme të theksohet se ka pasur debat të vazhdueshëm për ndryshimin e sistemit zgjedhor, edhe pse kjo lidhet më shumë me nevojën për përmirësimin e mënyrës së organizimit dhe menaxhimit të procesit zgjedhor sesa me sistemin zgjedhor në vetvete. Për sa i përket ndikimit të ndryshimit nga SP me lista të mbyllura në SP me lista të hapura në zgjedhjet e vitit 2007, mund të shtrohet pyetja nëse deputetët e zgjedhur në 2004 e dinin këtë në fillim të mandatit parlamentar dhe për këtë arsye e rregulluan sjelljen e tyre në përputhje me rrethanat. Megjithatë, të dhënat historike tregojnë se ndryshimi u bë në një fazë të vonshme përpara zgjedhjeve të 2007, dhe kryesisht si përgjigje ndaj presionit të jashtëm dhe jo si rezultat i zgjedhjes së pakufizuar të deputetëve. Nga intervistat e bëra me deputetë në parlamentin e viteve 2004-2007, është evidente se deputetët e zgjedhur në vitin 2004, deri vonë në mandatin e tyre nuk e dinin që sistemi proporcional me lista të mbyllura do të ndryshonte në SP me listë të hapur në zgjedhjet e radhës.

Përveç kësaj, përderisa organizatat e shoqërisë civile kishin bërë thirrje për një sistem proporcional me lista të hapura shumë më herët, u bë e ditur se kjo do të bëhej kur u miratua Propozimi Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, i ashtuquajtur i Plani i Ahtisaarit, më 2 shkurt 2007. Kjo sugjeroi se zgjedhjet do të duhej të realizoheshin me sistem proporcional me lista të hapura. Kuvendi i Kosovës më pas duhej të miratonte disa ligje, duke përfshirë atë për zgjedhjet, në përputhje me Planin e Ahtisaarit. Po kështu, prej kohësh kishte një sugjerim nga disa parti politike për mbylljen sërish të listave për zgjedhjet e vitit 2014, por asnjë nga deputetët e intervistuar nuk e përmendi këtë. Për më tepër, edhe pse në vitin 2011 u krijua një komision parlamentar për reformimin e ligjit, përfaqësuesit e partive nuk arritën marrëveshje për ndryshimet e nevojshme në

ligjin zgjedhor, i cili duhej të miratohej përpara zgjedhjeve parlamentare të 2014-ës. Zgjedhjet e vitit 2014 u zhvilluan dhe u mbajtën sipas të njëjtit sistem zgjedhor si ai i vitit 2010. Kjo ilustron mjedisin e pasigurt në të cilin funksionojnë deputetët.

Për më tepër, ndërkohë që kemi treguar më parë se ndryshimi i sistemit zgjedhor na lejon të krahasojmë sjelljen e deputetëve me kalimin e kohës, nuk është plotësisht e mundur të mbajmë gjithçka tjetër konstante ose në kontroll. Më e rëndësishmja, Kosova shpalli pavarësinë në shkurt 2008, menjëherë pasi zgjedhjet e vitit 2007 u mbajtën në nëntor të atij viti. Prandaj, fare mirë mund të argumentohet se deputetët në mandatin e kaluar i kushtuan më shumë vëmendje çështjeve kombëtare, si p.sh. kur do të bëhej pavarësia, sesa aktiviteteve me zgjedhësit. Duke e pranuar këtë vështirësi, mund të argumentohet edhe ndryshe, se deputetët ishin më të shqetësuar për interesat e elektoratit pas periudhës së pasluftës, pra në kohën kur statusi i Kosovës ende nuk ishte zgjidhur, sepse kjo ishte një periudhë në të cilën gjëra si p.sh. uji i pijshëm, rrugët dhe shkollat ende mungonin. Prandaj, do të supozojmë se njerëzit u drejtuan kërkesa bazike përfaqësuesve të tyre. Por, pasi u realizuan këto, në një kohë të mëvonshme, ndoshta deputetët u përballën me më pak kërkesa të tilla.

5.4 Gjetjet

Përpara se të thellohem në rezultate, është e rëndësishme të theksohen dy gjetje të rëndësishme që intervistat zbuluan për sa i përket natyrës së dobët të institucionalizimit të sistemit partiak. Së pari, ka një mungesë të dukshme të burimeve që deputetët kanë në dispozicion për trajtimin e zgjedhësve të tyre. Shumica e deputetëve pranuan se janë të vetëm kur bëhet fjalë për fushatën dhe ruajtjen e lidhjeve me zgjedhësit. Nga të gjithë deputetët, ata që kryesojnë komisionet parlamentare gëzojnë burimet më të mëdha me një zyrë që u jepet dhe një asistent të paguar nga parlamenti. Shumica prej tyre treguan se i përdorin këto burime për t'u takuar me zgjedhësit e tyre, megjithëse një numër prej tyre bënë dallimin mes mbështetësve të pastër të partisë që ata pretendonin se i takonin në zyrat e partisë dhe qytetarëve të zakonshëm që zakonisht i presin në zyrën e tyre parlamentare. Duhet theksuar se me iniciativën e Institutit Kombëtar Demokratik (NDI) dhe organizatave të shoqërisë civile, në mandatin e parë parlamentar (2004-2007) janë ngritur zyra të deputetëve nëpër komuna të Kosovës, në mënyrë që deputetët të mund të kalojnë një ditë në javë duke u takuar me zgjedhësit, por nga kjo përfituan vetëm pak deputetë dhe pas një kohe të shkurtër, me mbarimin e financimit, zyrat u mbyllën.

Së dyti, një numër i madh deputetësh vunë re parregullsi në lidhje me mënyrën e dhënies së votave preferenciale. Në fakt, një numër i madh i tyre besonin se lejimi i votuesve për të hedhur pesë vota preferenciale në zgjedhjet e fundit, linte shumë hapësirë për mashtrim të votuesve, pasi deputetët në bashkëpunim me komisionerët zgjedhorë u angazhuan në transferimin e paligjshëm të votave për të rritur mbështetjen zgjedhore për kandidatët. Një deputet i PDK-së ka theksuar (Intervistë me deputet kosovar, 08 prill 2013):

“Unë nuk jam kundër SP me lista të hapura, por sistemi ka nevojë për organizim më të mirë dhe vota e qytetarit duhet të shkojë atje ku do qytetari. Kur bëjmë fushatë, jemi të prirur të besojmë se votat që japin qytetarët për ne do të mbeten tonat. Në zgjedhjet e fundit, nuk kishte vullnet për t’u kërkuar qytetarëve që të votonin për ty, sepse vota e tyre nuk arrinte gjithmonë tek ai që ishte destinuar”.

Një deputet tjetër nga e njëjta parti deklaroi (Intervistë me deputet kosovar, 08 prill 2013):

“Ata (kandidatët) dhanë para. Le të themi se një komisioner merr 100 euro dhe pastaj merr 100 vota nga një kandidat dhe ia jep tjetrit. Në këto raste nuk ka rëndësi kush jeni, sa mbështetje keni apo si votojnë njerëzit”.

“Duket shumë keq, por kam dëgjuar kandidatët të pyesin njëri-tjetrin ‘sa vota të tjera të duhen këtu?’ Nuk është çudi, për shembull, unë kisha mbi 800 vota në Skenderaj fillimisht, por pasi u përsëritën zgjedhjet [një rivotim u bë më vonë], dikush që po vëzhgonte numërimin më tha se megjithëse mora përsëri të njëjtin numër votash, një numër i madh votash thjesht u zhdukën”.

Dihet mirë se shkalla më e madhe e manipulimit ka ndodhur në rajonin e Skenderajt, ku nganjëherë pjesëmarrja në zgjedhje ishte më e madhe se 100 për qind. I njëjti deputet, duke shprehur antagonizmin e tij ndaj sistemit aktual zgjedhor për sa i përket numrit të votave preferenciale që lejohen, theksoi më tej:

“Unë kisha propozuar përpara komisionit për ndryshimin e sistemit zgjedhor që duke qenë se numri i votave preferenciale

të hedhura nuk mund të ndryshojnë, pasi u vendos që të ishin pesë, të paktën t'u kërkohej votuesve të shënojnë numrin e votave preferenciale që kanë dhënë, për shembull, nëse hedhin katër, do të duhej të shënonin numrin katër për të parandaluar abuzimin”.

Në fakt, një tjetër deputet ka theksuar (Intervistë me deputet kosovar, 11 prill 2013):

“Nëse mbetet i njëjti sistem zgjedhor, organizimi i zgjedhjeve, votimi dhe mënyra e numërimit të votave duhet të kryhen më mirë për të parandaluar manipulimet dhe abuzimet me votat”.

Këto gjetje janë mbështetur edhe nga një raport i Misionit të Ekspertëve Zgjedhorë të Bashkimit Evropian në Kosovë (2010, fq. 29) i cili i referohet vendimit A08/2011 të datës 13 janar 2011 të Komisionit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrë (PZAP), që thekson “Në shumë qendra votimi ka pasur vjedhje votash, ryshfete për komisionerët, falsifikim nënshkrimesh, kërcënime, vjedhje votash, votime familjare, presione e shantazhe etj.” Në mënyrë të ngjashme, i njëjti raport citon një artikull të një gazete lokale që identifikoi 133 lëndë gjyqësore kundër komisionerëve (po aty, fq. 57). Kjo e bën të vështirë të kemi një pasqyrë të qartë se sa për qind e votuesve shprehin vërtet një votë preferenciale dhe sa prej tyre i shprehin të pesë votat e tyre preferenciale. Andaj, përdorimi i votave preferenciale mund të jetë i ndërlikuar në rastin e Kosovës, megjithëse ato do të na jepnin një tregues, siç u theksua në Kapitullin 2, nëse sa më shumë vota preferenciale të marrin deputetët aq më shumë ka gjasa që ata të krijojnë lidhje më të ngushta me zgjedhësit, dhe anasjelltas. Megjithatë, për të shqyrtuar vlefshmërinë e gjetjeve, testet e korrelacionit mes votave preferenciale dhe sasisë së lidhjeve me zgjedhësit që zhvillojnë deputetët janë bërë më vonë në kapitull.

Sigurisht, kjo ngre pyetjen se pse deputetët do të shqetësoheshin të ndërtonin lidhjet me zonat zgjedhore nëse do të mund të rizgjedhen vetëm duke paguar zyrtarin e numërimit për t'u dhënë atyre vota preferenciale? Dhe, në mënyrë të ngjashme, pse të shqetësohen për ndërtimin e lidhjeve me zgjedhësit pasi edhe nëse kjo i sjell një kandidati më shumë vota preferenciale, këto mund të hiqen nga zyrtarët e numërimit. Por, çështja nuk është aq e thjeshtë. Së pari, manipulimet e votave kanë ndodhur brenda partive dhe si të tillë kandidatët fillimisht duhej të siguroheshin që partia e tyre të fitojë sa më shumë vota. Sa më shumë vota të merrte partia, aq më e madhe ishte mundësia e deputetëve për të fituar një mandat për shkak të natyrës proporcionale të

shndërrimit të votave në ulëse. Mënyra më e mirë për ta bërë këtë, me sa duket, do të ishte mbajtja në kontakt me votuesit. Së dyti, kandidati nuk e di se sa vota preferenciale i nevojiten, duke ditur se kjo varet nga numri i votave preferenciale që mbledhin kandidatët e tjerë. Gjithashtu, për shkak të kuotës gjinore, gratë zakonisht zgjedhen në parlament me më pak vota preferenciale se burrat. Për shembull, në zgjedhjet e vitit 2007, brenda PDK-së, kandidati i parë mori 105,378 vota, ndërsa një kandidate grua në fund mori vetëm 6,503 vota. Ndërkaq, kandidati mashkull që mori më së paku vota në mesin e gjithë meshkujve mbledhi 11,353 sosh.

Për sa i përket rizgjedhjes, siç parashikohej, shumica e deputetëve të zgjedhur me SP me lista të hapura konsideruan se kjo varet nga votuesit edhe pse, siç tregohet më poshtë, disa konsideruan se kjo ishte për shkak të partisë dhe elektoratit. Një deputet i AAK-së në SP me listë të hapur deklaroi (Intervistë me deputet kosovar, 11 prill 2013):

“Edhe zgjedhja jonë brenda partisë është për shkak të votuesve. Ndonjëherë ka një keqkuptim. Njerëz që i njohin partitë politike e dinë një gjë, asnjë parti politike nuk do të përfshijë në listën e saj njerëz që mendohet se nuk do të fitojnë vota. Partia mund ta bëjë ministër, drejtor të ndonjë agjencie, apo ndonjë gjë tjetër, por në listë do të jenë vetëm ata që shihen ekskluzivisht se sjellin vota dhe nuk ka arsye tjetër”.

Nga ana tjetër, të zgjedhurit nën SP me listë të mbyllur pranuan se rizgjedhja e tyre ishte kryesisht për shkak të partisë. Në fakt, për të ilustruar kontrastin, një deputet që ka shërbyer në të dy sistemet zgjedhore ka theksuar (Intervistë me deputet kosovar, 08 prill 2013):

“Kur kam marrë pjesë për herë të parë në zgjedhjet në vitin 2004, listat ishin të mbyllura. Pra, ne u zgjodhëm me votën për partinë. Por, në zgjedhjet e vitit 2007 ne u votuam drejtpërdrejt dhe kështu u rizgjodhëm në bazë të votave që fituam si individë”.

Megjithatë, siç u përmend, kishte raste kur deputetët e zgjedhur nën SP me lista të hapura konsideronin se rizgjedhja e tyre varej si nga partia ashtu edhe nga votuesit. Dy deputetë të LDK-së theksuan (Intervistë me deputetë kosovarë, 10 prill 2013 dhe 09 prill 2013):

“Etiketa e partisë ndihmon gjithashtu. Jam i sigurt se nëse 90 për qind e deputetëve do të garonin si kandidatë të pavarur nuk do të fitonin”.

“Etiketa partiake nuk mund të neglizhohet. Ne kemi pasur raste brenda partisë sonë kur ata që nuk kanë qenë deputet apo kryetar komune kanë menduar se mund ta ndryshojnë etiketën dhe të fitojnë, por kjo ka treguar se të gjithë ata që e bëjnë do të humbasin mbështetjen e popullit”.

Një shpjegim për këtë është fakti se metodat e përzgjedhjes së kandidatëve janë mjaft të centralizuara, në kuptimin që në të gjitha partitë e shqyrtuara këtu, ishin organet qendrore të partisë që përzgjedhnin kandidatët. Për më tepër, i gjithë procesi i përzgjedhjes së kandidatëve është i ngjashëm në të gjitha partitë, pasi degët lokale propozojnë një numër kandidatësh, ndonjëherë edhe më të madh se sa kërkohet, kurse kryesia e partisë, e cila është organi ekzekutiv i partisë, bën listën përfundimtare dhe më pas ia dorëzon këshillit të përgjithshëm/drejtues të partisë për miratim zyrtar. Edhe pse fjala e fundit në shumicën e rasteve i takon këshillit apo kryesisë, deputetët përmendën disa cilësi që u kërkohen kandidatëve për t'u vendosur lart në listë. Ato përfshijnë reputacionin në mesin e votuesve, sa i afërt është dikush me elektoratin, sa i afërt është me udhëheqësin, kontributin e deputetit në parti, si dhe një sërë cilësish të tjera personale, si të qenit orator, demonstrimi i tipareve të udhëheqësisë, mospërfshirja në afëra korruptive, të qenit menaxher i mirë, dhe puna e mirë në Kuvend.

Në përgjithësi, kryesitë e partive janë më të vogla se këshillat e partive. Për shembull, Këshilli i Përgjithshëm i LDK-së përbëhej nga 99 anëtarë, ndërsa kryesia kishte 23 anëtarë. Ngjashëm, këshilli i PDK-së përbëhej nga 81 anëtarë, ndërsa kryesia kishte 29 anëtarë, dhe së fundi, në rastin e AAK-së këshilli përbëhej nga 120 anëtarë, ndërsa kryesia numëronte 60 anëtarë. Ka raste, sigurisht në kuadër të PDK-së, ku disa deputetë, siç do të tregohet më poshtë, kanë theksuar se në praktikë fjalën përfundimtare e ka udhëheqësi, i cili pasi lista të jetë miratuar nga këshilli, ka të drejtë të bëjë ndryshime në të. Është vërejtur nga një deputet se ka pasur raste kur kandidatët e miratuar nga këshilli janë nxjerrë nga udhëheqësi me arsyetimin se do të bëheshin ministra ose do t'u jepej ndonjë post tjetër qeveritar. Në fakt, një deputet që unë intervistova pranoi se ishte hequr nga lista për zgjedhjet e radhës pavarësisht se ishte përfshirë fillimisht (Intervistë me deputet kosovar, 30 korrik 2013). Këtë e përmendën edhe dy deputetë të tjerë, madje e justifikuan sjelljen e udhëheqësit, të cilin e konsideruan se 'e di më së miri se cili kandidat do të fitojë

më shumë vota'. Brenda LDK-së, deputetët theksuan se e drejta për ta hequr një kandidat i takon kryesisë, edhe pse disa prej tyre thanë se udhëheqësi e ruan këtë të drejtë. Në kuadër të AAK-së, shumë deputetë theksuan se e drejta për t'i hequr kandidatët e caktuar i takon këshillit, pa njohur asnjë rol të udhëheqësit mbi të. Një justifikim për këtë mund të jetë se udhëheqësi i partisë kaloi disa vite në Hagë, ku po gjykohej për krime lufte.

Kur flitet për përzgjedhjen e kandidatëve, sa i përket LDK-së, 71 për qind e të anketuarve nën SP me listë të hapur pohuan se fjala përfundimtare i takon këshillit, ndërsa 29 për qind deklaruan se vendimi përfundimtar i takon kryesisë; të dy janë zyra qendrore të partisë. Shifrat janë të ngjashme edhe për AAK-në, ku 80 për qind thanë se vendimi i takon këshillit dhe 20 për qind thanë se ky i takon kryesisë. Në anën tjetër, brenda PDK-së 64 për qind thanë se fjala përfundimtare për zgjedhjen e kandidatëve i takon këshillit, 9 për qind thanë se kjo i përket udhëheqësit, ndërsa 27 për qind thanë se fjala përfundimtare i takon kryesisë. Andaj, përzgjedhja e kandidatëve brenda të tri partive, në kohën e mbledhjes së të dhënave, ishte e centralizuar; në thelb varej nga zyrat qendrore të partisë, në krahasim me zyrat lokale të partisë. Për më tepër, metodat e përzgjedhjes së kandidatëve kanë mbetur të pandryshuara në të gjitha partitë, me përjashtim ndoshta të LDK-së, ku deputetët vunë re një rol më të fortë të udhëheqësit të partisë në SP me listë të mbyllur.

Duke u kthyer te sistemet zgjedhore, kontrasti mes dy llojeve të sistemeve proporcionale nuk është aq i dukshëm kur deputetëve iu kërkua të shpjegonin se cili ishte fokusi i tyre kryesor i përfaqësimit, megjithëse kontrasti rishfaqet më vonë. Shumica e deputetëve në të dy sistemet pretenduan se ata përfaqësonin kryesisht të gjithë popullin, siç tregojnë dy tabelat e mëposhtme. Për më tepër, në SP me listë të hapur numri më i madh i deputetëve deklaruan se së pari përfaqësonin votuesit e vet, së dyti votuesit e partisë, ndërsa përfaqësimi i partisë dhe grupeve specifike në shoqëri janë renditur më poshtë. Në SP me listë të mbyllur, përfaqësimi duket pothuajse i njëjtë duke pasur parasysh se përfaqësimi i votuesve të deputetëve përjashtohet si kategori për shkak të mungesës së votimit preferencial në sisteme të tilla. Në mënyrë specifike, Tabela 5-1 përmbledh rolet përfaqësuese të deputetëve në sistemin proporcional me lista të hapura ndërsa Tabela 5-2 përmbledh ato në sistemin proporcional me lista të mbyllura.

Tabela 5-1 Përfaqësimi në SP me lista të hapura

	Renditur i pari	Renditur i dyti	Renditur i treti	Renditur i katërti	Renditur i pesti
	%	%	%	%	%
Përfaqësimi i votuesve të vet	12.5	40.0	32.5	12.5	2.5
Përfaqësimi i votuesve të partisë	7.5	32.5	37.5	15.0	7.5
Përfaqësimi i të gjithë popullit	67.5	12.5	7.5	10.0	2.5
Përfaqësimi i partisë	5.0	15.0	7.5	40.0	32.5
Përfaqësimi i grupeve specifike	7.5	0.0	15.0	22.5	55.0
Gjithsej	100	100	100	100	100
N = 40					

Tabela 5-2 Përfaqësimi në SP me lista të mbyllura

	Renditur i pari	Renditur i dyti	Renditur i treti	Renditur i katërti
	%	%	%	%
Përfaqësimi i votuesve të partisë	10.5	47.4	42.1	0.0
Përfaqësimi i të gjithë popullit	73.7	5.3	15.8	0.0
Përfaqësimi i partisë	15.8	36.8	26.3	26.3
Përfaqësimi i grupeve specifike	0.0	10.5	15.8	73.7
Gjithsej	100	100	100	100
N = 19				

Ajo që sugjerojnë dy tabelat, e cila është në përputhje me pritshmërinë tonë, është se deputetët e zgjedhur në një zonë mbarëkombëtare nuk kanë një zonë të caktuar zgjedhore. Kështu, si në SP me listë të hapur ashtu edhe në SP me listë të mbyllur, deputetët e kishin të vështirë ta identifikonin veten me zona të veçanta zgjedhore përveç të gjithë kombit apo popullit. Ky konstatim është i ngjashëm me atë që gjejnë Dudzińska et al në rastin e Francës, Izraelit, Italisë, Polonisë dhe Portugalisë, ku deputetët theksuan një rëndësi më të madhe për përfaqësimin e të gjithë popullit në vendet e tyre (2014, fq. 25). Megjithatë, në vende të tjera, si në Austri, Gjermani, Irlandë, Spanjë dhe Mbretërinë e Bashkuar, deputetët i kushtuan më shumë rëndësi përfaqësimit të zonave të tyre zgjedhore, ose siç është rasti me Belgjikën, Holandën dhe Norvegjinë,

deputetët i kushtuan rëndësi më të madhe përfaqësimit të partisë (po aty). Përfaqësimi i gjithë popullit, megjithatë, nuk do të thotë se deputetët mbajnë lidhje me të gjithë. Në fakt, deputetët priren t'i fokusojnë aktivitetet e tyre në fusha të veçanta. Për shembull, kur deputetëve iu kërkua të jepnin shembuj si i ruajnë lidhjet me 'të gjithë popullin', shumica prej tyre përmendën shembuj nga zonat e tyre gjeografike. Ndoshta citimi i një deputeti të LDK-së shpjegon pse është kështu (Intervistë me deputet kosovar, 9 prill 2013):

"Në parim, ne përfaqësojmë të gjithë popullin sepse marrim vota në mbarë Kosovën, por është e vështirë të përfaqësosh interesat e gjithë këtyre njerëzve. Pra, çfarë të bëjmë? Normalisht, deputetët e fokusojnë aktivitetet e tyre në zonat nga vijnë. Për shembull, deputetët e LDK-së që vijnë nga Gjilani, Peja, Prizreni etj., janë më të afërt me qytetarët e atyre zonave sepse aty është baza e tyre zgjedhore, përkundër faktit se kanë mundur të kenë, dhe ndoshta kanë fituar vota edhe në Prishtinë. Fakti që ka deputetë nga rajone të ndryshme dhe nga komuna të ndryshme do të thotë që deputetët janë më të afërt me votues nga disa prej këtyre zonave sesa të tjerët".

Shumë prej tyre shprehën pakënaqësinë e tyre për këtë mënyrë të përfaqësimit, pasi në fakt u mungon 'një zonë zgjedhore' në kuptimin e zonës së përcaktuar gjeografikisht, të cilën ata mund ta gjejnë lehtësisht dhe t'i kushtojnë vëmendje. I njëjti deputet ka theksuar (Intervistë me deputet kosovar, 9 prill 2013):

"Duhet të jem i sinqertë, Kosova ka një zonë mbarëkombëtare, është e vërtetë që ne nuk jemi as shtet i madh, as komb i madh, por duke qenë deputet i të gjithëve rrezikon të jesh kudo dhe askund në të njëjtën kohë. Nëse në vend të kësaj, një deputet do të zgjedhej në një zonë më të vogël, ai do të fokusohet vetëm në atë zonë dhe sigurisht kontributi i tij do të ishte më i madh".

Kur shikohet shpërndarja e votave preferenciale, kjo ndoshta do të na ndihmonte të kuptojmë nëse deputetët priren t'i fokusojnë veprimet e tyre në ato rajone ku kanë marrë numrin më të madh të votave, por këto të dhëna nuk janë të disponueshme për Kosovën. Përpyekjet për të tërhequr të dhënat e vitit 2007 nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ose Organizata për Siguri

dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), e cila më parë ishte përgjegjëse për menaxhimin e zgjedhjeve, nuk dhanë rezultat. Për më tepër, një deputet që ka shërbyer në mandatin 2004-2007, i cili kandidoi në zgjedhjet pasuese por nuk fitoi, përmendi se nuk e kishte marrë kurrë vesh se sa vota mori personalisht. Megjithatë, mund të merret një ide për këtë duke parë përgjigjet e deputetëve. Për shembull, një deputet i LDK-së ka theksuar (Intervistë me deputet kosovar, 11 gusht 2013):

“Këtu ka një problem. Problemi është se unë supozohet të jem deputet i të gjithë qytetarëve të Kosovës dhe si i tillë nuk kam asnjë zonë të caktuar, por gjithmonë mundohem të angazhohem më shumë në ato zona ku kam marrë më shumë vota”.

Megjithatë, kur bëhet fjalë për fokusin parësor brenda parlamentit, deputetët kosovarë nuk dukeshin aq të interesuar në ofrimin e shërbimeve për zgjedhësit e tyre saç ishin për të kryer punë parlamentare. Në një farë mënyre, deputetët kosovarë janë të ngjashëm me deputetët gjermanë, të cilët e mendojnë veten kryesisht si ligjvënës (Saalfeld 2002, fq. 62). Siç tregon Tabela 5-3, kur u pyetën *‘Cili mendoni se është roli juaj parësor si parlamentar? A mendoni se roli juaj parësor është të përfaqësoni votuesit, të përfaqësoni partinë, të nxirrni ligje, të kërkonit llogaridhënie nga qeveria, apo të kryeni ndonjë detyrë tjetër?’* shumica e deputetëve nën SP me listë të hapur pohuan se roli i tyre parësor ishte të kryenin punë parlamentare si ligjvënës dhe mbikëqyrja e punës së qeverisë, ndërsa një numër pak më i vogël pohoi se ata ishin kryesisht të interesuar të përfaqësonin votuesit. Ndryshe, në kuadër të SP me listë të mbyllur, shumica e deputetëve thanë se ishin kryesisht të interesuar të përfaqësonin votuesit, ndërsa një numër pak më i vogël përmendi punën parlamentare. Edhe pse përfaqësimi i votuesve nuk kërkon, siç do të tregohet më vonë, më shumë aktivitete me votuesit, ndoshta kjo mund të lidhet me argumentin tonë të mëparshëm se deputetët ishin më të ndjeshëm ndaj çështjeve të zgjedhësve përpara se të shpallej pavarësia. Për më tepër, edhe pse përqindja e deputetëve që deklaruan se ishin kryesisht të interesuar për të përfaqësuar votuesit është pak më e lartë në SP me listë të hapur, diferenca mes dy proporcioneve nuk është statistikisht domethënëse (p -vlera=0.4). Dallimi në proporcione nuk është domethënës as për deputetët që kanë deklaruar se roli i tyre parësor ishte kryerja e punëve parlamentare (p -vlera=0.2), por është domethënëse për deputetët që deklaruan se roli i tyre parësor ishte të përfaqësojnë partinë (p -vlera=0.03), me një numër më të madh nën SP me listë të mbyllur që e thanë këtë.

Tabela 5-3 Rolet parësore të deputetëve

Sistemi zgjedhor	Deputetë	Përfaqësimi i votuesve	Përfaqësimi i partisë	Kryerja e punëve parlamentare	N
SP me listë të hapur	Nr.	18	2	20	40
	%	45.0	5.0	50.0	100
SP me listë të mbyllur	Nr.	8	4	7	19
	%	42.1	21.1	36.8	100

Se deputetët kosovarë janë më shumë të orientuar nga parlamenti se sa nga zonat zgjedhore shpjegohet gjithashtu në Tabelën 5-4. Në përgjithësi, deputetët në SP me lista të hapura raportuan se shpenzojnë më shumë kohë duke punuar si deputetë sesa ata në SP me listë të mbyllur, me dallimin mesor që është statistikiisht domethënës (p -vlera=0.05). Si në SP me listë të hapur ashtu edhe në SP me listë të mbyllur, shumica e deputetëve thanë se shpenzojnë më shumë kohë duke bërë punë parlamentare, që përfshinë seancat, punën e komisioneve dhe mbikëqyrjen e qeverisë⁹ në vend se të bëjnë aktivitete me elektoratin. Diferenca në orët mesatare mes të mëparshmit nuk është statistikiisht domethënëse (p -vlera=0.5) por është mes të mëvonshmit (p -vlera=0.01). Përveç punës së tyre si ligjvënës, deputetët u pyetën edhe se sa kohë kalojnë në zonën e tyre në muaj. Siç tregohet në kolonën e fundit të tabelës, deputetët në SP me listë të hapur thanë se shpenzonin mesatarisht rreth 12.7 orë më shumë në zonën e tyre lokale në muaj sesa ata në SP me listë të mbyllur. Dallimi mesatar mes të dyve, megjithatë nuk është statistikiisht domethënës (p -vlera=0.2).

⁹ Shënim: Deputetët patën vështirësi të diferenconin kohën që shpenzonin për secilin aktivitet apo çdo aktivitet tjetër parlamentar, shih për krahasimin De Winter 1997b, fq. 130-1.

Tabela 5-4 Zbërthimi i punës së deputetëve

Sistemi zgjedhor	Numri i orëve të punës si deputet në javë	% e shpenzuar duke kryer aktivitete me elektoratin në javë	% e shpenzuar duke kryer punë partie në javë	% e shpenzuar duke bërë punë legislative në javë	Numri i orëve të shpenzuara në zonën lokale	N
Lista të hapura	35.8	25.6	18.5	55.9	42.3	19
Lista të mbyllura	27.7	20.1	18.8	61.1	29.6	40
Të hapura dhe të mbyllura	33.3	24.0	18.5	57.5	38.9	59

Për të zbuluar si i ruajnë ata lidhjet me zgjedhësit, deputetëve iu kërkua të tregonin se sa shpesh kryejnë secilin nga nëntë aktivitetet e mëposhtme (pyetja e bërë në projektin PartiRep):

1. pjesëmarrje ose dërgim i letrave me rastin e dasmave, përvjetorëve të dasmave dhe rasteve të vdekjes në zonën lokale,
2. takime me grupe të vogla të zgjedhësve në shtëpitë e tyre private për të folur për dëshirat dhe nevojat e tyre,
3. mbajtja e ligjëratave dhe debateve,
4. dërgimi i një buletini personal dhe postimet e drejtpërdrejta për ta,
5. mbajtja e zyrës së deputetit,¹⁰
6. publikimi i shërbimeve të punës në zonën e tyre zgjedhore, p.sh. në gazeta ose duke vizituar lagje,
7. publiciteti për suksesin e tyre në tërheqjen e bizneseve dhe marrjen e granteve qeveritare për zonën e tyre lokale,
8. takimi me bizneset lokale dhe grupet e interesit, dhe
9. dalja në mediat lokale.

Siç ilustron Tabela 5-5, një përqindje më e madhe e deputetëve të zgjedhur në SP me lista të hapura, krahasuar me ata të zgjedhur në SP me listë të mbyllur, thanë se bënë të paktën një nga aktivitetet të paktën një herë në javë. Dallimi në proporcione ndërmjet të dyve është statistikisht domethënës (p -vlera=0.03). Për krahasim, në mesin e vendeve të Evropës Perëndimore sondazhi i PartiRep zbuloi se kishte variacion mes vendeve. Për shembull, në

¹⁰ Deputetët u pyetën nëse kanë një zyrë deputeti të cilën do ta vizitonin të paktën një herë në javë dhe ku qytetarët mund të futen lirisht duke e ditur se do të ishin atje.

Irlandë mbi 90 për qind e deputetëve bën të paktën një nga këto aktivitete çdo dy javë, në Holandë mbi 20 për qind e deputetëve e bën këtë, ndërsa në Norvegji rreth 25 për qind (Andre et al 2014b, fq. 174). Studimi gjithashtu konstaton se në Irlandë dhe Izrael është shumë e zakonshme që ligjvënësit të marrin pjesë shpesh në dasma, përvjetorë dasmash dhe funerale, ngjashëm me modelin që gjejmë në Kosovë. Në fakt, vlen të theksohet se ka pasur pajtim të gjerë në mesin e deputetëve kosovarë se nderimi i të ndjerit (duke shkuar për të pame) është një mënyrë e mirë për të mbajtur kontakte me njerëzit. Një deputet i LDK-së ka theksuar:

“Në rastin tonë është tradicionale që ne i bëjmë nder të ndjerit duke shkuar në të pame – nuk mendoj se kjo praktikohet diku tjetër. Për shembull, më ka ndodhur që në një ditë të vetme jam takuar personalisht me 200-300 njerëz në vende të ndryshme. Së pari, njerëzit ndihen të respektuar kur ne e bëjmë këtë dhe së dyti, si përfaqësues kemi ndjenjën e detyrimit për të qenë pranë popullit në momente të tilla të vështira”.

Po ashtu, i njëjti deputet ka thënë se ka pasur raste kur deputeti së bashku me kolegët e partisë kanë shkuar për të nderuar dikë që e kanë njohur, por një herë në fshat kanë mësuar se dikush tjetër kishte vdekur, dhe ka bërë të njëjtën gjë me familjen e tij/saj.

Tabela 5-5 Numri dhe përqindja e deputetëve që pohuan se kryejnë të paktën një nga aktivitetet në intervale të caktuara

Sistemi zgjedhor	Deputetë	Të paktën një herë në javë	Të paktën dy herë në javë	Të paktën një herë në muaj	Mund ta bëja	Nuk do ta bëja kurrë	N
Lista të hapura	Nr.	37	3	0	0	0	40
	%	92.5	7.5	0.0	0.0	0.0	100
Lista të mbyllura	Nr.	14	3	1	1	0	19
	%	73.7	15.7	5.3	5.3	0.0	100

Dallimet ndërmjet deputetëve në të dy sistemet janë më të dukshme kur deputetëve iu kërkua të thonë se sa shpesh kryejnë të paktën dy nga aktivitetet, dhe hendeuku zgjerohet me rritjen e numrit të aktiviteteve. Megjithëse shifrat

nuk tregohen këtu, 80 për qind e deputetëve në SP me listë të hapur thanë se bëjnë të paktën dy nga aktivitetet të paktën një herë në javë, ndërsa vetëm 58 për qind e deputetëve në SP me listë të mbyllur thanë të njëjtën gjë. Dallimi në proporcione ndërmjet të dyve është gjithashtu statistikisht domethënës (p -vlera=0.03). Deputetëve iu drejtua një pyetje tjetër nga projekti PartiRep si më poshtë: *Në rolin tuaj si deputet, sa shpesh keni pasur kontakte gjatë vitit të fundit me grupet, personat ose organizatat e mëposhtme:*

1. organizatat rinore,
2. organizatat për të moshuarit,
3. organizatat e punëtorëve dhe sindikatat,
4. organizatat e punëdhënësve,
5. organizatat e grave,
6. organizatat e fermerëve,
7. organizatat e pakicave etnike,
8. xhami/kisha apo organizata fetare,
9. organizatat mjedisore, dhe
10. gazetarë.

Qëllimi i shtrimit të kësaj pyetjeje deputetëve ishte që të kuptohej shpeshësia e kontakteve të deputetëve me grupe të ndryshme dhe llojin e grupeve ku deputetët priren të fokusohen; pra, nëse ata priren të fokusohen më shumë në grupe specifike, ose nëse partitë aplikojnë një strategji të kapjes së përgjithshme duke u fokusuar në disa grupe (Caramani et al 2014, fq. 44). Siç tregon Tabela 5-6, një përqindje më e madhe e deputetëve në SP me listë të hapur thanë se takohen me të paktën një grup/organizatë të paktën një herë në javë, krahasuar me ata në SP me listë të mbyllur. Dallimi në proporcione mes të dyve është statistikisht domethënës (p -vlera=0.03) duke sugjeruar që ata që ishin në SP me listë të hapur takoheshin më shpesh me këto organizata. Megjithatë, ky dallim nuk është më i dukshëm kur deputetët pyeten se sa shpesh takohen me të paktën dy grupe/organizata. Në fakt, 45 për qind e deputetëve në SP me listë të hapur thanë se e bëjnë këtë të paktën një herë në javë, ndërsa këtë e thanë 47 për qind në SP me listë të mbyllur. Megjithatë, ndryshimi mes dy proporcioneve nuk është domethënës (p -vlera=0.4).

Tabela 5-6 Numri dhe përqindja e deputetëve që pohuan se takohen me të paktën një organizatë

Sistemi zgjedhor	Deputetë	Të paktën një herë në javë	Të paktën një herë në muaj	Të paktën një herë në tre muaj	Të paktën një herë në vit	Asnjë kontakt	N
SP me lista të hapura	Nr.	37	3	0	0	0	40
	%	92.5	7.5	0.0	0.0	0.0	100
SP me lista të mbyllura	Nr.	16	3	0	0	0	19
	%	84.2	15.8	0.0	0.0	0.0	100

Për më tepër, Tabela 5-7 tregon llojin e grupeve që deputetët pohuan se takohen më shpesh; p.sh. një herë në javë ose një herë në muaj. Siç mund të shihet, si në SP me listë të mbyllur ashtu edhe në SP me listë të hapur, përqindja më e madhe e deputetëve prirën të takohen më shpesh me gazetarë, organizata rinore dhe sportive. Ata që pohuan se takohen me organizatat e të moshuarve, mjedisit, pakicave etnike dhe fermerëve, janë të paktë. Ndoshta, një nga arsytet pse deputetët prirën të fokusohen në organizatat rinore është sepse Kosova ka një popullatë të re, dhe në çdo palë zgjedhje të reja mesatarisht 30,000 të rinj fitojnë të drejtën e votës. Në mënyrë të ngjashme, duke mbajtur kontakte me gazetarët, deputetët mund të kenë më shumë publicitet.

Tabela 5-7 Kontaktet e deputetëve me organizata të ndryshme

	SP me listë të hapur	SP me listë të mbyllur
Organizatat rinore	60.0	63.2
Organizatat e të moshuarve	20.2	36.8
Organizatat e punëtorëve	35.0	36.8
Organizatat e punëdhënësve	27.5	26.3
Organizatat e grave	32.7	47.3
Organizatat e fermerëve	22.5	26.3
Organizatat e pakicave etnike	22.5	15.8
Organizatat fetare	27.5	31.5
Organizatat mjedisore	20.0	20.1
Organizatat sportive	45.0	36.8
Gazetarë	92.5	84.2

Shënim: Përqindjet e deputetëve që pohuan se kanë pasur kontakt të paktën një herë në javë ose një herë në muaj.

Në një farë mase, këto gjetje janë të ngjashme me ato që gjen Projekti PartiRep në vendet e Evropës Perëndimore. Deputetët atje priren të fokusohen kryesisht në përfaqësimin e grupeve të reja. Mbi 44 për qind e deputetëve në 15 vende thanë se kishin kontakte të paktën një herë në javë ose një herë në muaj me organizatat rinore. Katërdhjetë për qind të tjerë thanë se kishin kontakte po aq të shpeshta me organizatat e të moshuarve dhe të punëtorëve, rreth 29 për qind thanë se e kishin bërë këtë me organizatat e punëdhënësve, 26 për qind me organizatat e grave dhe fermerëve, rreth 15 për qind me organizatat e pakicave etnike, dhe 19 për qind me organizatat fetare (Caramani et al 2014, fq. 52). Matja e lidhjeve deputet-zona zgjedhore përfshinte shikimin e numrit të kërkesave që morën deputetët në të dy sistemet. Deputetëve iu drejtua pyetja 'Sa kërkesa për ndihmë (letra, e-mail, telefonata, vizita) në marrëdhëniet me autoritetet publike merrni mesatarisht në një javë? Dhe sa pyetje nga qytetarë individualë që lidhen kryesisht me çështjet e politikave merrni në javë?'. Siç raportohet në Tabelën 5-8, ata që ishin zgjedhur në sistemin SP me listë të hapur morën mesatarisht një numër më të madh kërkesash në javë, si nga ato që kishin të bënin me autoritetet publike, ashtu edhe ato që lidheshin me çështjet e politikave, krahasuar me deputetët në SP me listë të mbyllur. Krahasimi i mesoreve mes të dyve tregon se ndryshimi është statistikisht domethënës (p -vlera=0.02).

Tabela 5-8 Numri i kërkesave për ndihmë që deputetët raportuan se marrin mesatarisht në javë

Sistemi zgjedhor	Kërkesat që ishin të bënin me autoritetet publike	Kërkesat që kishin të bënin me çështjet e politikave	Kërkesa totale	N
SP me lista të hapura	11.0	2.7	13.8	40
SP me lista të mbyllura	5.1	2.8	7.9	19

Më pas, deputetëve iu kërkua të specifikonin sa orë pune shpenzuan për kërkesat që kërkonin ndihmë në marrëdhëniet me autoritetet publike. Siç tregon Tabela 5-9, deputetët në SP me listë të hapur shpenzuan më shumë kohë duke u marrë me ato lloj kërkesash sesa ata në SP me listë të mbyllur. Kur bëhet fjalë për llojin e kërkesave që deputetët raportuan se marrin, ata përmendën më së shumti kërkesa të llojit financiar, si gjetja e një vendi pune, trajtimi mjekësor jashtë vendit për një pjesëtar të familjes ose regjistrimi në

Universitet; këto kërkesa deputetët ia atribuojnë nivelit të ulët të zhvillimit social dhe ekonomik në Kosovë. Megjithatë, dallimi në mesore ndërmjet dy llojeve të sistemeve zgjedhore nuk rezulton statistikisht domethënës (p-vlera=0.1). Kjo mbase shpjegon pse, kur iu bë pyetja ‘Si ndiheni kur votuesit ju kontaktojnë?’, shumica e deputetëve deklaruan se ndihen mirë kur mund të bëjnë diçka për këto kërkesa, por ndihen shumë keq kur marrin kërkesa për të cilat nuk mund të bëjnë gjë. Ata të gjithë thanë se janë shumë të hapur që votuesit t’i kontaktojnë përmes telefonit, emailit, Facebook-ut, ose të takohen drejtpërdrejt me ta në parlament ose në zyrat e partive të tyre. Në fakt, përveç vizitave të drejtpërdrejta, deputetët thanë se përdorin kryesisht telefonin dhe internetin kur komunikojnë me votuesit. Për shembull, shumica e tyre deklaruan se përdorin Facebook-un për të mbajtur rregullisht kontakte me votuesit, ndërsa një numër prej tyre pranuan se marrin edhe mesazhe dhe telefonata të shpeshta. Disa deputetë përmendën edhe rastet kur votuesit u shkojnë në shtëpitë e tyre, gjë që ata e konsideruan normale.

Tabela 5-9 Orët mesatare që deputetët raportuan se shpenzojnë në javë për kërkesat që kanë të bëjnë me autoritetet publike

Sistemi zgjedhor	Orë mesatare në javë	N
SP me lista të hapura	4.9	40
SP me lista të mbyllura	3.4	19

Teksa shumica e deputetëve pranuan se udhëheqësi i partisë kërkon që ata të mbajnë kontakte të ngushta me votuesit, deputetët pranuan gjithashtu se ka përfitime zgjedhore nga ndihma për njerëzit dhe kërkesat e tyre. Për shembull, në pyetjen ‘Çfarë mendoni se do të ndodhte nëse do të reduktonit përpjekjet që bëni për t’i ndihmuar votuesit në marrëdhëniet e tyre me autoritetet publike?’, siç shihet në Tabelën 5-10, shumica e deputetëve në të dy sistemet ose u pajtuan ose u pajtuan fuqimisht që, ndër të tjera, do të humbisin një numër të konsiderueshëm votash si rezultat.

Tabela 5-10 Përgjigjet e deputetëve se çfarë do të ndodhte nëse do të reduktonin përpjekjet e tyre për t'iu përgjigjur kërkesave të elektoratit

	Nuk pajtohem aspak	Nuk pajtohem	Asnjëra	Pajtohem	Pajtohem plotësisht	Gjithsej
Do të humbisja një numër të konsiderueshëm votash	1 / 2.5%	5 / 12.5%	0 / 0%	16 / 40%	18 / 45%	40 / 100%
	1 / 5.3%	1 / 5.3%	1 / 5.3%	9 / 47.3%	7 / 36.8%	19 / 100%
Si rezultat, mund të përballim me një sfidë serioze në përzgjedhjen e kandidatëve	3 / 7.5%	13 / 32.5%	5 / 12.5%	11 / 27.5%	8 / 20%	40 / 100%
	0 / 0%	7 / 36.8%	1 / 5.3%	7 / 36.8%	4 / 21.10%	19 / 100%
Si rezultat, do të humbisja kontaktin me problemet me të cilat votuesit përballen në jetën e tyre të përditshme	1 / 2.5%	3 / 7.5%	1 / 2.5%	16 / 40%	16 / 40%	40 / 100%
	0 / 0%	1 / 5.3%	0 / 0%	10 / 52.6%	10 / 52.6%	19 / 100%

Rreshti i parë SP me listë të hapur, rreshti i dytë SP me listë të mbyllur.

Deri më tani, kemi dhënë dëshmi për disa aspekte të lidhjeve me zgjedhësit, por për të testuar efektet e sistemit zgjedhor, partisë dhe gjinisë në lidhjet me zonat zgjedhore (orët e punës në aktivitete me elektoratin në javë, numri i kërkesave në javë që kanë të bëjnë me autoritetet publike, orët e shpenzuara duke u marrë me këto kërkesa në javë, dhe numri i orëve të shpenzuara në zonën lokale në muaj), unë kryej analiza të regresionit binomial negativ për secilin nga ndryshorët e varur veç e veç. Arsyeja e përdorimit të regresioneve binomiale negative është për shkak të natyrës së të dhënave; d.m.th. këtu kemi të bëjmë me të dhëna shifrore, ose me numrin e orëve që deputetët ua kushtojnë aktiviteteve të ndryshme. Për më tepër, krahasuar me regresionin Poisson, regresionet binomiale negative janë më të përshtatshme për të dhëna të mbi-shpërndara, gjë që sigurisht është rasti ynë.¹¹ Së fundi, një test i mbi-shpërndarjes konfirmon se mesorja dhe varianca nuk janë të njëjta (p-vlera=0.001, p-vlera=0.01, p-vlera=0.006 dhe p-vlera= 0.0001 respektivisht për të katër ndryshorët e varur). Tabela 5-11 ofron statistika përmbledhëse për të gjithë ndryshorët e përdorur.

¹¹Krahasimi mesore-variancë i NV-ve: mesorja (orë zgjedhore në javë) = 8.01, var (orë zgjedhore në javë)=29.6, mesore (numri i kërkesave në javë)=9.9, var (numri i kërkesave në javë)=114.1, mesorja (orë të shpenzuara për kërkesat në javë)=4.5, var (orë të shpenzuara për kërkesat në javë)=13.9, mesore (orë mujore zona lokale)=38.9, var (orë mujore zona lokale)=1211.6.

Tabela 5-11 Statistika përshkruese

	Min	Mediane	Mesore	Maks	Devijimi standard
Orët e punës së deputetëve	13.50	37.50	35.81	60.00	10.54
Orët e punës me elektoratin	0.00	8.45	9.17	24.00	5.55
Orë pune për partinë	0.00	5.75	6.66	18.00	4.19
Orë pune parlamentare	5.00	19.20	20.03	40.00	8.60
Numri i kërkesave që kanë të bëjnë me autoritetet publike në javë	0.00	10.00	12.15	50.00	11.97
Kërkesa totale në javë	1.00	12.00	14.90	55.00	12.23
Orët e shpenzuara për kërkesat që kanë të bëjnë me autoritetet publike në javë	0.00	3.00	4.96	20.00	4.04
Numri i orëve në muaj të shpenzuara në zonën lokale	2.00	36.00	42.27	200.00	37.03

Rezultatet e paraqitura në Tabelën 5-12 tregojnë se sistemi zgjedhor është statistikisht domethënës në tre raste. Duke interpretuar koeficientët e regresionit të eksponencuar, së pari, deputetët në SP me listë të hapur priren të shpenzojnë rreth 3.2 orë më shumë për punë në njësitë zgjedhore jashtë orarit të tyre parlamentar në krahasim me ata në SP me listë të mbyllur. Ndryshori është domethënës në nivelin 0.05. Së dyti, deputetët në SP me listë të hapur marrin gjithashtu rreth 7.3 kërkesa më shumë që kanë të bëjnë me autoritetet publike në javë në krahasim me deputetët në SP me listë të mbyllur, dhe ndryshori është gjithashtu domethënës në të njëjtin nivel. Së treti, deputetët në SP me listë të hapur shpenzojnë rreth 1.7 orë më shumë në javë për kërkesat që kanë të bëjnë me autoritetet publike sesa deputetët në SP me listë të mbyllur. Ky ndryshor është domethënës në nivelin 0.1. Megjithatë, ndryshori i sistemit zgjedhor nuk rezulton të jetë domethënës kur ndryshori i varur është numri i orëve të shpenzuara në zonën lokale në muaj, megjithëse mesatarisht deputetët në sistemin SP me lista të hapura shpenzojnë rreth 6.3 orë më shumë se ata në SP me listë të mbyllur. Sa i përket ndryshorëve të tjera të pavarur, deputetët e PDK-së kanë tendencë të shpenzojnë rreth 3.1 orë më shumë në javë për kërkesat që kanë të bëjnë me autoritetet publike sesa ata të AAK-së. Ndryshori është domethënës në nivelin 0.05. Megjithatë, deputetët e PDK-së priren të shpenzojnë rreth 26 orë më pak se ata të AAK-së në zonën e tyre lokale në muaj. Ky ndryshor është domethënës në nivelin 0.05. As ndryshorët gjinorë dhe partiakë nuk janë domethënës në analiza.

Tabela 5-12 Regresioni binomial negativ për secilin ndryshor të varur: (1) Numri i orëve të shpenzuara duke bërë aktivitete me elektoratin në javë (2) Numri i kërkesave të pranuar në javë, (3) Orët e shpenzuara për ato kërkesa në javë, dhe (4) Numri i orëve të shpenzuara në zonën lokale në muaj.

	(1)	(2)	(3)	(4)
(konstantja)	1.91***	1.50***	1.02**	3.98***
	(0.28)	(0.39)	(0.32)	(0.33)
SP me lista të hapura	0.46*	0.91***	0.39.	0.19
	(0.20)	(0.26)	(0.22)	(0.22)
LDK	-0.37	0.14	0.44	-0.17
	(0.26)	(0.35)	(0.29)	(0.30)
PDK	-0.03	0.26	0.66*	-0.65*
	(0.25)	(0.35)	(0.29)	(0.30)
Meshkuj	0.00	-0.10	-3.64	-0.25
	(0.21)	(0.28)	(0.23)	(0.24)
Log-likelihood	-348.18	-475.66	-287.39	-538.07
N	59	59	59	59

Nivelet e domethënies: *p-vlera 0.1, **p-vlera 0.05, ***p-vlera 0.01, ****p-vlera 0.001.

Për më tepër, në kapitullin 2 u sugjerua që sa më i madh të jetë numri i votave preferenciale, aq më i madh do të jetë numri i lidhjeve me zgjedhësit që do të krijojnë deputetët. Po kështu, sa më e madhe të jetë sasia e lidhjeve me zonat zgjedhore që kanë deputetët, aq më e madhe do të jetë sasia e votave preferenciale që ata do të mbledhin. Grupi i parë i marrëdhënieve mund të testohet vetëm duke përdorur të dhëna nga 16 deputetë që shërbyen si në SP me lista të hapura ashtu edhe në SP me listë të mbyllur, përndryshe një krahasim nuk është i mundur për ata që janë zgjedhur vetëm në një sistem zgjedhor. Prandaj, për t'i bërë të dyja marrëdhëniet të krahasueshme, të dy mostrat vendosen në 16. Tabela 5-13 në vijim raporton koeficientët e korrelacionit. Siç mund të shohim nga tabela, votat preferenciale nuk janë një parashikues i mirë i sasisë së lidhjeve me elektoratin, dhe lidhjet me elektoratin nuk janë një parashikues i mirë për votat preferenciale, ndoshta me përjashtim të numrit të orëve të shpenzuara duke bërë aktivitete me elektoratin në javë dhe numrit të votave që deputetët morën për pasojë.

Tabela 5-13 Korrelacioni i votave preferenciale dhe mbështetjes zgjedhore për deputetët me ndryshorët e varur. (1) Numri i orëve të shpenzuara duke bërë punë me elektoratin në javë, (2) Numri i kërkesave të pranuar në javë, (3) Orët e shpenzuara për ato kërkesa në javë, dhe (4) Numri i orëve të shpenzuara në zonën lokale në muaj.

	(1)	(2)	(3)	(4)	N
A solli më shumë vota preferenciale puna më e madhe me elektoratin?	-0.10	0.56	-0.06	0.19	16
A krijuan më shumë lidhje me elektoratin ata që morrën më shumë vota preferenciale?	-0.23	0.13	-0.02	0.01	16

5.5 Diskutim

Qëllimi i këtij studimi ka qenë të hulumtojë natyrën e lidhjeve që deputetët kosovarë zhvillojnë me zgjedhësit e tyre duke krahasuar sjelljen e deputetëve si në SP me lista të hapura ashtu edhe në ato të mbyllura, duke ditur se niveli i institucionalizimit të sistemit partiak është i ulët në krahasim me atë të demokracive të konsoliduara evropiane. Pesëdhjetë e nëntë intervistat që u kryen me deputetë që shërbenin në të dy sistemet zbuluan natyrën e dobët të institucionalizimit të sistemit partiak, si mungesa e dukshme e burimeve partiake dhe manipulimi i votave që jo vetëm e vështirëson vlerësimin e marrëdhënieve votues-deputet, por gjithashtu ngre dyshime për stimujt e deputetëve për të tërhequr vota personale, duke e ditur se disa deputetë të tjerë mund t’ua vjedhin ato vota në bashkëpunim me një komisioner zgjedhor.

Në përgjithësi, gjetjet treguan se deputetët në SP me listë të hapur zhvilluan lidhje më të forta me zgjedhësit e tyre sesa deputetët në SP me listë të mbyllur, siç pritej me Hipotezën tonë 8. Domethënë, ish deputetët shpenzonin mesatarisht më shumë orë në javë jashtë orarit të tyre parlamentar, duke u marrë me elektoratin, takoheshin më shpesh me grupe të ndryshme, merrnin më shumë kërkesa në javë, kalonin më shumë orë duke u marrë me to, si dhe mesatarisht shpenzonin më shumë orë në muaj në zonën e tyre lokale. Në mesin e ndryshorëve të tjerë të pavarur, ndryshori i partisë ishte gjithashtu domethënës në mesin e deputetëve të PDK-së që shpenzonin më shumë orë për kërkesat që kishin të bënin me autoritetet publike në javë, por më pak orë në muaj krahasuar me deputetët e AAK-së në zonën e tyre lokale.

Për më tepër, siç pritej, deputetët në mungesë të zonave lokale zgjedhore, duke pasur zonë mbarëkombëtare, kishin një fokus më të madh te përfaqësimi. Shumica e deputetëve në të dy sistemet zgjedhore pretenduan se përfaqësonin të gjithë popullin. Megjithatë, kur bëhet fjalë për mbajtjen e lidhjeve me zgjedhësit, gjithashtu siç pritej, deputetët përgjithësisht i përqendruan aktivitetet e tyre rreth zonave të tyre gjeografike (H.12). Megjithëse deputetët ishin të vetëdijshëm se mbështetja e tyre me vota ishte e shpërndarë, ata pranuan se mbajtja e lidhjeve me të gjithë ishte praktikisht e pamundur. Për sa i përket roleve përfaqësuese të deputetëve në parlament, edhe pse ne prisnim që të zgjedhurit me SP me lista të hapura do ta shohin veten si përfaqësues të elektoratit në krahasim me ata të zgjedhur në SP me listë të mbyllur, gjetjet nuk ishin në përputhje me pritshmëritë (H.10). Së fundi, gjetjet sugjerojnë se deputetët në Kosovë priren të përqendrohen më shumë në kryerjen e punës parlamentare sesa në përfaqësimin e interesave të elektoratit, pasi ata e kalojnë shumicën e kohës së tyre parlamentare duke bërë të parën. Por, deputetët konsideruan se kur kalonin kohë duke u marrë me punë legislative, kujdesen që legjislacioni t'i merrte parasysh interesat e zgjedhësve.

Natyra e përzgjedhjes së kandidatëve gjithashtu u hulumtua në një masë të caktuar. Këto metoda janë të centralizuara ndërmjet partive, pasi organet qendrore të partisë i përzgjedhin kandidatët për zgjedhje. Për më tepër, nuk u vunë re dallime në metodat e përzgjedhjes së kandidatëve gjatë mandateve, duke e bërë kështu të pamundur për ne testimin e Hipotezës 9. Teksa shumica e deputetëve në listë e hapur menduan se rizgjedhjen e tyre ua detyronin votuesve, dhe ata në listën e mbyllur e konsideruan këtë për shkak të partisë, ne sugjeruam arsyen pse disa deputetë në sistemin SP me lista të hapura konsideruan se për rizgjedhjen e tyre i detyroheshin si partisë ashtu edhe votuesve, dhe kjo ishte për shkak të metodave të centralizuara të përzgjedhjes së kandidatëve. Prandaj, edhe pse votuesit mund të japin votat preferenciale për kandidatët e tyre të preferuar, partia vendos se kush kandidon për zgjedhje dhe ku vendosen kandidatët në listë.

Për ta përmbledhur, sistemi zgjedhor shpjegon në masë të madhe sjelljen e deputetëve në Kosovë. Intervistat tona me deputetë në të gjitha mandatet, treguan se ata që ishin në SP me listë të hapur në përgjithësi zhvilluan më shumë lidhje me elektoratin sesa ata në SP me listë të mbyllur. Duke pranuar të gjitha vështirësitë, dhe duke pasur parasysh se studimet mbi sjelljen e deputetëve në këtë aspekt mund të studiohen vetëm përmes intervistave në këtë pjesë të botës, studimi ka treguar se shqyrtimi i ndikimit të sistemeve

zgjedhore në një sistem partiak me institucionalizim të dobët jep gjetje interesante se mund të ketë implikime jo vetëm për Kosovën, por edhe për vende të sapodemokratizuara gjetiu. Andaj, hulumtimet e ardhshme mbi sjelljen e parlamentarëve duhet t'i kushtojnë vëmendje të veçantë natyrës së institucionalizimit të sistemit partiak në këto vende. Në kapitullin vijues, merremi me sjelljen e deputetëve të Maqedonisë së Veriut dhe krahasimin mes tyre dhe homologëve të tyre kosovarë.

6

Deri në çfarë mase zhvillojnë lidhje të ngushta me zgjedhësit e tyre deputetët në sistemet zgjedhore me lista të mbyllura? Dëshmi nga Maqedonia e Veriut

6.1 Hyrje

Kapitulli i mëparshëm u thellua në natyrën e lidhjeve që krijojnë deputetët në Kosovë duke krahasuar sjelljen e tyre në SP me listë të mbyllur dhe SP me listë të hapur, kurse ky kapitull synon të shqyrtojë shkallën në të cilën deputetët e Maqedonisë së Veriut krijojnë lidhje të ngushta me zgjedhësit e tyre në sistemin proporcional me listë të mbyllur. Siç u përshkrua në kapitujt e mëparshëm, në sisteme të tilla deputetët duket se kanë pak stimuj për të krijuar lidhje të ngushta me zgjedhësit e tyre për shkak të mungesës së konkurrencës zgjedhore brenda partisë me të cilën përballen deputetët në SP me listë të hapur. Në sisteme të tilla, për shkak se deputetët zgjidhen në një listë partiake, ata duhet vetëm të sigurohen që të rizgjidhen në një pozicion të sigurt në zgjedhjet e ardhshme. Sigurisht, kemi vërejtur se metodat e decentralizuara të përzgjedhjes së kandidatëve mund të bashkëjetojnë edhe me sistemet zgjedhore të orientuara kah partia, gjë që ka implikime në sjelljen e deputetëve, sepse në rast konflikti ndërmjet kryesisë së partisë dhe organizimit lokal të partisë, deputetët do të përballen me dilemën se kë të ndjekin.

Megjithatë, kujt i përgjigjen deputetët, varet kryesisht nga perceptimet e tyre se kush e kontrollon rizgjedhjen e tyre. Në një kuptim më të gjerë, zgjedhja e Maqedonisë së Veriut për të hetuar sjelljen e deputetëve është një vazhdim logjik i qëllimit të përgjithshëm të librit, i cili është të hetojë ndikimin e sistemeve zgjedhore në demokracitë e reja. Siç tregohet më në detaje në Kapitullin 1, Maqedonia e Veriut, ngjashëm me Kosovën, ka një nivel të ISP nën mesataren e përgjithshme për 34 vendet. Megjithatë, më konkretisht, zgjedhja e Maqedonisë së Veriut për të hetuar aktivitetet e deputetëve në zonën zgjedhore është rezultat i arsyeve teorike dhe praktike. Së pari, pasi kam kryer një studim të ngjashëm për Kosovën, Maqedonia e Veriut paraqet një rast që mund të krahasohet lehtësisht me atë të Kosovës, veçmas faktit se të dy vendet kufizohen gjeografikisht me njëri-tjetrin. Për shembull, të dy vendet ishin pjesë e ish Jugosllavisë. Për më tepër, Kosova pati një luftë në vitin 1999 dhe Maqedonia e Veriut pati një konflikt etnik në vitin 2001. Po kështu, të dy vendet kanë shumicë dominuese në parlament, por edhe një numër komunitetesh pakicë. Së fundi, vendet kanë pak a shumë të njëjtin nivel zhvillimi ekonomik dhe të dyja aspirojnë të bëhen anëtarë të Bashkimit Evropian. Së dyti, edhe pse Shqipëria dhe Serbia, nga vendet e rajonit, përdorin gjithashtu SP me listë të mbyllur, hetimi i natyrës së lidhjeve në Serbi do të kishte qenë më problematik si qytetare kosovare. Nga ana tjetër, teksa qasja në Shqipëri do të ishte mjaft e lehtë dhe praktike për sa i përket gjuhës, intervistimi i deputetëve atje do të paragjykonte zgjedhjen time ndaj shqiptarëve etnikë, duke qenë se tashmë kam intervistuar kryesisht deputetë shqipfolës në Kosovë.

Shumica e hipotezave, si për sistemin zgjedhor ashtu edhe për metodat e përzgjedhjes së kandidatëve, të cilat janë testuar këtu, janë të ngjashme me ato që kemi testuar tashmë në Kosovë, por i vetmi kufizim këtu është se sistemi zgjedhor nuk ka ndryshuar kohët e fundit në Maqedoninë e Veriut. Prandaj, krahasimi i sjelljes së deputetëve në kohë nuk është i mundur. Megjithatë, pas eksplorimit të masës në të cilën deputetët në Maqedoninë e Veriut zhvillojnë lidhje të ngushta me zgjedhësit e tyre, ne do të testojmë ndikimin e sistemeve zgjedhore në prirjen e deputetëve për të krijuar lidhje të ngushta me elektoratin (H.8) duke krahasuar sjelljen e deputetëve të Maqedonisë së Veriut me atë të deputetëve kosovarë në SP me listë të hapur dhe të mbyllur; siç u raportua në kapitullin e mëparshëm. Për sa i përket roleve përfaqësuese, pasi që deputetët e Maqedonisë së Veriut zgjedhen sipas një sistemi zgjedhor me orientim kah partia, ne presim që ata kryesisht do të priren ta shohin veten si përfaqësues të partisë dhe jo të elektoratit (H.10). Për më tepër, nëse deputetët janë në konflikt mes ndjekjes së një vije partiake ose asaj të zgjedhësve të tyre, presim që ata të ndjekin të parën (H.11) për arsye të cilat

u shpjeguan në Kapitullin 2. Po kështu, duke qenë se vendi është i ndarë në gjashtë zona, supozojmë se deputetët do të priren t'i përqendrojnë aktivitetet e tyre në zonat e tyre (H.12), megjithëse fakti që ata mund të kandidojnë në zona të ndryshme në zgjedhje të ndryshme mund t'i shtyjë të kenë një fokus më të gjerë të përfaqësimit. Së fundi, sa i përket përzgjedhjes së kandidatëve, ne presim që deputetët e zgjedhur sipas metodave të centralizuara të përzgjedhjes së kandidatëve të kenë më pak stimuj për të zhvilluar lidhje të ngushta me zgjedhësit e tyre në krahasim me ata të zgjedhur sipas metodave të decentralizuara të përzgjedhjes së kandidatëve (H.9).

Ky kapitull vazhdon si më poshtë. Seksioni i parë jep një pasqyrë të natyrës së institucionalizimit të sistemit partiak në Maqedoni të Veriut, duke u fokusuar veçanërisht në jostabilitetin partiak dhe ndërrimin e partive. Seksioni i dytë ofron disa informacione bazë mbi ligjin zgjedhor dhe sistemin partiak në Maqedoninë e Veriut. Seksioni i tretë jep një pasqyrë të gjetjeve nga intervistat tona me 49 deputetë, të cilat u zhvilluan gjatë vitit 2014, duke shpjeguar si shtrirjen ashtu edhe natyrën e lidhjeve që zhvillojnë deputetët. Pjesa e fundit ofron një analizë krahasuese të sjelljes së deputetëve të Maqedonisë së Veriut dhe atyre të Kosovës, përpara se të përmbillet me një përmbledhje të shkurtër në fund të kapitullit.

6.2 Institucionalizimi i Sistemit Partiak (ISP)

Natyra e institucionalizimit të sistemit partiak në Maqedoni të Veriut është e ngjashme me atë të Kosovës, në kuptimin që partitë shfaqin një model jostabiliteti, pasi ato paraqiten dhe zhduken shpesh nga skena politike. Në zgjedhjet e parakohshme të vitit 2011 morën pjesë dy koalicione të mëdha, njëri i udhëhequr nga Organizata e Brendshme Revolucionare Maqedonase - Partia Demokratike për Unitetin Kombëtar Maqedonas (VMRO-DPMNE), dhe tjetri i udhëhequr nga Bashkimi Social-Demokratik i Maqedonisë (LSDM), plus 16 parti të tjera politike. Më konkretisht, koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE përfshinte 22 parti, ndërsa koalicioni i LSDM-së përfshinte 15 parti. Në përgjithësi, gjithsej 53 subjekte politike janë regjistruar për të marrë pjesë në ato zgjedhje (OSBE 2011). Në zgjedhjet e vitit 2008, kishte edhe dy koalicione të mëdha të udhëhequra nga partitë etnike të Maqedonisë së Veriut, dy parti kryesore shqiptare dhe 16 parti të tjera politike. Në përgjithësi, 41 subjekte politike morën pjesë në zgjedhje (KQZ 2008). Në vitin 2006, në zgjedhje konkurruan 31 parti politike, koalicione dhe grupe votuesish (OSBE 2006). Numri i përgjithshëm i subjekteve të regjistruara në zgjedhje ishte 50 (Hislope 2013, fq. 614). Me një

mesatare prej 40 partish që paraqesin kandidatë në zgjedhjet kombëtare që nga zgjedhjet e para postkomuniste në 1990, Hislope e konsideron Maqedoninë e Veriut si një 'tryezë suedeze' e llojeve të partive (po aty, fq. 607).

Pjesa më e madhe e fragmentimit të partive në Maqedoninë e Veriut buron në parlament, pasi mosmarrëveshjet personale brenda partive parlamentare kanë çuar në krijimin e grupeve të reja partiake. Për shembull, mosmarrëveshjet e brendshme brenda VMRO-së kanë çuar në krijimin e dhjetë partive të ndara, me VMRO-në si prefiks të tyre, disa prej të cilave u bashkuan me VMRO-në në një datë të mëvonshme. Në mënyrë të ngjashme, Partia e Re Social Demokratike (NSDP) u nda nga LSDM në 2005, iu bashkua koalicionit VMRO-DPMNE në 2006, dhe më pas iu bashkua përsëri koalicionit SDSM në 2008. Për fundi, disa anëtarë të Partisë Demokratike të Shqiptarëve (PDSH) u larguan nga partia për të formuar Demokracinë e Re në 2008. Një numër i madh partish të vogla shpesh quhen 'parti të të famshmëve' të cilat shfaqen në skenën politike shpesh për të menaxhuar kandidaturën e politikanëve të shquar, por nuk arrijnë të fitojnë ndonjë bazë të fortë organizimi ose të fitojnë mbështetje të madhe popullore. Megjithatë, këto parti luajnë një rol të madh në natyrën e fragmentuar të sistemit partiak në Maqedoni të Veriut (Hislope 2013, fq. 612-3).

Për sa i përket ndërrimit të partive, Maqedonia e Veriut paraqitet mjaft stabile. Mes viteve 2006 dhe 2008 tre deputetë ndërruan parti dhe pesë deputetë u bënë të pavarur. Mes viteve 2008 dhe 2011 pesë deputetë, të gjithë nga PDSH, kaluan në partinë e sapoformuar Demokracia e Re (DR) dhe njëri prej tyre më vonë u bë i pavarur. Së fundi, mes viteve 2011 dhe 2014 asnjë deputet i vetëm nuk ndryshoi grup partiak. Në këtë aspekt Maqedonia e Veriut është gjithashtu më e qëndrueshme në krahasim me disa sisteme të tjera partiake si Brazili, për shembull, ku Desposate tregon se mbi një të tretën e deputetëve ndërrojnë parti, disa shpesh edhe shtatë herë (2006, fq. 63). Vlen të përmendet se para vitit 2004, Kodi Zgjedhor i Maqedonisë së Veriut parashikonte se deputetët që ndërronin partinë do të duhej të hiqnin dorë nga mandati i tyre partiak, dhe megjithëse kjo dispozitë në praktikë shpeshherë shpërfilllej, Gjykata Kushtetuese e anuloi atë (Gaber-Damjanovska dhe Jovevska 2006 cituar në Hislope 2013, fq. 612).

Sa i përket organizimit të partisë, Karasimeonov (2005) vëren se në përgjithësi ka mungesë demokracie dhe transparence në mënyrën si funksionojnë partitë në Maqedoninë e Veriut. Për më tepër, ekziston një tendencë e fortë që udhëheqësia e partisë të dominojë procesin e vendimmarrjes, duke lënë shumë pak hapësirë për diskutim në nivelet e ndryshme të organizimit të

partive (KAS pa datë, fq. 48). Dominimi i udhëheqësisë vërehet si në zgjedhjet brenda partisë ashtu edhe në metodat e përzgjedhjes së kandidatëve (Daskalovski et al 2012), dhe konsiderohet të jetë pengesa kryesore për demokratizimin e partive. Për më tepër, ndikimi i fortë i udhëheqësisë së partisë mbi politikën e partisë pengon aftësinë e partive për të përfaqësuar preferencat e zgjedhësve të tyre, dhe kjo e kufizon sjelljen e deputetëve në parlament, pasi deputetët rrallë mund të shkojnë kundër qëndrimit të partisë duke e ditur se prej kësaj mund të rezultojë marginalizimi dhe përjashtimi (KAS pa datë, fq. 13-4,48). Në përgjithësi, institucionalizimi i sistemit partiak në Maqedoninë e Veriut ngjan me atë të Kosovës dhe, siç u tregua në kapitullin 1, ata kanë pak a shumë të njëjtin nivel të ISP-së.

6.3 Sistemi zgjedhor dhe partiak

Sipas Kodit Zgjedhor të vendit, Maqedonia e Veriut përdor sistemin SP me listë të mbyllur për të zgjedhur 120 anëtarët e saj të Sobranie (Kuvendit), ndërsa 3 deputetë nga jashtë vendit, që përfaqësojnë Evropën dhe Afrikën, Amerikën Veriore dhe Jugore, si dhe Australinë dhe Azinë, zgjedhen me sistemin mazhoritar. Ky i fundit është rezultat i vendimit të vitit 2011 për ndryshimin e kodit zgjedhor të vitit 2006 pak para se të mbaheshin zgjedhjet e parakohshme të 2011-ës. Sipas sistemit proporcional, vendi është i ndarë në gjashtë zona me shumë anëtarë, të përbërë nga disa komuna që zgjedhin nga 20 deputetë secila. Kandidatët mund të kandidojnë në një njësi në një palë zgjedhje dhe në një njësi tjetër në një palë zgjedhje të tjera në varësi të popullaritetit të tyre në ato zona. Teksa nuk ka asnjë prag për të fituar përfaqësim, ekziston një kuotë prej 30 për qind për gratë (ose gjininë më pak të përfaqësuar) që siguron rritje të përfaqësimit të grave në parlament.

Sistemi zgjedhor në Maqedoni të Veriut ka pësuar disa ndryshime mes viteve 1990 dhe 2002, duke përfshirë një ndryshim nga mazhoritar, në sistem të përzier, dhe më pas në sistemin e përfaqësimit të pastër proporcional në vitin e fundit. Edhe pse Marrëveshja Kornizë e Ohrit, e cila i dha fund konfliktit etnik të vitit 2001 në Maqedoni të Veriut, nuk kishte sugjeruar në mënyrë specifike një ndryshim në sistemin zgjedhor (FES 2008), sistemi i përfaqësimit proporcional është miratuar kryesisht për të nxitur përfaqësimin e pakicave (MNVZ 2002). Duke marrë parasysh që maqedonasit përbëjnë 64 për qind të popullsisë, dhe si të tillë janë grupi më i madh etnik, sistemi proporcional ka rritur vërtet përfaqësimin e shqiptarëve që përbëjnë 25 për qind të popullsisë (shpesh përmendet si 30-35 për qind), si dhe atë të turqve dhe romëve që përbëjnë

përkatësisht 4 dhe 3 për qind.¹² Në fakt, ishin partitë shqiptare ato që kishin propozuar një sistem proporcional me një zonë zgjedhore mbarëkombëtare, e cila ata konsideronin se do të rriste numrin e deputetëve shqiptarë të përfaqësuar, ndërsa partitë e Maqedonisë së Veriut favorizuan ruajtjen e sistemit mazhoritar për zgjedhjen e disa ulëseve, përveç preferencës së tyre për zona më të vogla. Rezultati ishte një sistem proporcional me gjashtë zona zgjedhore shumë anëtarëshe (IEOM 2002).

Zgjedhjet e vitit 2011 rezultuan në një qeveri koalicioni ndërmjet koalicionit të Maqedonisë së Veriut të udhëhequr nga VMRO-DPMNE dhe partisë etnike shqiptare BDI. Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE mori 56 ulëse në parlament ndërsa BDI mori 15 (IPU Parline). Opozita përbëhej nga koalicioni i udhëhequr nga LSDM me 42 ulëse, PDSH me 8 ulëse dhe RDK (Rilindja Demokratike Kombëtare), gjithashtu parti shqiptare etnike, me dy ulëse. Qeveritë e koalicionit, që zakonisht përbëhen nga një shumicë etnike dhe një parti e pakicës shqiptare, janë normë sipas sistemit proporcional në Maqedoni të Veriut, dhe po ashtu ka pasur një tendencë që partitë më të mëdha të hyjnë në koalicione parazgjedhore me një numër partish më të vogla në mënyrë që të 'të fitojnë avantazh konkurrues ndaj kundërshtarëve të tyre' dhe/ose të jenë në gjendje të përmbushin kërkesat e shumicës së dyfishtë për miratimin e legjislacionit të caktuar (Hislope 2013, fq. 613). Deri diku, konkurrenca partiake është stabilizuar rreth dy blloqeve kryesore; ose partia e djathtë VMRO drejton qeverinë, ose blloku socialist i LSDM-së e bën këtë, por konkurrenca dhe përfaqësimi bazohen kryesisht në baza etnike, pasi partitë politike përfshijnë dhe përfaqësojnë votuesit në ato vija.

Duke qenë se partnerët kryesorë të koalicionit janë pothuajse gjithmonë nga dy bashkësi të ndryshme etnike, funksionimi i qeverisë nuk është një detyrë e lehtë. Për shembull, tensionet mes VMRO-së dhe BDI-së për një kandidat 'konsensual' për zgjedhjet presidenciale të 2014-ës e bënë BDI-në të dorëzonte mocionin e saj për shpërndarjen e parlamentit në fillim të marsit, si rezultat i të cilit zgjedhjet e parakohshme ishin caktuar për 27 prill. Për më tepër, marrëdhëniet qeveri-opozitë janë shpeshherë të tensionuara. Vlen të theksohet se opozita, përkatësisht LSDM, e bojkotoi parlamentin nga 24 dhjetori 2012; kur qeveria bëri presion për buxhetin e vitit 2013, atë LSDM e konsideroi 'jokushtetues' dhe u përjashtua nga parlamenti së bashku me një numër gazetarësh, deri më 1 mars 2013 kur u arrit një marrëveshje mes të

¹² Shih <http://www.minorityrights.org/?lid=4021>, qasur më 12 shtator, 2021.

dyve (EIU 2013). Kjo padyshim që ka pasur implikime për punën e parlamentit si dhe aktivitetet e deputetëve jashtë tij. Raporti i Progresit i Komisionit Evropian 2013, i cili vlerëson përparimin e vendit në përbushjen e kritereve të anëtarësimit në BE, deklaroi se megjithëse marrëveshja u arrit në mars, partitë kryesore të opozitës rrallë morën pjesë në seancat plenare deri në shtator të atij viti (KE 2013).

6.4 Gjetjet

Ngjashëm me Kosovën, intervistat me deputetë të Parlamentit të Maqedonisë së Veriut zbuluan mungesën e burimeve zgjedhore nga ana e ligjvënësve për të kryer aktivitete, edhe pse deputetët e Maqedonisë së Veriut, ndryshe nga ata kosovarë, ende përfitojnë nga projekti fillimisht i drejtuar nga NDI. Në përgjithësi, kryetarëve të grupeve parlamentare të partive dhe kryetarëve të komisioneve u jepet një zyrë brenda parlamentit, të cilën një numër prej tyre treguan se e përdorin edhe për t'u takuar me zgjedhësit e tyre gjatë kohës që janë në parlament, si dhe një asistent, apo edhe më shumë në rastin e kryetarëve të GP-ve. Deputetët tjerë gjithashtu kishin asistentë, por kishte vetëm një asistent për çdo pesë deputetë dhe ata ose mund të përdornin zyrën e GP-së ose të takoheshin me zgjedhësit e tyre diku tjetër.

Përveç kësaj, siç u tregua më lart, deputetët e Maqedonisë së Veriut gjithashtu kanë zyra në zonat e tyre lokale, të cilat u krijuan si pjesë e një projekti të drejtuar nga NDI që filloi në 2003.¹³ Në fazën fillestare të projektit, ishin hapur 46 zyra duke vendosur dy deputetë, normalisht, dhe një asistent në çdo zyrë. Kështu shumica e deputetëve përfituan nga projekti. Deri në vitin 2006 u hapën 19 zyra të tjera, dhe deri në vitin 2009 numri arriti në 75, duke i dhënë qasje një numri edhe më të madh të deputetëve në to. Këto zyra janë raportuar se ekzistonin ende, në kohën e mbledhjes së të dhënave, megjithëse nuk funksiononin mirë për një sërë arsyesh.¹⁴ Së pari, NDI ia dorëzoi projektin parlamentit në vitin 2012 dhe ky i fundit duket se kishte probleme me drejtimin e zyrave dhe pagesën e asistentëve. Së dyti, disa deputetëve nuk iu caktua asnjëherë një zyrë lokale. Madje, disa prej tyre treguan se asistentët paguhen që të rrinë në shtëpi, por se në mungesë të zyrës është e vështirë që njerëzit

13 Shënim: projekti u financua nga USAID (Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar) dhe CIDA (Agjencia Kanadeze për Zhvillim Ndërkombëtar), si dhe SDC (Bashkëpunimi Zviceran për Zhvillim) në një fazë të mëvonshme.

14 Intervistë personale me Gëzim Jasharin dhe Edip Bilallin nga Instituti Kombëtar Demokratik (NDI) 29 shkurt 2014.

të kontaktojnë me deputetët. Së treti, dhe ndoshta më e rëndësishmja, ndërkohë që ideja fillestare kishte qenë koordinimi me komunat lokale që ishin të gatshme të ofronin hapësira për zyra për qëllime zgjedhore, në vend të kësaj një numër deputetësh vendosën ta hapin zyrën e tyre brenda degës lokale të partisë, duke i dhënë një karakter politik. Andaj, qytetarët, përveç simpatizantëve të dukshëm partiakë, hezituan t'u drejtohen deputetëve.

Para prezantimit të gjetjeve të intervistave, është gjithashtu e rëndësishme të theksohet se ndryshe nga Kosova, intervistat nuk zbuluan asnjë manipulim të dukshëm të votave, ndoshta edhe sepse manipulimet brenda partisë nuk janë të mundshme pa vota preferenciale. Megjithatë, raporti i OSBE-së i 2011-ës për zgjedhjet parlamentare vë në dukje 'pretendimet reciproke për frikësimin e votuesve dhe keqpërdorimin e burimeve shtetërore kanë vazhduar'. Në të njëjtin raport thuhet gjithashtu se 'shumë pak ankesa zyrtare janë bërë në KSHZ (Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve) dhe asnjë në gjykata', por gjithashtu e lidh këtë me adresimin e pamjaftueshëm të procedurës ankimore në Kodin Zgjedhor dhe mungesën e besimit të qytetarëve në procedurat dhe organet e ankesave.¹⁵ Sigurisht që gjërat duket se janë përmirësuar me kalimin e viteve. Më parë, një raport i OSBE-së vë në dukje se dita e zgjedhjeve u shënuar nga dhuna e organizuar e cila 'ndërpreu votimin në shumë zona me shumicë shqiptare etnike, duke lënë një person të vdekur dhe disa të plagosur'. Për më tepër, kjo kontribuoi në një sërë parregullsish dhe rastesh të mashtrimit zgjedhor. Rezultati kumulativ i këtyre ngjarjeve ndikoi në lirinë e votuesve për të votuar pa frikësim, dhunë apo frikë nga hakmarrja' (OSBE 2008). Si rezultat, zgjedhjet duhej të përsëriteshin. Raporti i OSBE-së i vitit 2006 gjithashtu vë në dukje akuzat e partive për parregullsi të tilla si presioni ndaj votuesve, frikësimi dhe mashtrimi i mundshëm zgjedhor (OSBE 2006).

Siç është përshkruar tashmë në seksionin 3.2.1 më lart, gjithsej 49 deputetë të Maqedonisë së Veriut, që përfaqësojnë grupe të ndryshme etnike, janë intervistuar në shkurt 2014. Pyetjet që iu drejtuan deputetëve ishin të njëjta me ato të deputetëve kosovarë që shërbenin në SP me listë të mbyllur, dhe kryesisht të bazuara në sondazhin e PartiRep. Një nga pyetjet kryesore që iu drejtua deputetëve kishte të bënte me perceptimin e deputetëve për rizgjedhjen e tyre. Ne supozuam më herët se deputetët, duke qenë akterë racionalë, do t'i përqendrojnë burimet e tyre aty ku ata konsiderojnë se do të varet rizgjedhja e tyre, dhe për këtë i pyetëm nëse ata konsideronin se ia

¹⁵ Po aty.

detyronin rizgjedhjen e tyre kryesisht partisë, votuesve apo të dyjave. Shumica e tyre, 37, thanë se besonin se zgjedhja e tyre ishte rezultat i partisë dhe i votuesve. Një numër më i vogël, 7, thanë se zgjedhja e tyre ishte kryesisht për shkak të votuesve, ndërsa 5 deputetë thanë se kjo ishte kryesisht për shkak të partisë. Arsyeja kryesore që ofruan deputetët, veçanërisht ata nga partitë etnike maqedone, se pse mendojnë se rizgjedhja e tyre ishte për shkak të partisë dhe elektoratit, është se edhe pse partia merrte vendim për ta përfshirë dikë në listë, pozicioni ku vendosej kandidati ishte shumë i varur nga sondazhet parazgjedhore që partitë kryenin me votuesit. Në përgjigje të pyetjes, dy deputetë të LSDM-së theksuan:

“Partia bën sondazhe për të parë se kush është popullor në popull. Ata që janë popullorë arrijnë në pozicionet e larta në listë. Mund të ndodhë që një person që nuk është anëtar i partisë është gjithashtu shumë i popullarizuar, në këtë rast ne i detyrojmë ata të kandidojnë për ne në listën tonë të partisë. Kjo ka ndodhur shpesh sepse askush nuk kërkon që ata të kenë qenë anëtarë më parë” (Intervistë me deputet të Maqedonisë së Veriut, 5 shkurt 2014).

“Mendoj se janë të dyja, sepse siç thashë partia bën sondazhe... pra është e rëndësishme që të kesh një renditje të mirë në qytetin tënd” (Intervistë me deputet të Maqedonisë së Veriut, 6 shkurt 2014).

Në fakt, një deputet përmendi se vendimi që kandidatët të konkurrojnë në një zonë ose në një tjetër shpesh bazohet në popullaritetin e kandidatit në atë zonë. Citati i mëposhtëm e shpjegon (Intervistë me deputet të Maqedonisë së Veriut, 10 shkurt 2014)

“Kam qenë në zonën zgjedhore 6 në vitin 2006 dhe dy herë kam qenë në zonën zgjedhore 5”.

Kur e pyeta deputetin nëse mund të vendosin vetë se në cilën zonë do të kandidojnë, deputeti u përgjigj (Intervistë me deputet të Maqedonisë së Veriut, 10 shkurt 2014):

“Jo... sipas sondazheve”.

Një deputet tjetër nga e njëjta parti, kur u pyet për të përcaktuar nëse rizgjedhja e tij ishte kryesisht për shkak të partisë apo votuesve (Intervistë me deputet të Maqedonisë së Veriut, 5 shkurt 2014) u përgjigj kështu:

“Është pak e vështirë. Së pari, i detyrohesh partisë sepse të fut në listë dhe një vend më të lartë në listë ku fiton vërtet... Unë nuk isha, le të themi në një pozicion të sigurt, sepse sondazhet thoshin që ne do të kishim gjashtë deputetë [në zonë] dhe unë isha numri tetë... pra në thelb, mendoj se i detyrohem pak votuesve, sepse mendoj se puna gjatë fushatës dhe më parë bëri të mundur që unë të zgjedhem”.

Sigurisht, vendimi për të vendosur dikë në një pozicion të sigurt në listë duket se varet nga një sërë faktorësh, përveç të gëzuarit të një qëndrimi të mirë në sondazhe. Kjo përfshin të kesh një rang të lartë brenda hierarkisë së partisë, të jesh anëtar i përkushtuar i saj, të ruash mbështetjen e partisë lokale, të jesh besnik ndaj partisë dhe programit të saj, të kesh lidhje të mira me votuesit, të jesh folës i mirë, të jesh nga një qytet më i madh, të jesh aktiv në parlament e kështu me radhë. Megjithatë, fakti që shumica e deputetëve konsiderojnë se rizgjedhjen ia detyrojnë partisë dhe votuesve, mbi të gjitha shpjegohet me metodat e veçanta të përzgjedhjes së kandidatëve, sepse edhe pse vendimi përfundimtar për renditjen merret nga organet qendrore të partisë, ky vendim është ndikuar shumë nga popullariteti i secilit kandidat në mesin e votuesve.

Megjithatë, nuk ndodh kështu në të gjitha partitë. Për shembull, në mesin e partive shqiptare që nuk raportuan se bënë sondazhe për kandidatët individualë, shumica e deputetëve thanë se vendimi përfundimtar se kush përfshihet dhe ku do të vendosen kandidatët në listë, merret nga udhëheqësi. Në radhët e BDI-së, 56 për qind e deputetëve thanë se vendimi i takon udhëheqësit, 33 për qind thanë se i takon kryesisë, dhe 11 për qind thanë se ky i takon këshillit. Brenda PDSH-së, 60 për qind thanë se vendimin e merr udhëheqësi, ndërsa 40 për qind thanë se këtë e bën kryesia. Në mesin e partive të Maqedonisë së Veriut, duke pranuar rëndësinë e statusit të kandidatëve në mesin e elektoratit, të gjithë deputetët përmendën organet qendrore të partisë si ato që thonë fjalën e fundit për përzgjedhjen e kandidatëve. Brenda VMRO-së, shumica (82 për qind) thanë se vendimi përfundimtar është marrë nga komiteti qendror, i cili përbëhet nga rreth 120 persona,¹⁶ ndërsa 18 për

16 Anëtarët janë kryetari, nënkryetari, sekretari i përgjithshëm, kryetarët e komiteteve komunale, anëtarët e komitetit ekzekutiv etj. Shih statutin e partisë në http://vmro-dpmne.org.mk/?page_id=174.

qind thanë se kjo është bërë nga udhëheqësi. Në mesin e deputetëve të LSDM-së, 71 për qind e tyre thanë se vendimin përfundimtar e merr komiteti qendror, i cili përbëhet nga rreth 90 persona, ndërsa 29 për qind thanë se këtë e bën konferenca (këshilli i përgjithshëm) që përbëhet mesatarisht nga rreth 700 anëtarë¹⁷ dhe konsiderohet si një nga organet më të larta që mbledhet rregullisht para zgjedhjeve parlamentare dhe presidenciale.

Fakti që në mesin e partive etnike maqedone, votuesit mund të ndikojnë në shanset e kandidatëve për t'u vendosur lart në listë, reflektohet në fokusin e përfaqësimit të deputetëve. Kur deputetët u pyetën se cilat ishin rolet e tyre parësore dhe dytësore si deputetë, mes përfaqësimit të votuesve, përfaqësimit të partisë, apo punës me legjislacionin, shumica e tyre, nga të gjitha partitë, përmendën përfaqësimin e votuesve si rolin e tyre parësor, ndërsa një numër i barabartë përmendi përfaqësimin e partisë dhe punën me legjislacionin. Për sa i përket rolit dytësor, shumica e deputetëve deklaruan se ky ishte për të përfaqësuar partinë, një numër më i vogël thanë se ishte për të përfaqësuar votuesit dhe një numër akoma më i vogël përmendën që kanë të bëjnë me legjislacionin. Tabela 6-1 dhe 6.2 në vijim japin një përmbledhje të përgjigjeve.

Tabela 6-1 Rolet parësore të deputetëve

	Përfaqësimi i votuesve	Përfaqësimi i partisë	Kryerja e punëve parlamentare	N
Numri i deputetëve	29	10	10	49
% e deputetëve	59.2	20.4	20.4	100

Tabela 6-2 Kryerja e punëve parlamentare

	Përfaqësimi i votuesve	Përfaqësimi i partisë	Kryerja e punës parlamentare	N
Numri i deputetëve	14	25	10	49
% e deputetëve	28.6	51.0	20.4	100

17 Shënim: përfshin kryetarin, nënkryetarin, sekretarin e përgjithshëm, anëtarët e organeve të tjera të partisë, deputetët, ministrat dhe kryetarët e komunave. Për më shumë, shih statutin në http://www.sdsm.org.mk/upload/documents/STATUT%20SDSM_2013.pdf.

Për të pasur një pasqyrë më të afërt mbi fokusin e përfaqësimit, deputetëve iu kërkua të renditin nga 1-4 atë që u duket më e kënaqshme për sa i përket përfaqësimit, ndër sa vijon: përfaqësimi i votuesve të partisë, përfaqësimi i të gjithë njerëzve, përfaqësimi i grupeve të veçanta në shoqëri, dhe përfaqësimi i partisë. Siç tregon Tabela 6-3, shumica e deputetëve renditën përfaqësimin e të gjithë popullit të parin, përfaqësimin e votuesve të partisë të dytin, përfaqësimin e partisë të tretin, dhe përfaqësimin e grupeve specifike në vendin e katërt. Duhet të theksohet se, bazuar në përgjigjet e dhëna, koncepti i përfaqësimit të 'të gjithë popullit' është i ndryshëm në mesin e partive të ndryshme etnike, veçanërisht në komunitetet pakicë, të cilat kryesisht kanë lënë të kuptohet për përfaqësimin e grupit të tyre etnik. Edhe pse kjo nuk u shpreh në mesin e deputetëve të Maqedonisë së Veriut të cilët pretendonin se përfaqësonin të gjithë popullin, nga partitë etnike shqiptare, për shembull, ishte shumë e qartë se ata ishin të fokusuar kryesisht në përfaqësimin e interesave të komunitetit shqiptar. Sa i përket grupeve që deputetët pretenduan se përfaqësojnë, ato përfshijnë gratë, grupet LGBT (veçanërisht në mesin e deputetëve të LSDM-së), punëtorët, etj.

Tabela 6-3 Fokusi i përfaqësimit të deputetëve

	Renditur i pari %	Renditur i dyti %	Renditur i tretë %	Renditur i katërti %
Përfaqësimi i votuesve të partisë	10.2	49.0	26.5	14.4
Përfaqësimi i të gjithë popullit	67.3	8.2	14.3	10.2
Përfaqësimi i partisë	14.3	22.4	30.6	32.6
Përfaqësimi i grupeve specifike	8.2	20.4	28.6	42.8
Gjithsej	100	100	100	100
N = 49				

Mund të ketë disa shpjegime se përse deputetët priren të përfaqësojnë të gjithë popullin në fillim, por ne fokusohemi në dy të dukshme. Së pari, neni 2 (3) i Ligjit për Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut thotë: "Deputeti përfaqëson qytetarët dhe vendos brenda Kuvendit sipas bindjeve të veta". Arsyeja tjetër ka të bëjë si me sistemin zgjedhor, pasi votuesit votojnë për partitë dhe deputetët nuk e dinë se kush ka votuar për partinë, ashtu edhe me

metodat e përzgjedhjes së kandidatëve, ku sondazhet bëhen para zgjedhjeve apo edhe rregullisht nga disa parti. Për pjesën e parë të argumentit të fundit, një deputet vuri në dukje (Intervistë me deputet të Maqedonisë së Veriut, 25 shkurt 2014).

“Është shumë e vështirë të bësh dallimin mes një qytetari që ka votuar për partinë tënde dhe atij që nuk e ka votuar. Besoj në momentin që një deputet fillon mandatin e tij/saj, ai/ajo është përfaqësues jo vetëm i votuesve të tij/saj, por i gjithë popullit”.

Për pjesën e dytë të argumentit, një tjetër deputet deklaroi (Intervistë me deputet të Maqedonisë së Veriut, 18 shkurt 2014):

“Duhet të përfaqësosh të gjithë njerëzit, sepse në fund nuk mund ta marrësh me mend se kujt do t’i bëhet një pyetje ose do të jetë pjesë e ndonjë sondazhi për reputacionin tënd”.

Edhe pse deputetët duket se janë të fokusuar kryesisht në përfaqësimin e popullit përpara se të përfaqësojnë partinë apo edhe të merren me legjislacionin, kur atyre iu kërkua të zbërthenin kohën që kalonin duke punuar si deputet mes punës në zonat zgjedhore, punës në parti dhe punës për legjislacionin, siç tregon Tabela 6-4, shumica e deputetëve, ngjashëm me homologët e tyre në Kosovë, pohuan se pjesën më të madhe të kohës e kalojnë duke u marrë me legjislacionin. Një nga arsyet për këtë është se deputetët raportuan se ishin të mbingarkuar me detyra komisionesh, në fakt në një masë më të madhe se sa homologët e tyre në Kosovë. Domethënë, mesatarisht, një deputet i përkiste rreth pesë komisioneve qoftë si anëtar apo zëvendës anëtar, ku ky i fundit merrte pjesë në mbledhje vetëm nëse anëtari nuk mund të merrte pjesë ose merrte pjesë në një komision tjetër në atë kohë. Siç tregon tabela, sasia e kohës së raportuar që deputetët shpenzojnë për të bërë aktivitete në zonat zgjedhore është shumë më pak se koha që deputetët shpenzojnë duke u marrë me legjislacionin. Për më tepër, koha e shpenzuar për punë me elektoratin në zonat zgjedhore ndryshon në mënyrë thelbësore mes deputetëve. Rreth 50 për qind shpenzojnë më pak se 10 orë në javë, ndërsa vetëm rreth 16 për qind shpenzojnë më shumë se 15 orë në javë.

Për sa i përket punës në zonën zgjedhore, deputetët u pyetën gjithashtu se sa orë pune në muaj kanë shpenzuar në zonën e tyre zgjedhore (përfshirë në evente dhe takime publike), rezultatet e të cilave janë paraqitur në kolonën

e fundit të Tabelës 6-4. Megjithatë, para se të merremi me gjetjet, duhet të theksojmë se me njësi zgjedhore nënkuptojmë komunën. Për shembull, kryeqyteti i Maqedonisë së Veriut; Shkupi, është i ndarë në 10 komuna, prej të cilave deputetë vijnë nga zona zgjedhore. Për më tepër, vlen të theksohet se neni 36 (2) i Ligjit për Kuvendin thotë se “çdo e premtë do t’i kushtohet kontakteve të deputetëve me qytetarët në zonat zgjedhore” dhe deputetët dukej se e dinin mirë këtë dispozitë. Ditët e caktuara për shërbimin e zonave zgjedhore janë ato që gjejmë edhe në vendet e Evropës Perëndimore. Leston-Bandeira dhe Tiburcio theksojnë se Rregullorja e Punës Parlamentare në Portugali, në vitin 1993 vendosi ditë specifike për kontaktin me zonat zgjedhore (2012, fq. 390).

Tabela 6-4 Zbërthimi i punës së deputetëve

	Numri i orëve të punës në javë	% e shpenzuar duke kryer aktivitete në zonën zgjedhore në javë	% e shpenzuar duke bërë punë partie në javë	% e shpenzuar duke bërë punë legislative në javë	Numri i orëve të shpenzuara në zonën lokale në javë
Mesore	43.7	20.5	14.9	64.6	38.0
Mediane	45	9.8	5.0	30.0	40.0
DS	11.5	6.3	6.3	11.3	20.7
N = 49					

Megjithatë, shumica e deputetëve vunë në dukje se vështirë se mund të shkojnë në zonat e tyre lokale të premtëve, pasi seancat ose komisionet janë caktuar në atë ditë. Në vend të kësaj, ata zakonisht takoheshin me zgjedhësit gjatë fundjavave ose disa takoheshin me zgjedhësit e tyre kryesisht në parlament, ose kafene dhe vende të tjera jashtë tij. Andaj, edhe shpërndarja e orarit të punës që kalojnë deputetët në zonat e tyre zgjedhore ndryshon shumë. Ajo shkon nga 2.5 në 80 orë. Do të prisnim që deputetët nga Shkupi të shpenzojnë më shumë orë në zonën e tyre zgjedhore në muaj, kryesisht për shkak të afërsisë, por në fakt, ata shpenzojnë mesatarisht vetëm rreth 30.6 orë. Nga ana tjetër, ata nga qytetet e tjera shpenzojnë rreth 43.2. Ndoshta një nga shpjegimet për këtë është se deputetët nga Shkupi mund të mendojnë se nuk kanë nevojë të jenë aq të pranishëm në komunën e tyre, sepse zgjedhësit mund t’i takojnë lehtësisht edhe në parlament.

Në përpjekje për të koordinuar kohën që deputetët kalojnë në parlament në krahasim me jashtë tij, një deputet shpjegoi një iniciativë të dështuar nga ana e deputetëve (Intervistë me deputet të Maqedonisë së Veriut, 5 shkurt 2014):

“Ne e patëm një ide të mirë kur filloi mandati, që të kishte një lloj orari, kështu që jo të gjithë duhet të jenë të pranishëm në seancë plenare... le të themi se ramë dakord që njerëzit që janë në komisionet që trajtojnë ligjet që diskutohen në seancë plenare do qëndronin brenda dhe të tjerët do të bënin këtë lloj mbledhjesh me zgjedhësit, por për fat të keq nuk u zbatua kurrë. Funksionoi një javë ose dy javë dhe më pas të gjithë filluan të gjenin justifikime”.

Për më tepër, ata që pretendonin se kishin një zyrë lokale i pyeta nëse i trajtonin vetë kërkesat e zgjedhësve apo nëse pjesën më të madhe të punës e bën asistenti i tyre, i cili zakonisht punon me kohë të pjesshme. Shumica thanë se roli i asistentit ishte vetëm të caktonte takimet dhe të merrej me logjistikën, por kur të vinte puna për të takuar njerëzit, ata e bënin këtë vetë. Nga ana tjetër, ata që nuk kishin zyrë, pohuan se i vizitojnë edhe zonat e tyre zgjedhore, por kryesisht përmes organizimeve partiake. Dy deputetë u shprehën:

“Zakonisht shkoj në zonën time këtu në qendër të Shkupit ku jetoj, edhe në zona të tjera, por sipas rrjetit që organizon partia në ndonjë zonë që duhet të mbulohet nga sistemi i partisë” (Intervistë me deputet të Maqedonisë së Veriut, 10 shkurt 2014).

“Ne kemi, le të themi, aktivitete partiake në vizitat e lagjeve... këto janë aktivitete kolektive, jo se unë personalisht shkoj atje” (Intervistë me deputet të Maqedonisë së Veriut, 20 shkurt).

Për të zbuluar si i ruajnë deputetët lidhjet me zgjedhësit, deputetëve iu kërkua të tregonin se sa shpesh kryejnë secilin nga nëntë aktivitetet (siç përshkruhet në Kapitullin 5). Siç ilustron Tabela 6-5, shumica e deputetëve pohuan se kryejnë të paktën një nga aktivitetet të paktën një herë në javë. Kur merren parasysh të paktën dy aktivitete, rezultatet ndryshojnë pak, me 84 për qind që pohojnë se bëjnë të paktën dy nga aktivitetet të paktën një herë në javë, 2 për qind e bëjnë këtë të paktën një herë në çdo dy javë, 6 për qind e bëjnë këtë të paktën një herë në muaj, 2 për qind e bëjnë këtë të paktën një herë në tre muaj, dhe 6 për qind të tjerë thanë se mund të bënin dy nga këto aktivitete.

Tabela 6-5 Numri dhe përqindja e deputetëve që pohuan se kryejnë të paktën një nga aktivitetet në intervale të caktuara

	Të paktën një herë në javë	Të paktën dy herë në javë	Të paktën një herë në muaj	Të paktën një herë në tre muaj	Mund ta bëj	Nuk do ta bëja kurrë	N
Numri i deputetëve	45	3	1	0	0	0	49
% e deputetëve	91.8	6.1	2.1	0	0	0	100

Përveç aktiviteteve të përfshira në pyetje, deputetët përmendën edhe një sërë aktiviteteve të tjera. Më shpesh, ata përmendën të qenit rregullisht aktivë në Facebook, si p.sh. përgjigje ndaj mesazheve, bisedat me zgjedhësit, dhe madje publikimi i aktiviteteve të tyre atje. Në fakt, me shpalljen e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare, një deputet i VMRO-së përmendi faktin se kandidatëve u kërkohet nga partia që të hapin Fan Pages në Facebook, përveç llogarive të tyre individuale. Aktivitete të tjera, që deputetët përmendën se i bëjnë rregullisht përfshijnë lojën e futbollit ose basketbollit me zgjedhësit, shkuarjen në një dyqan bastesh, takimin me zgjedhësit në kafene/çajtove dhe restorante lokale, pritjen e njerëzve në shtëpitë e deputetëve, dhe sigurisht takimin me zgjedhësit në degët lokale të partisë. Unë vetë vizitova dy zyra lokale partiake, së bashku me deputetë të dy partive të ndryshme, por në kohën kur po zhvillohej fushata jozyrtare për zgjedhjet e ardhshme, veç mbledhjeve partiake nuk bëhej fjalë për tjetër gjë.

Duke qenë se dalja në media (si lokale ashtu edhe kombëtare, pasi jo të gjitha qytetet kanë media lokale) u përfshi në aktivitetet që bëjnë rregullisht deputetët, vlen të theksohet se për sa i përket qasjes në media, disa prej deputetëve të opozitës pohuan se media, sidomos ato kombëtare, janë ose të orientuara pro-qeverisë ose të kontrolluara prej saj. Si të tillë, ata pohuan se vështirë se e kanë mundësinë të paraqiten në to, përveç paraqitjes në kanalën parlamentar që transmeton të gjitha seancat dhe mbledhjet e komisioneve siç ndodhin. Ndoshta kjo është arsyeja pse rrjetet sociale duket se janë kaq të përhapura mes deputetëve si një mjet komunikimi me publikun. Përgjigja e mëposhtme e një deputeti të LSDM-së ilustron vështirësinë e qasjes në media (Intervistë me deputet, 13 shkurt 2014):

“Jo...nuk dal në media sepse jam pjesë e opozitës... mediat janë pro-qeveritare dhe nuk i lënë hapësirë opozitës. Për shembull, për mua... për 2-3 sekonda që jam shfaqur në media, më kërkohet të paguaj

1500 euro. Prandaj e vetmja mënyrë për ta kapërcyer këtë pengesë është të kem kontakte të drejtpërdrejta me njerëzit, dhe madje të përditshme”.

Një deputet tjetër, nga një parti tjetër opozitare, deklaroi (Intervistë me deputet të Maqedonisë së Veriut, 12 shkurt 2014).

“Ata hezitojnë të na ftojnë sepse jemi parti opozitare”.

Përgjigja ishte shpesh e njëjtë kur deputetët u pyetën nëse do të bënin publicitet për suksesin e tyre në tërheqjen e biznesit dhe marrjen e granteve qeveritare për zonën zgjedhore, për çka ata pretenduan se është e pamundur të marrësh ndonjëherë ndonjë gjë nga qeveria për zonën e tyre zgjedhore. Një deputet vuri në dukje (Intervistë me deputet të Maqedonisë së Veriut, 11 shkurt 2014):

“Unë flas për Shkupin... nuk është e mundur që të kem para nga qeveria për të promovuar projektin tim. Nuk mundet... unë jam opozitë e fortë”.

Një deputet tjetër nga e njëjta parti vuri në dukje (Intervistë me deputet të Maqedonisë së Veriut, 20 shkurt 2014):

“Jo... jo... nuk kemi shumë shanse ta bëjmë këtë, sepse jemi në opozitë të thellë”.

Tabela 6-6 Numri dhe përqindja e deputetëve që pohuan se takohen me të paktën një grup në intervale të caktuara

	Të paktën një herë në javë	Të paktën një herë në muaj	Të paktën një herë në tre muaj	Të paktën një herë në vit	Asnjë kontakt	N
Numri i deputetëve	35	13	1	0	0	49
% e deputetëve	71.4	26.5	2.1	0	0	100

Deputetët u pyetën edhe se sa shpesh takoheshin me grupe të ndryshme, si organizata biznesi, gra, pakica e kështu me radhë, siç u përshkrua në kapitullin e mëparshëm. Siç tregon Tabela 6-6, shumica e deputetëve deklaruan se

takohen me të paktën një nga ato grupe të paktën një herë në javë, pasuar nga përqindja më e madhe e tyre që thanë se takohen me të paktën një grup të paktën një herë në muaj. Asnjë deputet nuk përmendi se nuk është takuar të paktën me një grup brenda një intervali tre mujor. Tabela 6-7 tregon llojin e grupeve me të cilat takohen më shpesh deputetët e Maqedonisë së Veriut. Ngjashëm me homologët e tyre kosovarë, shumica e deputetëve të Maqedonisë së Veriut priren të takohen më shpesh me organizata rinore dhe gazetarë. Kjo përqindje është shumë më e madhe se ata deputetë që pretenduan se takohen me lloje të tjera organizatash.

Tabela 6-7 Kontaktet e deputetëve me organizata të ndryshme

	%
Organizatrat rinore	77.6
Organizatrat e të moshuarve	36.7
Organizatrat e punëtorëve	36.7
Organizatrat e punëdhënësve	26.5
Organizatrat e grave	48.9
Organizatrat e fermerëve	44.9
Organizatrat e pakicave etnike	34.7
Organizatrat fetare	28.6
Organizatrat mjedisore	30.6
Gazetarë	75.5

Shënim: Deputetët që pohuan se kishin kontakt të paktën një herë në javë ose një herë në muaj

Një pyetje tjetër që iu bë deputetëve për të vlerësuar lidhjet e tyre me zgjedhësit ishte *'Sa kërkesa për ndihmë (letra, e-mail, telefonata, vizita) në marrëdhëniet me autoritetet publike merrni mesatarisht në një javë? Dhe sa pyetje nga qytetarë individualë që lidhen kryesisht me çështjet e politikave merrni në javë?'*, dhe më pas u pyetën edhe sa orë kanë kaluar duke u marrë me kërkesat e llojit të parë. Numri i kërkesave që marrin deputetët në javë ndryshon shumë, nga 1 deri në 1000, siç raportohet në Tabelën 6-8.

Tabela 6-8 Numri i kërkesave për ndihmë që marrin deputetët mesatarisht në javë

	Kërkesat që kanë të bëjnë me autoritetet publike	Kërkesat që kanë të bëjnë me çështjet e politikave	Kërkesa totale	Koha e shpenzuar për kërkesat që kanë të bëjnë me autoritetet publike në javë
Mesore	83.5	3.4	86.0	7.6
Mediane	21	1	25	5
N = 49				

Duhet theksuar se lloji i kërkesave që deputetët i kanë përmendur më shpesh kanë qenë të lidhura me vende pune, të ngjashme me atë që kemi gjetur në rastin e Kosovës. Pothuajse çdo deputet përmendi marrjen e kërkesave të tilla në baza të rregullta nga individët që kërkojnë punësim në sektorin publik, si dhe pohuan se mbi 90 për qind e kërkesave që marrin kanë të bëjnë me vende pune. Deputetët përmendën edhe marrjen e kërkesave që kanë të bëjnë me problemet sociale dhe shëndetësore, dhënien e lejeve të ndërtimit, subvencionet bujqësore, infrastrukturën, si dhe kërkesat direkte për para. Deputetët theksuan gjithashtu se këto kërkesa prirën të jenë më të mëdha për partitë qeveritare, e vërtetuar edhe nga gjetjet tona, pasi nga elektorati perceptohet se mund të ndikojnë në vendime të tilla në masë më të madhe sesa deputetët e partive opozitare. Deputetët e opozitës pohuan se e vetmja herë që mund të bëjnë diçka në lidhje me kërkesat është kur, për shembull, kryetari i komunës, në zonën zgjedhore nga vjen deputeti, i përket partisë së tij/saj. Sigurisht, edhe deputetët e partive në pushtet e pranuan se gjetja e punës për të gjithë është e vështirë, por megjithatë deputetët shpesh do t'i ndihmojnë zgjedhësit e tyre të gjejnë një punë në sektorin publik. Citati i mëposhtëm e ilustron këtë (Intervistë me deputet të Maqedonisë së Veriut, 7 shkurt 2014):

“Unë i motivoj për shembull studentët të vijnë për praktikë... disa prej tyre u interesuan dhe unë sapo i thirra kur kishim një thirrje të hapur për asistentë në grupin parlamentar ... ata u bënë asistentë ...sigurisht që aplikuan... por e arritën”.

Më pas deputeti shtoi (Intervistë me deputet të Maqedonisë së Veriut, 7 shkurt 2014):

“...nëse nuk e arrijnë, atëherë kemi iniciativa vetëpunësimi ku marrin grante nga shteti prej rreth 3,500 eurosh për hapjen e një biznesi privat”.

Megjithëse shumica e kërkesave kanë të bëjnë me vende pune, shumica e deputetëve thanë se ndihen mjaft mirë kur votuesit i kontaktojnë dhe e konsiderojnë mjaft të rëndësishme trajtimin e këtyre kërkesave. Edhe në rastin kur nuk mund të bëjnë shumë, deputetët pohuan se është e rëndësishme të takohen me zgjedhësit për t'u treguar se si është situata dhe për të shpjeguar pse nuk mund të bëhet asgjë. Gjithsesi, për të kuptuar se përse deputetët merren me këto kërkesa nga zgjedhësit, i pyetëm se çfarë mendonin se do të ndodhte nëse nuk do t'i ndihmonin njerëzit për ato kërkesa (pyetja siç u bë në sondazhin e PartiRep) duke zgjedhur mes: a. humbja e një numri të konsiderueshëm votash në zgjedhjet e ardhshme, b. vështirësi në procesin e përzgjedhjes së kandidatëve, dhe c. humbja e kontaktit me problemet me të cilat njerëzit përballen në jetën e tyre të përditshme. Siç tregon tabela në vijim, shumica e tyre e pranuan se arsyeja kryesore për trajtimin e kërkesave është rizgjedhja. Siç raportohet në Tabelën 6-9, mbi 70 për qind e deputetëve ose u pajtuan ose u pajtuan fuqimisht se do të humbnin një numër të konsiderueshëm votash nëse nuk do të merreshin me këto kërkesa. Në mënyrë të ngjashme, rreth 70 për qind pohuan se do të përballëshin me një sfidë serioze në procedurën e përzgjedhjes së kandidatëve si rezultat, dhe më në fund mbi 80 për qind thanë se trajtimi i kërkesave ishte i rëndësishëm për të mbajtur kontakt me problemet me të cilat përballëshin votuesit në jetën e tyre të përditshme.

Tabela 6-9 Përgjigjet e deputetëve se çfarë do të ndodhte nëse do të reduktonin përpjekjet e tyre për t'iu përgjigjur kërkesave të elektoratit

	Nuk pajtohem aspak	Nuk pajtohem	Asnjëra	Pajtohem	Pajtohem plotësisht	Gjithsej
Do të humbisja një numër të konsiderueshëm votash	3 / 6.2%	6 / 12.5%	2 / 4.2%	16 / 33.3%	21 / 43.8%	48 / 100%
Si rezultat, mund të përballem me një sfidë serioze në përzgjedhjen e kandidatëve	0 / 0%	10 / 20.8%	4 / 8.3%	25 / 52.1%	9 / 18.8%	48 / 100%
Si rezultat, do të humbisja kontaktin me problemet me të cilat votuesit përballen në jetën e tyre të përditshme	0 / 0%	4 / 8.3%	4 / 8.3%	19 / 39.6%	21 / 43.8%	48 / 100%

Pra, si mund ta shpjegojmë gjithë këtë variacion në lidhje me aktivitetet e deputetëve? Ngjashëm me rastin e Kosovës, meqenëse ndryshorët e varur janë të dhëna numërimi, p.sh. numri i orëve të shpenzuara në javë duke u marrë me punë të zonave zgjedhore, edhe këtu përdoret një regresion binomial negativ. Tabela 6-10 përmbledh statistikat përshkruese të ndryshorëve të varur dhe të pavarur.

Tabela 6-10 Statistikat përshkruese (Maqedonia e Veriut)

	Min	Mediane	Mesore	Max	Devijimi standard
Orët e punës së deputetëve	15.00	45.00	44.17	65.00	5.55
Orët e punës në aktivitete me elektoratin në zonën zgjedhore	0.00	5.00	10.00	9.51	5.55
Orë pune rreth partisë	0.00	5.00	6.66	25.00	6.26
Orë pune parlamentare	6.00	30.00	28.53	54.00	8.60
Numri i kërkesave që kanë të bëjnë me autoritetet publike në javë	0.00	22.00	86.53	100.00	11.97
Orët e shpenzuara për kërkesat që kanë të bëjnë me autoritetet publike në javë	0.00	5.00	7.90	25.00	6.11
Numri i orëve në muaj të shpenzuara në zonën lokale	2.50	40.00	38.84	80.00	20.78

Tabela 6-11 paraqet rezultatet e analizave të regresionit binomial negativ në katër nga ndryshorët e varur: 1) numri i orëve që shpenzojnë në javë deputetët duke bërë aktivitete me elektoratin në zonën zgjedhore, 2) numri i kërkesave që marrin mesatarisht në javë që kanë të bëjnë me autoritetet publike, 3) numri i orëve që shpenzojnë në javë duke u marrë me ato kërkesa, dhe 4) numri i orëve që kalojnë në zonën e tyre lokale në muaj. Duke parë kolonën e parë, asnjë nga ndryshorët nuk është domethënës përveç ndryshorit të mandatit që është domethënës në nivelin 0.01. Interpretimi i koeficientëve të eksponenciar, tregon se ata që janë në mandatin aktual të dytë ose të treti, shpenzojnë rreth 2 orë më shumë në lidhjet me zonat zgjedhore në krahasim me ata që janë në mandatin e parë. Kolona jonë e dytë tregon se ndryshori i partisë dhe ai i moshës së re janë domethënës në nivelin 0.001 dhe nivelin 0.05 respektivisht. Domethënë, anëtarët e VMRO-së priren të marrin rreth 10 kërkesa më shumë në javë në krahasim me anëtarët e PDSH-së. Po kështu, deputetët më të rinj (nën 40 vjeç) priren të marrin rreth 3 kërkesa më pak në krahasim me deputetët më të vjetër. Kolona e tretë tregon se ndryshorët e partisë janë domethënës, por jo të tjerët. Deputetët e VMRO-së kanë prirje të shpenzojnë rreth 3 orë më shumë në javë për t'u marrë me këto kërkesa në krahasim me anëtarët e PDSH-së. Ky ndryshor është domethënës në nivelin 0.01. Gjithashtu, anëtarët e LSDM-së kanë prirje të shpenzojnë rreth 2.5 orë më shumë se deputetët e PDSH-së. Kolona e fundit tregon se asnjë nga ndryshorët nuk është domethënës.

Tabela 6-11: Regresioni binomial negativ për: (1) Numrin e orëve të shpenzuara duke bërë aktivitete me elektoratin në javë, (2) Numrin e kërkesave të pranuar në javë, (3) Orët e shpenzuara për ato kërkesa në javë, dhe (4) Numrin e orëve të shpenzuara në zonën lokale në muaj.

	(1)	(2)	(3)	(4)
(konstantja)	1.93***	2.93***	1.34**	3.40***
	(0.33)	(0.68)	(0.43)	(0.31)
BDI	-0.26	1.34.	0.49	0.14
	(0.37)	(0.76)	(0.47)	(0.35)
SDSM	-0.05	1.36.	0.89*	0.29
	(0.34)	(0.70)	(0.44)	(0.32)
VMRO	0.08	2.32***	1.18**	0.26
	(0.33)	(0.69)	(0.43)	(0.31)
Meshkuj	0.10	0.10	-0.10	0.06
	(0.19)	(0.39)	(0.23)	(0.18)
Të rinj	0.03	-1.02*	-0.09	0.08
	(0.20)	(0.42)	(0.23)	(0.19)
Mandati i 2-të	0.63**	-0.04	-0.23	-0.08
	(0.19)	(0.33)	(0.22)	(0.19)
Log-gjasat	-290.01	-479.95	-230.32	-418.29
N	47	47	40	47

Nivelet e domethënies: ‘p-vlera 0.1, *p-vlera 0.05, **p-vlera 0.01, ***p-vlera 0.001.

Përderisa analizat e mëparshme treguan se deputetët e Maqedonisë së Veriut piren të zhvillojnë lidhje të ngushta me zgjedhësit e tyre, pasi u thelluan në aktivitetet e ndryshme që kryejnë deputetët, pjesa e fundit fokusohet në sjelljen e votimit të deputetëve. Për të vlerësuar shkallën në të cilën deputetët e Maqedonisë së Veriut janë të konflikt mes ndjekjes së vijës së partisë apo asaj vetanake, unë u bëra atyre pyetjen vijuese të sondazhit PartiRep ‘*Si duhet, sipas jush, të votojë një deputet në një situatë ku partia ka një opinion për një çështje për t’u votuar në Parlament, dhe ju personalisht keni një opinion tjetër?*’ Kjo ishte një nga pyetjet që deputetët e kishin më të vështirë t’i përgjigjen me arsyetimin se më shpesh nuk ka raste të tilla ku ai/a jo ka opinion të ndryshëm nga ai i partisë. Megjithatë, shumica e deputetëve, siç tregon Tabela 6-12, pranuan se nëse do të krijohej një situatë e tillë do të duhej të ndiqnin vijën e partisë. Ata që pohuan se kanë votuar kundër vijës partiake të paktën një herë, përmendën legjislacionin, si ligji për gjykatat, administratën, arsimin, duhanin, bujqësinë, tatimet, privatizimin, mjedisin dhe mediat. Vetëm rreth dy deputetë nuk kanë pranuar të përmendin rastet kur kanë votuar kundër vijës partiake. Mirëpo,

edhe ata deputetë që asnjëherë nuk kanë votuar kundër vijës partiake, thanë se ka pasur raste kur nuk mund të pajtohen me qëndrimin e partisë, por në vend që të votojnë kundër, kanë vendosur të abstenojnë ose të mos votojnë fare.

Tabela 6-12 Pikëpamjet e deputetëve se si duhet votuar

	Deputeti/ja duhet të votojë sipas opinionit të vet	Deputeti/ja duhet të votojë sipas opinionit të partisë së vet	Deputetët që pohuan se kanë votuar kundër vijës partiake të paktën një here
Numri i deputetëve	18	31	17
% e deputetëve	36.7	63.6	34.7
N = 49			

Disa deputetë e kishin mjaft të qartë se cilën vijë të ndiqnin. Një deputet vuri në dukje (Intervistë me deputet të Maqedonisë së Veriut, 06 shkurt 2014):

“Unë nuk jam deputet i pavarur, jam deputet partiak... është detyra ime morale të mbështes qëndrimin e partisë sime të cilës i përkas”.

Një deputet tjetër vuri në dukje (Intervistë me deputet të Maqedonisë së Veriut, 7 shkurt 2014):

“Ndonjëherë ka një vendim politik, kështu që pavarësisht nëse na pëlqen ligji apo jo, ne duhet ta mbështesim... duhet të jemi të ndershëm”.

Përderisa kjo sjellje nga ana e deputetëve është në kundërshtim me nenin 2(3) të Ligjit për Kuvendin, i cili përcakton se deputeti “...do të vendosë brenda Kuvendit sipas bindjeve të tij/saj”, megjithatë është në pajtim me qëndrimet formale të partive për këtë. Në vlerësimin e demokracisë së brendshme mes partive të Maqedonisë së Veriut, një raport i Konrad Adenauer Stiftung thotë se anëtarët e LSDM-së kanë shumë pak hapësirë për manovrim, pasi ‘Bordi Qendror vlerëson punën e grupit parlamentar dhe jep sugjerime në lidhje me çështjet në debatin parlamentar (neni 77)’ (KAS pa datë, fq. 20). Brenda VMRO-së, raporti argumenton se deputetët në teori kanë të drejtë të votojnë kundër vijës partiake, por në praktikë kjo ndodh rrallë. Në fakt, një deputet i VMRO-së përmendi se i gjithë legjislacioni që kalon në parlament diskutohet

thellësisht edhe brenda partisë. Në mesin e partive shqiptare, statutet e tyre parashikojnë se është detyrë e grupit parlamentar të partisë të koordinojë aktivitetet e anëtarëve të tij dhe të sigurohet që ato të jenë në përputhje me statutin dhe programin e partisë (po aty).

6.5 Krahasimi i sjelljes së deputetëve të Maqedonisë së Veriut me atë të homologëve të tyre kosovarë

Deri më tani kemi shpjeguar natyrën dhe shtrirjen e lidhjeve me zonat zgjedhore që krijojnë deputetët e Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut, si dhe kemi ofruar një pasqyrë të aktiviteteve të ndryshme që kryejnë deputetët për të mbajtur kontakte me votuesit. Për më tepër, duke përdorur regresione binomiale negative, ne testuam efektin e disa ndryshorëve të pavarur në shtrirjen e lidhjeve me zgjedhësit në të dy vendet. Në këtë pjesë, ne krahasojmë sjelljen e deputetëve kosovarë me atë të deputetëve të Maqedonisë së Veriut. Ne jemi veçanërisht të interesuar të shpjegojmë nëse sjellja e deputetëve të Maqedonisë së Veriut ngjan me atë të deputetëve kosovarë në SP me lista të mbyllura ose me lista të hapura, apo nëse deputetët kosovarë kanë më shumë të përbashkëta me njëri-tjetrin për sa i përket sjelljes së tyre, sesa me deputetët e Maqedonisë së Veriut duke parë rolet parësore të deputetëve, fokusin e tyre të përfaqësimit, caktimin e kohës për aktivitete të ndryshme, dhe shtrirjen e lidhjeve me zgjedhësit.

Për sa i përket roleve parësore të deputetëve, është e ngjashme përqindja e deputetëve në SP në lista të hapura dhe të mbyllura në Kosovë të cilët pohuan se roli i tyre parësor ishte të përfaqësonin votuesit. Ne raportuam në kapitullin 5 se ndryshimi në proporcione mes të dyve nuk është statistikisht domethënës. Megjithatë, një përqindje pak më e madhe e deputetëve në Maqedoni të Veriut raportuan se roli i tyre parësor ishte të përfaqësonin votuesit, siç mund të shihet në Tabelën 6-13. As diferenca në përmasa ndërmjet secilit grup të deputetëve të Kosovës dhe deputetëve të Maqedonisë së Veriut nuk është statistikisht domethënëse (vlerat- $p=0.17$ dhe 0.20 respektivisht). Megjithatë, vetëm kjo nuk na jep të kuptojmë nëse sjellja e deputetëve është e ngjashme apo e ndryshme në të dy vendet dhe sistemet zgjedhore. Siç u përmend në kapitujt përkatës, deputetët mund ta shohin përfaqësimin e votuesve si një nga rolet e tyre më të rëndësishme për sa i përket përfaqësimit të opinionëve dhe interesave të tyre të gjera, por kjo nuk shfaqet domosdoshmërisht në lidhje më të forta me zgjedhësit.

Tabela 6-13 Roli parësor i deputetëve të Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut

	Kosovë		Maqedoni e Veriut
	SP me listë të hapur	SP me listë të mbyllur	SP me listë të mbyllur
Përfaqësimi i votuesve	45.0	42.1	59.2
Përfaqësimi i partisë	5.0	21.1	20.4
Kryerja e punëve parlamentare	50.0	36.8	20.4
Gjithsej	100.0	100.0	100.0
N	40	19	49

Deputetët e Kosovës dhe të Maqedonisë së Veriut janë përgjithësisht të ngjashëm kur bëhet fjalë për fokusin e tyre të përfaqësimit. Siç tregon Tabela 6-14, numri më i madh i deputetëve si në Kosovë, sipas dy sistemeve, ashtu edhe në Maqedoni të Veriut në SP me listë të mbyllur, thanë se fokusi i tyre kryesor ishte të përfaqësonin të gjithë popullin. Testet e diferencës në përmasa mes tre grupeve tregojnë se asnjë nga ndryshimet nuk është domethënëse. Në Kosovë, thamë se arsyeja kryesore pas kësaj është ekzistenca e një zone zgjedhore mbarëkombëtare në të cilën zgjedhen deputetët. Në një zonë zgjedhore mbarëkombëtare, deputetët duket se kanë një fokus të gjerë përfaqësimi, sepse mbështetja e tyre zgjedhore vjen nga i gjithë vendi. Në Maqedoninë e Veriut, nga ana tjetër, edhe pse deputetët zgjedhen në gjashtë njësi zgjedhore me shumë anëtare, përveç faktit që rregullorja parlamentare përcakton se deputetët përfaqësojnë të gjithë popullin, deputetët janë të vetëdijshëm se opinioni i votuesve ka rëndësi për udhëheqjen e partisë kur kjo e fundit harton listën e kandidatëve. Sa më i mirë të jetë reputacioni i kandidatëve në mesin e votuesve, aq më lart në listë vendosen ata kandidatë. Natyrisht, duhet pranuar se opsioni i ‘përfaqësimit të të gjithë popullit’ ndoshta ka më shumë konotacione pozitive sesa, le të themi, ‘përfaqësimi i partisë’, i cili mund të duket një rol më partiak dhe më pak me frymë publike, kështu që nuk duhet t’i marrim të gjitha këto përgjigjeve si të mirëqena. Megjithatë, mund të shohim se ka variacion mes deputetëve në përgjigjet që kanë dhënë dhe, përveç kësaj, në intervista shumë deputetë kanë dhënë një shpjegim më të nuancuar të asaj që kanë parasysh kur flasin për ‘përfaqësimin e të gjithë popullit’.

Tabela 6-14 Fokusi i përfaqësimit të deputetëve të Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut

	Kosovë		Maqedoni e Veriut
	SP me listë të hapur (%)	SP me listë të mbyllur (%)	SP me listë të mbyllur (%)
Përfaqësimi i votuesve të vet	12.5		
Përfaqësimi i votuesve të partisë	7.5	10.5	10.2
Përfaqësimi i të gjithë popullit	67.5	73.7	67.3
Përfaqësimi i partisë	5.0	15.8	14.3
Përfaqësimi i grupeve specifike	7.5	0.0	8.2
Gjithsej	100.0	100.0	100.0
N	40	19	49

Megjithatë, kur bëhet fjalë për ndarjen e kohës së deputetëve si parlamentarë, vërejmë disa dallime. Duke parë Tabelën 6-15, përshtypja jonë e parë është se në përgjithësi, shumica e deputetëve në të tri kolonat shpenzojnë përqindjen më të madhe të kohës duke bërë punë legislative, në krahasim me punë me zgjedhësit dhe për partinë. Një test i diferencës në përmasa vërtet tregon se diferencat nuk janë statistikisht domethënëse për secilën kategori (vlerat-p = 0.19 dhe 0.30 respektivisht). Koha e madhe që deputetët shpenzojnë duke u marrë me punën parlamentare mund të lidhet me ngarkesën e madhe legislative ndaj të cilës janë të ekspozuar deputetët në të dy vendet. Në Maqedoni të Veriut, deputetët janë pjesë e disa komisioneve dhe seancat parlamentare zhvillohen shumë shpesh, duke përfshirë edhe të premtën, të cilat në teori janë të destinuara për punë në zonën zgjedhore. Në Kosovë, nga ana tjetër, ligjvënësit duhej të miratonin një sasi të madhe legjislacioni si rezultat i shpalljes së pavarësisë së vendit në vitin 2008. Për më tepër, deputetët në të dy vendet konsiderojnë se kalimi i pjesës më të madhe të kohës së tyre parlamentare duke u marrë me legjislacionin nuk do të thotë domosdoshmërisht se neglizhohen interesat e zonave zgjedhore, sepse përmes legjislacionit deputetët sigurohen që të përfaqësohen interesat e zonave zgjedhore. Së fundi, puna parlamentare përfshin edhe detyra të tjera si puna e komisioneve dhe mbikëqyrja e qeverisë, të cilat përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të punës së ligjvënësve, dhe të cilat ligjvënësit e kishin të vështirë t'i dallonin.

Tabela 6-15 Zbërthimi i punës së deputetëve të Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut

	Kosovë		Maqedoni e Veriut
	SP me listë të hapur	SP me listë të mbyllur	SP me listë të mbyllur
Numri i orëve të punës	35.8	27.7	43.7
% e shpenzuar për kryerjen e punëve rreth elektoratit	24.6	18.8	20.5
% e shpenzuar për punë partiake	18.6	18.0	14.9
% e shpenzuar për punë parlamentare	55.8	57.9	64.6
Gjithsej	100.0	100.0	100.0
N	40	19	49

Megjithatë, një ndryshim në testin e mesoreve për orët e punës tregon se deputetët e Maqedonisë së Veriut punojnë, mesatarisht, më shumë orë në javë si deputetë në krahasim me kolegët e tyre kosovarë në SP me listë të mbyllur (p -vlera=0.09), por jo në krahasim me ata në SP me listë të hapur (p -vlera=0.91). Dallimi tjetër statistikiqst domethënës që vërejmë lidhet me sasinë e kohës, jashtë orarit të punës, që deputetët kalojnë në javë duke bërë punë për zonën zgjedhore. Deputetët e Maqedonisë së Veriut shpenzojnë më shumë orë në javë nga koha e tyre parlamentare duke bërë punë për zonën zgjedhore në krahasim me homologët e tyre kosovarë në SP me listë të mbyllur (p -vlera=0.03), por ata shpenzojnë më pak se ata në SP me listë të hapur (p -vlera=0.03). Në përgjithësi, pra, mund të shohim se për sa i përket roleve parësore të deputetëve dhe fokusit të tyre të përfaqësimit, ligjvënësit e Maqedonisë së Veriut janë shumë të ngjashëm me homologët e tyre kosovarë si në sistemet proporcinoale me lista të hapura ashtu edhe në ato të mbyllura. Megjithatë, kur bëhet fjalë për numrin e orëve të punës dhe sasinë e kohës që deputetët e Maqedonisë së Veriut shpenzojnë duke bërë punë në zonën zgjedhore, ata janë më të ngjashëm me deputetët kosovarë në listën e hapur sesa ata në SP me listë të mbyllur. Ky është përgjithësisht modeli që marrim kur shikojmë shtrirjen e lidhjeve me zgjedhësit përgjatë katër ndryshorëve tanë të varur, siç tregohet në Tabelën 6-16.

Pas raportimit të dallimeve domethënëse mes deputetëve kosovarë në SP me lista të hapura dhe të mbyllura në Kapitullin 5, numri mesatar i orëve që shpenzojnë në javë deputetët në Maqedoninë e Veriut duke bërë aktivitete me elektoratin në zonën zgjedhore është më i madh në krahasim me numrin e orëve që shpenzonin deputetët e Kosovës në SP me listë të mbyllur (p -vlera=0.01), por nuk janë dukshëm të ndryshme nga ato në SP me listë të hapur (p -vlera=0.97). Për sa i përket numrit të kërkesave që kanë të bëjnë

me autoritetet publike që ligjvënësit marrin në javë, siç tregohet në tabelë, numri është shumë më i madh për deputetët e Maqedonisë së Veriut, dhe ato e tejkalojnë numrin e kërkesave që kanë marrë deputetët kosovarë në SP me listë të hapur (p-vlera=0.003) dhe SP me listë të mbyllur (p-vlera= 0.003). Diferenca e madhe në numrin e kërkesave të tilla të marra nga deputetët në Maqedoni të Veriut në krahasim me ata në Kosovë është dukshëm për shkak të faktorëve specifikë të vendit që janë jashtë fushëveprimit të këtij libri. Deputetët e Maqedonisë së Veriut gjithashtu shpenzojnë më shumë orë në javë duke u marrë me ato kërkesa në krahasim me deputetët kosovarë në SP me listë të hapur (p-vlera=0.004), por nuk u kushtojnë më shumë kohë atyre sesa deputetët në SP me listë të mbyllur (p-vlera=0.75). Së fundi, për sa i përket orëve të shpenzuara në zonën lokale në muaj, as dallimi mes deputetëve të Maqedonisë së Veriut dhe deputetëve kosovarë në SP me listë të hapur (p-vlera=0.52), as ai i deputetëve të Maqedonisë së Veriut dhe deputetëve kosovarë në SP me listë të mbyllur, nuk është statistikiisht domethënës (p-vlera=0.40).

Tabela 6-16 Deputetët e Kosovës kundrejt atyre të Maqedonisë së Veriut përgjatë katër ndryshorëve të varur

	Numri i orëve në aktivitete me elektoratin në javë	Numri i kërkesave që kanë të bëjnë me autoritetet publike në javë	Numri i orëve të shpenzuara për trajtimin e kërkesave në javë	Numri i orëve në zonën lokale në muaj	N
SP me listë të hapur (Kosovë)	9.17	9.33	4.50	42.28	40
SP me listë të mbyllur (Kosovë)	5.49	8.63	3.41	29.61	19
SP me listë të mbyllur (Maqedonia e Veriut)	9.22	83.49	7.58	38.01	49

Për ta përmbledhur, deputetët kosovarë në të dy sistemet tregojnë një sjellje të ngjashme me homologët e tyre të Maqedonisë së Veriut në SP me listë të mbyllur kur bëhet fjalë për rolet parësore dhe fokusin e përfaqësimit të deputetëve. Por, duke gjykuar sjelljen e deputetëve në kuptimin e katër ndryshorëve tanë të varur, mund të shohim se deputetët e Maqedonisë së Veriut u ngjajnë më shumë, apo edhe performojnë më mirë se homologët e tyre kosovarë në SP me listë të hapur. Këtë ngjashmëri në sjellje nga ana e deputetëve të Maqedonisë së Veriut ia atribuojmë kryesisht mënyrës së përzgjedhjes së kandidatëve atje. Edhe pse në të dyja vendet përzgjedhja e

kandidatëve është e centralizuar, në kuptimin që vendimi përfundimtar për vendosjen e kandidatëve varet nga organet qendrore të partisë, fakti që në Maqedoni të Veriut ky vendim për pozitën e kandidatëve ndikohet nga sondazhet e opinionit publik, i shtyn deputetët të zhvillojnë lidhje më të mëdha me zgjedhësit. Prandaj, sipas metodave të tilla të përzgjedhjes së kandidatëve, deputetët e Maqedonisë së Veriut të zgjedhur sipas SP me lista të mbyllura kanë më shumë stimuj për t'i kushtuar vëmendje lidhjeve me zgjedhësit sesa homologët e tyre në Kosovë të zgjedhur si në SP me listë të mbyllur ashtu edhe me metoda të centralizuara të përzgjedhjes së kandidatëve.

6.6 Diskutim

Ky kapitull ka synuar të shqyrtojë shkallën në të cilën deputetët e Maqedonisë së Veriut, nën sistemin SP me listë të mbyllur, krijojnë lidhje të ngushta me zgjedhësit e tyre. Në përgjithësi, përgjigjet zbuluan natyrën e dobët të institucionalizimit të sistemit partiak, edhe pse jo në të njëjtën masë si në rastin e Kosovës, ku pengesa kryesore për stabilitetin e sistemit partiak ishte abuzimi me votat preferenciale. Anëtarët e Parlamentit të Maqedonisë së Veriut gjithashtu gëzojnë më shumë burime sesa homologët e tyre në Kosovë, duke përfituar nga i njëjti projekt i NDI-së që nuk ishte aq i suksesshëm në Kosovë. Duke qenë se zyrat lokale tashmë janë transferuar nën kompetencat parlamentare, duket e paqartë nëse deputetët do të vazhdojnë me të njëjtin intensitet në bërjen e aktiviteteve me elektoratin. Për më tepër, një numër i madh deputetësh nga partitë opozitare përmendën qasjen selektive në media, e cila duket një mënyrë e rëndësishme për të ruajtur vizibilitetin dhe komunikimin me publikun.

Rezultatet e intervistave me 49 deputetë treguan se, në përgjithësi, deputetët e Maqedonisë së Veriut konsiderojnë se rizgjedhja e tyre varet njësoj nga partia dhe nga elektorati. Për më tepër, dhe ngjashëm me rastin e Kosovës, roli parësor i deputetëve të Maqedonisë së Veriut është të përfaqësojnë votuesit, në kundërshtim me atë që sugjeronte hipoteza 10, edhe pse kur bëhet fjalë për ndarjen e kohës, një përqindje më e madhe shpenzohet për të kryer punë parlamentare sesa për të bërë ndonjë detyrë tjetër. Në këtë kuptim, si deputetët e Maqedonisë së Veriut ashtu edhe ata të Kosovës janë më të fokusuar në zhvillimin e punëve parlamentare sesa në përfaqësimin e interesave të zgjedhësve. Po ashtu, sikurse në Kosovë, fokusi i përfaqësimit në mesin e deputetëve të Maqedonisë së Veriut është shumë i gjerë. Shumica

e deputetëve përmendën se përfaqësonin të gjithë popullin në fillim, përsëri në kundërshtim me parashikimet tona (H.12). Një shpjegim përse deputetët mendojnë se duhet të jenë të vëmendshëm ndaj qytetarëve është sepse partitë kryejnë sondazhe të rregullta të opinionit përpara se t'i vendosin kandidatët në listë. Ruajtja e një reputacioni të mirë në mesin e qytetarëve është pra thelbësore për të siguruar një pozicion kyç në listën për zgjedhjet e ardhshme. Njëkohësisht, deputetët duhet të jenë të vëmendshëm ndaj udhëheqësisë së partisë, sepse ajo ka fjalën e fundit për përzgjedhjen e kandidatëve. Efekti partiak ishte veçanërisht i fortë, kur deputetët u pyetën se kë do të ndiqnin në rast të përplasjes së opinionit të partisë dhe atij të votuesve (H11), pasi shumica e deputetëve u shprehën se do të ndiqnin partinë.

Duke testuar efektin e partisë, moshës, gjinisë dhe mandatit në lidhjet me zonat zgjedhore, ne treguam se vetëm disa prej këtyre ndryshorëve kishin një ndikim domethënës. Së pari, deputetët që po kryenin mandatin e tyre të dytë ose të tretë shpenzonin më shumë kohë duke bërë punë zgjedhore sesa ata që kryenin mandatin e tyre të parë. Anëtarët e VMRO-së, në një masë më të madhe, si dhe ata të BDI-së dhe LSDM-së, kanë pasur prirje të pranojnë më shumë kërkesa dhe të shpenzojnë më shumë kohë në javë duke u marrë me ato kërkesa në krahasim me anëtarët e PDSH-së. Për sa i përket orëve të kaluara në aktivitete me elektoratin, deputetët e kryeqytetit, megjithatë, çuditërisht nuk shpenzojnë më shumë kohë në krahasim me të tjerët që jetojnë më larg. Një nga shpjegimet për këtë është se deputetët nga Shkupi mund të kontaktohen lehtësisht në parlament nga zgjedhësit e tyre.

Kur krahasojmë sjelljen e deputetëve të Maqedonisë së Veriut me atë të deputetëve të Kosovës në të dy sistemet, thamë se ka ngjashmëri sa i përket roleve parësore dhe fokusit të përfaqësimit. Megjithatë, kur është fjala për shtrirjen e lidhjeve me zgjedhësit, ne treguam se sjellja e deputetëve të Maqedonisë së Veriut është më e ngjashme, madje edhe më e mirë se sjellja e deputetëve kosovarë në SP me listë të hapur. Ne ia atribuam këtë lloj sjelljeje natyrës së përzgjedhjes së kandidatëve, ku vendimi i partisë se ku do të vendosen kandidatët në listë ndikohet nga popullariteti i këtij të fundit në mesin e votuesve. Prandaj, studimi ynë na ka mundësuar të kuptojmë se edhe një kombinim i një sistemi me lista të mbyllura dhe një metode të centralizuar të përzgjedhjes së kandidatëve mund të krijojë stimuj zgjedhorë për deputetët për të krijuar popullaritet mes votuesve, pavarësisht nëse kjo bëhet përmes lidhjeve me zgjedhësit apo ndonjë metode tjetër. Megjithatë, pa kryer intervistat nuk do të kishim mundur të tregonim se vetëm sistemi zgjedhor nuk mjafton për ta shpjeguar sjelljen e deputetëve.

7

Konkluzion

Ky libër kishte si qëllim të eksploronte ndikimin e sistemeve zgjedhore në sjelljen e deputetëve në dy dimensione, unitetin e Grupit Parlamentar të Partisë (GP) dhe shtrirjen e lidhjeve me zgjedhësit që krijojnë deputetët. Marrë parasysh se është konstatuar se sistemet zgjedhore kanë pak ndikim në mënyrën se si sillen deputetët në vendet e Evropës Perëndimore, ndoshta për shkak të natyrës shumë të institucionalizuar të sistemit partiak, ose për arsye të tjera, dukej premtues shqyrtimi i ndikimit të sistemeve zgjedhore mes sistemeve partiake me institucionalizim të dobët. Mbi të gjitha, siç argumenton Moser, nuk mund të ketë siguri se gjetjet mes demokracive të konsoliduara zbatohen lehtësisht në demokracitë e reja, duke ditur se këto vende funksionojnë brenda një konteksti krejtësisht të ndryshëm të zhvillimeve politike dhe sociale (1999a, fq. 360). Në të vërtetë, gjetjet nga analizat tona sugjerojnë se edhe pse efektet e sistemit zgjedhor nuk janë aq të forta sa parashikoheshin, ato janë të kushtëzuara nga niveli i institucionalizimit të sistemit partiak.

Marrë parasysh që literatura aktuale konstaton se deputetët në vendet e Evropës Perëndimore votojnë njëloj me grupet e tyre parlamentare dhe krijojnë lidhje të ngushta me zgjedhësit e tyre pavarësisht nga rregullat zgjedhore, ne përvijojmë disa arsye përse i konsideruam efektet e sistemeve zgjedhore si më të mëdha në sistemet partiake me institucionalizim të dobët në krahasim me ato me institucionalizim të lartë. Së pari, konkurrenca partiake është fluide në vendet me ISP të dobët. Në këto vende, partitë shfaqen dhe zhduken shpejt, gjë që e vështirëson identifikimin e votuesve me një parti të caktuar. Së dyti, partitë kanë rrënjë të dobëta në shoqëri dhe si të tilla baza e marrëdhënieve janë lidhjet personale mes elektoratit dhe përfaqësuesve të tyre, në vend të elektoratit dhe partive. Së treti, partive u mungon legjitimiteti, pasi qytetarët shpesh nuk i konsiderojnë si organizata të nevojshme për

funksionimin demokratik (Mainwaring dhe Torcal 2005). Së fundi, partitë shihen nga akterët politikë si organizata të dobëta. Duke qenë se partia nuk perceptohet si e vlefshme për ligjvënësit, partia nuk mund ta kërcënojë bindshëm deputetin se do t'ia heqë përfitimet zgjedhore nëse ligjvënësi e cenon unitetin e partisë (Tavits 2011, fq. 410).

Prandaj, pritsshmëria jonë teorike ishte që uniteti i GP-së në përgjithësi do të ishte më i lartë në sistemet zgjedhore me partinë në qendër, siç është SP me lista të mbyllura, dhe do të ishte më i ulët në sistemet zgjedhore me kandidatin në qendër, si SP me listë të hapur (H.1). Megjithatë, rezultatet sugjeruan se kjo nuk ndodh domosdoshmërisht. Gjithashtu, parashikuam që efekti i sistemit zgjedhor të kushtëzohej nga niveli i ISP-së; domethënë, efekte të tilla të sistemit zgjedhor do të vëreheshin vetëm në sistemet partiake me institucionalizim të dobët (H.1.a). Duke testuar ndikimin e sistemeve zgjedhore në unitetin e GP-së duke përdorur disa mijëra rezultate të votimeve nga 21 vende evropiane, zbuluam se niveli i kohezionit ishte pak më i ulët mes vendeve të EJK-së, megjithëse ky ndryshim nuk ishte statistikisht domethënë. Kur modelit tonë i shtuam efektet e ndërveprimit ndërmjet sistemeve zgjedhore dhe nivelit të ISP-së, rezultatet treguan se institucionalizimi i sistemit partiak ka më shumë rëndësi sesa sistemi zgjedhor. Kështu, kur niveli i ISP ishte i ulët, efektet e SP me lista të hapura dhe SP me lista të mbyllura, edhe pse jo të llojeve të tjera të sistemit zgjedhor, ishin siç ishin parashikuar.

Ndër hipotezat e tjera, ne zbuluam se uniteti i GP-së ishte më i lartë për partitë qeveritare sesa për partitë opozitare (H.4). Për më tepër, sa më i vogël të jetë hendeku mes partive në qeveri dhe atyre në opozitë, aq më i lartë ishte niveli i unitetit të GP (H.5). Nga ana tjetër, ne nuk gjetëm se kohezioni ishte më i ulët me rritjen e madhësisë së zonës zgjedhore (H.6), ose se kohezioni ishte më i lartë për partitë më të vjetra krahasuar me partitë më të reja (H.7). Analiza jonë e çështjeve për të cilat votuan ligjvënësit në Kosovë dhe Maqedoni të Veriut tregoi se niveli i unitetit ishte i lartë ndërmjet çështjeve, pavarësisht se sa të rëndësishme ishin apo jo çështjet për mbijetesën e qeverisë (H.2). Po kështu, modeli i kohezionit nuk ishte konsistent ndërmjet partive. Disa parti treguan nivelet më të larta të kohezionit për disa çështje, ndërsa të tjerat ishin më kohezive për çështje të tjera.

Nga ana tjetër, ndikimi i sistemeve zgjedhore në lidhjet me zonat zgjedhore u testua duke përdorur intervista me deputetë nga dy sisteme partiake me institucionalizim të dobët, përkatësisht Kosova dhe Maqedonia e Veriut. Shembulli i Kosovës paraqiti një rast të mirë për të testuar efekte të tilla, pasi ndryshimi i sistemit zgjedhor nga SP me listë të mbyllur në SP me listë të hapur na lejoi të krahasojmë sjelljen e deputetëve me kalimin e kohës. Rasti

i Maqedonisë së Veriut, nga ana tjetër, ishte mjaft i krahasueshëm me atë të Kosovës, si vend fqinj, edhe pse sjellja e deputetëve u hetua vetëm nën sistemin proporcional me listë të mbyllur, në të cilin deputetët mund të dukej se kishin pak stimuj për të krijuar lidhje të ngushta me zgjedhësit e tyre. Të dy studimet zbuluan gjetje interesante që sugjerojnë se si sistemet zgjedhore ashtu edhe metodat e përzgjedhjes së kandidatëve ndikojnë në sasinë e lidhjeve me zgjedhësit që krijojnë deputetët.

Në përgjithësi, hipoteza 8 u konfirmua në rastin e Kosovës, por jo në atë të Maqedonisë së Veriut. Kurse akti që kandidatët në të gjitha sistemet në të dy vendet zgjedheshin përmes metodave të centralizuara të përzgjedhjes së kandidatëve, na e bëri të pamundur testimin e ndikimit të rregullave të përzgjedhjes së kandidatëve në sjelljen e tyre (H.9).

Në Kosovë, deputetët e zgjedhur sipas sistemit proporcional me lista të hapura u zbulua se zhvillonin lidhje më të ngushta sesa kolegët e tyre në sistemin proporcional me listë të mbyllur. Mesatarisht, deputetët në sistemin e mëparshëm shpenzonin më shumë orë në javë, jashtë kohës së tyre parlamentare, duke u marrë me aktivitete me elektoratin, merrnin një numër më të madh kërkesash në javë, shpenzonin më shumë kohë në javë duke u marrë me ato kërkesa, dhe shpenzonin më shumë kohë në muaj në zonën e tyre lokale sesa ata në sistemin e fundit. Sa i përket Maqedonisë së Veriut, shkalla në të cilën deputetët zhvillojnë lidhje të ngushta me zgjedhësit e tyre ishte mjaft e krahasueshme me sasinë e lidhjeve me zgjedhësit që zhvilluan deputetët kosovarë në SP me listë të hapur. Shpjegimi kryesor për këtë, argumentuam, janë metodat e përzgjedhjes së kandidatëve atje, të paktën për partitë etnike të Maqedonisë së Veriut, ku udhëheqja e partisë merr parasysh popullaritetin e kandidatëve në mesin e votuesve para se ta hartojë listën zgjedhore.

Duke krahasuar sjelljen e deputetëve kosovarë me ata të Maqedonisë së Veriut, treguam se kishte ngjashmëri sa i përket roleve parësore dhe fokusit të përfaqësimit. Shumica e deputetëve në të dy vendet pohuan se roli i tyre parësor ishte të përfaqësonin votuesit, duke e mohuar hipotezën tonë 10, e cila pretendonte se deputetët në sistemet zgjedhore të orientuara kah kandidatët do të kishin më shumë gjasa ta shohin veten si përfaqësues të elektoratit sesa ata të zgjedhur në sisteme zgjedhore me SP me lista të mbyllura. Për më tepër, numri më i madh i deputetëve në të dy vendet thanë se fokusi i tyre kryesor i përfaqësimit ishte 'i gjithë populli'. Në rastin e Kosovës, thamë se kjo ishte kryesisht rezultat i ekzistencës së një zone zgjedhore mbarëkombëtare, në të cilën mbështetja zgjedhore e deputetëve vjen nga

i gjithë vendi. Megjithatë, në Maqedoni të Veriut, ku deputetët zgjedhen në gjashtë zona zgjedhore me shumë anëtare, ne ia atribuam këtë metodave të përzgjedhjes së kandidatëve. Prandaj, hipoteza 11 u konfirmua vetëm pjesërisht. Tabela 7-1 liston të gjitha hipotezat e përshkruara në libër, si dhe efektet e tyre të pritshme dhe të vëzhguara, si në unitetin e GP-së ashtu edhe në shtrirjen e lidhjeve me elektoratin. Hipotezat 10 dhe 11 janë lënë jashtë tabelës, sepse ato lidhen me rolet përfaqësuese dhe fokusin e përfaqësimit dhe jo me lidhjet me zgjedhësit në vetvete.

Tabela 7-1 Marrëdhëniet e pritshme dhe të vëzhguara të ndryshorëve të pavarur mbi unitetin e GP-së dhe lidhjet me zgjedhësit

Hipotezat	Ndryshorët e pavarur (NP)	Marrëdhënia e pritshme	Marrëdhënia e vëzhguar
		Uniteti i GP	
H.1	Sistem zgjedhor i orientuar kah kandidati	-	Refuzuar
	Sistem zgjedhor i orientuar kah partia	+	
H.1.a	Sistem zgjedhor i orientuar kah kandidati * ISP	-	Pjesërisht e konfirmuar
	Sistem zgjedhor i orientuar kah partia * ISP	+	
H.2	Çështje të rëndësishme për mbijetesën e qeverisë	-	Refuzuar
	Çështje jo të rëndësishme për mbijetesën e qeverisë	+	
H.3	Përmasa më e madhe e zonës zgjedhore	-	Refuzuar
	Përmasa më e vogël e zonës zgjedhore	+	
H.4	Partitë qeveritare	+	I konfirmuar
	Partitë opozitare	-	
H.5	Marzh i gjerë i qeverisë ndaj opozitës	-	I konfirmuar
	Marzh i vogël i qeverisë ndaj opozitës	+	
H.6	Partitë e vogla	+	Refuzuar
	Partitë e mëdha	-	
H.7	Partitë e vjetra	+	Refuzuar
	Partitë e reja	-	
Lidhjet me elektoratin			
H.8	SP me lista te hapura	+	Pjesërisht e konfirmuar
	SP me lista të mbyllura	-	
H.9	Metoda të centralizuara të përzgjedhjes së kandidatëve	-	Refuzuar
	Metoda të decentralizuara të përzgjedhjes së kandidatëve	+	

7.1 Implikimet

